



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 78

Tiranë – E martë, 25 maj 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 20.5.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2020.....	8325
Rezolutë e Kuvendit datë 20.5.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2020.....	8326
Dekret i Presidentit nr. 13069, datë 19.5.2021	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8327
Dekret i Presidentit nr. 13070, datë 19.5.2021	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8328
Dekret i Presidentit nr. 13076, datë 20.5.2021	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8328
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021	Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.....	8329
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 288, datë 19.5.2021	Për miratimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, për trajnimin dhe bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë ushtarake.....	8392
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 295, datë 19.5.2021	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i spitalit rajonal ‘Memorial’ në Fier”.....	8398
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 296, datë 19.5.2021	Për përcaktimin e flamurit, stemës, uniformës, si dhe ngjyrës e shenjave në mjetet e Policisë së Burgjeve.....	8399
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 297, datë 19.5.2021	Për miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist.....	8403

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 298, datë 19.5.2021	Për miratimin e projektit pilot “Për masat për nxitjen e të nxëniet, të vijueshmërisë dhe përparimit të nxënësve të shkollës 9-vjeçare ‘Naim Frashëri’ Korçë, për vitin shkollor 2021–2022”.....	8408
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 301, datë 19.5.2021	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të pronës së paluajtshme, me sipërfaqe prej 10 000 m ² , e llojit truall, ndodhur në zonën kadastrale 8561, me numër pasurie 1/911, në pronësi të Bashkisë Korçë.....	8409
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 10, datë 17.5.2021	Për regjistrimin dhe mbështetjen në institucionet arsimore parauniversitare publike të fëmijëve të personave në situatë migrimi/azili, refugjatë, të fëmijëve të huaj të pashoqëruar, të fëmijëve që kthehen nga emigracioni, nga zonat e konfliktit apo fëmijë, viktima të trafikimit, në Republikën e Shqipërisë.....	8411
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 20, datë 20.4.2021	Me objekt shfuqizimin e neneve 34, pika 2, shkronja “gj”, dhe 38, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimin e nenit 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	8413
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 104, datë 22.4.2021	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 27, datë 29.1.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Ageta’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC ‘Borie – Lurë 1’ me kapacitet të instaluar 1800 kw”.....	8438
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 105, datë 22.4.2021	Mbi kërkesën e shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., për rinovimin e licencës nr. 343, seria F16, për furnizimin e energjisë elektrike.....	8439
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 106, datë 22.4.2021	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 241, datë 21.12.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘HEC Zall Xhuxhë’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Xhuxhë 1’, me kapacitet të instaluar 3487 kw, dhe HEC ‘Xhuxhë 2’, me kapacitet të instaluar 1254 kw, dhe me kapacitet total të instaluar 4741 kw”.....	8441
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 107, datë 22.4.2021	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 21.12.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘HEC Zall Xhuxhë’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.....	8442
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 108, datë 22.4.2021	Mbi miratimin e “Rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë, në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”.....	8443
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 109, datë 22.4.2021	Mbi kërkesën e OSSH sh.a., lidhur me vendimin e ERE-s nr. 60, datë 25.2.2021.....	8445
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Mentor Horjeti.....	8446

**REZOLUTË****PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
AUTORITETIT TË KONKURRENCËS
PËR VITIN 2020****Kuvendi i Shqipërisë:**

- Duke vlerësuar rolin e Autoritetit të Konkurrencës në sigurimin e një konkurrence të lirë dhe efektive në treg, në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar;

- Duke njohur bashkëpunimin e këtij Autoriteti me institucionet qendrore e ato rregullatore për aktet që mund të prekin funksionimin e konkurrencës në tregje;

- Duke konsideruar se mirëfunksionimi i tregjeve kërkon gjithëpërfshirjen e aktorëve dhe faktorëve të tregut për t'i bërë ata konkurrues dhe sa më të hapur, me synim mirëqenien e konsumatorit,

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2020, në drejtim të:

- Angazhimit maksimal të Komisionit të Konkurrencës për zhvillimin normal të veprimtarisë së institucionit, edhe pse në kushtet e vështira të krijuara si pasojë e pandemisë *Covid-19*, i cili është pasqyruar në miratimin e një numri total prej 87 vendimesh;

- Monitorimit të vazhdueshëm së bashku me institucionet e tjera mbikëqyrëse të përqendrimeve të autorizuar gjatë vitit 2019 në dy nga tregjet me ndikim të drejtpërdrejtë në interesat dhe mirëqenien e konsumatorëve, si: tregu i telefonisë celulare dhe tregu financiar, me qëllim vlerësimin e efekteve që do të sillte në treg ndryshimi i kontrollit të shoqërive përkatëse;

- Përfundimit të procedurave hetimore në 5 tregjet që janë hetuar gjatë vitit 2019, për të cilat ka pasur dyshime të arsyeshme ose janë konstatuar raste të marrëveshjeve të ndaluara ose abuzim me pozitën dominuese, si: tregu i shërbimeve bankare, tregu i veprimtarive ekonomike, që zhvillohen nga Federata Shqiptare e Futbollit, tregu i importit të grurit dhe prodhimit të miellit, tregu i prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, tregu i depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, si dhe përfundimi i hetimit të përgjithshëm në sektorin e arsimit të lartë, shoqëruar me detyrimet dhe rekomandimet përkatëse për IAL-të publike dhe

private, rekomandimet e dhëna MASR-së dhe INSTAT-it;

- Rritjes së numrit të hetimeve në tregjet tradicionale, si dhe nisjen e hetimeve në tregjet e reja shumë sensitive për publikun e gjerë, siç është tregu për shitjen me shumicë dhe pakicë të materialeve paramjekësore, kërkesa e të cilave është rritur ndjeshëm si pasojë e pandemisë;

- Përafrimit të mëtejshëm të kuadrit rregullator të konkurrencës me direktivat e BE-së, duke hartuar dhe miratuar gjatë vitit 2020 katër akte nënligjore në formën e udhëzuesit, ku ndër më kryesorit është miratimi i direktivës së Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, ECN+ “Për fuqizimin e Autoritetit të Konkurrencës për të qenë sa më i efektshëm në zbatueshmërinë e ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, ‘Për mbrojtjen e konkurrencës’, të ndryshuar, dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut”, e cila jep sigurinë se Autoriteti i Konkurrencës ka të gjitha mjetet e duhura për zbatimin e ligjit të konkurrencës, duke ofruar garanci dhe standarde në veprimtarinë e tij, si dhe aktet e tjera që do të vijnë në ndihmë të ndërmarrjeve, konsumatorëve dhe publikut në tërësi, për sa u takon çështjeve që lidhen me konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike, me praktikën më të mira për kryerjen e procedurave për zbatimin e dispozitave ligjore për marrëveshjet e ndaluara dhe abuzimin me pozitën dominuese në treg apo edhe implementimin e rregullave të konkurrencës, që lidhen me konfidencialitetin dhe aksesin në dosjet e Komisionit;

- Dhënies së kontributit për Kuvendin dhe institucionet e tjera, për sa i takon vlerësimit ligjor të akteve ligjore dhe nënligjore, ku për vitin 2020 Autoriteti ka vlerësuar në total 37 akte, nga të cilat 3 projektligje, 4 projektakte normative, 24 akte nënligjore në tregun e energjisë, 4 akte nënligjore në sektorin e furnizimit me ujë dhe përpunimit të ujërave të ndotura, si dhe Dokumentin Strategjik dhe Planin e Veprimtimit të AMA-s;

- Trajnimit të vazhdueshëm të stafit të realizuar në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar nëpërmjet projekteve të BERZH-it dhe IPA-s, duke bërë të mundur zhvillimin e 12 trajnimeve brenda vendit dhe 10 trajnimeve jashtë, si dhe një pjesëmarrje aktive në organizmat ndërkombëtarë, si: UNCTAD, OECD/RCC, ICN, etj.;



- Përmirësimi ndërmjet vite të përpjekjeve të institucionit në drejtim të advokacisë përkundrejt shumë palëve në treg, si: konsumatorët, komuniteti i biznesit dhe institucionet shtetërore, ku konkretisht gjatë vitit 2020 është hartuar dhe miratuar në bashkëpunim me projektin e asistencës teknike të dhënë nga BERZH-i dokumenti “Advokacia e konkurrencës dhe strategjia e komunikimit”; realizimi në datën 5 dhjetor i “Ditës Kombëtare të Konkurrencës” dhe nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

- Ndjekjes së 3 proceseve gjyqësore gjatë vitit 2020, ku Autoriteti rezulton të jetë i paditur nga ndërmarrjet për të cilat me vendimmarrje të Komisionit është konstatuar abuzimi me pozitën dominuese dhe për të cilat gjykata administrative e shkallës së parë i ka dhënë të drejtë Autoritetit;

- Dhënies së rekomandimeve konkrete për entet rregullatore dhe institucionet e administratës qendrore, si dhe pasurimin e Platformës Parlamentare Online me këto rekomandime duke përditësuar statusin e tyre në vazhdimësi.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2021 të angazhohet në këto drejtime:

- Të vazhdojë monitorimet, hetimet dhe analizat në tregjet sensitive dhe me ndikim të drejtpërdrejtë për mirëqenien e konsumatorit, por edhe në tregjet e tjera referuar praktikave të ngjashme të vendeve të BE-së, si tregu i medias audiovizive, shërbimet portuale dhe sektori i ekonomisë digjitale;

- Brenda vitit 2021 të paraqesë në Kuvend për amendim ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar;

- Të zgjerojë më tej ndërhyrjen në procesin ligjvënës duke mos u fokusuar në vlerësimin e projektit të një propozimi të ri ligjor, por edhe në vlerësimin e legjislacionit ekzistues, me qëllim evidentimin e pasojave të padëshirueshme që mund të ketë pasur një ligj, duke harmonizuar këtë ndërhyrje në nivel kombëtar dhe vendor;

- Të jetë aktiv dhe i përfshirë në advokacinë e reformave që promovojnë konkurrencën në procedurat e prokurimit publik dhe dhënies së ndihmës shtetërore, duke kontribuar drejtpërdrejtë në të ardhurat e kursyera që lejojnë rritje të shpenzimeve në fusha të tjera të buxhetit;

- Të organizojë më shumë trajnime/seminare në fushën e prokurimit publik për autoritetet kontraktuese dhe për bashkësinë e biznesit në mënyrë që të udhëzohet drejt hartimi optimal i procedurave të prokurimit publik, për të shmangur marrëveshjen e fshehtë dhe *bid rigging* dhe të rritet ndërgjegjësimi për rëndësinë e konkurrencës në prokurimin publik;

- Të krijojë mekanizma efektivë konsultimi me bizneset dhe partnerët socialë për të siguruar transparencë dhe parashikueshmëri të masave mbështetëse dhe legjislacionit në fushën e konkurrencës;

- Të rrisë përpjekjet për zhvillimin e mëtejshëm të kulturës së konkurrencës me fokus të veçantë botën akademike, me synimin që të sigurojë një gjeneratë profesionistësh, të cilët do të jenë të formuar në fushën e ligjit dhe të ekonomisë së konkurrencës dhe të pajisur me dije për të trajtuar politikat e konkurrencës dhe çështje të rregullimit.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 20.5.2021.

REZOLUTË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur e vlerësuar rolin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për sigurimin dhe kompensimin e depozitave të qytetarëve të vendosura në bankat që operojnë në Republikën e Shqipërisë;

- Duke vlerësuar kontributin e saj në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë së sistemit financiar e bankar;

- Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë agjenci, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e saj me institucionet kombëtare e ndërkombëtare,

Vlerëson veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në drejtim të:

- Miratimit të “Platformës për përmirësimin e cilësisë së të dhënave të depozituesve dhe depozitave në sistemin bankar” si një domosdoshmëri për një proces kompensimi të saktë dhe të shpejtë;



- Bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionet dhe autoritetet rregullatore, për monitorimin e ecurisë së treguesve të anëtarëve të skemës dhe ruajtjes së integritetit të operacioneve të saj;

- Administrimit me efektivitet të mjeteve financiare, duke diversifikuar portofolin me investime në maturitet më afatgjatë;

- Angazhimit të Agjencisë në rritjen e nivelit të edukimit dhe ndërgjegjësimin të depozituesve, për përfitimet dhe kufizimet e skemës së sigurimit të depozitave;

- Realizimit të trajnimeve të punonjësve të shërbimit me klientelën, si përcjellësit e parë dhe më të rëndësishëm të informacionit për sigurimin dhe kompensimin e depozitave.

Kuvendi rekomandon që Agjencia e Sigurimit të Depozitave, për vitin 2021, të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Të bashkëpunojë me të gjitha bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit për ndjekjen dhe zgjidhjen e të gjitha problematikave të dala gjatë simulimeve teknike të mëparshme;

- Të përmirësojë kapacitetet monitoruese dhe vlerësuese të Agjencisë, duke kryer stres-teste në vazhdimësi për vlerësimin e mjaftueshmërisë së fondit të kompensimit të depozitave në banka;

- Të përmirësojë sistemin e teknologjisë së informacionit të Agjencisë, në lidhje me modulet e kryerjes së pagesave në një proces kompensimi, dhe të rrisë funksionalitetin e ambientit të raportimit për të mundësuar një paraqitje dhe administrim më të mirë të sistemit të informacionit në Agjenci;

- Të verifikojë në vijueshmëri rezultatet e testimeve të dijeve, në lidhje me sigurimin dhe kompensimin e depozitave, dhe të propozojë materiale trajnuese për përmirësimin e këtyre dijeve për punonjësit e shërbimit me klientin në banka dhe shoqëritë e kursim-kreditit;

- Të vazhdojë bashkëpunimin me anëtarët e rrjetit të sigurisë financiare, për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend dhe mbrojtjen e interesave të depozituesve.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 20.5.2021.

DEKRET

Nr. 13069, datë 19.5.2021

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 1, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, këtyre personave:

1. Nehat Hakif Dervishi
2. Agnesa Hamdi Lumi
3. Hassan Mohamed Moustafa Ebid
4. Walid Faiez Aldabak
5. Zeynep Sefa Shabaj (Sekin)
6. Hansa Hikmet Ali Aksoy (Rihtim)
7. Maria Aleksander (Aleksandr) Avar (Orekhova)
8. Shehriban Muharem Hoxha (Koshi)
9. Valon Osman Miftari
10. Samir Abdulhamid Bizan
11. Sofian Samir Bizan
12. Nart Erhan Bula
13. Gazi Salih Durmaz
14. Leutrim Raif Gashi
15. Shpend Aqif Beqiri
16. Beqir Bajram Bucaliu
17. Erlin Bangayan Maximo Cauilan Nonan (Calimag)
18. Betül Veli Ergün (Karaoğlu)
19. Kadir Salim Aral
20. Harun Erol Er
21. Ibrahim Hasan Yıldırım
22. Rukiye Ali Yıldırım (Karataş)
23. Behlül Bilal Kocagöz

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

**DEKRET****Nr. 13070, datë 19.5.2021****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 1, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, këtyre personave:

1. Serdar Osman Acar
2. Ilknur Altan Boni (Encan)
3. Suhaib Samir Bizan
4. Naman Othman Kunbargi
5. Halid Rafet Bilaç
6. Daniele Orazio Giuseppe Conte
7. Francesco Mariano Guerzoni
8. Simone Ciro Andreozzi
9. Enzo Alfonso Zago
10. Elma Ali Azemi (Ibro)
11. Hüseyin Mehmet Şentürk
12. Safer Mehmet Jusufi
13. Asmaa Mhd Zuhir Al Rabbat (Alrabbat)
14. Arieta Ismail Martini (Gashi)
15. Ali Hasan Çapar
16. Liberta Sami Ulaj
17. Sazan Sami Ulaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

DEKRET**Nr. 13076, datë 20.5.2021****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe të nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 1, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, këtyre personave:

1. Bekim Beqir Shala
2. Donika Ekrem Qerimi
3. Mimoza Selim Shabani
4. Nexhmedin Xhemal Kalisi
5. Feride Ibish Saramati (Ademaj)
6. Sedat Bedri Zejnullahu
7. Imad Eddin Samir Darwish Taleb
8. May (Mai) Anas Kardi
9. MohamadSamir EmadEddin (Imad Eddin) Darwish Taleb
10. Taym EmadEddin (Imad Eddin) Darwish Taleb
11. Lays EmadEddin (Imad Eddin) Darwish Taleb
12. Vllaznim Aslan (Asllan) Maloku
13. Atlantida Vllaznim Maloku
14. Ali Arfan Matawea
15. Fatlinda Faik Hergaja Krasniqi (Hergaja)
16. Asllan Hysen Axhanela
17. Ibush Qazim Salihu
18. Abdulrahman Mohamed Abdulzاهر Shahin

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

**VENDIM****Nr. 285, datë 19.5.2021****PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
PROKURIMIT PUBLIK¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, pika 2; 13, pika 1, shkronja “a”; 14, pika 3; 17, pikat 1 dhe 2; 21, pika 4; 23, shkronjat “c” dhe “g”; 33, pika 2; 34, pika 2; 35, pika 3; 41, pika 2; 42, pikat 1 dhe 3, shkronja “a”; 43, pikat 1 dhe 4, shkronja “a”; 44, pika 1; 50, pikat 2 dhe 7; 54, pika 1; 56, pika 4; 57, pikat 1 dhe 2, shkronja “c”; 58, pika 2; 71, pikat 1 dhe 2, shkronja “c”; 72, pika 1; 74, pika 1; 78, pika 3; 82, pikat 1 dhe 5; 111, pika 1; 116, pika 4; 124, pika 6; 131, pika 2; e 132, pika 2, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave të prokurimit publik, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Agjencia e Prokurimit Publik, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi,

¹ Ky vendim është përafëruar pjesërisht me:

- Direktivën 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Mbi prokurimin publik dhe që shfuqizon direktivën 2014/18/KE”, të ndryshuar, me numër CELEX 32014L0024, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 94, datë 28.3.2014, faqe 65–242;

- Direktivën 2014/25/BE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për prokurimin nga entitete që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon direktivën 2004/17/KE”, të ndryshuar, me numër CELEX 32014L0025, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, numër 94, datë 28.3.2014, faqe 243–374;

- Direktivën e Këshillit 92/13/KEE, datë 25 shkurt 1992, “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative, në lidhje me zbatimin e rregullave të Komunitetit për procedurat e prokurimit të enteve që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe telekomunikacionit”, të ndryshuar, me numër CELEX 31992L0013, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, numër 76, datë 23.3.1992, faqe 14-20;

- Direktivën e Këshillit (89/665/KEE), datë 21 dhjetor 1989, “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative, në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, të ndryshuar, me numër CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, numër 395, datë 30.12.1989, faqe 33–35.

të hartojë dhe të miratojë dokumentet standarde të tenderit.

3. Vendimi nr. 914, datë 29.12.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohen autoritetet dhe entet kontraktore, të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, për zbatimin e rregullave të miratuara me këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK**KREU I
AUTORITETI OSE ENTI KONTRAKTOR****Neni 1****Përgjegjësia e autoritetit/entit kontraktor**

1. Autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike të përcaktuara për përdorim në prokurimet publike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” (në vijim “LPP”) të këtyre rregullave dhe udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik (në vijim “APP”), të dala në bazë dhe për zbatim të LPP-së.

2. Autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të planifikojë në cilësi dhe në kohë nevojat e tij e fondet publike respektive dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 2**Dokumentimi i procesit**

1. Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri tek zbatimi i kontratës. Për këtë qëllim, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera.

2. Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:



a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;

b) arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar, nëse është rasti;

c) argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit;

ç) vlerën dhe mënyrën e përllogaritjes së vlerës, në përputhje me parashikimet e LPP-së dhe parashikimet në këto rregulla;

d) të gjitha kërkesat për sqarim për dokumentet e tenderit, përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, si dhe modifikimet e bëra në këto dokumente, nëse është rasti;

dh) emrat dhe adresat e ofertuesve që kanë dorëzuar oferta;

e) emrin dhe adresën e ofertuesit, oferta e të cilit është përcaktuar si fituese, kur ka një të tillë, si dhe vlerën e kontratës;

ë) arsyet e kualifikimit dhe të skualifikimit të ofertuesve ose të kandidatëve;

f) procesin e hedhjes së shortit, nëse ka pasur;

g) arsyet e anulimit, sipas nenit 98, të LPP-së;

gj) argumentet për rastin kur një ofertë është refuzuar për shkaqe të parashikuara në nenin 76, pikat 3, shkronja “F”, 4 dhe 5, të LPP-së;

h) argumentet për rastin kur një ofertë është kualifikuar për shkaqe të parashikuara në pikën 6, të nenit 76, të LPP-së;

i) ankesat dhe vendimmarrjes lidhur me to;

j) administrimin dhe verifikimin e dokumentacionit të operatorit ekonomik fitues, në formë shkresore, përpara nënshkrimit të kontratës ose përpara nënshkrimit të marrëveshjes kuadër nga organi qendror blerës;

k) raport përmbledhës të ecurisë së procedurës, sipas parashikimeve në LPP;

l) planin e zbatimit të kontratës;

ll) një raport për zbatimin e kontratës dhe raporte periodike, kur është rasti.

3. Dokumentimi i proceseve që zhvillohen në sistemin e prokurimit elektronik bëhet automatikisht në sistem.

KREU II

REGJISTRI I PARASHIKIMEVE DHE I REALIZIMEVE

Neni 3

Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik

1. Në bazë të nevojave për punë, mallra ose shërbime, autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për hartimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së.

2. Regjistri i parashikimeve duhet të synojë planifikimin e mirë të përdorimit të fondeve publike dhe planifikimin e realizimit në kohë të procedurave të prokurimit publik.

3. Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të nevojave, gjatë periudhës shtator–dhjetor të çdo viti, përgatit regjistrin për vitin ushtrimor në vijim, bazuar në ligjin që miraton parashikimet buxhetore afatmesme. Në çdo rast, afati maksimal i hartimit të regjistrit është jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës.

Autoritetit/enti kontraktor, brenda 5 (pesë) ditëve nga hartimi i regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit, duhet të dërgojë në organin qendror blerës të dhënat teknike e sasiore dhe fondin përkatës për objektet që do të prokurohen në mënyrë të përqendruar.

4. Autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të krijojë regjistrin e parashikimeve në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i zërave të tij nga APP-ja duhet të bëhet brenda 3 (tri) ditëve nga dita e nesërme e punës, nga dërgimi i tij për publikim në sistem.

APP-ja, nëse vëren se regjistri i parashikimeve nuk është hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik, kthen e këshillon autoritetin/entin kontraktor për hartimin e tij në përputhje me këto kërkesa.

Një kopje e regjistrit të parashikimeve i vihet në dispozicion degës së thesarit dhe institucionit qendror, që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë.

5. Çdo autoritet/ent kontraktor, i cili do të luajë rolin e organit qendror blerës, dhe autoriteti/enti, të cilit i është deleguar e drejta për prokurim (nëse



është rasti), duhet të krijojnë një regjistër parashikimi për procedurat e prokurimit që do të zhvillohen prej tyre, menjëherë me mbledhjen e të dhënave, por, në çdo rast, jo më vonë se 20 (njëzet) ditë nga marrja e kërkesave për prokurim nga autoritetet kontraktore.

Në rast të marrjes së kërkesave për prokurim, të cilat nuk janë në përputhje me rregullat e prokurimit publik, organi qendror blerës ose autoriteti/enti, të cilit i është deleguar e drejta për prokurim, duhet të krijojë zërin e regjistrit brenda 5 (pesë) ditëve nga plotësimi ose saktësimi i të dhënave, nga autoritetet/entet kontraktore.

Organi qendror blerës dhe autoriteti, të cilit i është deleguar e drejta për prokurim (nëse është rasti), kanë detyrimin të krijojnë/të modifikojnë regjistrin e parashikimeve në sistemin e prokurimit elektronik. Publikimi i elementeve të tij nga APP-ja bëhet brenda 3 (tri) ditëve nga dita e nesërme e punës, e krijimit të tij në sistem.

6. Organet e pushtetit vendor, ndërmarrjet/shoqëritë me kapital mbi 50% shtetëror apo çdo autoritet/ent kontraktor tjetër jobuxhetor përgatisin regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik, bazuar në programet e zhvillimit ekonomik dhe, në çdo rast, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas miratimit të buxhetit apo programet e zhvillimit ekonomik nga këshillat vendorë ose nga organet drejtuese përkatëse.

7. Autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të bëjë ndryshime në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit, vetëm në raste kur këto ndryshime vijnë për arsye që nuk kanë qenë të mundura të parashikohen në kohën e hartimit të regjistrit.

Çdo ndryshim i regjistrit të parashikimeve bëhet nga vetë autoriteti ose enti kontraktor në sistemin e prokurimit elektronik, dhe publikimi i tij nga APP-ja bëhet brenda 3 (tri) ditëve nga dita e nesërme e punës nga dërgimi i tij për publikim në sistem.

APP-ja, nëse konstaton se ky ndryshim nuk është bërë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik, kthen dhe këshillon autoritetin/entin kontraktor për hartimin e tij, në përputhje me këto kërkesa.

Një kopje e këtyre ndryshimeve i vihet në dispozicion degës së thesarit dhe institucionit qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë.

Neni 4

Regjistri i realizimit të procedurave të prokurimit

1. Në përfundim të çdo procedure prokurimi, pas lidhjes së kontratës krijohet regjistri i realizimeve të procedurave të prokurimit publik, në sistemin e prokurimit elektronik, në përputhje me formën dhe metodën e përcaktuar në udhëzimet e APP-së.

2. Autoriteti/enti kontraktor, çdo katër muaj, por jo më vonë se datat 10 maj, 10 shtator dhe 10 janar të çdo viti, dorëzon në organet qendrore, që vënë në dispozicion fondet, një informacion të hollësishëm për procedurat e prokurimit të realizuara.

3. Në fillim të çdo viti, një kopje e regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit për vitin paraardhës, u dorëzohet organeve qendrore, që vënë në dispozicion fondet, jo më vonë se data 15 janar.

4. Regjistri Kombëtar i Procedurave të Prokurimit Publik të realizuara për vitin paraardhës gjendet i publikuar në faqen e internetit të APP-së.

5. Në përfundim të çdo procedure prokurimi të kryer nga organi qendror blerës, pas lidhjes së kontratës, krijohet regjistri i procedurave të prokurimit të realizuara, në përputhje me formën dhe metodën e përcaktuar në udhëzimet e APP-së.

KREU III

NJOFTIME DHE PUBLIKIME

Neni 5

Llojet e njoftimeve

Njoftimet që publikohen në procedurat e prokurimit publik janë, si më poshtë vijon:

- a) njoftimi paraprak i informacionit;
- b) njoftimi periodik i informacionit;
- c) njoftimi mbi praninë e një sistemi kualifikimi;
- ç) njoftimi i kontratës/i konkursit të projektimit;
- d) njoftimi vullnetar i transparencës për procedurën me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;
- dh) njoftimi mbi ndryshimet dhe informacionet shtesë në një procedurë;
- e) njoftimi i fituesit;
- ë) njoftimi i procedurës së anuluar;
- f) njoftimi i lidhjes së kontratës;



g) njoftimi i ndryshimit të kontratës gjatë kohëzgjatjes së saj.

Neni 6

Buletini i Njoftimeve Publike

1. APP-ja publikon Buletinin e Njoftimeve Publike çdo ditë të hënë. Në rastet kur dita e hënë përkon ditë pushimi, publikimi bëhet ditën e nesërme të punës.

APP-ja publikon Buletinin e Njoftimeve Publike në çdo rast tjetër të parashikuar në akte të tjera ligjore ose me vendim të posaçëm të saj.

2. Në Buletinin e Njoftimeve Publike publikohen, në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik:

a) njoftimi i shkurtuar i kontratës për procedurat e prokurimit me vlerë mbi dhe nën kufijtë e ulët monetarë, sipas parashikimit të nenit 11, të këtyre rregullave;

b) njoftimi i fituesit, njoftimi i kontratës së lidhur dhe njoftimi i anulimit;

c) lista e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga pjesëmarrja në prokurimin publik, nga koncesionet/partneriteti publik privat apo nga pjesëmarrja në ankandet publike, si dhe arsyet e këtij përjashtimi, në bazë të nenit 78, të LPP-së;

ç) çdo njoftim tjetër publik, informacion apo akt tjetër, që duhet të publikohet në përputhje me LPP-në dhe akte të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 7

Rregulla të përgjithshme për formën dhe mënyrën e shpalljes së njoftimeve

1. Njoftimet e procedurave të prokurimit dhe konkursit të projektimit publikohen në përputhje me afatet e përcaktuara në LPP dhe në këto rregulla.

2. Njoftimet bëhen në sistemin e prokurimit elektronik dhe në mënyrë të shkurtuar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Njoftimet, sipas parashikimeve të nenit 56, të LPP-së, për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, publikohen edhe në gazetën zyrtare të Bashkimit Evropian.

3. Hedhja e njoftimit të kontratës, dokumenteve të tenderit dhe procesverbalit të argumentimit të specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta të pranimit, në sistemin elektronik, bëhet nga vetë

autoriteti/enti kontraktor. Në çdo rast, përmbajtja e këtyre dokumenteve duhet të përputhet me versionin e miratuar dhe të administruar nga autoriteti/enti kontraktor. Shpallja e njoftimit në sistemin e prokurimit elektronik do të bëhet publike ditën e nesërme të punës nga dita e hedhjes së njoftimit në sistem.

4. Në njoftimet që publikohen sipas LPP-së duhet të përfshihen të gjitha informacionet që u lejojnë operatorëve ekonomikë të vendosin nëse do të marrin pjesë apo jo në procedurat e prokurimit. Në çdo rast, njoftimet do të bëhen sipas formatit, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit për çdo lloj procedure prokurimi.

5. Autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim, njoftimin e fituesit, në përputhje me parashikimet e nenit 97, të LPP-së, dhe njoftimin e lidhjes së kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës.

Në rastin e prokurimit të përqendruar, autoriteti/et/enti/et kontraktor/e përfitues/e duhet të dërgojnë njoftimin e kontratës së lidhur pranë organit qendror blerës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës. Organi qendror blerës dërgon për publikim, njoftimin e kontratës së lidhur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas marrjes së këtij njoftimi nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e delegimit të prokurimit, autoriteti/et kontraktor/e përfitues/e duhet të dërgojnë njoftimin e kontratës së lidhur pranë autoritetit kontraktor, i cili ka zhvilluar procedurën e prokurimit, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës. Ky i fundit dërgon për publikim njoftimin e kontratës së lidhur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas marrjes së këtij njoftimi nga autoriteti kontraktor.

6. Autoriteti/enti kontraktor publikon njoftimin për anulimin e procedurës së prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç është publikuar njoftimi i kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e përfundimit të afatit për paraqitjen e ankesave ose dhënies së një vendimi përfundimtar për ankesën.

7. Hedhja në sistemin elektronik të njoftimit të fituesit, njoftimit të anulimit dhe njoftimit të kontratës së lidhur bëhet nga vetë autoriteti/enti kontraktor. Shpallja e njoftimit të fituesit, njoftimit të anulimit dhe njoftimit të kontratës së lidhur në faqen e internetit të APP-së do të bëhet publike jo



më vonë se ditën e nesërme të punës, nga dita e hedhjes së njoftimit në sistem.

8. Në rast se njoftimet e fituesit, njoftimet e anulimit dhe njoftimet e kontratës së lidhur nuk janë hartuar në përputhje me formën dhe mënyrën e përcaktuar në këto rregulla, APP-ja kthen e këshillon autoritetin/entin kontraktor për hartimin e tyre në përputhje me këto kërkesa.

9. Për të gjitha njoftimet që bëhen sipas LPP-së dhe këtyre rregullave në sistemin elektronik të prokurimit, afatet fillojnë të përlogariten nga dita pasardhëse e punës.

10. Afatet, kur nuk përcaktohen ndryshe në LPP dhe në këto rregulla, janë në ditë kalendarike, dhe përlogariten sipas përcaktimit në Kodin e Procedurave Administrative.

11. Në rastin kur procedura zhvillohet në formë shkresore, autoriteti/enti kontraktor është i detyruar të dërgojë për publikim në APP, me shkresë përcjellëse, një kopje të shkruar dhe elektronike (CD), të njoftimit të kontratës.

Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor publikon, në faqen e tij zyrtare të internetit, dokumentet e tenderit dhe procesverbalin e argumentimit të specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta të pranimit. Autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për barazvlershmërinë e kopjes së sipërpërmendur, së bashku me dokumentet e tenderit të hartuara nga njësia e prokurimit dhe që administrohen prej tij.

Gjithashtu, në rastin kur, procedura zhvillohet në formë shkresore, autoriteti/enti kontraktor është i detyruar të dërgojë për publikim në APP, me shkresë përcjellëse, një kopje të shkruar dhe elektronike (CD) të njoftimit të fituesit, njoftimit të kontratës së lidhur dhe njoftimit të anulimit.

KREU IV RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË PROKURIMIT

Neni 8

Përgjashtimet e veçanta

1. Shërbimet, sipas përcaktimit në pikën 1, shkronja “ë”, të nenit 7, të LPP-së, janë:

- a) shërbimet e kërimit e të zhvillimit, si dhe shërbimet e konsulencës të lidhura me to;
- b) shërbimet e zhvillimit eksperimental;

c) projektimi dhe ekzekutimi i kërkimeve dhe të zhvillimit;

ç) studimi i fizibilitetit dhe demonstrimi teknologjik;

d) testimi dhe vlerësimi.

2. Shërbimet, sipas përcaktimit në pikën 1, shkronja “g”, të nenit 7, të LPP-së, janë, si më poshtë vijon:

a) shërbimet e shpëtimit dhe ato të zjarrfikëses;

b) shërbimet e zjarrfikëses;

c) shërbimet e parandalimit të zjarrit;

ç) shërbimet zjarrfikëse të pyjeve;

d) shërbimet e shpëtimit;

dh) shërbimet e mbrojtjes civile;

e) shërbimet e sigurisë bërthamore;

ë) shërbime ambulance.

3. Shërbimet, sipas përcaktimit në pikën 1, shkronja “h”, të nenit 7, të LPP-së, janë, si më poshtë vijon:

a) shërbime të fushatës reklamuese;

b) prodhimi i filmit propagandistik;

c) prodhimi i videokasetës/videoregjistrimeve propagandistike.

Neni 9

Kontratat e subvencionuara nga autoritetet kontraktore

1. Autoriteti kontraktor do të zbatojë rregullat e përcaktuara në LPP dhe këto rregulla, kur vendos të bashkëfinancojë, në masën 50% ose më shumë, kontrata pune, për:

a) veprimtari të inxhinierisë së ndërtimit, sipas kodeve përkatëse në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) punë ndërtimi për spitale, ambiente sportive, argëtimi dhe për kohën e lirë, ndërtesa shkolle e universiteti dhe ndërtesa që përdoren për qëllime administrative.

2. Autoriteti kontraktor do të zbatojë rregullat e përcaktuara në LPP dhe këto rregulla, kur vendos të bashkëfinancojë, në masën 50% ose më shumë, kontrata shërbimi të lidhura me kontratat e punës të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Vlera e parashikuar e kontratave sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, pa TVSH, duhet të jetë e barabartë ose më e madhe se kufiri i ulët monetar.

4. Në rastin kur, kontrata e punës përballohet nga buxheti i autoriteteve kontraktore për më pak



se 50% e fondit dhe vlera e parashikuar e të cilave, pa TVSH, është e barabartë ose më e vogël se kufiri i ulët monetar, autoritetet kontraktore detyrohen që në dhënien e këtyre kontratave të respektojnë parimet e përzgjedhjes të parashikuara në nenin 3, të LPP-së.

Në këtë rast, autoriteti kontraktor duhet të kujdeset, që të paktën:

- a) të përfshijë parashikimin për bashkëfinancimin në regjistrin e parashikimit;
- b) të publikojë njoftimin për dhënien e kontratës, sipas parashikimit në LPP dhe këto rregulla;
- c) të respektojë parimet e parashikuara në LPP për trajtimin e operatorëve ekonomikë;
- ç) të mbajë evidenca të plota për zbatimin e kontratës.

Neni 10

Format e komunikimit

Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit, si rregull, bëhet në përputhje me nenin 17, të LPP-së.

Autoriteti/enti kontraktor mund të komunikojë, në formë shkresore, vetëm në rastet e mëposhtme:

- a) kur, për shkak të natyrës së veçantë të prokurimit, për komunikimin elektronik do të nevojiteshin pajisje, mjete apo formate të posaçme, të cilat nuk janë të disponueshme gjerësisht apo nuk suportohen nga aplikacione të disponueshme gjerësisht;
- b) kur aplikacionet që suportojnë formatet e dokumenteve që janë të përshtatshme për përshkrimin e ofertave përdorin formate, që nuk mund të trajtohen nëpërmjet aplikacioneve të hapura apo të disponueshme gjerësisht, ose janë të regjistruara si pronësi intelektuale dhe nuk mund të vihen në dispozicion për t'u shkarkuar apo përdorur në distancë nga ana e autoritetit ose entit kontraktor;
- c) kur për përdorimin e mjeteve elektronike të komunikimit nevojiten pajisje zyre të posaçme që nuk janë gjerësisht të disponueshme për autoritetet/entet kontraktore;
- ç) për procedura prokurimi ose faza të tyre, të cilat kërkojnë dorëzimin e modeleve, projekteve ose maketeve, të cilat nuk mund të transmetohen nëpërmjet mjeteve elektronike.

Neni 11

Kufijtë monetarë

1. Në përputhje me nenin 33, të LPP-së, kufijtë monetarë janë:

- a) Kufiri i lartë monetar:
 - 650 000 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;
 - 40 000 000 (dyzet milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.
- b) Kufiri i ulët monetar:
 - 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;
 - 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

Të njëjtët kufij monetarë zbatohen edhe për kontratat sektoriale.

c) Kufiri monetar për prokurime me vlerë të vogël:

Për prokurimet, vlera e përlogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, është nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën prokurim me vlerë të vogël, siç përshkruhet në nenin 56, të këtyre rregullave.

2. Në çdo rast, nëse autoriteti kontraktor ka realizuar prokurimin e gjithë vlerës së parashikuar prej 1 000 000 (një milion) lekësh, por gjatë vitit kalendarik i lindin nevoja shtesë që janë në kufirin e prokurimit me vlerë të vogël dhe nuk ka qenë e mundur të parashikoheshin në fillim të vitit, mund të përdorë përsëri këtë lloj procedure.

3. Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përlogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor nuk u nënshtrohet procedurave të prokurimit.

Në çdo rast, pavarësisht nga fakti që nuk do të prokurohen, planifikimi i këtyre objekteve dhe vlerat përkatëse duhet të pasqyrohen respektivisht në regjistrin e parashikimeve dhe në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik.

Pagesat për këto objekte bëhen sipas legjislacionit tatimor në fuqi dhe faturat e lëshuara në këto raste kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë nënshkruar një të tillë.

4. Për veprimtari të përcaktuara në ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë, si dhe për artikuj dhe shërbime protokollare, sipas legjislacionit në



fuqi, përcaktohen rregulla të posaçme me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Asnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP-ja.

Neni 12

Metoda të zbatueshme në përlogaritjen e vlerës së kontratës

1. Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar, pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti/enti kontraktor, duke përfshirë çdo pagesë, siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Kur autoriteti ose enti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, duhet t'i mbajë ato parasysh kur përlogarit vlerën e prokurimit.

2. Autoriteti/enti kontraktor, në rastet e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, konverton vlerën limit të kontratës me një monedhë ndërkombëtare, të përzgjedhur prej tij sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën dërgohet për publikim njoftimi i kontratës. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor vendos dhe kursin e këmbimit të përdorur prej tij.

3. Përzgjedhja e metodës që përdoret për përlogaritjen e vlerës së prokurimit nuk bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga fusha e zbatimit të LPP-së dhe këtyre rregullave, apo për të copëzuar kontratën, me qëllim shmangien e procedurave sipas kufijve monetarë.

4. Autoriteti/enti kontraktor, në fazën e hartimit të nevojave për mallra, punë ose shërbime mban në konsideratë, metodat e përlogaritjes së vlerës së prokurimit. Vlera e përlogaritur e prokurimit duhet të jetë vlerë reale e përlogaritur përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit.

5. Për marrëveshjet kuadër dhe sistemet dinamike të blerjes, vlera që do të merret parasysh është vlera maksimale e parashikuar pa TVSH, e të gjitha kontratave që mund të lidhen gjatë gjithë afatit të marrëveshjes kuadër ose sistemit dinamik të blerjes.

6. Në rastin e partneriteteve për inovacion, vlera që duhet marrë në konsideratë është vlera maksimale pa TVSH, e veprimtarive të kërkimit dhe të zhvillimit që do të kryhen gjatë të gjitha

fazave të partneritetit të parashikuara, si edhe të furnizimeve, shërbimeve ose punëve që do të zhvillohen ose prokurohen në përfundim të partneriteteve të parashikuara. Vlera e parashikuar e mallrave, shërbimeve ose punëve, që synohen të përfitohen në këtë rast, duhet të jetë në proporcion me investimin që kërkohet për realizimin e tyre.

7. Në lidhje me kontratat publike për punë, llogaritja e vlerës së parashikuar merr në konsideratë koston e punëve dhe vlerën totale të parashikuar të furnizimeve dhe të shërbimeve që vihen në dispozicion të kontraktorit nga autoriteti/enti kontraktor, nëse ato janë të nevojshme për kryerjen e punëve.

8. Kur një punë, mall ose shërbim mund të rezultojë në dhënien e disa kontratave në formën e loteve të veçanta, për qëllim të përlogaritjes së vlerës së kontratës, duhet të merret parasysh vlera e përgjithshme e të gjitha këtyre loteve.

9. Në rastin e kontratave publike të furnizimit ose të shërbimit, që kanë natyrë të vazhdueshme ose me mundësi ripërtëritjeje brenda një periudhe të caktuar, përlogaritja e vlerës së kontratës bazohet:

a) në vlerën e përgjithshme reale të kontratave të njëpasnjëshme të të njëjtit lloj, të dhëna gjatë vitit kalendarik ose gjatë 12 muajve paraardhës, vlerë e përshtatur, nëse është e mundur, në mënyrë që të merren parasysh ndryshimet në sasi ose në vlerë që mund të ndodhin gjatë 12 muajve pas kontratës fillestare; ose

b) në vlerën e përgjithshme të kontratave të njëpasnjëshme të dhëna gjatë 12 muajve pas dorëzimit të parë ose gjatë vitit ushtrimor, nëse është më i gjatë se 12 muaj.

10. Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi ripërtëritjeje, autoriteti/enti kontraktor duhet të parashikojë klauzola për rishikimin e vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar. Autoriteti/enti kontraktor, në çdo rast, duhet të argumentojë aplikimin e kontratës shumëvjeçare dhe të bëjë një përlogaritje të saktë të fondit, ku të jepen hollësi për investimin që do të kryhet, amortizimin për çdo vit dhe përbërësit/elementet e tjera të ngjashme me to.

11. Në rastet e kontratave të furnizimit të mallrave, përmes qirasë me ose pa mundësi blerjeje të mallrave, fondi limit llogaritet duke përfshirë qiranë apo këstin mujor, shumëzuar me numrin e muajve, gjatë të cilëve do të zgjasë kontrata.



12. Për kontratat publike të shërbimit, baza për përlogaritjen e vlerës së kontratës është si më poshtë, sipas rastit:

a) shërbime sigurimi: primi që duhet paguar dhe çdo formë tjetër pagese;

b) shërbime bankare ose shërbime të tjera financiare: tarifat, komisionet që duhet të paguhet, interesi dhe forma të tjera të pagesës;

c) kontratat e projektimit: tarifat, komisionet që duhen paguar dhe format e tjera të pagesës.

Neni 13

Studimi paraprak i tregut

1. Përpara se të nisë një procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor mund të studiojë tregun, me qëllim që të përgatisë prokurimin, të përditësojë të dhënat që ka përdorur për hartimin e buxhetit dhe regjistrave të parashikimit, si dhe të informojë operatorët ekonomikë për planet dhe kërkesat e tyre për prokurim.

2. Studimi i tregut ka për qëllim përlogaritjen e një vlere reale të kontratës dhe të shmangë dështimin e procedurës për vlera që nuk përputhen me vlerat reale të tregut.

3. Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit ngarkon me detyrë për studimin e tregut, një ose disa persona, që mund të jenë një grup pune i ngritur për këtë qëllim çdo fillim viti ose rast pas rasti.

4. Për studimin e tregut, autoriteti/enti kontraktor, mund të konsultohet me ekspertë, autoritete të pavarura ose operatorët ekonomikë në treg me shkrim ose verbalisht. Në rastin e konsultimit verbalisht, grupi i ngritur për këtë qëllim harton një procesverbal me këto të dhëna. Këto këshilla mund të përdoren në planifikimin dhe kryerjen e procedurës së prokurimit, nëse nuk rezultojnë në shtrembërimin e konkurrencës dhe cenojnë parimet e mosdiskriminimit dhe të transparencës.

Autoriteti/enti kontraktor duhet të kujdeset që konsultimi të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe të shmangë dhënien e çdo informacioni preferencial, që mund të favorizojë operatorë të caktuar në përgatitjen e ofertës për procedurën e prokurimit.

5. Në çdo rast, duhet të shmanget rreptësisht çdo konflikt interesi apo edhe shfaqja e një konflikti interesi, në marrëdhëniet e punonjësit të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit

ekonomik. Zyrtarët e përfshirë në studimin e tregut duhet të plotësojnë deklaratën për situatën e konfliktit të interesit.

KREU V

DOKUMENTET E TENDERIT

SEKSIONI I

DOKUMENTET STANDARDE TË TENDERIT

Neni 14

Miratimi dhe përdorimi i dokumenteve standarde të tenderit

1. APP-ja harton dhe miraton me vendim formatin e dokumenteve standarde të tenderit që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit, për çdo lloj procedure prokurimi, sipas nenit 41 të LPP-së, dhe çdo tip kontrate.

2. Autoriteti/enti kontraktor përdor dokumentet standarde të tenderit, sipas përcaktimit në këto rregulla dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike ose kundrejt pagesës, në procedurat që zhvillohen në formë shkresore. Në çdo rast, pagesa e kërkuar nga autoriteti ose enti kontraktor, për dokumentet e tenderit, nuk duhet të tejkalojë shpenzimet për kopjimin e këtyre dokumenteve. Emrat dhe numri i operatorëve ekonomikë, që kanë shfaqur interes për blerjen e dokumentacionit të tenderit apo këqyrjen e tij, duhet të mbahen sekret.

3. Autoriteti/enti kontraktor, nëpërmjet mjeteve elektronike, duhet të ofrojë akses të pakufizuar, të plotë dhe të drejtpërdrejtë pa pagesë të dokumenteve të tenderit, duke nisur nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose ftesës për shprehje interesi.

Kur, për arsye objektive dhe të argumentuara, autoriteti/enti kontraktor nuk mund të ofrojë akses të pakufizuar, të plotë dhe të drejtpërdrejtë pa pagesë, nëpërmjet mjeteve elektronike, të disa prej dokumenteve të tenderit, duhet të përcaktojë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, se këto dokumente tenderi do t'u vendosen në dispozicion nëpërmjet mjeteve të ndryshme nga ato elektronike dhe procedurën e qartë për pajisjen e operatorëve ekonomikë me këto dokumente. Afati për pritjen e ofertave në



këtë rast, zgjatet sipas parashikimit në pikën 3, të nenit 74, të LPP-së.

Neni 15

Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit

1. Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik.

2. Informacioni i përgjithshëm përgatitet sipas formularëve përkatës, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit. Ky informacion përfshin të paktën:

- njoftimin paraprak të informacionit/njoftimin periodik të informacionit;
- njoftimin e kontratës;
- ftesën për ofertë (në rastet e procedurave me fazë);
- udhëzimet për kandidatët/ofertuesit;
- kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes;
- formulari përmbledhës i vetëdeklarimit;
- deklaratën e konfliktit të interesit;
- deklaratën e informacionit konfidencial;
- formularin e ofertës ekonomike;
- sigurimin e ofertës;
- njoftimin e skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve;
- njoftimin e fituesit;
- formularin e ankesës;
- modelin e marrëveshjes kuadër;
- njoftim për lidhjen e marrëveshjes kuadër;
- model kontrate, ku përfshihen kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të propozuara të kontratës;
- sigurimin e kontratës;
- njoftimin e lidhjes së kontratës;
- njoftimin e anulimit të procedurës.

3. Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve:

a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:

- projektin dhe specifikimet;
- preventivin e hollësishëm dhe strukturën e kostos mënyrën e paraqitjes së ofertës;
- grafikun e zbatimit;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

b) Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:

- specifikimet teknike;
- grafikun e livrimit
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

c) Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:

- termat e referencës;
- grafikun e ekzekutimit;
- kërkesat për personelin kryesor;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

SEKSIONI II

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Neni 16

Njoftimi paraprak i informacionit

1. Pasi autoriteti kontraktor ka bërë planifikimin e procedurave të prokurimit, për procedura të veçanta mund të shpallë një njoftim paraprak të informacionit. Njoftimi paraprak i informacionit shpallet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletin e Njoftimeve Publike.

2. Në Buletin e Njoftimeve Publike, njoftimet paraprake të informacionit qëndrojnë të publikuara:

a) deri në shpalljen e njoftimit të kontratës për procedurën respektive;

b) në rastet e njoftimeve që synojnë të krijojnë një sistem dinamik blerjeje, për periudhën e vlefshmërisë së sistemit dinamik të blerjes.

3. Njoftimi paraprak i informacionit përmban të paktën:

- emrin dhe adresën e autoritetit kontraktor;
- emrin dhe kontaktet e personit/ave përgjegjës të prokurimit;
- objektin e kontratës dhe kodin përkatës në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit (CPV);
- llojin e procedurës së prokurimit;
- tipin e kontratës;
- vlerën limit të përlogaritur të kontratës/vlerën limit të përlogaritur për këtë objekt në parashikimet buxhetore të autoritetit kontraktor;
- kohëzgjatjen e përafërt të kontratës;
- një përshkrim të shkurtër të kontratës dhe/ose lotet nëse përdoren;
- llojin e marrëveshjes kuadër, nëse është rasti;



- kohën e përafërt të zhvillimit të procedurës së prokurimit;

- informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Për procedurat e kufizuara dhe për procedurat konkurruese me negociim, kur autoriteti kontraktor përdor njoftimin paraprak të informacionit si një ftesë për ofertë, sipas parashikimeve në LPP-së, ky njoftim, veç informacionit të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, përmban edhe:

- një përshkrim specifik për furnizimet, punët ose shërbimet që do të jenë objekt i kontratës;

- përcaktimin se kontrata do të jepet nëpërmjet procedurës së kufizuar ose procedurës konkurruese me negociim, pa shpallje të mëtejshme të një ftese për ofertë dhe fton operatorët ekonomikë të interesuar për të shprehur interesin e tyre.

5. Autoriteti kontraktor mund të klasifikojë një njoftim, si njoftim paraprak të informacionit, kur ai ka përmbajtjen e përcaktuar në LPP dhe në këtë nen, dhe është publikuar jo më larg se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga momenti i publikimit të njoftimit të kontratës deri 35 (tridhjetë e pesë) ditë para publikimit të saj.

6. Për njoftimet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 57, të LPP-së, dhe në pikën 3, të këtij neni, afati i përcaktuar në pikën 5, përlllogaritët nga data kur dërgohet ftesa për ofertë.

7. Nga afati i përcaktuar në pikën 5, bëjnë përjashtim, njoftimet për kontratat për shërbime sociale dhe shërbime të tjera specifike, ku njoftimi paraprak i informacionit mund të mbulojë një periudhë më të gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Neni 17

Njoftimi periodik i informacionit

1. Enti kontraktor, pasi ka bërë planifikimin e procedurave të prokurimit, për procedura të veçanta mund të shpallë një njoftim periodik të informacionit. Njoftimi periodik i informacionit shpallet në sistemin e prokurimit elektronik dhe Buletin e Njoftimeve Publike.

2. Në Buletin e Njoftimeve Publike, njoftimet periodike të informacionit qëndrojnë të publikuara:

a) deri në shpalljen e njoftimit të kontratës për procedurën respektive;

b) në rastet e njoftimeve që synojnë të krijojnë një sistem kualifikimi, për periudhën e vlefshmërisë së sistemit të kualifikimit.

3. Njoftimi periodik i informacionit përmban të paktën:

- emrin dhe adresën e entit kontraktor;

- emrin dhe kontaktet e personit/ave përgjegjës të prokurimit;

- objektin e kontratës dhe kodin përkatës në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit (CPV);

- llojin e procedurës së prokurimit;

- tipin e kontratës;

- vlerën limit të përlllogaritët të kontratës; /vlerën limit të përlllogaritët për këtë objekt në parashikimet buxhetore të autoritetit kontraktor;

- kohëzgjatjen e përafërt të kontratës;

- një përshkrim të shkurtër të kontratës dhe/ose lotet nëse përdoren;

- llojin e marrëveshjes kuadër, nëse është rasti;

- kohën e përafërt të zhvillimit të procedurës së prokurimit;

- informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga enti kontraktor.

4. Enti kontraktor mund të klasifikojë një njoftim si njoftim periodik të kontratës, kur ai ka përmbajtjen e përcaktuar në LPP dhe në këtë nen dhe është publikuar jo më larg se 12 muaj nga momenti i publikimit të njoftimit të kontratës deri 35 (tridhjetë e pesë) ditë para publikimit të saj.

5. Njoftimi periodik i informacionit mund të përdoret si mjet për të bërë ftesën për konkurrim në procedurën e hapur, të kufizuar, negociim me shpallje paraprake të njoftimit, partneritetit për inovacion dhe dialogun konkurrues të kontratave sektoriale dhe, në këtë rast, afati për pritjen e ofertave mund të shkurtrohet, por nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.

Neni 18

Njoftimi për praninë e një sistemi kualifikimi

1. Enti kontraktor, në prokurimin e kontratave sektoriale, mund të zgjedhë të përdorë sistemet e kualifikimit. Njoftimi në këtë rast është i detyrueshëm dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletin e Njoftimeve Publike, përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së sistemit.



2. Njoftimi për krijimin e një sistemi kualifikimi përmban të paktën:

- emrin dhe adresën e entit kontraktor;
- emrin dhe kontaktet e personit/ave përgjegjës të prokurimit;
- qëllimi i sistemit të kualifikimit;
- objektin e kontratës dhe kodin përkatës në Fjalorin e Përbashkët të prokurimit (CPV);
- llojin e kontratës ose kategori sipas llojit të kontratës, kur ka një ndarje të tillë;
- llojin e procedurës së prokurimit që enti kontraktor planifikon të përdorë për dhënien e kontratave;
- periudhën e vlefshmërisë së sistemit të kualifikimit;
- kriteret për kualifikim të operatorëve ekonomikë;
- kriteret për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga sistemi i kualifikimit;
- kriteret për përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë të tjerë dhe përditësimin periodik të kualifikimeve;
- informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga enti kontraktor.

3. Enti kontraktor njofton për çdo ndryshim gjatë periudhës së vlefshmërisë së një sistemi kualifikimi, në të njëjtën mënyrë sikurse përcaktohet në këtë nen.

Neni 19

Njoftimi i kontratës

1. Njoftimi i kontratës përmban të gjithë informacionin e nevojshëm që i jep mundësi operatorëve ekonomikë të vendosin nëse do të marrin pjesë ose jo në procedurat e prokurimit publik.

2. Njoftimi i kontratës përfshin të paktën informacionin e mëposhtëm:

- emrin dhe adresën autoritetit/entit kontraktor;
- emrin dhe kontaktet e personit/ave përgjegjës për procedurën;
- objektin e procedurës dhe kodin përkatës në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit (CPV);
- referencën e njoftimit;
- llojin e procedurës së prokurimit;
- tipin e kontratës;
- vlerën limit të përlogaritur të kontratës dhe burimin e financimit;
- vlerën e sigurimit të ofertës;

- kohëzgjatjen e kontratës;
- një përshkrim të shkurtër të kontratës dhe/ose lotet nëse përdoren;
- kriteret e shpalljes së fituesit;
- kushtet e marrëveshjes kuadër, nëse është rasti;
- vendin, mënyrat dhe tarifën për tërheqjen e dokumenteve të tenderit, nëse kërkohet;
- vendin, datën dhe orën për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre;
- gjuhën/gjuhët e ofertave dhe të dokumenteve;
- informacion nëse është përdorur njoftim paraprak/periodik i informacionit;
- informacion nëse lejohet nënkontraktim dhe masa/përqindja e lejuar;
- informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga autoriteti/enti kontraktor.

3. Në rastet e procedurave të prokurimit me faza, informacioni i dhënë në njoftimin e kontratës duhet t'i referohet fazës së parë të kualifikimit të procedurës.

4. Në rastet e aplikimit të mundësisë së reduktimit të numrit të operatorëve ekonomikë, në procedurat e prokurimit me faza, ky informacion duhet të bëhet i ditur në njoftimin e kontratës.

5. Në rastet e procedurave të prokurimit të rishpallura pas anulimit, njoftimi i kontratës duhet të përmbajë të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar, si numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik, objekti dhe fondi limit.

Neni 20

Njoftimet e konkursit të projektimit

1. Autoriteti/enti kontraktor që synon të zhvillojë një konkurs projektimi, njofton qëllimin e tij nëpërmjet njoftimit të konkursit. Njoftimi i konkursit përmban të gjithë informacionin e nevojshëm që i jep mundësi operatorëve ekonomikë të vendosin nëse do të marrin pjesë ose jo në konkurs. Informacioni i dhënë në njoftimin e kontratës duhet t'i referohet fazës së parë të kualifikimit të procedurës.

2. Njoftimi i konkursit të projektimit përfshin të paktën informacionin e mëposhtëm:

- emrin dhe adresën e autoritetit/entit kontraktor;
- emrin dhe kontaktet e personit/ave përgjegjës për procedurën;
- objektin e kontratës dhe kodin përkatës në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit (CPV);



- referencën e njoftimit;
 - numrin dhe vlerën e çmimeve;
 - lloji i konkursit të projektimit (me ose pa reduktim të numrit të operatorëve);
 - procedurën e prokurimit që do të ndiqet, në rast se në vijim synohet lidhja e një kontrate shërbimi, sipas përcaktimit në nenin 47, të LPP-së;
 - në rastin e një konkursi projektimi pa reduktim numri të operatorëve, afatin kohor për dorëzimin e projekteve;
 - në rastin e një konkursi projektimi me reduktim numri të operatorëve ekonomikë, sipas parashikimit në pikën 3, të nenit 106, të LPP-së, njoftimi duhet të përmbajë edhe numrin e parashikuar të pjesëmarrësve, emrat e pjesëmarrësve të përzgjedhur, nëse ka, kriteret e qarta për përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe afatin kohor për kërkesat për pjesëmarrje;
 - një përshkrim të shkurtër të kontratës dhe/ose lotet nëse përdoren;
 - kohëzgjatjen e kontratës;
 - kriteret e kualifikimit;
 - vendin, mënyrat dhe tarifën për tërheqjen e dokumenteve të tenderit, nëse kërkohet;
 - vendin, datën dhe orën për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe hapjen e tyre;
 - gjuhën/gjuhët e ofertave dhe të dokumenteve;
 - informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga autoriteti/enti kontraktor.
3. Në rastet e konkursit të projektimit të rishpallur pas anulimit, njoftimi mbi ndryshimet dhe informacionet shtesë në një konkurs projektimi, duhet të përmbajë të njëjtat të dhëna që parashikohen në nenin 19, të kësaj rregullore.
- Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor respekton rregulla të njëjta si për publikimin e njoftimit të kontratës dhe rregullat e përcaktuara në nenin 75, të LPP-së, për shtyrjen e afateve për pritjen e ofertave, kur është rasti.
4. Njoftimi për rezultatet e konkursit publikohet sipas përcaktimit në pikën 3, të nenit 105, të LPP-së, dhe përmban:
- emrin dhe adresën e autoritetit/entit kontraktor;
 - emrin dhe kontaktet e personit/ave përgjegjës për prokurimin;
 - objektin e konkursit;
 - një përshkrim të shkurtër të kontratës;
 - referencën e njoftimit;
 - numrin dhe vlerën e çmimeve;

- llojin e konkursit të projektimit (me ose pa reduktim të numrit të operatorëve ekonomikë);
- kriteret që janë zbatuar për vlerësimin e projekteve;
- numrin e pjesëmarrësve;
- datën e vendimit të jurisë;
- emrat e fituesve të konkursit dhe identifikimi i tyre (NIPT, adresë etj.);
- datën e dërgimit të njoftimit;
- informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga autoriteti/enti kontraktor.

5. Kur autoriteti/enti kontraktor gjykon se është në kushtet e parashikuara në pikën 4, të nenit 105, të LPP-së, duhet të argumentojë dhe dokumentojë arsyet e mospublikimit të informacionit mbi rezultatet e konkursit të projektimit.

Neni 21

Ftesa për ofertë

1. Ftesa për ofertë u dërgohet vetëm kandidatëve të përzgjedhur në fazën e parë të kualifikimit në procedurën e prokurimit me faza. Ftesa përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që t'u mundësojë kandidatëve të përzgjedhur të dorëzojnë ofertat e tyre.
2. Ftesa për ofertë përfshin të paktën informacionin e mëposhtëm:
 - një referencë për njoftimin e publikuar të kontratës;
 - kriteret e shpalljes së fituesit;
 - kushtet e marrëveshjes kuadër, nëse është rasti;
 - vendin, datën dhe orën për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre;
 - gjuhën/gjuhët e ofertave dhe të dokumenteve;
 - informacione të mëtejshme që autoriteti/enti kontraktor i vlerëson të nevojshme.

Neni 22

Njoftimi vullnetar i transparencës për procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës

1. Pavarësisht se publikimi i njoftimit të kontratës nuk është i detyrueshëm, në rastin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor, mund të vendosë të publikojë një njoftim për të



rritur transparencën dhe konkurrueshmërinë në procedurë.

2. Ky njoftim publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletin e Njoftimeve Publike.

3. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor publikon njoftimin e kontratës, me të njëjtën përmbajtje sipas përcaktimit në nenin 19, të këtyre rregullave, si dhe në dokumentet përkatëse të tenderit.

Neni 23

Njoftimi i modifikimit të kontratës gjatë kohëzgjatjes së saj

1. Kur autoriteti/enti kontraktor modifikon një kontratë ose marrëveshje kuadër, të lidhur në përfundim të procedurave që parashikon LPP-ja dhe këto rregulla, duhet të pasqyrojë modifikimin, në sistemin e prokurimit elektronik dhe të publikojë një njoftim me këtë përmbajtje, në Buletin e Njoftimeve Publike.

2. Modifikimi i kontratave apo marrëveshjeve kuadër bëhet vetëm në rastet e parashikuara në nenin 127, të LPP-së, kur autoriteti/enti kontraktor mund të argumentojë se ndodhet në njërin nga këto raste.

3. Njoftimi i modifikimit të kontratës apo marrëveshjes kuadër përmban të paktën:

- emrin dhe adresën e autoritetit/entit kontraktor;
- emrin dhe kontaktet e personit/ave përgjegjës për procedurën;
- objektin e procedurës dhe kodin përkatës në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit (CPV);
- llojin e procedurës;
- tipin e kontratës;
- referencën e njoftimit;
- situatën e parashikuar në nenin 127, të LPP-së, në të cilën ndodhet autoriteti/enti kontraktor, për modifikimin e kontratës apo marrëveshjes kuadër dhe argumentet për përdorimin e saj;
- një përshkrim të shkurtër të modifikimit të kontratës apo marrëveshjes kuadër. Përfshihen këtu, natyra dhe volumi i punëve, natyra dhe sasia ose vlera e mallrave, natyra dhe volumi i shërbimeve;
- vlerën e kontratës së nënshkruar dhe vlerën e ndryshuar (nëse ka);

- kohëzgjatjen e kontratës apo marrëveshjes kuadër dhe afatin e ri (nëse ka);

- emrin dhe adresën, duke përfshirë kontaktet dhe identifikimin e operatorit/ve operatorëve ekonomikë të rinj (kur është rasti);

- datën e nënshkrimit të modifikimit;

- burimin e financimit;

- informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Autoriteti/enti kontraktor, pasi ka modifikuar kontratën apo marrëveshjen kuadër, publikon njoftimin për modifikimin, brenda pesë ditëve nga data e modifikimit.

Neni 24

Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët

1. Udhëzimet duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e duhur për përgatitjen e ofertës, nga pjesëmarrësit bazuar në dokumentet standarde të tenderit.

2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.

Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.

3. Në rastin e procedurave mbi kufijtë e lartë monetarë, autoriteti/enti kontraktor publikon njoftimet e procedurave të prokurimit, në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Publikimet edhe në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, sipas përcaktimeve të nenit 56, të LPP-së, bëhet kur ky detyrim vjen nga angazhimi i shtetit shqiptar në raport me strukturat e Bashkimit Evropian.

4. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, autoriteti/enti kontraktor mund të konvertojë vlerën e ofertës së paraqitur në një monedhë ndërkombëtare, të përzgjedhur prej tij në dokumentet e tenderit, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të



cilën është dërguar për publikim njoftimi i kontratës.

5. Në udhëzime duhet të përcaktohet që, nëse autoriteti/enti kontraktor vendos të organizojë një vizitë në terren/objekt, atëherë të gjithë operatorët ekonomikë, të interesuar për të marrë pjesë në tender, duhet të kenë mundësi të barabarta për të vëzhguar terrenin e punës/ekzekutimit. Gjithashtu, autoriteti/enti kontraktor mund të organizojë një konferencë paraprake (edhe në rastin e mallrave), ku të gjithë kandidatët të mund të kërkojnë sqarime për paqartësitë që u lindin gjatë përgatitjes së dokumenteve.

Kërkesat për sqarime duhet të paraqiten me shkrim dhe përgjigjet përkatëse të autoritetit/entit kontraktor duhet t'u dërgohen, pa përjashtim, të gjithë operatorëve ekonomikë që kanë kërkuar dokumentet e tenderit.

Në rastin e procedurave të prokurimit me mjete elektronike, kërkesat për sqarim bëhen sipas udhëzimeve të APP-së.

Çdo ndryshim në dokumentet e tenderit duhet t'i bëhet i njohur çdo operatori ekonomik të interesuar, në përputhje me nenin 75, të LPP-së, dhe me këto rregulla.

6. Gjatë përgatitjes së ofertave, kandidatët ose ofertuesit duhet të përfshijnë të gjitha detyrimet fiskale, që janë në fuqi deri në 28 (njëzet e tetë) ditë para hapjes së ofertave, me përjashtim të TVSH-së, e cila, nëse është e aplikueshme, do të llogaritet mbi vlerën e ofertës.

7. Ofertat ekonomike, të dhëna nga ofertuesi, duhet të jenë të fiksuara përgjatë ekzekutimit të kontratës dhe nuk duhet t'i nënshtrohen asnjë ndryshimi.

Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Oferta e paraqitur me çmim të ndryshueshëm do të refuzohet nga autoriteti/enti kontraktor, si e papranueshme.

8. Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 (pesë) ditë përpara përfundimit të afatit kohor për vlefshmërinë e ofertave, autoriteti/enti

kontraktor mund t'i kërkojë ofertuesit, me shkrim, të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton autoritetin/entit kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së autoritetit/entit kontraktor, lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë autoriteti/enti kontraktor do të refuzojë ofertën.

Nëse autoriteti/enti kontraktor nuk ka bërë një kërkesë me shkrim për operatorin ekonomik që të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës, sipas parashikimit të paragrafit të parë të kësaj pike, atëherë operatori ekonomik nuk mund të penalizohet për këtë mungesë.

9. Udhëzimet japin informacion edhe për procedurën e rishikimit dhe të dorëzimit të ankesave.

Neni 25

Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes

Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t'u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Këto kriteret synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.

Neni 26

Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.



2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionarit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërket të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga



operatori ekonomik, si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Neni 27

Deklarimi i konfliktit të interesit

1. Operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë gjendjen mbi konfliktin e interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Ky deklarami garanton autoritetin/entit kontraktor që ofertuesit/kandidatët nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.

2. Deklarimi i konfliktit të interesit përmban të dhënat personale të ofertuesit/kandidatit dhe grupet e personave që konsiderohen si persona në konflikt interesi, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 28

Deklarimi i informacionit konfidencial

1. Nëpërmjet listës së informacionit konfidencial, kandidati/ofertuesi deklaron informacionin ose dokumentet që kërkon të mbahet konfidenciale dhe argumentet për këtë. Një operator ekonomik, në përputhje me legjislacionin në fuqi, mund të mos bëjë publik ose shpërndajë informacione të caktuara, përfshirë sekretet teknike ose tregtare dhe veçoritë konfidenciale të ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje.

2. Nëse operatori ekonomik e ka klasifikuar informacionin si konfidencial, ai është i detyruar të cilësojë bazën juridike, mbi të cilën ky informacion është klasifikuar si i tillë.

3. Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publike dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 29

Oferta ekonomike

1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.

2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

Neni 30

Sigurimi i ofertës

1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së.

Enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së.

Enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, mund të kërkojë ose jo sigurim oferte për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës së vlerës së sigurimit, nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, sigurimi i ofertës mund të ketë formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari.

3. Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.

4. Lëshuesi i sigurimit të ofertës duhet:

a) të mos vendosë asnjë kusht për pagimin;

b) të paguajë shumën brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës zyrtare të autoritetit/entit kontraktor.

5. Autoriteti/enti kontraktor duhet t'ua kthejë apo t'ua lirojë ofertuesve sigurimin e ofertës jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga:

a) data kur ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës, për të gjithë ofertuesit, përveç ofertuesit/ve fitues;

b) data kur është lidhur kontrata, për ofertuesin/it fitues;

c) data kur janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues, për të gjithë ofertuesit.

6. Autoriteti/enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës, në rast të:



a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave;

b) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese;

c) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit. Në rast se kontrata nuk nënshkruhet nga ofertuesi fitues për ndonjë situatë të forcës madhore, autoriteti kontraktor nuk mban sigurimin e ofertës.

7. Rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik, sipas pikës 6, të këtij neni, raportohen nga autoriteti/enti kontraktor pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, me qëllim veprimin nga kjo e fundit, sipas parashikimeve të nenit 78, të LPP-së.

8. Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe asaj në vend të dytë, është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr.

Me të njëjtën rregull, mund të kalohet tek ofertat e renditura në vijim, në rast se diferenca e ofertës së radhës me ofertën fituese fillestare, të mos jetë më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës, të renditur para saj.

Neni 31

Njoftimi i skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve

Ky njoftim përmban të gjitha arsyet e skualifikimit të një ofertuesi apo kandidati në një procedurë prokurimi.

Neni 32

Njoftimi i fituesit

1. Menjëherë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen ose përfundohen në formë shkresore, autoriteti/enti kontraktor publikon njoftimin e fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit, sipas parashikimeve të nenit 109 të LPP-së, dhe këtyre rregullave.

3. Njoftimi i fituesit për kontratën duhet të përmbajë të paktën:

- emrin dhe adresën e autoritetit/entit kontraktor;

- referencën e procedurës;

- objektin e prokurimit (përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve);

- emrin, NIPT-in dhe adresën e ofertuesit/ve (në rast të bashkimit të operatorëve), të shpallur fitues;

- kohëzgjatjen e kontratës dhe çmimin/vlerën e ofertës fituese;

- emrat, NIPT-et dhe çmimet/vlerën e ofertuesve të tjerë;

- emrat, NIPT-et e ofertuesve të skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit.

4. Njoftimi i fituesit për marrëveshjen kuadër duhet të përmbajë të paktën:

- emrin dhe adresën e autoritetit/entit kontraktor;

- referencën e procedurës;

- emrin, NIPT-in dhe adresën e ofertuesit/ofertuesve të shpallur fitues;

- objektin e prokurimit (përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve);

- kohëzgjatjen e marrëveshjes kuadër dhe çmimin/vlerën e ofertës/ave fituese;

- emrat, NIPT-et dhe çmimet/vlerën e ofertuesve të tjerë;

- emrat, NIPT-et e ofertuesve të skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit.

5. Në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë një njoftim për fituesin, pas procesit të ankimit, me të cilin njofton fituesin për vijimin e hapave të mëtejshëm drejt nënshkrimit të kontratës.

Neni 33

Formulari i ankesës

Kundër veprimeve ose mosveprimeve të autoritetit/entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar mund të bëjnë ankesë pranë këtij të fundit dhe Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet një formulari standard, i cili përmban



udhëzimet e nevojshme për plotësimin dhe nënshkrimin e tij.

Neni 34

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës

1. Kushtet e përgjithshme të kontratës përcaktojnë kushtet e zbatueshme sipas tipit të kontratave për mallra, për punë ose për shërbime.

2. Kushtet e veçanta të kontratës përkufizojnë tërësinë e punëve që do të kryhen, të gjitha mallrat apo shërbimet që do të furnizohen, të drejtat dhe detyrimet ndërmjet autoritetit/entit kontraktor dhe kontraktorit, si dhe detyrimet për përmbushjen, mbikëqyrjen dhe administrimin e kontratës.

Neni 35

Marrëveshja kuadër

Marrëveshja kuadër përmban formën e marrëveshjes, objektin, si dhe termat e kushtet e marrëveshjes.

Neni 36

Sigurimi i kontratës

1. Sigurimi i kontratës garanton autoritetin/entin kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës. Para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i përzgjedhur si fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit/entit kontraktor një sigurim kontrate prej 10% të vlerës së saj. Sigurimi i kontratës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari. Ky afat nuk mund të jetë më i gjatë se afati për përfundimin e garancisë së punëve/shërbimit/mallrave, kur një gjë e tillë parashikohet në kontratë.

2. Gjatë ekzekutimit, nëse janë parashikuar pagesa periodike sipas grafikut të zbatimit të kontratës, kontraktori mund të kërkojë reduktimin e përqindjes së vlerës së sigurimit në mënyrë përpjesëtimore. Në çdo rast, të paktën 25% e vlerës korresponduese të sigurimit të kontratës do të mbetet si garanci deri në përfundim të afatit të sigurimit të kontratës.

Neni 37

Njoftimi i lidhjes së kontratës

1. Autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim njoftimin e lidhjes së kontratës brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi i saj.

2. Njoftimi i lidhjes së kontratës duhet të përmbajë të paktën:

- emrin dhe adresën e autoritetit/entit kontraktor;
- numrin e referencës së procedurës/kontratës;
- objektin e kontratës (përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve);
- emrin, NIPT-in dhe adresën e ofertuesit/ofertuesve (në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë), me të cilin është nënshkruar kontrata;
- çmimin dhe kohëzgjatjen e kontratës;
- të dhëna të tjera nga autoriteti/enti kontraktor.

3. Autoriteti kontraktor duhet të dërgojë për publikim kontratën fituese për çdo kontratë të lidhur nga një marrëveshje kuadër.

Neni 38

Njoftimi i anulimit

1. Autoriteti/enti kontraktor publikon njoftimin për anulimin e procedurës së prokurimit, menjëherë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga marrja e vendimit.

2. Njoftimi i anulimit duhet të përmbajë të paktën:

- emrin dhe adresën e autoritetit/entit kontraktor;
- numrin e referencës së procedurës;
- objektin e procedurës së prokurimit (përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve);
- emrin, NIPT-et dhe adresat e ofertuesve;
- arsyet dhe bazën ligjore të anulimit të procedurës, sipas përcaktimeve të nenit 98, të LPP-së.

3. Në përfundim të afatit për paraqitjen e ankesave apo dhënies së një vendimi përfundimtar për ankesën, autoriteti/enti kontraktor vijon me publikimin e vendimit përfundimtar.



SEKSIONI III
KËRKESA TË VEÇANTA SIPAS TIPAVE
TË KONTRATAVE

Neni 39

**Kërkesa të veçanta për kontratat për punë
publike**

1. Punët publike mund të prokurohen:

a) me anë të punimeve me matje, në bazë të çmimeve fikse, në rastet kur vëllimi i punëve të specifikuar në projektpreventiv mund të ndryshojë gjatë realizimit. Në këtë rast, kontraktori është i detyruar të ruajë, pa asnjë ndryshim çmimet për njësi të përcaktuara në ofertën e dorëzuar.

Kur punët prokurohen me anë të punimeve me matje, vëllimi i punëve jepet me hollësi dhe përmban të gjitha çmimet dhe përqindjet që autoriteti/enti kontraktor i vlerëson të nevojshme (si për shembull: fondi rezervë, të ardhurat minimale, shpenzimet minimale).

b) me kontratë me çelësa në dorë:

i. Ku vëllimi i punëve i parashikuar në projektpreventiv mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit.

Në këtë rast, kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

ii. Kur autoriteti kontraktor nuk ka hartuar projektpreventiv, por ka vetëm një projektide apo detyrë projektimi dhe terma reference për objektin që prokuron.

Në këtë rast, autoriteti kontraktor kërkon nga kontraktori hartimin e projektpreventivit, si dhe realizimin e punimeve të zbatimit të këtij projekti, pas miratimit paraprak të tij nga autoriteti kontraktor.

Autoriteti/enti kontraktor duhet të kërkojë nga ofertuesit disponimin e kapaciteteve teknike për realizimin e secilës fazë të sipërcituar: për hartimin e projektit, si dhe për realizimin e tij, duke lejuar edhe mundësinë që projektimi mund të nënkontraktohet apo që ofertuesi (zbatuesi i punimeve) të paraqesë kontratë bashkëpunimi me subjekte që operojnë në fushën e projektimit dhe që plotësojnë të gjitha kriteret e hartuara nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë qëllim.

Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, sipas projektpreventivit të miratuar paraprakisht nga autoriteti kontraktor, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

2. Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.

3. Autoriteti/enti kontraktor në dokumentet e tenderit parashikon me grafik, fazat dhe afatet e realizimit të punëve.

4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë vjetëve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj



dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon, që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të

hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me vlerën totale të përlogaritur të kontratës/ave.

Neni 40

Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave

1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të livrojnë, si dhe grafikun e livrimit të mallrave.

2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.



5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon, që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

9. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlogaritur.

Neni 41

Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve

1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera e



kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën;

d) në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

5. Për të provuar, se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon, që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim, në përputhje me fondin total të përllogaritur.

Neni 42

Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit.

Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

4. Autoriteti/enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose, kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi



kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa, ose për të gjitha lotet.

5. Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, me kusht që numri maksimal i loteve për ofertues të deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.

6. Kur zbatimi i kritereve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve se sa numri maksimal, autoriteti/enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen. Këto kritere duhet të jenë në përputhje me LPP-në dhe me ato të përcaktuara në nenin 91 të këtyre rregullave.

7. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti/enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, vetëm nëse ka specifikuar më parë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

8. Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkojnë operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

9. Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.

Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit, të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vjetët e fundit financiarë.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkojnë operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur, nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vjetët e fundit financiarë, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur, nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

5. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiros minimale llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

6. Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Neni 44

Kërkesat e cilësisë

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në



specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37 të LPP-së.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

3. Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

4. Nëse autoriteti/enti kontraktor kërkojnë një certifikatë ose etiketë, ata janë të detyruar të pranojnë çdo certifikatë ose etiketë ekuivalente/të barasvlershme me të ose një dokument që provon të njëjtin informacion.

5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Neni 45

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

1. Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose të kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim–cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve, që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

3. Për punët/mallrat/shërbimet, që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të

mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.

4. Në kontratat, që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet, në:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose

c) shërbimin, koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

5. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë, në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

7. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar



ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

8. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.

KREU VI LLOJET DHE PËRZGJEDHJA E PROCEDURËS

Neni 46

Llojet e procedurave të prokurimit

1. Në përzgjedhjen e kontratave publike, autoriteti/enti kontraktor zbaton konkurset e projektimit dhe procedurat standarde të prokurimit publik, të përcaktuara në nenin 41 të LPP-së.

2. Llojet e procedurave që duhen përdorur në përzgjedhjen e kontratave të prokurimit publik, janë:

- a) procedurë e hapur;
- b) procedurë e kufizuar;
- c) partneritet për inovacion;
- ç) dialogu konkurrues;
- d) shërbim konsulence;
- dh) procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;
- e) procedurë konkurruese me negociim, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave të sektorit klasik;
- ë) procedurë me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave sektoriale;
- f) procedurë e hapur e thjeshtuar;
- g) prokurim me vlerë të vogël.

Neni 47

Procedura e hapur

1. Procedura e hapur, sipas nenit 42, të LPP-së, është procedura e prokurimit me një fazë, që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor që prokuron punë/shërbime/mallra, me një vlerë mbi kufirin e ulët monetar.

2. Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinën e Njoftimeve Publike, në përputhje me nenin 56 të LPP-së dhe me këto rregulla.

3. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 42, të LPP-së. Autoriteti/enti kontraktor mund të përlogarisë afate më të gjata se afatet minimale të përcaktuara në LPP, kur një gjë e tillë diktohet nga kompleksiteti i objektit të prokurimit apo i kërkesave që do të duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë.

4. Pas mbarimit të afatit për paraqitjen e ofertave, të përcaktuar në njoftimin e kontratës, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 42 të LPP-së, autoriteti/enti kontraktor hap ofertat, vlerëson dokumentacionin e ofertuesve, në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenet 76 e 77, të LPP-së dhe këtyre rregullave dhe përzgjedh ofertën fituese, pas krahasimit të ofertave, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 87, të LPP-së.

Neni 48

Procedura e kufizuar

1. Procedura e kufizuar, sipas nenit 43, të LPP-së, është procedurë prokurimi me dy faza, që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor që prokuron punë/shërbime/mallra, në të cilën mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar.

2. Autoriteti/enti kontraktor, në përzgjedhjen e kësaj procedure, duhet të mbajë parasysh:

- a) kompleksitetin e objektit të kontratës;
- b) gjendjen e tregut;
- c) numrin e pritshëm të ofertuesve.

3. Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 77, të këtyre rregullave, duhet të japë arsyet për përdorimin e kësaj procedure.

4. Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinën e Njoftimeve Publike, në përputhje me



LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, njoftimi i kontratës shoqërohet me ftesën për shprehje interesi për procedurën e prokurimit. Çdo operator i interesuar ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në fazën e parë të kualifikimit.

5. Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë.

Nëse do të përdorë këtë mundësi, autoriteti/enti kontraktor duhet ta bëjë të ditur në njoftimin e kontratës, ku duhet të përcaktojë dhe numrin minimal të kandidatëve që synon të ftojë dhe, sipas rastit, numrin maksimal.

6. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 43, të LPP-së. Autoriteti/enti kontraktor mund të përllogarisë afate më të gjata se afatet minimale të përcaktuara në LPP, kur një gjë e tillë diktohet nga kompleksiteti i objektit të prokurimit apo kërkesave që do të duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë.

7. Pas mbylljes së fazës së parë të kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, sipas parashikimit në nenin 110, të LPP-së, autoriteti/enti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur të dorëzojnë ofertat.

Ofertat duhet të hartohen në bazë të specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë, sipas afateve të përcaktuara në nenin 43, të LPP-së.

8. Në përfundim të procesit të vlerësimit të dokumentacionit të ofertuesve, në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenet 76 e 77, të LPP-së dhe këtyre rregullave, autoriteti/enti kontraktor përzgjedh ofertën fituese, pas krahasimit të ofertave, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 87 të LPP-së.

Neni 49

Procedurë konkurruese me negociim, në rastet e kontratave të sektorit klasik

1. Procedura konkurruese me negociim është procedura e prokurimit me faza, që mund të përdoret nga çdo autoritet kontraktor, vetëm në rastet e parashikuara në nenin 51, të LPP-së.

2. Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 77, të këtyre rregullave, duhet të japë arsyet për përdorimin e kësaj procedure.

3. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 44, të LPP-së. Autoriteti kontraktor mund të përllogarisë afate më të gjata se afatet minimale të përcaktuara në LPP, kur një gjë e tillë diktohet nga kompleksiteti i objektit të prokurimit apo kërkesave që do të duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë.

4. Njoftimi i kontratës hartohet e publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla.

Në çdo rast, njoftimi i kontratës shoqërohet me ftesën për shprehje interesi për procedurën e prokurimit. Çdo operator i interesuar ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në fazën e parë të kualifikimit.

5. Autoriteti mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë.

Nëse do të përdorë këtë mundësi, autoriteti kontraktor duhet ta bëjë të ditur në njoftimin e kontratës, ku duhet të përcaktojë dhe numrin minimal të kandidatëve që synon të ftojë dhe, sipas rastit, numrin maksimal.

6. Pas mbylljes së fazës së parë të kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 110 të LPP-së, autoriteti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur të dorëzojnë ofertat tekniko-ekonomiko. Vetëm operatorët ekonomikë që janë ftuar nga autoriteti ose enti kontraktor mund të paraqesin ofertë fillestare, e cila shërben si bazë për negociimet vijuese.

7. Autoriteti kontraktor mund të negociojë individualisht me secilin nga ofertuesit e përzgjedhur deri në përcaktimin e ofertës fituese sipas parashikimit në LPP. Nuk ka një limit për numrin e fazave të njëpasnjëshme të negociimit, me kusht që autoriteti ose kontraktor të ketë publikuar informacionin ose të njoftojë rregullisht të gjithë ofertuesit për çdo fazë të negociimit sipas përcaktimit në nenin 44, të LPP-së.

8. Gjatë fazës së negociimit, autoriteti kontraktor, synon që ofertat të qartësohen, specifikohen dhe të përshtaten sipas kërkesës dhe nevojës së autoritetit kontraktor. Megjithatë, ky qartësim, specifikim, përshtatje ose informacion shtesë nuk duhet të përfshijë ndryshime në aspektet kryesore të ofertës, duke përfshirë nevojat dhe



kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës, të cilat mund të shtrembërojnë konkurrencën ose të kenë efekt diskriminues.

Nevojat dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës nuk mund të ndryshohen në këtë fazë, pasi do të përfitohet një kontratë e ndryshme nga ajo, për të cilën është realizuar procedura e prokurimit.

9. Në përfundim të procesit të vlerësimit të dokumentacionit të ofertuesve, në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenet 76 e 77 të LPP-së dhe këtyre rregullave, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertën fituese, pas krahasimit të ofertave, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 87, të LPP-së.

Neni 50

Dialogu konkurrues

1. Dialogu konkurrues është procedura e prokurimit me tri faza: faza parakualifikuese, faza e dialogut dhe faza e paraqitjes së ofertës përfundimtare, që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor vetëm në rastet e parashikuara në nenin 51, të LPP-së.

2. Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 77 të këtyre rregullave, duhet të japë arsyet për përdorimin e kësaj procedure.

3. Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, njoftimi i kontratës shoqërohet me ftesën për shprehje interesi për procedurën e prokurimit.

4. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 45 të LPP-së. Autoriteti/enti kontraktor mund të përllogarisë afate më të gjata se afatet minimale të përcaktuara në LPP, kur një gjë e tillë diktohet nga kompleksiteti i objektit të prokurimit apo kërkesave që do të duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë.

5. Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë.

Nëse do ta përdorë këtë mundësi, autoriteti/enti kontraktor duhet ta bëjë të ditur në njoftimin e kontratës, ku duhet të përcaktojë dhe numrin minimal të kandidatëve që synon të ftojë dhe, sipas rastit, numrin maksimal.

6. Çdo operator i interesuar ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në fazën e parë të kualifikimit, në përgjigje të njoftimit të kontratës apo edhe të njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi në rastin e kontratave sektoriale, duke dhënë informacionin që kërkohet, nga autoriteti ose enti kontraktor.

7. Pas mbylljes së fazës së kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 110 të LPP-së, autoriteti/enti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur në fazën e dialogut. Vetëm operatorët ekonomikë që janë ftuar nga autoriteti ose enti kontraktor mund të marrin pjesë në këtë fazë.

8. Në këtë procedurë, kontrata jepet vetëm mbi bazën e kriterit të raportit çmim–cilësi, sipas parashikimeve në LPP.

9. Autoriteti/enti kontraktor fillon dialogun individual me pjesëmarrësit e përzgjedhur sipas parashikimeve në LPP, me qëllim identifikimin dhe përcaktimin e mjeteve që përshtaten më mirë me nevojat e tyre. Ata mund t'i diskutojnë të gjitha aspektet e prokurimit me pjesëmarrësit e përzgjedhur, gjatë këtij dialogu.

Dialogu mund të zhvillohet në disa faza për të ulur numrin e zgjidhjeve që do të diskutohen në fazat pasardhëse të dialogut, kur autoriteti/enti kontraktor e ka njoftuar këtë mundësi në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë.

Autoriteti/enti kontraktor nëse nuk bie dakord me të gjithë pjesëmarrësit për afatin ndërmjet fazave, cakton një afat të arsyeshëm dhe njofton pjesëmarrësit në kohë.

Autoriteti/enti kontraktor siguron trajtim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit dhe, në asnjë rast nuk jep informacione në mënyrë diskriminuese, të cilat mund të favorizojnë disa prej pjesëmarrësve.

Autoriteti/enti kontraktor nuk u tregon pjesëmarrësve të tjerë zgjidhjet e propozuara ose informacionin konfidencial që është komunikuar nga një kandidat ose një ofertues që merr pjesë në dialog, pa pëlqimin e këtij të fundit.

10. Gjatë fazës së dialogut, autoriteti/enti kontraktor synon që ofertat të qartësohen, specifikohen dhe të përshtaten, sipas kërkesës dhe nevojës së autoritetit/entit kontraktor. Megjithatë, ky qartësim, specifikim, përshtatje ose informacion shtesë nuk duhet të përfshijë ndryshime në aspektet kryesore të ofertës, duke përfshirë nevojat dhe



kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose ftesën për ofertë, të cilat mund të shtrembërojnë konkurrencën ose të kenë efekt diskriminues.

Nevojat dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose ftesën për ofertë, nuk mund të ndryshohen në këtë fazë, pasi do të përfitohet një kontratë e ndryshme nga ajo, për të cilën është realizuar procedura e prokurimit.

11. Pasi të ketë arritur në një zgjidhje të kënaqshme, autoriteti/enti kontraktor deklaron mbylljen e dialogut dhe informon pjesëmarrësit që kanë mbetur për përfundimin e kësaj faze.

12. Autoriteti/enti kontraktor i kërkon secilit prej pjesëmarrësve të mbetur në garë, të paraqesin ofertat përfundimtare, në bazë të zgjidhjes ose zgjidhjeve të paraqitura dhe të specifikuara gjatë dialogut. Këto oferta përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe të nevojshme për realizimin e projektit.

13. Autoriteti/enti kontraktor shqyrton dhe vlerëson ofertat e marra dhe mund t'i kërkojë ofertuesit që ka dorëzuar ofertën me raportin më të mirë çmim–cilësi, sipas parashikimeve në LPP, përmes negociatave, të konfirmojë angazhimet financiare ose kushtet e tjera që përmban oferta, duke finalizuar kushtet e kontratës, nëse kjo nuk ndikon në ndryshimin e aspekteve thelbësore të ofertës, nevojave dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë, të cilat mund të shtrembërojnë konkurrencën ose të kenë efekt diskriminues.

14. Nëse autoriteti/enti kontraktor ka parashikuar pagesa për pjesëmarrësit në dialog, në varësi të natyrës dhe të kostos që ka objekti i prokurimit, kur një gjë e tillë është njoftuar në njoftimin e kontratës dhe/ose ftesën për ofertë, do ta kryejë pagesën pas nënshkrimit të kontratës me ofertuesin fitues.

Neni 51

Partneriteti për inovacion

1. Partneriteti për inovacion është procedurë prokurimi me faza, që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor vetëm në rastet e parashikuara në nenin 46 të LPP-së, kur, si rregull, mallrat, punët ose shërbimet që kërkohen të prokurohen nuk janë produkte të gatshme në treg dhe produkti i përfituar në përfundim të kontratës është një inovacion.

Autoriteti/enti kontraktor duhet të bëjë të qartë në dokumentet e tenderit, faktin që partneriteti për inovacion ka si qëllim zhvillimin e një produkti, shërbimi apo pune inovatore dhe blerjen më pas të mallrave, shërbimeve ose punëve që rezultojnë prej tyre nëse ato përkojnë me nivelet e performancës dhe kostot minimale të dakordësuara ndërmjet autoritetit ose entit kontraktor dhe pjesëmarrësve. Në këtë kuadër, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë edhe objektiva të ndërmjetëm, të cilët duhet të arrihen nga partnerët/kontraktuesit dhe pagesat përkatëse që do të bëhen sipas një plani të caktuar.

2. Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 77, të këtyre rregullave, duhet të japë arsytet për përdorimin e kësaj procedure.

3. Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinën e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, njoftimi i kontratës shoqërohet me ftesën për shprehje interesi për procedurën e prokurimit. Çdo operator ekonomik i interesuar mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në fazën e parë të kualifikimit, në përgjigje të njoftimit të kontratës apo edhe të njoftimit periodik të informacionit në rastin e kontratave sektoriale, duke dhënë informacionin që kërkohet, nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 46 të LPP-së. Autoriteti/enti kontraktor mund të përllogarisë afate më të gjata se afatet minimale të përcaktuara në LPP, kur një gjë e tillë diktohet nga kompleksiteti i objektit të prokurimit apo kërkesave që do të duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë.

5. Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë.

Nëse do të përdorë këtë mundësi, autoriteti/enti kontraktor duhet ta bëjë të ditur në njoftimin e kontratës, ku duhet të përcaktojë dhe numrin minimal të kandidatëve që synon të ftojë dhe, sipas rastit, numrin maksimal.

6. Pas mbylljes së fazës së kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 110 të LPP-së, autoriteti/enti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur për të paraqitur një ofertë fillestare.



Vetëm ata operatorë ekonomikë që ftohen nga autoriteti/enti kontraktor, pasi ky i fundit ka vlerësuar informacionin e kërkuar, mund të dorëzojnë projekte kërkimi dhe inovacioni, që kanë si qëllim përmbushjen e nevojave të autoritetit/entit kontraktor, të cilat nuk mund të përmbushen nëpërmjet zgjidhjeve ekzistuese.

7. Në këtë procedurë kontrata jepet vetëm mbi bazën e kriterit të raportit çmim–cilësi, sipas parashikimeve në LPP.

8. Autoriteti/enti kontraktor mund të vendosë që të krijojë partneritet për inovacion me një partner ose disa partnerë që kryejnë veprimtari të veçanta kërkimi dhe zhvillimi.

9. Autoriteti/enti kontraktor zhvillon faza të njëpasnjëshme me pjesëmarrësit e përzgjedhur sipas parashikimeve në LPP, bazuar në hapat e procesit të kërkimit dhe të zhvillimit, me qëllim identifikimin dhe përcaktimin e mjeteve që përshtaten më mirë me nevojat e tyre. Fazat e njëpasnjëshme mund të përfshijnë prodhimin e produkteve, ofrimin e shërbimeve ose përfundimin e punëve.

Autoriteti/enti kontraktor negocion me ofertuesit, sipas parashikimeve në LPP, ofertat fillestare dhe të gjitha ofertat pasuese që ata kanë dorëzuar për të përmirësuar përmbajtjen e tyre, përveç ofertës përfundimtare.

Kërkesat minimale dhe kriteret e përzgjedhjes nuk janë objekt negocimi. Nevojat dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose ftesën për ofertë, nuk mund të ndryshohen në këtë fazë, pasi do të përfitohet një kontratë e ndryshme nga ajo, për të cilën është realizuar procedura e prokurimit.

10. Autoriteti/enti kontraktor informon me shkrim të gjithë ofertuesit, të cilët kalojnë në fazën tjetër, për çdo ndryshim në specifikimet teknike ose dokumente të tjera të tenderit, përveç atyre që përcaktojnë kërkesat minimale. Pas këtyre ndryshimeve, autoriteti/enti kontraktor parashikon një kohë të mjaftueshme që ofertuesit të modifikojnë dhe të dorëzojnë përsëri ofertat e ndryshuara, sipas rastit.

Negociatat gjatë procedurave të partneritetit për inovacion mund të zhvillohen në faza të njëpasnjëshme, për të ulur numrin e ofertave që do të negociohen bazuar në kriteret e përzgjedhjes, kur autoriteti/enti kontraktor e ka njoftuar këtë mundësi në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë.

Autoriteti/enti kontraktor siguron trajtim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit, dhe në asnjë rast nuk jep informacione në mënyrë diskriminuese, të cilat mund të favorizojnë disa prej pjesëmarrësve.

Autoriteti/enti kontraktor nuk u tregon pjesëmarrësve të tjerë, zgjidhjet e propozuara ose informacionin konfidencial që është komunikuar nga një kandidat ose një ofertues që merr pjesë në negociatë, pa pëlqimin e këtij të fundit.

11. Autoriteti/enti kontraktor garanton që struktura e partneritetit dhe, në veçanti, kohëzgjatja dhe vlera e fazave të ndryshme të pasqyrojë shkallën e inovacionit të zgjidhjes së propozuar dhe rendin e veprimtarive të kërkimit dhe inovacionit të nevojshme për zhvillimin e një zgjidhjeje inovatore ende të padisponueshme në treg. Vlera e parashikuar e mallrave, shërbimeve ose punëve duhet të jetë në proporcion me investimin që kërkohet për realizimin e tyre.

12. Bazuar mbi objektivat e vendosur nga autoriteti/enti kontraktor dhe rezultatet për çdo fazë, ai mund të vendosë që ta përfundojë partneritetin për inovacion pas çdo faze ose, në rastin e partneritetit për inovacion me disa partnerë, të reduktojë numrin e tyre, duke zgjidhur kontratat individuale. Në çdo rast, një mundësi e tillë dhe kushtet për përdorimin e saj duhet të parashikohet qartësisht në dokumentet e tenderit.

13. Duke qenë se, produktet e përfituara nga kjo procedurë janë në vetvete zgjidhje inovatore, autoriteti/enti kontraktor përcakton rregullat e zbatueshme për të drejtat e pronësisë intelektuale në dokumentet e tenderit. Në rastin e një partneriteti për inovacion me disa partnerë, bazuar mbi parimet e konfidencialitetit të parashikuara në këtë ligj, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet t'u tregojë partnerëve të tjerë zgjidhjet e propozuara ose informacione të tjera konfidenciale të komunikuar nga një partner në kuadrin e partneritetit, pa pëlqimin e tij.

Neni 52

Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës

1. Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, është procedurë prokurimi me faza, që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor që prokuron punë/shërbime/mallra,



vetëm në rastet e parashikuara në nenin 47 të LPP-së, kur:

a) Në përgjigje të dy procedurave të njëpasnjëshme të hapura ose të hapura të thjeshtuara, shërbimit të konsulencës ose procedurës së kufizuar apo në përgjigje të një procedure të publikuar për konkurrim të lidhur me aktivitetet sektoriale, sipas kreut VIII të LPP-së, nuk është paraqitur asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje, ose kur ofertat apo kërkesat për pjesëmarrje të dorëzuara kanë qenë të papërshtatshme. Në çdo rast, kushtet fillestare të kontratës nuk duhet të kenë pësuar ndryshime thelbësore.

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor mund të përdorë procedurën me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit, kur në përgjigje të procedurës negociim me shpallje paraprake të njoftimit, nuk është paraqitur asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje ose ato që janë dorëzuar kanë qenë të papërshtatshme, duke pasur parasysh që kushtet fillestare të kontratës të mos kenë pësuar ndryshime thelbësore.

Ofertat dhe kërkesa për pjesëmarrje, konsiderohen si të papërshtatshme, kur mangësitë nuk kanë lidhje me kontratën dhe duket qartë që nuk mund të plotësojnë, pa pësuar ndryshime thelbësore, nevojat dhe kërkesat e autoritetit/entit kontraktor, të specifikuar në dokumentet e tenderit, si edhe kur operatori ekonomik ndodhet në kushtet e skualifikimit, sipas nenit 76 të LPP-së ose nuk përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor sipas nenit 77 të LPP-së.

Në çdo rast, mosdorëzimi i asnjë oferte apo kërkesë për pjesëmarrje nuk duhet të vijë si shkak i gabimeve të bëra në dokumentet e tenderit dhe/ose për shkak të ndonjë veprimi të autoritetit/entit kontraktor.

b) Kur punët, mallrat apo shërbimet mund të ofrohen vetëm nga një operator ekonomik i caktuar, për një nga arsytet e mëposhtme:

- i. qëllimi i prokurimit është krijimi ose blerja e një veprë arti ose performance artistike unike;
- ii. për arsye teknike, nuk ka konkurrencë;
- iii. për të mbrojtur të drejtat ekskluzive, duke përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale.

Përjashtimet e përcaktuara në paragrafët “ii” dhe “iii” zbatohen vetëm kur nuk ekziston asnjë alternativë ose zëvendësim i arsyeshëm dhe

mungesa e konkurrencës nuk vjen si rezultat i kufizimit të kërkesave që autoriteti/enti kontraktor përcakton për objektin e prokurimit. Ekzistenca e këtyre kushteve duhet të vërtetohet e të dokumentohet nga autoritetet ose entet kontraktore.

c) Kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti/enti kontraktor, afatet kohore për procedurat e hapura, procedurat e hapura të thjeshtuara, procedurat e kufizuara, shërbimet e konsulencës, procedurat konkurruese me negociim ose procedurat me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit në kontratat sektoriale, nuk mund të respektohen. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga autoriteti/enti kontraktor.

Në këtë rast, duhet të plotësohen njëkohësisht të gjitha kushtet e mëposhtme:

- i. konstatimi i një ngjarjeje të paparashikuar;
- ii. autoriteti/enti kontraktor nuk ka përgjegjësi për ngjarjen;
- iii. ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshëm të një komuniteti të gjerë;
- iv. nuk është e mundur të ndiqen procedurat konkurruese mbi ose nën kufirin e ulët monetar.

Në të gjitha rastet, autoriteti/enti kontraktor duhet të vërtetojë, të argumentojë dhe të dokumentojë se nevoja ekstreme e konstatuar, nuk është shkaktuar nga veprimi a mosveprimi i tij.

Neglizhenca apo vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk janë shkaqe, që argumentojnë zbatimin e kësaj procedure.

Kjo procedurë nuk mund të zbatohet për të justifikuar lidhjen e kontratave afatgjata, por vetëm për përballimin e nevojës ekstreme.

Me krijimin e nevojës ekstreme, autoriteti/enti kontraktor duhet njëkohësisht, të marrë të gjitha masat për realizimin e procedurave normale të prokurimit.

Për kontratat e nënshkruara në përfundim të një procedure prokurimi, sipas kësaj shkronje, nuk mund të përdoret procedura me negociim, pa shpallje paraprake për mallra, shërbime ose punë shtesë, sipas parashikimeve në këtë nen.

ç) Kjo procedurë mund të përdoret për kontratat publike të mallrave:



i. Kur produktet e përfshira janë prodhuar vetëm për arsye kërkimi, eksperimentimi, studimi ose zhvillimi. Kontratat që jepen në zbatim të kësaj pike nuk përfshijnë prodhimin në masë për të arritur qëndrueshmëri tregtare ose për të mbuluar kostot e kërkimit dhe të zhvillimit;

ii. Për dorëzime shtesë nga furnizuesi fillestar, të cilat janë ose një zëvendësim i pjesshëm i mallrave apo i instalimeve ose si shtesë e mallrave apo e instalimeve ekzistuese, kur një ndryshim i furnizuesit do ta detyronte autoritetin ose entin kontraktor të marrë mallra me karakteristika të ndryshme teknike, të cilat do të rezultojnë në papërputhshmëri ose në vështirësi teknike joproporcionale në shfrytëzim dhe mirëmbajtje.

Kontrata, në këtë rast, duhet të nënshkruhet nga autoriteti/enti kontraktor brenda tre vjetëve nga lidhja e kontratës fillestare dhe vlera e këtyre furnizimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Ky përcaktim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Situata e parashikuar në këtë pikë nuk zbatohet për ato lloj mallrash, për të cilat autoriteti/enti kontraktor ka nevojë të vazhdueshme.

iii. Për mallrat e kuotuar dhe të blera në bursë;

iv. Për blerjet e mallrave me kushte veçanërisht të favorshme nga një furnitor që mbyll përfundimisht veprimtarinë e tij tregtare, është në proces falimenti, nga një marrëveshje me kreditorët ose sipas një procedure të ngjashme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

d) Kjo procedurë mund të përdoret për kontratat publike të shërbimit kur kontrata në fjalë pason një konkurs projektimi të organizuar në përputhje me LPP-në dhe, sipas rregullave të parashikuara në konkursin e projektimit, duhet t'i jepet fituesit ose njërit prej fituesve të konkursit të projektimit; në rastin e dytë të gjithë fituesit duhet të ftohen të marrin pjesë në negociata.

dh) Procedura me negociim pa shpallje paraprake mund të përdoret për punë ose shërbime të reja që kanë të bëjnë me përsëritje të punëve apo shërbimeve të ngjashme, që i janë besuar një operatori ekonomik, të cilit autoriteti/enti kontraktor i ka dhënë kontratën fillestare, me kusht që këto punë ose shërbime të përputhen me projektin bazë, për të cilin është lidhur kontrata fillestare mbi bazën e një procedure konkurruese. Në projektin bazë duhet të cilësohet niveli i punëve

ose i shërbimeve shtesë dhe kushtet, sipas të cilave ato do të jepen.

Situata e parashikuara në këtë pikë nuk zbatohet për ato lloj shërbimesh, për të cilat autoriteti kontraktor ka nevojë të vazhdueshme.

Përdorimi i mundshëm i kësaj procedure duhet të bëhet i ditur që në momentin e shpalljes së procedurës së parë, dhe autoriteti ose enti kontraktor, gjatë përlogaritjes së fondit limit duhet të marrë parasysh edhe një kosto të përgjithshme të punëve ose shërbimeve shtesë.

Kjo procedurë mund të përdoret vetëm brenda tre vjetëve nga data e lidhjes së kontratës fillestare dhe vlera nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Ky përcaktim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

2. Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 77, të këtyre rregullave, duhet të paraqesë arsyet e përdorimit të kësaj procedure.

3. Me përjashtim të rrethanave të parashikuara në pikat 1, shkronja “b”, 2, shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, 3 dhe 4, të nenit 47, të LPP-së, autoriteti/enti kontraktor fton jo më pak se 3 (tre) kandidatë, duke garantuar konkurrencë dhe barazi ndërmjet tyre.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e kandidatëve që do të ftojë.

4. Kur autoriteti/enti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen, duhet të provojë se kandidatët plotësojnë minimalisht kërkesat e nenit 76 dhe 77 të LPP-së.

5. Në rastin e procedurës së prokurimit me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen, afatet kohore parashikohen nga vetë autoriteti/enti kontraktor, në varësi të objektit të prokurimit dhe rrethanave, duke krijuar mundësinë që operatorët ekonomikë të ftuar të kenë mundësinë e përgatitjes së ofertës dhe të jenë të mos diskriminohen.



Neni 53

**Procedura me negocim, me shpallje
paraprake të njoftimit të kontratës, për
kontratat sektoriale**

1. Procedura me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, është një procedurë prokurimi me faza, e cila përdoret vetëm për prokurimin e kontratave sektoriale në rrethanat e parashikuara në nenin 48 të LPP-së.

2. Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 77 të këtyre rregullave, duhet të japë arsyet për përdorimin e kësaj procedure.

3. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 48 të LPP-së. Enti kontraktor mund të përllogarisë afate më të gjata se afatet minimale të përcaktuara në LPP, kur një gjë e tillë diktohet nga kompleksiteti i objektit të prokurimit apo kërkesave që do të duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë.

4. Njoftimi i kontratës ose ftesa për shprehje interesi për procedurën e prokurimit sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Çdo operator i interesuar ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në fazën e parë të kualifikimit, duke dhënë informacionin që kërkohet, nga enti kontraktor.

5. Enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në negocim, në përputhje me parashikimet e LPP dhe të këtyre rregullave.

Nëse do ta përdorë këtë mundësi, enti kontraktor duhet ta bëjë të ditur në njoftimin e kontratës, ku duhet të përcaktojë dhe numrin minimal të kandidatëve që synon të ftojë dhe, sipas rastit, numrin maksimal.

6. Pas mbylljes së fazës së kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 110 të LPP-së, enti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur për të negociuar. Vetëm ata operatorë ekonomikë që ftohen nga enti kontraktor, pasi ky i fundit ka vlerësuar informacionin e kërkuar, mund të marrin pjesë në negocim.

7. Në këtë procedurë, kontrata jepet vetëm mbi bazën e kriterit të raportit çmim–cilësi, sipas parashikimeve në LPP.

8. Negocimi mund të zhvillohet në disa faza, deri në përcaktimin e ofertës fituese.

Enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të ftuar në këtë fazë, vetëm nëse enti kontraktor e ka njoftuar këtë mundësi në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë.

Enti kontraktor nëse nuk bie dakord me të gjithë pjesëmarrësit për afatin ndërmjet fazave, cakton një afat të arsyeshëm, por jo më të shkurtër se afatet e parashikuara në nenin 48 të LPP-së, dhe njofton pjesëmarrësit në kohë.

Enti kontraktor siguron trajtim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit dhe, në asnjë rast, nuk jep informacione në mënyrë diskriminuese, të cilat mund të favorizojnë një ose disa prej pjesëmarrësve.

Enti kontraktor nuk u tregon pjesëmarrësve të tjerë zgjidhjet e propozuara ose informacionin konfidencial që është komunikuar nga një kandidat ose një ofertues që merr pjesë në negocim, pa pëlqimin e këtij të fundit.

Neni 54

Shërbim konsulence

1. Shërbim konsulence është një procedurë prokurimi me faza, e cila përdoret në rrethanat e parashikuara në nenin 50 të LPP-së, për shërbime të një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese.

2. Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 77 të këtyre rregullave, duhet të japë arsyet për përdorimin e kësaj procedure.

3. Në rastin e shërbimit të konsulencës, të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të jenë ekspertë të fushës së objektit që prokurohet.

4. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 50 të LPP-së. Autoriteti/enti kontraktor mund të përllogarisë afate më të gjata se afatet minimale të përcaktuara në LPP, kur një gjë e tillë diktohet nga kompleksiteti i objektit të prokurimit apo kërkesave që do të duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë.

5. Njoftimi i kontratës për shërbimin e konsulencës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimeve elektronike dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike. Ky njoftim përshkruan nevojat dhe kërkesat e autoritetit/entit kontraktor, karakteristikat e kontratës dhe kriteret minimale të përzgjedhjes së kandidatëve.



Njësia e prokurimit apo edhe struktura të specializuara duhet të hartojnë projektkontratën me përkufizime të qarta të objektivave, qëllimeve dhe të synimit të detyrës në fjalë dhe dokumentet e tenderit.

Çdo operator i interesuar ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në fazën e parë të kualifikimit, duke dhënë informacionin që kërkohej, nga autoriteti/enti kontraktor.

6. Në këtë procedurë kontrata jepet vetëm mbi bazën e kriterit të raportit çmim–cilësi, sipas parashikimeve në LPP.

7. Pas mbylljes së fazës së kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur me anë të një kërkesë për propozim, për të negociuar.

8. Autoriteti/enti kontraktor cakton një afat të arsyeshëm për paraqitjen e kërkesës për propozim, por jo më të shkurtër se afatet e parashikuara në nenin 50 të LPP-së.

Autoriteti/enti kontraktor siguron trajtim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit, dhe në asnjë rast nuk jep informacione në mënyrë diskriminuese, të cilat mund të favorizojnë një ose disa prej pjesëmarrësve.

Autoriteti/enti kontraktor nuk u tregon pjesëmarrësve të tjerë, zgjidhjet e propozuara ose informacionin konfidencial që është komunikuar nga një kandidat ose një ofertues që merr pjesë në këtë procedurë.

9. Përcaktimet e parashikuara në këtë nen janë njësoj të zbatueshme për konsulentin, si person fizik ose juridik, për stafin e konsulentit dhe nënkonsulentët, si dhe për bashkimet e konsulentëve.

Konsulentët mund të bashkohen me njëri-tjetrin, në formën e një bashkimi konsulentësh ose me një marrëveshje nënkonsulente, për plotësimin e fushave të tyre përkatëse të ekspertizës për fuqizimin e anës teknike të propozimeve të tyre dhe për vënien në dispozicion të një ekipi më të madh ekspertësh, për të ofruar propozime më të mira dhe, në disa raste, për të ofruar çmime më të ulëta. Një bashkim i tillë mund të krijohet për një afat të gjatë, pavarësisht nga detyra specifike ose mund të krijohet edhe për një detyrë të veçantë. Në çdo rast, ky bashkim duhet të dokumentohet me një kontratë të lidhur.

Në rastin e bashkimit të konsulentëve, secili prej tyre duhet të plotësojë kriteret detyruese për

kualifikim sipas nenit 76, të LPP-së, ndërkohë kërkesat për kualifikim sipas përcaktimit në nenin 77, të LPP-së, dhe këto rregulla plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi.

10. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kriterëve të përcaktuara në LPP, për skualifikimin e kandidatëve ose të ofertuesve duhet të vlerësojë edhe mbi kushtet e konfliktit të interesit, nëpërmjet vetëdeklarimeve për situatat si vijon:

a) Konfliktin ndërmjet konsulentëve. Konsulentët nuk mund të ofertojnë me të njëjtën përbërje të stafit. Për këtë qëllim, anëtarët e stafit të një konsulenti duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë e tyre për konsulentin dhe mosangazhimin në konsulentë të tjerë ofertues në të njëjtën procedurë.

b) Konfliktin ndërmjet veprimtarive të konsulencës dhe prokurimit të mallrave, punëve ose shërbimeve. Në këtë rast, operatori ekonomik i kontraktuar nga autoriteti kontraktor për mallra, punë ose shërbime për një projekt dhe secili prej anëtarëve të tij duhet të skualifikohet nga ofrimi i shërbimeve të konsulencës që lidhen me këto mallra, punë ose shërbime. Nga ana tjetër, konsulenti i kontraktuar nga autoriteti kontraktor për përgatitjen ose zbatimin e një projekti dhe secili prej anëtarëve të tij duhet të skualifikohet nga furnizimi i mallrave, kryerja e punëve ose shërbimeve (me përjashtim të shërbimeve të konsulencës), që rrjedhin ose janë të lidhura drejtpërdrejt me shërbimet e konsulencës për këtë përgatitje ose zbatim.

c) Konfliktin ndërmjet detyrave të konsulencës. As konsulentët dhe as ndonjëri prej anëtarëve të stafit të tyre nuk duhet të punësohen për kryerjen e ndonjë detyre që për nga natyra e saj mund të jetë në konflikt me një detyrë tjetër të konsulentëve.

ç) Marrëdhënien me stafin e autoritetit/entit kontraktor: konsulentët (përfshirë stafin e tyre dhe nënkonsulentët) nuk duhet të kenë marrëdhënie biznesi ose familjare me një anëtar të stafit të autoritetit/entit kontraktor, direkt ose indirekt, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

11. Hapat e procedurës së shërbimit të konsulencës janë:

a) Në fazën e parë të kualifikimit, autoriteti/enti kontraktor përgatit preventivin e kostos dhe



buxhetit, të cilat janë pjesë e njoftimit të kontratës. Preventivi i kostos bazohet në vlerësimin që autoriteti ose enti kontraktor u bën burimeve që i nevojiten për të përmbushur detyrën: kostoja për stafin, mbështetja logjistike dhe inputi fizik.

Kostot duhet të ndahen në dy kategori kryesore:

- i. tarifiat (ose shpërblimi);
- ii. rimbursimet.

b) Në fazën e dytë, kërkesa për propozime, që u dërgohet kandidatëve të përcaktuar në listën e shkurtër, përfshin:

i. ftesat, ku deklarohen qëllimi i autoritetit ose entit kontraktor për të nënshkruar kontratën për shërbimet e konsulencës, burimi i fondeve, hollësi të tjera për kandidatin, adresa, data, ora e përcaktuar për dorëzimin e propozimeve;

ii. udhëzimet për ofertuesit, ku jepet i gjithë informacioni i nevojshëm që do t'i ndihmonte ofertuesit për përgatitjen e propozimeve, si dhe informacione për procesin e vlerësimit, metodologjinë, kriteret e vlerësimit e faktorët e rëndësishëm përkatës të tyre dhe pikët minimale për cilësinë;

iii. periudhën e vlefshmërisë së propozimit;

iv. kushtet e projektkontratës, që do të prokurohet;

v. afatet kohore për dorëzimin e propozimeve;

vi. formularin e sigurimit të ofertës sipas përcaktimit në LPP.

Nga marrja e kërkesës për propozim deri në afatin e fundit për dorëzimin e propozimeve, ofertuesit mund të kërkojnë sqarime për informacionet e dhëna në kërkesën për propozime. Autoriteti/enti kontraktor jep sqarimet përkatëse dhe ua dërgon të gjithë kandidatëve të përcaktuar në listën e shkurtër. Nëse është e nevojshme, autoriteti/enti kontraktor zgjat afatet kohore për dorëzimin e propozimeve, duke argumentuar dhe dokumentuar nevojën për këtë zgjatje.

c) Propozimet teknike dhe ekonomike duhet të dorëzohen në të njëjtën kohë, të ndara nga njëra-tjetra. Pas mbarimit të afateve kohore për dorëzim, nuk duhet të pranohet asnjë ndryshim i propozimeve teknike ose ekonomike. Propozimet teknike, hapen menjëherë pas mbarimit të afatit për dorëzimin e propozimeve, ndërkohë që propozimet ekonomike mbeten të pahapura. Çdo propozim që merret pas mbarimit të afatit, kthehet i pahapur.

ç) Vlerësimi i propozimeve teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

- i. përvojën e konsulentit;
- ii. cilësinë e metodologjisë së propozuar;
- iii. kualifikimet e stafit kryesor të propozuar;
- iv. transferimin e njohurive, nëse kërkohet.

Nëse nuk kërkohet, pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t'i shtohen kriterit “kualifikimet e stafit kryesor të propozuar”.

Çdo kriter vlerësohet në një shkallë nga 1 deri në 100 dhe më tej, pesha e tyre kthehet në pikë përkatëse. Minimumi i pikëve të propozimit teknik për të vazhduar me vlerësimin e propozimit ekonomik është 70 pikë. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.

Vlerësimi i propozimeve teknike kryhet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga afati i përfundimtar i përcaktuar për hapjen e tyre.

Secili prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të shpjegojë në detaje vlerësimin e tij.

Në çdo rast, ky proces dokumentohet.

Autoriteti/enti kontraktor vë në dijeni ofertuesit që kanë dorëzuar propozime për çdo vlerësim teknik me pikë për secilin konsulent. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor njofton ata konsulentë, propozimet e të cilëve, nuk kanë arritur të fitojnë pikët minimale ose që janë vlerësuar se nuk i plotësojnë kërkesat për propozim, dhe nuk vijon me hapjen e propozimeve të tyre ekonomike.

d) Në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor njofton konsulentët që kanë realizuar pikët minimale kualifikuese për datën, orën dhe adresën për hapjen e propozimeve ekonomike.

Propozimet ekonomike hapen publikisht, në prani të përfaqësuesve të konsulentëve që marrin pjesë, vetë ose përmes telekonferencës apo mjeteve të tjera elektronike, nëse është e mundur. Emri i ofertuesit, pikët e vlerësimit teknik dhe çmimet e propozuara lexohen me zë të lartë dhe regjistrohen gjatë hapjes së propozimeve ekonomike. Për vlerësimin në çmim përfshihen të gjitha pagesat e konsulentëve, si dhe shpenzimet e tjera, si p.sh., shpenzimet për udhëtime, përkthimin, printimin e raporteve ose shpenzimet sekretariale. Propozimit me çmimin më të ulët i jepet vlerësimi financiar prej 100 pikësh, ndërsa propozimeve të tjera u



jepen vlerësime financiare ku çmimet e tyre janë në përpjesëtim me çmimin më të ulët.

dh) Vlerësimi përfundimtar total në pikë realizohet duke mbledhur pikët për cilësinë dhe koston. Pikët për “koston” caktohen duke marrë parasysh kompleksitetin e objektit të kontratës së prokurimit, si dhe rëndësinë përkatëse të cilësisë.

e) Në vijim, autoriteti/enti kontraktor identifikon ofertën më të mirë dhe shpall ofertuesin fitues. Në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor fillon bisedimet me fituesin për të sqaruar dhe për të përmirësuar kushtet e kontratës, metodologjinë, përbërjen e stafit dhe kushtet e veçanta. Bisedimet nuk duhet t'i ndryshojnë në mënyrë thelbësore kushtet fillestare të kontratës ose propozimin e përzgjedhur.

Oferta ekonomike nuk duhet të ndryshohet në asnjë rast.

ë) Kur fituesi nuk arrin të nënshkruajë kontratën ose nuk arrin të bëjë sigurimin e kontratës, autoriteti/enti kontraktor fton për lidhjen e kontratës ofertuesin vijues në klasifikimin e ofertuesve;

f) Në rast se kontrata lidhet me një bashkim operatorësh, të gjithë anëtarët e bashkimit të operatorëve duhet të nënshkruajnë kontratën dhe të jenë, individualisht dhe bashkërisht, përgjegjës për detyrën.

Neni 55

Procedurë e hapur e thjeshtuar

1. Procedura e hapur e thjeshtuar është një procedurë me një fazë, që mund përdoret nga autoriteti kontraktor për kontrata nën kufirin e ulët monetar, sipas parashikimit në nenin 49, të LPP-së.

2. Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Çdo operator ekonomik i interesuar mund të paraqesë një ofertë në këtë procedurë.

3. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 49, të LPP-së.

4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:

a) Për kontratat e punëve:

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë vjetëve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

5. Shqyrtimi i ofertave duhet të bëhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dorëzimi i ofertave.

6. Në përfundim të procesit të vlerësimit të dokumentacionit të ofertuesve, në bazë të kritereve të përcaktuara në nenet 76 e 77, të LPP-së dhe këtyre rregullave, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertën fituese, pas krahasimit të ofertave, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 87, të LPP-së.

Neni 56

Procedura e prokurimit me vlerë të vogël

1. Autoriteti/enti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbime, kur vlera e përlogaritur është ndërmjet kufijve nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë në vit, sipas përcaktimit në pikën 2, të nenit 41, të LPP-së.



2. Autoriteti/enti kontraktor planifikon natyrën, sasinë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi.

Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup-mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure.

3. Titullari i autoritetit/entit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në fillim të vitit kalendarik, ngre një komision të veçantë, të përbërë prej 3 (tre) anëtarësh, nga të cilët njëri është kryetar.

4. Titullari i autoritetit/entit kontraktor ose një zyrtar tjetër i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit ku përcaktohen objekti i prokurimit dhe sasia e tyre.

Në çdo rast, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit nga titullari i autoritetit/entit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës, duhet të përllogarisë fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, në përputhje me nenin 76 të kësaj rregullore, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posaçme.

Urdhri i prokurimit duhet të shoqërohet me ftesën për ofertë, që iu drejtohet operatorëve ekonomikë, në të cilën përcaktohen të gjitha të dhënat e nevojshme që lidhen me objektin e prokurimit.

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, autoriteti kontraktor publikon ftesën për ofertë, në sistemin e prokurimit elektronik, ku mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar.

Afati i fundit për pranimin dhe hapjen e ofertave nuk duhet të jetë ditë pushimi (e shtunë, e diel, festë zyrtare).

6. Në çdo rast, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet t'i përgjigjet autoritetit/entit kontraktor, brenda afatit të përcaktuar nga ky i fundit në ftesën për ofertë.

Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet të njoftojë autoritetin/entin kontraktor brenda afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë. Në njoftim duhet të jepen arsyet, që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit.

Autoriteti/enti kontraktor mund të refuzojë ofertën e paraqitur nga një operator ekonomik, i cili

në një procedurë të mëparshme prokurimi me vlerë të vogël, të zhvilluar nga ky autoritet/ent brenda periudhës njëvjeçare nga data e zhvillimit të kësaj procedure, nuk e ka njoftuar brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesën për ofertë mbi arsyet që kanë çuar në pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit.

Kur ofertuesi i renditur në vend të parë tërhiqet nga oferta e tij ose nuk plotëson kërkesat e autoritetit/entit kontraktor, ky i fundit përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me radhë, deri në ofertuesin e renditur në vend të dhjetë.

Këto veprime duhet të dokumentohen nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor të marrë në konsideratë për realizimin e objektit të kontratës vetëm operatorët ekonomikë të renditur deri në vendin e dhjetë të klasifikimit.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor të marrë në konsideratë për realizimin e objektit të kontratës vetëm operatorët ekonomikë, oferta e të cilëve, nuk është ulur më shumë se 50% e fondit limit të përllogaritur.

Kryerja e procedurës me mjete elektronike të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.

7. Në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, nuk zbatohen dispozitat e LPP për ofertat anomalisht të ulëta.

8. Në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël zbatohen parashikimet e nenit 116 të LPP-së, për ankimin administrativ.

9. Autoriteti/enti kontraktor mund të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për blerjen e mallrave, për të cilat ka një nevojë emergjente apo për kryerjen e shërbimeve të paparashikueshme, me kusht që vlera e përllogaritur e mallrave dhe e shërbimeve, për plotësimin e nevojave të lidhura me situatën e paparashikuar, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë. Në të tilla raste, emergjence ose ku prania e komisionit është e pamundur, prokurimet mund të kryhen edhe nga persona që nuk janë anëtarë të komisionit.

10. PAGESA për prokurimet me vlerë të vogël bëhet sipas legjislacionit tatimor në fuqi. Në çdo rast, faturat e mallrave apo të shërbimeve duhet të jenë të rregullta sipas legjislacionit në fuqi. Faturat e lëshuara kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë mundur të nënshkruajnë një të tillë.



11. Në asnjë rast, autoriteti/enti kontraktor në momentin e planifikimit të nevojave të tij, nuk duhet të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat e prokurimit.

Neni 57

Konkursi i projektimit

1. Konkursi i projektimit është një procedurë prokurimi me faza, sipas nenit 104, të LPP-së, nëpërmjet së cilës, autoriteti/enti kontraktor përzgjedh një studim ose projekt, që ka kryesisht natyrë estetike, duke i mundësuar autoritetit/entit kontraktor që të blejë, kryesisht, në fushat e planifikimit urban dhe rural, arkitekturës dhe inxhinierisë ose përpunimit të të dhënave, një plan ose projekt.

2. Konkursi i projektimit mund të organizohet si pjesë e një procedure, që shërben për përfitimin e një projekti ose për përcaktimin e një fituesi të një kontrate shërbimi publik.

a) Në rastin kur autoriteti/enti kontraktor organizon një konkurs projektimi, ku objekti është një projektide, në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohen qartë kriteret e vlerësimit teknik, çmimi dhe/ose rimbursimet që jepen për kandidatin fitues dhe për kandidatët e tjerë të pranuar.

b) Në rastin kur autoriteti/enti kontraktor organizon konkurs projektimi, si pjesë të një procedure që çon në përzgjedhjen e kontratës fituese për shërbime, mund të përdorë procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit për kryerjen e shërbimit me kandidatin e suksesshëm të dalë në përfundim të konkursit të projektimit, në përputhje me pikën 3, të nenit 47, të LPP-së.

3. Në çdo rast, në dokumentet e tenderit, autoriteti/enti kontraktor duhet të bëjë të njohur qëllimin e tij për të marrë vetëm një projektide apo për të marrë projektide dhe shërbimin në lidhje me këtë projektide.

4. Nuk mund të jenë në cilësinë e kandidatëve në një konkurs projektimi, punonjës të autoritetit/entit kontraktor, i cili zhvillon këtë konkurs.

5. Hapat e procedurës së konkursit të projektimit janë, si më poshtë vijon:

a) Titullari i autoritetit/entit kontraktor apo personi i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit, sipas parashikimeve të nenit 77 të këtyre rregullave. Për këtë lloj procedure prokurimi, urdhri i prokurimit nuk përmban fondin limit.

b) Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla.

Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë.

Nëse do të përdorë këtë mundësi, autoriteti/enti kontraktor duhet ta bëjë të ditur në njoftimin e konkursit. Në çdo rast, numri i kandidatëve të zgjedhur duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar konkurrencë të drejtë.

c) Afatet kohore për dorëzimin e kërkesave për shprehjen e interesit janë ato të përcaktuara në nenin 105, të LPP-së.

ç) Autoriteti/enti kontraktor shqyrton kualifikimet e kandidatëve që kanë shprehur interes në bazë të kriterëve për kualifikim, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e hapjes së procedurës. Në përfundim të kësaj faze, kandidatët e kualifikuar përshihen në një listë të shkurtër, e cila duhet të përmbajë të paktën dy kandidatë.

d) Pas mbylljes së fazës së kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor fton kandidatët e përcaktuar në listën e shkurtër për paraqitjen e propozimeve të tyre. Ftesa përfshin qëllimin e autoritetit/entit kontraktor, adresën, datën dhe orën e përcaktuar për dorëzimin e propozimeve.

Ftesa shoqërohet me udhëzimet e nevojshme për ofertuesit, ku jepet i gjithë informacioni që do t'i ndihmonte për përgatitjen e propozimeve.

dh) Autoriteti/enti kontraktor përcakton një afat kohor për dorëzimin e propozimeve, që u jep ofertuesve kohë të mjaftueshme për të përgatitur propozimet e tyre.

Afati kohor për dorëzimin e propozimeve është, si më poshtë vijon:

- Në procedurën e konkursit të projektimit, me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, afati minimal kohor për dorëzimin e ofertës është 20 (njëzet) ditë nga data në të cilën është dërguar ftesa për ofertë të kandidatët;

- Në procedurën e konkursit të projektimit, me vlerë nën kufirin e lartë monetar, afati minimal



kohor për dorëzimin e ofertës është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data, në të cilën është dërguar te kandidatët ftesa për ofertë.

Gjatë kësaj kohe, ofertuesit mund të kërkojnë sqarime për informacionet e dhëna në kërkesën për propozime. Autoriteti/enti kontraktor bën sqarimet përkatëse dhe ua dërgon të gjithë kandidatëve të përcaktuar në listën e shkurtër. Nëse është e nevojshme, autoriteti/enti kontraktor zgjat afatet kohore për dorëzimin e propozimeve, duke argumentuar dhe dokumentuar nevojën për këtë zgjatje.

Pas mbarimit të afateve kohore për dorëzim nuk duhet të pranohet asnjë ndryshim i propozimeve.

Propozimet, hapen pas mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e tyre. Çdo propozim që merret pas mbarimit të afatit, kthehet i papatur.

e) Vlerësimi i propozimeve bëhet brenda 20 (njëzet) ditëve nga afati i përfundimtar i përcaktuar për hapjen e tyre dhe u komunikohet ofertuesve pjesëmarrës. Në varësi të kompleksitetit të objektit, ky afat mund të shtyhet duke argumentuar dhe dokumentuar arsyet konkrete. Procesi i vlerësimit regjistrohet nëpërmjet procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim.

ë) Juria e vlerësimit duhet të përbëhet nga një numër tek anëtarësh (të paktën tre), pjesëtarë ose jo të autoritetit/entit kontraktor. Nëse nga pjesëmarrësit në konkurs kërkohet kualifikim i posaçëm profesional, së paku një e treta e anëtarëve të komisionit të jurisë duhet të kenë kualifikime të njëjta ose të barasvlershme profesionale si pjesëmarrësit, si dhe një përvojë 10-vjeçare në çështjet e projektit që do të prokurohet.

f) Juria shqyrton projektet e paraqitura nga kandidatët, në mënyrë anonime dhe vetëm mbi bazën e kritereve të përcaktuara në njoftimin për konkurs. Anonimiteti i projekteve duhet të respektohet deri në momentin që juria merr vendimin e saj.

g) Juria është e pavarur në vendimet dhe opinionet e saj. Nëse është e nevojshme, juria fton kandidatët për t'iu përgjigjur pyetjeve që ka regjistruar në procesverbal, për të sqaruar çdo aspekt të planeve apo projekteve të paraqitura. Këto diskutime regjistrohen në një procesverbal.

gi) Në vijim, juria harton një raport, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët, ku pasqyrohet

renditja sipas cilësisë të planeve ose projekteve dhe komentet apo vërejtjet konkrete.

KREU VII MJETET E PROKURIMIT

Neni 58

Mjetet e prokurimit

Në procesin e prokurimit, autoriteti/enti kontraktor mund të përdorë këto mjete prokurimi:

- a) marrëveshja kuadër;
- b) prokurimi i përqendruar dhe delegimi i prokurimit;
- c) sistemi dinamik i blerjes.

Neni 59

Përdorimi i marrëveshjes kuadër

1. Autoriteti/enti kontraktor përdor marrëveshjen kuadër për punë/mallra/shërbime, për të arritur një marrëveshje ndërmjet një apo më shumë autoriteteve/enteve kontraktore dhe një apo më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Qëllimi i një marrëveshjeje kuadër është të vendosë kushtet e kontratave që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin, dhe aty ku është e përshtatshme, me sasinë e parashikuara, sipas përcaktimit në nenin 52 të LPP-së.

Neni 60

Palët në një marrëveshje kuadër

1. Një marrëveshje kuadër mund të lidhet ndërmjet:

- a) disa autoriteteve/enteve kontraktore dhe disa operatorëve ekonomikë;
- b) disa autoriteteve/enteve kontraktore dhe një operatori ekonomik;
- c) një autoriteti/enti kontraktor dhe disa operatorëve ekonomikë;
- ç) një autoriteti/enti kontraktor dhe një operatori ekonomik.

2. Në njoftimin e procedurës së prokurimit duhet të përcaktohen të gjitha autoritetet/entet kontraktore përfituese. Nuk mund të bëhen pjesë e një marrëveshjeje kuadër autoritetet/entet kontraktore, të cilat nuk janë palë e marrëveshjes kuadër që në publikimin e saj.



Pas nënshkrimit të marrëveshjes, nuk lejohet të pranohen operatorë ekonomikë të tjerë, të cilët nuk janë palë në këtë marrëveshje.

3. Operatorët ekonomikë, që janë palë në një marrëveshje kuadër, nuk mund të krijojnë një bashkim operatorësh ekonomikë dhe të paraqesin ofertë për një kontratë, pasi janë bërë palë e kësaj marrëveshjeje kuadër.

4. Operatori ekonomik, që është palë në një marrëveshje kuadër, nuk mund të caktohet si nënkontraktor i një operatori ekonomik tjetër, që i është dhënë kontrata sipas së njëjtës marrëveshjeje kuadër.

Neni 61

Qëllimi i përdorimit dhe detyrimet që rrjedhin nga një marrëveshje kuadër

1. Një marrëveshje kuadër është e përshtatshme për mallra dhe shërbime të përdorura zakonisht me natyrë të përsëritur dhe/ose kur është e vështirë ose e pamundur për të përcaktuar paraprakisht volumet që duhet të prokurohen dhe nuk ka siguri për kohën e ekzekutimit të kontratave.

2. Një marrëveshje kuadër është ligjërish e detyrueshme për të dyja palët. Autoriteti/enti kontraktor nuk është i detyruar të prokurojë një sasi të caktuar mallrash/shërbimesh/punësh të përfshira në marrëveshje, por, në çdo rast gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër, autoritetet/entet kontraktore nuk lejohen të blejnë nga asnjë operator ekonomik tjetër të njëjtat mallra/shërbime/punë të mbuluara nga një marrëveshje kuadër, pasi kjo do të konsiderohej një shkelje e marrëveshjes.

Neni 62

Rregulla për prokurimin e marrëveshjes kuadër

1. Autoritetet/entet kontraktore mund të lidhin një marrëveshje kuadër nëpërmjet procedurave të prokurimit të parashikuara në LPP.

2. Njoftimi për marrëveshjen kuadër hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit publik dhe Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Çdo operator ekonomik i interesuar mund të paraqesë një ofertë në procedurën për dhënien e një marrëveshjeje kuadër.

3. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 52, të LPP-së.

4. Përlllogaritja e vlerës së marrëveshjes kuadër bëhet si më poshtë vijon:

a) Vlera e parashikuar e një marrëveshjeje kuadër duhet të përfshijë shumën e përlllogaritur të të gjitha vlerave të kontratave që parashikohen të jepen gjatë kohës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

b) Në rastin kur, autoriteti/enti kontraktor e ka të pamundur të përcaktojë sasinë e objektit të prokurimit, për efekt të përlllogaritjes së vlerës së marrëveshjes kuadër duhet t'u referohet, për aq sa është e mundur, nevojave të planifikuara dhe/ose nevojave të mëparshme për këtë objekt. Në çdo rast, përlllogaritja e nevojave duhet të jetë sa më e plotë dhe gjithëpërfshirëse, me qëllim shmangien e situatave kur dalin nevoja të reja, për të njëjtin objekt, të papërfshira në marrëveshjen kuadër.

5. Operatorët ekonomikë përzgjidhen si palë të marrëveshjes kuadër, duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, sipas përcaktimeve të neneve 80 dhe 87, të LPP-së. Në rast se autoriteti/enti kontraktor e ka objektivisht të pamundur të përcaktojë sasinë që do të prokurohet, atëherë do të vlerësojë ofertën/ofertat fituese duke u bazuar në çmimin për njësi.

Kjo metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore, kur sasi të janë të llogaritshme në bazë vjetore sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe të shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar.

6. Nëse një operator ekonomik, palë në marrëveshjen kuadër, nuk përmbush më kriteret e kualifikimit, për të cilat është shpallur fitues në këtë marrëveshje, është i detyruar të njoftojë autoritetin/entin kontraktor menjëherë, por jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga momenti i ndodhjes së një ndryshimi të tillë. Në rast se autoriteti/enti kontraktor konstaton mospërmbushjen e këtij detyrimi, duhet të veprojë në përputhje me nenin 78, të LPP-së.

7. Në rast se operatorët ekonomikë palë në një marrëveshje kuadër, për shkak të forcës madhore (lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo transiti) nuk mundet që të furnizojnë



autoritetin/autoritetet kontraktore palë në këtë marrëveshje, me një ose disa artikuj/shërbime objekt i kësaj marrëveshje, atëherë vlefshmëria dhe efektiviteti marrëveshjes pushojnë së ekzistuari vetëm për këto artikuj/shërbime, dhe vijon për artikujt/shërbimet e tjera, sipas kushteve të marrëveshjes.

8. Autoriteti/enti kontraktor harton dhe publikon njoftimin e fituesit për një marrëveshje kuadër në përputhje me LPP-në dhe këto rregulla. Në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor fton ofertuesin/t fitues për nënshkrimin e marrëveshjes.

Neni 63

Kohëzgjatja e një marrëveshjeje kuadër

1. Kohëzgjatja e një marrëveshjeje kuadër nuk mund të jetë më shumë se 4 (katër) vjet.

2. Në rastin e marrëveshjes kuadër për kontratat sektoriale, ky afat nuk është më i gjatë se 8 (tetë) vjet.

Neni 64

Llojet e marrëveshjes kuadër

1. Llojet e marrëveshjes kuadër janë:

- a) marrëveshje kuadër e lidhur me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara;
- b) marrëveshje kuadër e lidhur me disa operatorë ekonomikë, ku:
 - i. të gjitha kushtet janë të përcaktuara;
 - ii. jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

2. Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Në kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk mund të bëhen ndryshime të kushteve, për të cilat është lidhur marrëveshja, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e marrëveshjes kuadër.

Nëse nevojat e autoritetit/entit kontraktor ndryshojnë, atëherë do të duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re. Një operatori ekonomik i kërkohet të përgatisë ofertën e tij për kontratën, bazuar në marrëveshjen kuadër, vetëm në lidhje me kushtet për të cilat është rënë dakord paraprakisht në marrëveshjen kuadër.

3. Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Meqenëse këto marrëveshje kuadër vlerësohen si kontrata, nuk lejohet të bëhen ndryshime të kushteve të tyre, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e kontratës. Nëse nevojat e autoritetit kontraktor ndryshojnë, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re.

Në rast të përdorimit të kësaj lloji marrëveshjeje, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë në dokumentet e tenderit kushtet që do të zbatohen për dhënien e kontratave brenda marrëveshjes kuadër. Në çdo rast, dhënia e kontratave do të bëhet pa rihapur konkurrimin, duke u bazuar në kushtet e përcaktuara në marrëveshjen kuadër.

Kjo lloji marrëveshjeje përdoret në rastin e ndarjes së objektit të prokurimit në lote, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues.

Marrëveshjet kuadër me disa operatorë ekonomikë duhet të lidhen me të paktën tre operatorë ekonomikë. Në rast të kundërt, autoritetet/entet kontraktore mund të lidhin marrëveshje kuadër me ato operatorë ekonomikë që i kanë përmbushur të gjitha kriteret, me kusht që të jenë të paktën dy.

4. Marrëveshjet kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, nuk konsiderohen kontrata, sipas LPP-së.

Në rast të përdorimit të kësaj lloji marrëveshjeje, autoriteti/enti kontraktor, për të lidhur kontratë brenda marrëveshjes kuadër, duhet të rihapë konkurrimin.

Autoriteti/enti kontraktor përgatit një ftesë për ofertë dhe ua dërgon vetëm operatorëve ekonomikë palë të marrëveshjes kuadër, pa bërë njoftim publik. Ftesa për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë duhet të përcaktojë afatin kohor për dorëzimin e ofertave, kriteret për shpalljen e ofertës fituese për kontratën e bazuar në marrëveshjen kuadër dhe çdo informacion të nevojshëm për përgatitjen e ofertave.

Në këto dokumente duhet, gjithashtu, duhet të specifikohet se, cilat kushte mund t'i nënshtrohen rihapjes së konkurrimit.

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese gjatë rihapjes së konkurrimit mund të jenë të njëjta si ato



të marrëveshjes kuadër ose autoriteti/enti kontraktor mund të përdorë kritere të tjera, me kusht që ato të jenë të përcaktuara në dokumentet fillestare të marrëveshjes kuadër. Këto kritere mund të jenë çmimet për volume të caktuara, informacion për konsulentat për një shërbim intelektual, koha e nevojshme për dorëzim ose orët e nevojshme për kryerjen e punimeve specifike.

Komunikimi ndërmjet autoritetit/entit kontraktor dhe operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër, për përzgjedhjen e fituesit për kontratat bëhet në formë të shkruar ose elektronike dhe, në çdo rast, duhet të dokumentohet dhe të bëhet pjesë e dosjes së procedurës.

Forma e komunikimit përzgjidhet nga autoriteti/enti kontraktor, në varësi të kohës në dispozicion për përmbushjen e nevojës. Autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për të ruajtur konfidencialitetin e përmbajtjes së ofertave, deri në vlerësimin përfundimtar të tyre.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet t'u dërgojë, në të njëjtën kohë, ftesën për ofertë të gjithë operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër.

Kjo lloj marrëveshjeje kuadër nuk është e zbatueshme në rastet e kontratave sektoriale.

Neni 65

Dhënia kontratave sipas marrëveshjes kuadër

1. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të zbatojnë kontratën sipas cilësisë dhe çmimit të ofertuar, në kohën e kërkuar prej autoriteteve kontraktore.

2. Për dhënien e kontratave sipas marrëveshjes kuadër zbatohen këto rregulla:

a) Kontratat mund të jepen mbi bazën e marrëveshjes kuadër përgjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së saj. Periudha e vlefshmërisë së kontratave të lidhura mbi bazën e një marrëveshjeje kuadër mund të kalojë periudhën e vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

b) Në rastin e marrëveshjes kuadër ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, gjatë rihapjes së konkurimit autoriteti/enti kontraktor krijon një komision vlerësimi për dhënien e një kontrate në bazë të marrëveshjes kuadër.

Nuk është e detyrueshme që përbërja e komisionit të jetë e njëjtë me atë të komisionit të

vlerësimit të ofertave, të përcaktuar për kryerjen e procedurës së prokurimit për marrëveshjen kuadër.

c) Dhënia e kontratave në bazë të një marrëveshjeje kuadër të realizuar nga një autoritet/ent kontraktor në cilësinë e organit qendror blerës do të bëhet nga vetë autoritetet/entet kontraktore përfituese.

ç) Autoritetet/entet kontraktore do t'i japin kontratën ofertuesit, që ka dorëzuar ofertën më të mirë, në bazë të kritereve të shpalljes së kontratës fituese, të përcaktuara në dokumentet e tenderit të marrëveshjes kuadër.

d) Në një marrëveshje kuadër, sasitë e parashikuara janë vetëm “sasi orientuese”. Autoriteti/enti kontraktor mund të blejë më pak ose më shumë se sasitë e parashikuara (por në çdo rast brenda vlerës së përlogaritur të marrëveshjes kuadër).

3. Autoriteti/enti kontraktor harton dhe publikon njoftimin e fituesit për një kontratë bazuar në marrëveshjen kuadër në përputhje me LPP-në dhe këto rregulla. Në përfundim të afateve të ankimit fton fituesin për nënshkrimin e kontratës.

4. Në rastin e marrëveshjeve kuadër, të realizuara nga një autoritet/ent kontraktor, njoftimi i kontratave të lidhura gjatë një viti kalendarik do të dërgohet për publikim në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti/enti kontraktor.

5. Në rastin e marrëveshjeve kuadër, të realizuara nga një autoritet/ent kontraktor në cilësinë e organit qendror blerës, njoftimi i kontratave të lidhura gjatë një viti kalendarik do të dërgohet për publikim, në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti/enti kontraktor, prokurues në cilësinë e organit qendror blerës.

Neni 66

Ndryshimi i palëve/përfundimi i marrëveshjes

1. Nëse para mbarimit të marrëveshjes kuadër, të nënshkruar me disa operatorë ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër, mbetet vetëm një operator ekonomik, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të japë kontrata sipas kësaj marrëveshjeje kuadër.

Kur lind një situatë e tillë, autoriteti/enti kontraktor është i detyruar të njoftojë menjëherë operatorin ekonomik të mbetur në marrëveshjen



kuadër. Vlefshmëria dhe efektiviteti i marrëveshjes kuadër pushojnë së ekzistuari me këtë njoftim.

2. Në rast se një operator ekonomik nuk i përgjigjet dy herë radhazi ftesës së autoritetit kontraktor gjatë rihapjes së konkurrimit, ky operator nuk do të jetë më palë e marrëveshjes kuadër.

Neni 67

Prokurimi i përqendruar dhe delegimi i prokurimit

1. Prokurimi i përqendruar mund të përdoret, kur:

a) blerja e përqendruar mundëson përfitime ekonomike, për shkak të rritjes së sasisë së mallrave, punëve ose shërbimeve homogjene dhe që ofrohen në treg me kushte të ngjashme;

b) autoriteti kontraktor, që luan rolin e organit qendror blerës, ka njohuri të mjaftueshme për zhvillimin e procedurave të prokurimit për mallrat, punët ose shërbimet që do të prokurohen.

2. Në përputhje me nenin 53, të LPP-së dhe me qëllim realizimin dhe përdorimin më të mirë të fondeve publike, Këshilli i Ministrave mund t'ia ngarkojë rolin e organit qendror blerës një autoriteti tjetër kontraktor për zhvillimin e procedurave të prokurimit për blerjen e mallrave, kryerjen e punëve ose të shërbimeve të njëjta, si dhe/ose lidhjen e marrëveshjes kuadër për punë, furnizime ose shërbime të caktuara, në emër dhe për llogari të institucioneve në varësi të Kryeministrit dhe ministrave.

3. Ministritë ose institucionet e tjera, që kanë në varësi disa autoritete kontraktore, mund të prokurojnë në mënyrë të përqendruar për autoritetet kontraktore të varësisë.

Në këtë rast, ministritë ose institucionet e tjera, që kanë në varësi disa autoritete kontraktore, mund të përdorin blerjen e përqendruar, duke nxjerrë udhëzimet e duhura për autoritetet kontraktore të varësisë.

4. Nëse disa autoritete kontraktore kanë nevojë të prokurojnë të njëjtin mall, punë ose shërbim, ata mund të bien dakord t'i caktojnë njërit prej tyre rolin e organit qendror blerës për të zhvilluar procedurat e prokurimit në emër të tyre.

5. Delegimi i prokurimit bëhet kur autoriteti kontraktor nuk ka kapacitete dhe/ose njohuri të

mjaftueshme për realizimin e një procedure prokurimi.

6. Nëse një ose disa autoritete kontraktore kanë nevojë të prokurojnë mall/punë ose shërbim, ata mund të bien dakord të delegojnë të drejtën e kryerjes së procedurës së prokurimit një autoriteti tjetër kontraktor, për shkak të kapaciteteve që ky i fundit ka në fushën e objektit të prokurimit. Çdo autoritet tjetër kontraktor mund të kërkojë dhe, rrjedhimisht, të bjerë dakord me organin qendror blerës për kryerjen e prokurimit në emër të tij.

7. Organi qendror blerës ose autoriteti kontraktor, të cilit i është deleguar e drejta e prokurimit, është plotësisht përgjegjës për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit, që nga njoftimi i kontratës deri te publikimi i njoftimit të shpalljes së fituesit, ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga vetë autoriteti/et kontraktor/e përfitues/e. Në rastin e përdorimit të marrëveshjes kuadër, procedura e prokurimit për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje bëhet nga organi qendror blerës, ndërsa procedura e minikonkurimit për të lidhur kontratë brenda marrëveshjes kuadër bëhet nga vetë autoritetet kontraktore përfituese.

8. Në bazë të një marrëveshjeje të shkruar ose të udhëzimeve administrative, organi qendror blerës kryen procedurën e prokurimit në emër të çdo autoriteti kontraktor, ndërsa ky i fundit përcakton specifikimet teknike, sasitë e punëve mallrave /shërbimeve, që do të prokurohen, si dhe fondet përkatëse.

9. Organi qendror blerës shqyrton specifikimet teknike, të dërguara nga autoritetet kontraktore.

Nëse organi qendror blerës vlerëson se specifikimet teknike nuk janë përgatitur në përputhje me LPP-në ose mund të shkaktojnë dështim të procedurës së prokurimit, kryen rishikimin dhe modifikimin e tyre dhe njofton për këtë autoritetin kontraktor, i cili duhet të konfirmojë, nëse specifikimet e rishikuara/modifikuara përmbushin qëllimin për të cilin nevojitet objekti i prokurimit i kërkuar.

Për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, organi qendror blerës bashkërendon punën me ekspertë të fushës, të institucioneve përgjegjëse, si dhe me ekspertë të jashtëm, vendës ose të huaj, për unifikimin e specifikimeve teknike, në përputhje me standardet.

10. Nëse autoritetet kontraktore, në përcaktimin e të dhënave sasiore kanë marrë për bazë çmime të



ndryshme për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, organi qendror blerës bashkërendon punën për testimin e tregut dhe përlogarit të dhënave sasiore, sipas fondit përkatës.

Organi qendror blerës duhet të dakordësojë të dhënave sasiore me autoritetin kontraktor, para publikimit të procedurës së prokurimit.

11. Organi qendror blerës mund të kërkojë ndihmën e autoritetit kontraktor, si dhe duhet t'i sigurojë këtij të fundit, sa herë që e kërkon, akses të plotë në çdo informacion për procedurën e prokurimit.

12. Ky nen nuk zbatohet në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale kur autoritetet kontraktore janë ente private.

Neni 68

Sistemi dinamik i blerjes

1. Sistemi dinamik i blerjes është një sistem tërësisht elektronik që mund të përdoret për blerje të përsëritura të punëve, mallrave apo shërbimeve të zakonshme në treg.

2. Autoriteti/enti kontraktor publikon thirrjen për konkurrim ku përcaktohet përdorimi i sistemit dinamik të blerjes dhe përcakton në dokumentet e tenderit të gjithë informacionin e nevojshëm për sistemin dinamik, përfshirë të dhënave teknike mbi funksionimin e sistemit dinamik.

Njoftimi për sistemin dinamik të blerjes hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me parashikimin në këto rregulla për njoftimin e kontratës.

Ky njoftim përmban edhe informacionin për hapjen ose intervalet kohore të vlerësimit të kërkesave të reja të paraqitura nga operatorët ekonomikë, për t'u përfshirë në sistemin dinamik të blerjes, përgjatë periudhës së vlefshmërisë së tij.

3. Çdo operator ekonomik i interesuar mund të paraqesë një ofertë për t'u bërë pjesë e sistemit dinamik të blerjes përgjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së tij, në çdo kohë që operatori ka interes për këtë ose përmbush kushtet e vendosura nga autoriteti ose enti për t'u bërë pjesë e sistemit dinamik të blerjes.

Ky sistem është i hapur për të gjithë operatorët ekonomikë, që regjistrohen në sistemin e prokurimit elektronik dhe operojnë në fushën e aktivitetit të objektit që prokurohet.

4. Për të pasur një sistem dinamik të blerjes, autoriteti/enti kontraktor përdor rregullat e procedurës së kufizuar, duke përfshirë në sistem të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e përzgjedhjes.

Kufizimi i numrit të kandidatëve sipas nenit 85, të LPP-së, nuk mund të aplikohet në rastin e sistemit dinamik të blerjes.

5. Autoriteti/enti kontraktor mund të ndajë mallrat, punët apo shërbimet në kategori, duke përcaktuar për secilën prej tyre karakteristikat dhe kriteret e përzgjedhjes, duke krijuar kategoritë përkatëse të sistemit dinamik të blerjes.

6. Për t'u krijuar mundësinë operatorëve ekonomikë që të bëhen pjesë e sistemit dinamik të blerjes në çdo kohë, autoriteti/enti kontraktor u jep akses të plotë dhe të pakufizuar të dokumenteve të tenderit të gjithë operatorëve ekonomikë përgjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së sistemit dinamik.

7. Hapat për krijimin e sistemit dinamik të blerjes dhe shpalljen e fituesit në përfundim janë:

a) Autoriteti/enti kontraktor publikon thirrjen për konkurrim dhe sipas rastit specifikon nëse ka një ndarje në kategori të mallrave/ punëve/ shërbimeve;

b) Autoriteti/enti kontraktor vendos një afat të arsyeshëm, por jo më pak se 20 (njëzet) ditë, për paraqitjen e dokumentacionit për kualifikim nga ana e operatorëve ekonomikë;

c) Autoriteti/enti kontraktor vlerëson dokumentacionin për kualifikim të paraqitur nga operatorët ekonomikë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga paraqitja e tyre dhe në përfundim të këtij afati, njofton për kualifikimin ose arsyet e skualifikimit nga sistemi dinamik i blerjes;

ç) Pas përfundimit të afateve të ankimit autoriteti/enti kontraktor përfundon krijimin e sistemit dinamik të blerjes me operatorët e kualifikuar;

d) Autoriteti/enti kontraktor bën njoftime periodike, sipas përcaktimit në njoftimin për konkurrim, për rifreskimin e dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesit, pjesë e sistemit dinamik të blerjes dhe zbaton të njëjtat rregulla dhe afate për kualifikimin e operatorëve ekonomike të tjerë.

dh) kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, sipas përcaktimeve për krijimin e sistemit dinamik të blerjes, autoriteti/enti kontraktor u dërgon ftesën për ofertë operatorëve ekonomikë në sistemin dinamik të blerjes, duke u lënë një afat të



arsyeshëm, por jo më pak se 48 orë për paraqitjen e një oferte.

e) Autoriteti/enti kontraktor bën vlerësimin e ofertave sipas nenit 87, të LPP-së dhe përcaktimeve në ftesën për ofertë. Në përfundim të vlerësimit, fton ofertuesin e renditur i pari sa herë është e mundur nënshkruan kontratë.

8. Operatorët ekonomikë, që janë pjesë e sistemit dinamik të blerjes, nëse gjatë afatit të vlefshmërisë së këtij sistemi, humbasin një ose disa nga kapacitetet e nevojshme për kualifikim, duhet të venë në dijeni autoritetin ose entin kontraktor menjëherë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga marria dijeni për faktin. Nëse autoriteti/enti kontraktor merr dijeni për një situatë të tillë, por nuk është njoftuar nga operatori ekonomik, vepron sipas parashikimit në nenin 78, të LPP-së.

9. Autoriteti/enti kontraktor përdor sistem të thjeshtuar të blerjes dinamike për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar, në përputhje me udhëzimet e APP-së.

KREU VIII PROKURIMI I KONTRATAVE SEKTORIALE

Neni 69

Entet kontraktore që kryejnë procedura për kontratat sektoriale

1. Do të zbatojnë dispozitat e këtij kreu dhe rregullave të përgjithshme për prokurimin publik, pavarësisht nëse ato operojnë në bazë të një të drejte ekskluzive apo të veçantë, entet kontraktore që kryejnë veprimtari në sektorët e shërbimit, si më poshtë vijon:

a) Gazi dhe ngrohja, sipas përcaktimit në nenin 60, të LPP-së:

i. ofrimin ose përdorimin e rrjeteve, që kanë për qëllim t'i ofrojnë publikut shërbime për prodhimin, transportin ose shpërndarjen e gazit ose ngrohjes;

ii. furnizimin me gaz ose ngrohje të këtyre rrjeteve.

b) Energjia elektrike, sipas përcaktimit në nenin 61, të LPP-së:

i. ofrimin ose përdorimin e rrjeteve, që kanë për qëllim t'i ofrojnë publikut, shërbime për prodhimin, transportin ose shpërndarjen e energjisë elektrike;

ii. furnizimin e këtyre rrjeteve me energji elektrike.

c) Uji, sipas përcaktimit në nenin 62, të LPP-së:

i. ofrimin ose përdorimin e rrjeteve, që kanë për qëllim t'i ofrojnë publikut shërbime për prodhimin, transportin ose shpërndarjen e ujit të pijshëm;

ii. furnizimin me ujë të pijshëm të këtyre rrjeteve.

Rregullat për prokurimin e kontratave sektoriale zbatohet edhe për kontratat ose konkurset e projektimit që jepen ose organizohen nga entet kontraktore që kryejnë një veprimtari që përmendet në nënndarjet “i” dhe “ii” dhe që janë të lidhura me një nga veprimtaritë e mëposhtme:

- projekte të inxhinierisë hidraulike, ujitjes ose drenazhimit të tokës, me kusht që vëllimi i ujit që do të përdoret për furnizimin me ujë të pijshëm të përbjë më shumë se 20% të vëllimit të përgjithshëm të ujit të vënë në dispozicion nga këto projekte ose nga infrastruktura ujitëse ose drenazhuese;

- asgjësimin ose trajtimin e ujërave të zeza.

ç) Shërbimet e transportit, sipas përcaktimit në nenin 63, të LPP-së;

d) Portet dhe aeroportet, sipas përcaktimit në nenin 64, të LPP-së;

dh) Shërbimet postare, sipas përcaktimit në nenin 65, të LPP-së.

Sipas përcaktimit në shkronjën “c”, të pikës 2, të nenit 65, të LPP-së, shërbime postare janë dhe ato shërbime që kanë të bëjnë me zhdoganimin, klasifikimin, përcaktimin e itinerareve dhe dorëzimin e artikujve postarë. Kur enti kontraktor ofron shërbime postare, edhe shërbime të tjera që kanë lidhje me to janë të mbuluara nga rregullat për prokurimin e kontratave sektoriale.

e) Nxjerrja e naftës dhe e gazit dhe kërkimi ose nxjerrja e qymyrit ose lëndëve të tjera djegëse të ngurta, sipas përcaktimit në nenin 66, të LPP-së.

Si rregull, enti kontraktor do të zbatojë rregullat për prokurimin e kontratave sektoriale për të gjitha blerjet, për sa kohë që objekti që do të prokurohet do të përdoret vetëm për veprimtaritë e kontratave sektoriale.

2. Këtyre rregullave mund t'u nënshtrohen edhe entet private. Në këtë rast, enti privat duhet, detyrimisht, të kryejë veprimtari në sektorët e shërbimit ujor, energjetik, transportit dhe atij postar, sikurse është përcaktuar në LPP dhe në pikën 1, të këtij neni, mbi bazën e një të drejte të



veçantë ose ekskluzive të lëshuar nga një autoritet kompetent i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet çdo klauzole legislative, rregullatore apo administrative.

3. E drejtë e veçantë ose ekskluzive do të thotë një e drejtë që e kufizon të drejtën për kryerjen e veprimtarisë në fjalë, duke ua dhënë atë vetëm një apo më shumë shoqërive tregtare. Kjo e drejtë duhet ta vendosë entin në një pozicion monopoli ose oligopoli, në mënyrë që të mund t'ua kalojë kostot klientëve, meqenëse ata nuk do të kenë alternativë tjetër. Nëse një e drejtë e veçantë ose specifike mund të merret nga të gjitha entet që e kërkojnë atë, këto shoqëri tregtare nuk u nënshtrohen këtyre rregullave, pasi ato operojnë në një treg konkurrues.

4. Entet private, që kryejnë veprimtari në sektorët e shërbimit ujqor, energjetik, transportit dhe atij postar pas fitimit të një kontrate prokurimi, nuk u nënshtrohen këtyre rregullave edhe në rastet kur ato përfundojnë në një pozicion monopolistik ose oligopolistik.

Neni 70

Kontratat e lidhura për qëllime të rishitjes apo dhënies me qira palëve të treta

Sipas parashikimit në nenin 67, të LPP-së, kontratat sektoriale të lidhura nga enti kontraktor për qëllime të rishitjes apo dhënies me qira palëve të treta, nuk mbulohen nga rregullat e prokurimit publik, nëse nuk ekziston një e drejtë e veçantë ose ekskluzive në lidhje me objektin e kontratës.

Kushti për përjashtim është që enti kontraktor në asnjë mënyrë nuk i përpunon produktet, por vetëm i blen dhe i shet ato, pa pasur ndonjë të drejtë ekskluzive.

Neni 71

Sipërmarrjet e lidhura

1. Sipërmarrjet e lidhura me entet kontraktore (në parim, shoqëria tregtare nënë, motër dhe nëndegë të shoqërisë tregtare) apo brenda një bashkimi operatorësh, për blerjen e mallrave, shërbimeve ose punëve, nuk janë të detyruara të prokurojnë sipas rregullave të këtij kreu.

2. Sipërmarrjet e lidhura, 80% të xhiros vjetore e realizojnë me furnizimin e mallrave/ shërbimeve/ punëve që prokurohen nga shoqëritë tregtare, me

të cilat ajo është e lidhur dhe vetëm deri në 20% të mallrave/ shërbimeve/ punëve mund të tregtohet në tregun e hapur.

Ky kufizim ka për qëllim parandalimin e konkurrencës të shoqërive tregtare të lidhura me shoqëri tregtare të tjera dhe për të shijuar përfitimet e të operuarit vetëm e pa konkurrencë për furnizimin e bizneseve me pozicion monopolistik ose oligopolistik.

Nëse më tepër se një shoqëri tregtare e lidhur me entin kontraktor ofron mallra/punë/shërbime të njëjta ose të ngjashme, është e domosdoshme të llogaritet duke iu referuar xhiros totale të të gjithave shoqërive tregtare të lidhura. Nëse xhiroja e krijuar nga tregtia me shoqëritë tregtare të jashtme e kalon vlerën 20%, përjashtimi nuk është i zbatueshëm.

3. Në mënyrë që të lehtësojnë bashkëpunimin në projektet madhore, entet kontraktore që operojnë në sektorët e shërbimeve utilitare mund të formojnë të ashtuquajturit bashkime operatorësh. Bashkimet e operatorëve mund të blejnë mallra/shërbime/punë nga njëri prej enteve kontraktore që janë partnerë, pa e shpallur kontratën për konkurrim.

Kjo dispozitë aplikohet me kusht që entet kontraktore të kenë formuar bashkimin e operatorëve për një afat të paktën 3-vjeçar dhe ekskluzivisht për të kryer një veprimtari në sektorët e shërbimeve utilitare.

Neni 72

Sistemet e kualifikimit

1. Entet kontraktore në sektorët e shërbimeve utilitare mund të krijojnë dhe të zbatojnë një sistem kualifikimi, për parakualifikimin e operatorëve ekonomikë. Qëllimi i një sistemi kualifikimi është të kursejë kohë kur një ent kontraktor blen rregullisht disa mallra/shërbime/punime të caktuara.

Sistemi i kualifikimit zëvendëson fazën e parë të një procedure të kufizuar ose me negociim dhe duhet të përmbajë kritere përzgjedhjeje që zakonisht u kërkojnë operatorëve ekonomikë në fazën e parë të prokurimit. Kriteret e përzgjedhjes duhet të jenë të disponueshme për të gjithë operatorët e interesuar.

2. Të gjithë operatorët ekonomikë, që kërkojnë të marrin pjesë dhe që përmbushin kriteret e përzgjedhjes do të përfshihen në sistem. Aplikimet



do t'i dorëzohen entit kontraktor, i cili duhet ta shqyrtojë aplikimin brenda gjashtë muajve.

Një operator ekonomik, të cilit i janë refuzuar aplikimet, do të njoftohet për arsyet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e marrjes së vendimit.

Një operator ekonomik që është pranuar në sistem mund të përjashtohet vetëm për arsye të publikuara paraprakisht në rregullat e kualifikimit për krijimin e sistemit.

3. Kur duhet të prokurohen mallra/shërbime, enti kontraktor mund t'i drejtohet drejtpërdrejt operatorit ekonomik në listë, pa pasur nevojë të shpallë një konkurrim të ri.

Enti kontraktor nuk është i detyruar t'u drejtohet të gjithë operatorëve ekonomikë të përfshirë në listë, por duhet që gjithmonë të kërkojë oferta nga ata operatorë ekonomikë që kanë aftësinë për të përmbushur kontratën specifike dhe janë të kualifikuar në kategorinë respektive, kur sistemi i kualifikimit është ndarë në kategori sipas llojit të kontratës.

KREU IX

ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË AUTORITETIN/ENTIN KONTRAKTOR

Neni 73

Titullari i autoritetit/entit kontraktor

1. Titullari i autoritetit/entit kontraktor mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e autoritetit/entit kontraktor, të përcaktuar në nenin 21 të LPP-së dhe është përgjegjës, për:

- caktimin e personit/ave përgjegjës në fillim të vitit;
- ngritjen e njësive të prokurimit, komisioneve dhe/ose grupeve të punës, sipas rastit, të përfshira në procesin e prokurimit;
- nxjerrjen e urdhrat të prokurimit;
- miratimin e raportit përmbledhës të procedurës së prokurimit dhe adresimin e çështjeve apo problematikave që mund të dalin nga ky raport.

2. Titullari i autoritetit/entit kontraktor mund t'ia delegojë kryerjen e detyrave në këtë cilësi, një zyrtari të autorizuar prej tij. Zyrtar i autorizuar duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit/entit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari, por kur nuk ka një të tillë, këtë rol

e mban zyrtari me pozicionin më të lartë pas titullarit. Në këtë rast, zyrtari i autorizuar do të konsiderohet titullar për efekt të procesit të prokurimit.

3. Titullari i autoritetit/entit kontraktor duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.

4. Titullari i autoritetit/entit kontraktor duhet të marrë masa për shmangien e çdo konflikti interesi në marrëdhëniet e tij, punonjësve të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit ekonomik, sikurse përcaktohet në nenin 19, të LPP-së.

Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysh në emërimin e çdo nëpunësi, të angazhuar në procesin e prokurimit. Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Nuk lejohet që titullari i autoritetit/entit kontraktor të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla.

Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Neni 74

Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit

1. Titullari i autoritetit/entit kontraktor, në fillim të vitit, cakton me urdhër të veçantë personin/personat përgjegjës për prokurimin dhe dërgon emrin/emrat respektivë, me kontaktet përkatëse, në Agjencinë e Prokurimit Publik.

Personi/at përgjegjës duhet të jenë minimalisht me arsim të lartë. Autoritetet/entet kontraktore duhet të nxisin trajnimin e personit/personave përgjegjës në fushën e prokurimit publik.

Personi/at përgjegjës për prokurimin duhet të administrojë/jnë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit.

Në varësi të numrit të procedurave të prokurimit të parashikuara për t'u zhvilluar,



autoriteti/enti kontraktor mund të caktojë më shumë se një person përgjegjës për prokurimin.

2. Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit/entit kontraktor krijon njësinë e prokurimit.

Në përbërje të njësisë së prokurimit është detyrimisht, personi përgjegjës për prokurimin, dhe të paktën një specialist fushe, në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit.

Në rastet kur autoriteti/enti kontraktor ka më shumë se një person përgjegjës, titullari i autoritetit ose entit kontraktor mund të vlerësojë përfshirjen e dy ose më shumë prej tyre, në njësinë e prokurimit.

Në raste të tjera, titullari i autoritetit/entit kontraktor cakton në përbërjen e njësisë së prokurimit, përveç personit përgjegjës për prokurimin, një ose disa persona të tjerë, me arsim të lartë.

Në çdo rast, numri i anëtarëve të njësisë së prokurimit duhet të jetë numër tek.

Në rast mungese personeli, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë staf të specializuar nga autoritete/ente të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm.

Përveç sa më sipër, autoriteti/enti kontraktor mund të krijojë një njësi të përbashkët prokurimi me një apo më shumë autoritete/ente kontraktore.

3. Personi/at përgjegjës për prokurimin kryen/jnë detyrat e mëposhtme:

a) sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;

b) përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin, kur është rasti) kur kjo nuk bëhet nga struktura të tjera të posaçme;

c) hartimin e urdhrit të prokurimit;

ç) përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre;

d) hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;

dh) hartimin dhe dërgimin e ftesave për pjesëmarrje kandidatëve të ftuar në një procedurë prokurimi, nëse është rasti, duke argumentuar përzgjedhjen e tyre;

e) administrimin e të gjitha procesverbaleve për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, duke

përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;

ë) llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti;

f) në kuadër të hartimit të dokumenteve të tenderit, bashkërendimin e punës me APP-në, me qëllim realizimin e kësaj detyre me efikasitet dhe në përputhje me legjislacionin e fushës në fuqi;

g) ndjek procesin e komunikimit me operatorët ekonomikë, të përfshirë në procesin e ankimimit, për çdo vendim në procesin e shqyrtimit të ankesës, sipas parashikimeve në këto rregulla;

gj) administrimin e dokumentacionit në formë të shkruar, original ose fotokopje të noterizuar të operatorit ekonomik fitues, përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti/enti kontraktor;

h) ndjekjen e procedurave për konfiskimin e sigurimit të ofertës, sipas përcaktimit në LPP dhe në këto rregulla;

i) administrimin e sigurimit të kontratës përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti kontraktor;

j) përcjelljen, pranë APP-së, të planit të zbatimit të kontratës, sipas parashikimit në nenin 125, të LPP-së, raportimeve për ecurinë e zbatimit të kontratës, në rastet kur kërkohet, si dhe të raportimit përfundimtar të ekzekutimit të kontratës.

4. Në rast se nuk janë krijuar struktura të posaçme, detyrat e mëposhtme kryhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit:

- hartimi i specifikimeve teknike;

- përllogaritja e fondit limit;

- hartimi i kërkesave për kualifikim, lidhur me kapacitetin teknik;

- hartimi i kriterëve për shpalljen e ofertës fituese, nëse është rasti;

- përcaktimi i çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit (si p.sh., grafiku i livrimit).

Në rast se detyrat e sipërpërmendura në këtë pikë nuk janë hartuar nga struktura të posaçme, si më sipër, ato do të kryhen nga njësia e prokurimit për objektin që prokurohet.

Neni 75

Komisioni i vlerësimit të ofertave

1. Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit/entit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 (tre)



persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës, nëse nevojitet për objektin e prokurimit.

2. Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

3. Një prej anëtarëve të komisionit caktohet kryetar dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit.

Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek.

Në rastin e mungesës së personelit, autoriteti/enti kontraktor mund të punësojë me kontratë ekspertë të jashtëm, si anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

4. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Anëtarët e komisionit duhet të zbatojnë detyrat në pavarësi të plotë. Nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, përgjegjësia për vlerësimin e ofertave është e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Përfundimisht, nëse komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson dhe argumenton se një ose disa kritere janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit dhe/ose legjislacionin e fushës në fuqi, ka të drejtë t'i propozojë titullarit anulimin e procedurës.

Anëtarët e komisionit nuk kryejnë asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla.

KREU X ZHVILLIMI I PROCEDURAVE

Neni 76 Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit

1. Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT) ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

3. Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund të caktojë struktura të posaçme. Në rast se nuk ngrihen struktura të posaçme, kjo detyrë i ngarkohet specialistit të fushës ose njësisë së prokurimit.

Neni 77 Urdhri i prokurimit

Pas përllogaritjes së fondit limit sipas nenit 76, të këtyre rregullave, titullari i autoritetit/entit kontraktor nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;
- fondin e përllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër;
- llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti);
- emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit, duke evidentuar personin/at përgjegjës dhe, nëse është rasti edhe specialistin e fushës, sipas parashikimeve të nenit 74, të këtyre rregullave.

Neni 78 Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit

1. Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit, njësia e prokurimit duhet të përdorë



dokumentet standarde të tenderit, sipas llojit të procedurës e të tipit të kontratës.

2. Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit.

3. Nëse gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, përpara publikimit të një procedure prokurimi, njësia e prokurimit ka nevojë për asistencë, komunikon me APP-në, për të marrë një mendim të specializuar mbi mënyrën e zbatimit të legjislacionit të prokurimit publik.

Me qëllim dhënien e asistencës, ngritjen e kapaciteteve dhe sigurimin e mirëzbatimit të legjislacionit të prokurimit publik, APP-ja, në koordinim me personin/at përgjegjës për prokurimin mund të asistojë këta të fundit gjatë përgatitjes të dokumenteve të tenderit në përputhje me dokumentet standarde të tenderit dhe rregullat e prokurimit publik.

Për efekt shpejtësie, komunikimi me APP-në për koordinimin e veprimtarisë gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit dhe marrjes së asistencës mund të bëhet me mjete elektronike (me *email*).

Afatet dhe procedura e detajuar e koordinimit të veprimtarisë së njësive të prokurimit me APP-në, në funksion të marrjes së asistencës dhe ngritjes së kapaciteteve, rregullohen me udhëzim të APP-së.

4. Pas nënshkrimit të njoftimit të kontratës nga titullari i autoritetit kontraktor, personi/at përgjegjës për prokurimin dërgon/jnë dokumentet e tenderit dhe procesverbalin e argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, për publikim, në përputhje me nenet 55 e 56, të LPP-së.

5. Në procedurat e prokurimit me mjete elektronike, publikimi i njoftimit të kontratës, dokumenteve të tenderit dhe procesverbalit të argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.

Neni 79

Dorëzimi i ofertave

1. Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e përcaktuar në dokumentet e tenderit brenda afatit kohor, të përcaktuar në këto dokumente si afati i fundit për dorëzimin e tyre.

Në rastin e procedurave që zhvillohen në formë shkresore, çdo ofertë e dorëzuar pas afatit të përcaktuar në njoftimin e autoritetit/entit kontraktor nuk shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit të ofertave dhe i kthehet e pahapur kandidatit/ofertuesit.

Operatorët ekonomikë mund të jenë të pranishëm, nëse e kërkojnë, në procesin e hapjes së ofertave.

2. Në rastin e procedurave të prokurimit me një fazë, ofertuesit dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar, duke përfshirë dhe ofertën ekonomike, në të njëjtën kohë.

Kur procedura zhvillohet në formë shkresore, ky dokumentacion duhet të paraqitet në një zarf të mbyllur, me vulën e shoqërisë.

3. Në rastin e procedurave të prokurimit me faza, në fazën e parë të kualifikimit, dokumentacioni duhet të përmbajë vetëm dokumentet e kualifikimit, siç parashikohet në dokumentet e tenderit. Në fazën e dytë e në vijim, operatori ekonomik duhet të dorëzojë ofertën teknike dhe ofertën ekonomike.

Kur procedura zhvillohet në formë shkresore, në secilën fazë, dokumentet e kualifikimit, oferta teknike dhe ajo ekonomike duhet të paraqiten respektivisht në zarfe të mbyllura, me vulën e shoqërisë.

Në rastin e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, dorëzimi i ofertave të operatorëve do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.

4. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative.



Neni 80

Hapja e ofertave

1. Komisioni i vlerësimit të ofertave hap dhe lexon ofertat në përputhje me nenin 90, të LPP-së, dhe me përcaktimet në këto rregulla.

2. Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave nënshkruajnë një deklaratë, përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës.

Nëse evidentohet se një ose disa prej operatorëve ekonomikë ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me një ose disa prej zyrtarëve të caktuar për vlerësimin e ofertave, atëherë duhet të zëvendësohet zyrtari/zyrtarët në fjalë dhe më pas të vazhdojë procesi i prokurimit.

3. Personi përgjegjës për prokurimin, anëtar i njësisë së prokurimit, mund të jetë i pranishëm gjatë fazës së hapjes së ofertave duke kryer funksione të karakterit ndihmës, si mbajtja e procesverbalit, sistemimi dhe ruajtja e dokumenteve.

4. Në rastin kur procedura zhvillohet në formë shkresore, komisioni i vlerësimit të ofertave lexon emrin dhe adresën e ofertuesit dhe hap zarfin përkatës. Më pas, lexohet me zë të lartë oferta ekonomike dhe lista e dokumenteve ligjore, administrative dhe kualifikuese të paraqitura nga ofertuesi. Procesverbali dhe një vërtetim, që pasqyron të gjitha dokumentet, që shoqërojnë ofertën e tij duhet t'i vihet në dispozicion në bazë të kërkesës çdo ofertuesi, ndërsa ofertuesve që kanë paraqitur ofertë, por që nuk janë të pranishëm ose të përfaqësuar në hapjen e ofertave, duhet t'u dërgohet njoftim për hapjen e procedurës.

Oferta ekonomike nënshkruhet në pjesën e pasme të fletës nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal. Personi përgjegjës për prokurimin, anëtar i njësisë së prokurimit është përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

5. Nëse anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë mendime të ndryshme ose nëse komisioni vendos me votim, kjo gjë duhet të dokumentohet.

6. Dokumentet që shoqërojnë ofertën nuk u kthehen ofertuesve, por mbeten pjesë e dosjes së procedurës dhe administrohen, në përputhje me nenin 21, të LPP-së.

Neni 81

Ndërhyrja në ofertë

1. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.

2. Ndërhyrje në ofertë do të konsiderohet edhe pjesëmarrja e dy ose më shumë ofertuesve me të njëjtin ortak dhe/ose administrator në të njëjtën procedurë prokurimi.

3. Autoriteti/enti kontraktor vlerëson rast pas rasti nëse konstaton të dhëna të tilla, që mund të shërbejnë si tregues për ndërhyrje në oferta nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues.

Neni 82

Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave

1. Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 20 (njëzet) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregulla.

Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/ve.

2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

i. “devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;

ii. “rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga



pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe

iii. “mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.

3. Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

a) nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij;

b) nëse ka ndonjë mospërputhje të çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij;

c) nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga kjo rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigjohet.

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shumat absolute e të gjitha korrigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

4. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogarit;

- në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/et e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

5. Në rastin e procedurave të prokurimit me faza, komisioni i vlerësimit të ofertave lexon emrin dhe adresën e kandidatit dhe listën e të gjitha dokumenteve të kualifikimit, të paraqitura prej tij. Jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 10 (dhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, nga data e dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar, komisioni i vlerësimit përcakton listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar, që do të vlerësohen për ofertën dhe ia komunikon këtë informacion menjëherë të gjithë kandidatëve, që kanë paraqitur kërkesë për pjesëmarrje. Kandidatëve të kualifikuar, në përfundim të afateve të ankimit, u dërgohet një ftesë për ofertë, në përputhje me nenin 58, të LPP-së.

Më pas, komisioni i vlerësimit të ofertave vazhdon vlerësimin e ofertave teknike të kandidatëve të kualifikuar dhe bën klasifikimin teknik.

Në varësi të llojit të procedurës së prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, në varësi të kompleksitetit të kontratës, mund të zhvillojë negociata në faza të ndryshme me secilin nga kandidatët e përzgjedhur, por gjithmonë duhet të pasqyrojë përmbajtjen e tyre në procesverbalin përkatës.

Komisioni i vlerësimit të ofertave kalon në shqyrtimin e ofertës ekonomike dhe verifikon nëse ka gabime aritmetike apo çmim anomalisht të ulët, sipas përcaktimeve në pikat 3 dhe 4, të këtij neni.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të pasqyruara në procesverbal.



Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit të ofertave merr vendim për shpalljen e fituesit, i cili publikohet në sistemin e prokurimit elektronik menjëherë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit.

Në rastin e procedurave me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, afatet për vlerësimin e ofertave përcaktohen nga autoriteti kontraktor, në varësi të kompleksitetit të kontratës dhe situatës konkrete.

6. Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Njoftimi për datën dhe orën e hedhjes së shortit u njoftohet ofertuesve. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën shkak për skualifikim.

Neni 83

Njoftimi i fituesit

1. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave, autoriteti/enti kontraktor bën klasifikimin përfundimtar dhe harton njoftimin e fituesit.

2. Menjëherë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti/enti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit, në përputhje me nenin 97, të LPP-së.

3. Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në formë shkresore, autoriteti/enti kontraktor publikon njoftimin e fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Neni 84

Raporti përmbledhës

1. Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit/entit kontraktor.

2. Raporti përmbledhës duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;
- përshkrimin e punëve/ mallrave/shërbimeve;
- respektimin e kërkesave ligjore në procesin e hapjes së ofertave;
- çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës;
- korrigjimin e gabimeve aritmetike dhe ofertat anomalisht të ulëta (nëse ka pasur të tilla);

- të dhënat e ofertuesve të skualifikuar, ofertën ekonomike dhe arsyet e skualifikimit;

- të dhënat e ofertuesve të kualifikuar, ofertën ekonomike të tyre;

- informacion për hedhjen e shortit (nëse ka pasur oferta me vlerë të njëjtë);

- të dhënat e ofertuesit fitues;

- informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrjen në lidhje me to, si dhe çdo informacion tjetër a korrespondencë që lidhet me vlerësimin e ofertave.

Neni 85

Lidhja e kontratës

1. Autoriteti/enti kontraktor do të ftojë operatorin ekonomik të shpallur fitues, që të lidhë kontratën menjëherë pas përfundimit të afateve të ankimit ose dhënies së një vendimi përfundimtar për ankesën, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga kjo datë.

Operatori ekonomik i shpallur fitues është i detyruar t'i përgjigjet kërkesës së autoritetit/entit kontraktor për lidhjen e kontratës brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

2. Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Neni 86

Publikimi i njoftimit të lidhjes së kontratës

Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar.

Neni 87

Mënyra e zhvillimit të procedurave me mjete elektronike

Mënyra e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.



KREU XI KUSHTE TË PËRGJITHSHME PËR ZBATIM

Neni 88

Bashkimi i operatorëve ekonomikë

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

4. Operatori ekonomik, anëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht edhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt

oferta e tij refuzohet. Autoriteti ose enti kontraktor, para lidhjes së kontratës, mund të kërkojë që bashkimi i operatorëve ekonomikë të krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar.

5. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

6. Në rast falimentimi të një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me operatorin/ët e tjerë ekonomikë, anëtarë të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti/enti kontraktor zgjidh kontratën.

Neni 89

Nënkontraktimi

1. Autoriteti/enti kontraktor mund të lejojë nënkontraktimin për realizimin e një pjese të kontratës sipas përcaktimit në nenin 126, të LPP-së. Në asnjë rast, kontraktorët nuk mund t'ua transferojnë kontratën palëve të treta. Autoriteti/enti kontraktor lejon në veçanti nënkontraktimin për të nxitur pjesëmarrjen e operatorëve të vegjël e të mesëm ekonomikë.

2. Në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohet qartë nëse lejohet ose jonënkontraktimi, si dhe nëse autoriteti/enti kontraktor do t'i bëjë pagesa të drejtpërdrejta nënkontraktorit.

3. Në asnjë rast nënkontraktimi nuk duhet të tejkalojë 50% të vlerës së kontratës.

4. Me dorëzimin e ofertave, ofertuesit duhet të deklarojnë punët/shërbimet/mallrat ose një pjesë të tyre që ata kanë qëllim të nënkontraktojnë, në rast se shpallen fitues, si dhe emrin e nënkontraktorit.

5. Përpara lidhjes së kontratës, ofertuesi i shpallur fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit/entit kontraktor një kopje të noterizuar të marrëveshjes së nënkontraktimit.

Nënkontraktori duhet të plotësojë kërkesat e nenit 76, të LPP-së, dhe të plotësojë kriteret e kualifikimit për pjesën e punës/shërbimit/mallrave që merr përsipër të furnizojë. Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson nëse nënkontraktori



plotëson këto kërkesa, në mënyrë që autoriteti/enti kontraktor të mund të miratojë nënkontraktimin.

6. Në rast të mosplotësimit nga nënkontraktori, të kriterëve të kërkuara, autoriteti/enti kontraktor vijon me lidhjen e kontratës vetëm me operatorin ekonomik të shpallur fitues.

7. Në rastet kur nënkontraktori miratohet nga autoriteti/enti kontraktor, pjesë e kontratës duhet të jenë dhe detyrimet e marra përsipër për t'u realizuar nga nënkontraktori.

8. Gjatë ekzekutimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet të kontrollojë nëse pjesa e kontratës, e marrë përsipër për t'u realizuar nga nënkontraktori, po realizohet nga ky i fundit. Në rast se autoriteti/enti kontraktor konstaton se, nënkontraktori nuk po realizon pjesën e kontratës së marrë përsipër, i kërkon kontraktorit kryesor të ndërpresë nënkontraktimin dhe të vijojë me zbatimin e kontratës.

9. Autoriteti/enti kontraktor lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti te nënkontraktori për furnizimet, shërbimet ose punët që i ka ofruar kontraktorit kryesor, kur një gjë e tillë është përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Në çdo rast, kontraktori kryesor duhet të vihet në dijeni dhe të japë miratimin me shkrim për këto pagesa, të cilat janë të lidhura me faturat e pranuar nga autoriteti/enti kontraktor për llogari të ofertuesit kryesor.

Neni 90

Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera

1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë e tillë që në dokumentet e ofertës;

- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme;

- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së;

- në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit.

Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.



Neni 91

Ulja e numrit të kandidatëve të kualifikuar që do të ftohen

1. Në procedurat e prokurimit me faza, autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve që do të ftojë për të dhënë ofertë ose për të kryer një dialog, pavarësisht numrit të kandidatëve që përmbushin kriteret e përzgjedhjes, nëse një gjë e tillë ka qenë e parashikuar dhe publikuar në dokumentet e tenderit.

2. Autoriteti/enti kontraktor, në çdo rast, duhet të argumentojë arsyen e aplikimit të mundësisë së uljes së numrit të operatorëve të kualifikuar që do të ftohen. Rastet kur ky kufizim mund të përdoret, janë:

- numri i operatorëve në treg, që mund të kualifikohen është shumë i lartë;

- operatorët e kualifikuar do të kenë akses në dokumente me informacion konfidencial, të cilin autoriteti/enti kontraktor nuk mund ta shpërndajë te shumë operatorë.

3. Për qëllim të zbatimit të nenit 85, të LPP-së, autoriteti/enti kontraktor duhet të ketë publikuar paraprakisht informacionin, si më poshtë vijon:

- a) kriteret ose rregullat objektive dhe jodiskriminuese që do të zbatohen për uljen e numrit, të cilat duhet të jenë të lidhura me vlerësimin e ofertës ekonomike të favorshme (p.sh. kandidatët e kualifikuar me numrin më të lartë të pikëve do të ftohen);

- b) numrin minimal të kandidatëve që synojnë të ftojnë, i cili, në çdo rast, nuk mund të jetë më pak se 5 (pesë) në procedurën e kufizuar dhe 3 (tre) në procedurën konkurruese me negociim, dialogun konkurrues dhe në partneritetin për inovacion. Në rastin e kontratave sektoriale, është e drejtë e entit kontraktor të përcaktojë numrin minimal të lejuar të kandidatëve, por jo më pak se 2 (dy).

Pavarësisht numrit të përcaktuar sipas kësaj pike, nëse numri i kandidatëve që përmbushin kriteret e përzgjedhjes është nën numrin minimal të lejuar, autoriteti ose enti kontraktor mund të vazhdojë procedurën, duke ftuar vetëm kandidatët e kualifikuar;

- c) numrin maksimal të kandidatëve, që synojnë të ftojnë.

Neni 92

Ulja e numrit të ofertave dhe zgjidhjeve

1. Në procedurat e prokurimit me faza, autoriteti/enti kontraktor, në fazën përfundimtare, mund të kufizojë numrin e ofertave dhe zgjidhjeve, nëse një gjë e tillë ka qenë e parashikuar dhe publikuar në dokumentet e tenderit.

2. Autoriteti/enti kontraktor, në çdo rast, duhet të argumentojë arsyen e aplikimit të mundësisë së uljes së numrit të ofertave dhe zgjidhjeve.

3. Autoriteti/enti kontraktor nuk mund të vendosë të përcaktojë numrin minimal të ofertave dhe zgjidhjeve në më pak se dy.

Në çdo rast, numri i zvogëluar i ofertave ose i zgjidhjeve duhet të sigurojë konkurrencë të drejtë në fazën përfundimtare të negociatave ose të dialogut.

Neni 93

Sigurimi i konkurrencës

1. Autoriteti/enti kontraktor duhet të marrë masa të sigurojë pjesëmarrje të gjerë të operatorëve ekonomikë dhe konkurrencë të drejtë në procedurat e prokurimit.

2. Në rast mungese të sigurimit të konkurrencës, autoriteti/enti kontraktor anulon procedurën, si më poshtë vijon:

- a) në procedurat me faza:

- i. në fazën e parë nuk është dorëzuar asnjë kërkesë për pjesëmarrje e përshtatshme;

- ii. në fazën e dytë nuk është asnjë ofertë e vlefshme;

- b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme.

3. Autoriteti/enti kontraktor, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizon shkaqet që çuan në dështimin e procedurës dhe, nëse është rasti, i korrigjon ato në mënyrë që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës.

Ky proces dokumentohet në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim, nga njësia e prokurimit.



KREU XII ANKIMI ADMINISTRATIV

Neni 94 **Paraqitja e ankesave**

1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP-së, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe komisionit të prokurimit publik.

2. Operatori ekonomik ankimues duhet të dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe komisionin e prokurimit publik.

3. Ankimesi përdor formularin standard të ankesës, që përmban të paktën: emrin, adresën, adresën elektronike të ankimesit, referencën e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkëlqes së pretenduar.

Ankimesi është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës pranë komisionit të prokurimit publik.

Ankimesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe komisionin e prokurimit publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë komisionit të prokurimit publik. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet.

4. Në rast se autoriteti/enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është bërë sipas formularit standard ose i mungon ndonjë prej elementeve të sipërpërmendura ose nuk është shoqëruar me mandat pagesën, duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin.

Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë dhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të njoftojë komisionin e prokurimit publik lidhur me veprimet e mësipërme, për korrigjimin e të metave të ankesës.

5. Ankesa duhet të korrigjohet dhe paraqitet në autoritetin/entin kontraktor dhe komisionin e prokurimit publik brenda 2 (dy) ditëve nga njoftimi.

Nëse ankesa nuk korrigjohet/plotësohet brenda këtij afati, ajo vlerësohet si e paraqitur.

Nëse afati i fundit bie gjatë ditëve të pushimit zyrtar, atëherë afati i fundit për plotësimin e ankesës do të jetë ditën pasardhëse të punës.

6. Formulari standard i ankesës hartohet nga APP-ja, në bashkëpunim me komisionin e prokurimit publik, dhe është pjesë e dokumenteve standarde të tenderit.

Neni 95 **Veprimet paraprake të komisionit të prokurimit publik**

1. Komisioni i prokurimit publik, me marrjen e ankesës në përputhje me parashikimet e nenit 94, të këtyre rregullave, publikon në bazën e të dhënave të tij:

a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in;

b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës);

c) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit;

ç) pretendimet për arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;

d) pretendimet për kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë, duke referuar vetëm arsyet, për të cilat ngrihen pretendime.

2. Veprimet, sipas shkronjave “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 1, të këtij neni, bëhen jo më vonë se dita pasardhëse e punës.

Neni 96 **Veprimet paraprake të autoritetit/entit kontraktor**

1. Me marrjen e ankesës me shkrim nga ankimesi, personi përgjegjës për prokurimin konfirmon në bazën e të dhënave të publikuara nga komisioni i prokurimit publik, nëse ankesa është paraqitur edhe pranë KPP-së.

Në rast se, ankesa rezulton e publikuar, titullari i autoritetit/entit kontraktor urdhëron njësinë e prokurimit dhe komisionin e vlerësimit të ofertave të pezullojnë vazhdimin e procedurës, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, sipas parashikimeve të LPP-së.

Veprimet dhe vendimet e autoritetit/entit kontraktor, sipas kësaj pike, bëhen jo më vonë se dita pasardhëse e punës.



Autoriteti/enti kontraktor duhet të vijojë të verifikojë bazën e të dhënave të publikuara nga komisioni i prokurimit publik përgjatë afatit 10-ditor (dhjetëditor).

Procesi i pezullimit në sistemin e prokurimit elektronik bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.

2. Në rast se ankesa është paraqitur pranë autoritetit/entit kontraktor, por ende nuk është publikuar nga KPP-ja, autoriteti/enti kontraktor do të cilësojë si datë të fillimit të afateve procedurale, datën e publikimit të ankesës në bazën e të dhënave të KPP-së.

3. Nëse autoriteti/enti kontraktor konstaton se, ankesa nuk është paraqitur në komisionin e prokurimit publik, në përputhje me nenin 110, të LPP-së, e refuzon atë, si të pavlefshme.

Neni 97

Afatet për paraqitjen e ankesave

1. Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

2. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

3. Në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, në procedurat e prokurimit me faza, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/ entit kontraktor:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

4. Në rastin e ankesave për lidhjen e një kontrate në bazë të një marrëveshjeje kuadër, me disa operatorë ekonomikë, pas procedurave për rihapjen e konkurrimit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të fituesit të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të fituesit të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

Neni 98

Afate për ankime të veçanta

1. Në rastin e procedurave me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit.

Nëse është publikuar njoftimi vullnetar për transparencë, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi, sa i takon plotësimit të kushteve për përdorimin e kësaj procedure prokurimi, si dhe përmbajtjes së dokumenteve të tenderit.

2. Në rastin e konstatimit të një kontrate publike të lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP dhe/ose në rastin kur nuk është publikuar njoftimi i fituesit ose njoftimi i kontratës së nënshkruar, afati për paraqitjen e një ankese lidhur me këtë kontratë është 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga dita e konstatimit të saj, por jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.



Neni 99

Paraqitja e argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar

1. Për ankesat për vendimet e autoritetit/entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me ankesën, njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe komisionit të prokurimit publik.

2. Paraqitja e argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar bëhet sipas një formulari standard, i cili hartohet nga APP-ja, në bashkëpunim me komisionin e prokurimit publik, dhe është pjesë e dokumenteve standarde të tenderit.

3. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e argumenteve, sipas pikës 1, të këtij neni, është 7 (shtatë) ditë nga publikimi i ankesës nga komisioni i prokurimit publik.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, ky afat është 5 (pesë) ditë.

4. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar, nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të kësaj pike, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë lidhur me ankesën për këtë procedurë prokurimi.

Neni 100

Afatet e shqyrtimit të ankesave nga autoriteti/enti kontraktor

1. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti/enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar ose deklarativ nga komisioni i prokurimit publik.

2. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti/enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur, brenda 5 (pesë) ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga komisioni i prokurimit publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të

ofertave, autoriteti/enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur, brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113, të LPP-së, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

3. Në rastin kur, për shqyrtimin e ankesës, autoriteti/enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar, afati nuk duhet të tejkalojë 30 (tridhjetë) ditë.

Autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni komisionin e prokurimit publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

4. Autoriteti/enti kontraktor merr vendim, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 114, të LPP-së, dhe vë në dijeni, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, komisionin e prokurimit publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit/entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë komisionit të prokurimit publik, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4, të këtij neni.

Neni 101

Hapat për shqyrtimin e ankesave në autoritetin/entin kontraktor

Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti/enti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm:

1. Titullari i autoritetit/entit kontraktor, me urdhër të veçantë, cakton një person ose ngre një komision të përbërë nga të paktën 3 (tre) persona për shqyrtimin e ankesës.

Të paktën njëri nga anëtarët e komisionit për shqyrtimin e ankesës duhet të jetë ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim.

Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit për të cilin është paraqitur ankesa.



Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave ose ekspertit të fushës, anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave.

2. Personi përgjegjës për prokurimin duhet të kujdeset që të njoftojë ankimuesit dhe operatorët ekonomikë të interesuar, të përfshirë në proces për çdo vendim në procesin e shqyrtimit të ankesës edhe në adresën elektronike të përcaktuar prej tyre në formularin e ankesës, jo më vonë se ditën e nesërme të punës pas marrjes së çdo vendimi.

3. Në rastin kur ankesa është pranuar plotësisht dhe nuk ka pasur argumente nga operatorët ekonomikë të interesuar, titullari i autoritetit/entit kontraktor njofton komisionin e prokurimit publik lidhur me këtë vendimmarrje dhe adreson zbatimin pas marrjes së vendimit deklarativ nga komisioni i prokurimit publik.

4. Në rastet kur afatet kohore të procedurës së prokurimit, për të cilat janë njoftuar ofertuesit, ndryshojnë për shkak të marrjes parasysh të ankesës, autoriteti/enti kontraktor u shpërndan ofertuesve një njoftim të posaçëm, ku jepen arsyet për zgjatjen e këtyre afateve.

Neni 102

Vendimet e autoritetit/entit kontraktor në përfundim të shqyrtimit të ankesave

1. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, sipas parashikimeve në këto rregulla, autoriteti/enti kontraktor, mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë komisionin e prokurimit publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

3. Vendimi i autoritetit/entit kontraktor u komunikohet të gjitha subjekteve të përfshira në proces.

Neni 103

Vendimet e komisionit të prokurimit publik

1. Komisioni i prokurimit publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin/entit kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit, nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin/entit kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, komisioni i prokurimit publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111, të LPP-së;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin/ entit kontraktor të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin/ entit kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3, të nenit 115, të LPP-së;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga komisioni i prokurimit publik, në rast të një ankese tjetër që i përket së njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik.

Në çdo rast, vendimet e komisionit të prokurimit publik duhet të merren në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 5, të nenit 115, të LPP-së.

Në kuadër të shqyrtimit të një ankese, komisioni i prokurimit publik ka të drejtë të kërkojë ekspertizë nga palë të treta ose të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, por nuk mund të pezullojë vendimmarrjen dhe t'u kërkojë organeve të tjera kryerjen e procedimeve administrative për çështjen në fjalë.

3. Pas lidhjes së kontratës, komisioni i prokurimit publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit/entit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e LPP-së, ka të drejtë:



a) të deklarojë të pavlefshme kontratën e nënshkruar, në përputhje me parashikimet e LPP-së;

b) të shkurtojë kohëzgjatjen e kontratës dhe të kërkojë ndërprerjen e parakohshme të saj;

c) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme, si rezultat i shkeljes së ligjit.

Neni 104

Ankesat për prokurimet me vlerë të vogël

1. Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, operatorët ekonomikë të refuzuar ose të renditur deri në vend të dhjetë, sipas përcaktimeve në nenin 56, të këtyre rregullave, kanë të drejtën të ankohen vetëm në autoritetin/entit kontraktor.

Ankesat mund të bëhen për kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë ose për procesin e vlerësimit të ofertave.

2. Operatori/ët ekonomikë, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij neni, të cilët kanë pretendime për procedurën e prokurimit, mund të paraqesin ankesë me shkrim brenda 2 (dy) ditëve nga konfirmimi i njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik.

3. Titullari i autoritetit/entit kontraktor cakton me detyrën e shqyrtimit të ankesave një person që nuk ka qenë më parë i përfshirë në procedurën respektive.

4. Me marrjen e ankesës, autoriteti/enti kontraktor pezullon vijimin e procedurës së prokurimit, deri në shqyrtimin e plotë të ankesës.

5. Personi i ngarkuar me shqyrtimin e ankesës duhet të shprehet me vendim për pranimin ose refuzimin e ankesës, brenda 2 (dy) ditëve nga marrja e ankesës.

6. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këto rregulla, autoriteti/enti kontraktor, mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

Vendimi i dhënë nga autoriteti/enti kontraktor i komunikohet menjëherë edhe në rrugë elektronike ankuesit/ankuesve.

Kundër vendimit të autoritetit/entit kontraktor, operatori ekonomik ka të drejtë të ankohet në

gjykatën përkatëse që shqyrton mosmarrëveshjet administrative.

7. Ankimi në gjykatë nuk pezullon procedurën, lidhjen e kontratës apo ekzekutimin e detyrimeve mes palëve.

Neni 105

Tërheqja e ankimit

Operatori ekonomik ankimues ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar, në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e komisionit të prokurimit publik.

Me paraqitjen e kërkesës për tërheqje, ndërpritet shqyrtimi i ankesës menjëherë. Për efekt të tarifës, ankesa konsiderohet si e mospranuar dhe tarifa e ankesës nuk kthehet.

KREU XIII

EKZEKUTIMI DHE MBIKËQYRJA E KONTRATËS

Neni 106

Kohëzgjatja e kontratës

1. Autoriteti/enti kontraktor për fondet buxhetore prokuron kontrata bazuar në fondin e një viti buxhetor.

2. Autoriteti/enti kontraktor mund të lidhë kontrata shumëvjeçare vetëm në rrethana të argumentuara, të shpallura në njoftimin e kontratës, që lidhen ngushtësisht me natyrën, kompleksitetin dhe financimin e saj, autoriteti/enti kontraktor mund të lidhë një kontratë shumëvjeçare, nëse:

a) objekti i tyre është blerja, qiraja ose blerja me këste e mallrave, me ose pa mundësinë e kalimit të pronësisë, shërbimeve, që zgjat deri në pagimin e plotë të vlerës ose derisa pronësia t'i kalojë autoritetit kontraktor;

b) është kontratë komplekse, që kërkon financim shumëvjeçar ose të strukturuar, e cila nuk mund të zbatohet brenda vitit buxhetor (si për shembull, projektet komplekse në infrastrukturë) dhe ku financimi i saj është i garantuar.

3. Autoriteti/enti kontraktor nuk lidh kontrata shumëvjeçare për punë, mallra ose shërbime, për të cilat bëhen planifikim dhe përdorime vjetore, që gjenden lehtësisht në treg dhe mund të prokurohen normalisht.



4. Në çdo rast, financimi i kontratave të prokurimit bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

Neni 107

Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës

1. Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore të autorizuar me ligj mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë dhe legjislacionin në fuqi.

2. Autoriteti/enti kontraktor, gjatë hartimit të kontratës, mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe nuk vijnë në kundërshtim me dokumentet e tenderit. Këto kushte mund të përfshijnë faktorë ekonomikë, ato që lidhen me inovacionin, faktorë mjedisorë, socialë ose që lidhen me punësimin. Këto kushte nuk duhet të rëndojnë ose të favorizojnë operatorin ekonomik fitues, ato duhet të jenë në përputhje me objektin e kontratës.

3. Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti/enti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës sipas një plani zbatimi. Autoriteti/enti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

4. Plan i zbatimit të kontratës përfshin në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor. Plan duhet të nënshkruhet nga autoriteti/enti kontraktor dhe operatori ekonomik, brenda 7 (shtatë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe, në çdo rast, para fillimit të zbatimit të saj.

Një kopje e këtij plani i dërgohet APP-së brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi.

Pas çdo modifikimi që mund t'i bëhet kontratës, plani përditësohet brenda 7 (shtatë) ditëve nga hartimi dhe nënshkrimi i modifikimit nga palët.

Plan i përditësuar i dërgohet APP-së brenda 5 (pesë) ditëve nga përditësimi.

5. Autoriteti/enti kontraktor duhet raportojë në APP për çdo fazë: për modifikimin/modifikimet e

çdo kontrate, ndërprerjen, përfundimin (me sukses apo penaltet) apo shpalljen e pavlefshme të saj, duke pasqyruar në formularin përkatës, arsyet, rrethanat dhe argumentimin përkatës, mbi bazën e dispozitave ligjore që është bërë modifikimi, ndërprerja, përfundimi apo shpallja e pavlefshme e kontratës.

6. Personi ose strukturat e ngarkuara për ndjekjen e kontratës lidhur me ecurinë e zbatimit të kontratës, përgatisin informacione të vazhdueshme për problematikat në këtë proces dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, të cilat ia përcjellin personit përgjegjës për prokurimin, me qëllim raportimin prej këtij të fundit, pranë APP-së.

Në përfundim të kontratës, personi ose strukturat e ngarkuara për ndjekjen e kontratës përgatisin një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti, si dhe paraqet një informacion për likuidimin ose jo të kontratës. Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i kontratës, si dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at përgjegjës për prokurimin.

7. Personi apo strukturat e ngarkuara nga titullari i autoritetit/entit kontraktor, sipas legjislacionit të fushës në fuqi, duhet të ndjekin me përpikëri ecurinë e zbatimit të kontratës, për t'u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës.

Personi apo strukturat e ngarkuara për ecurinë e zbatimit të kontratës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi:

a) harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës;

b) kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë;

c) administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

ç) sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë dhe afateve, kur është rasti;

d) menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/modifikime/përshtatje të saj;



dh) raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor për shkelje të dispozitave kontraktuale;

e) administron kërkesat për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;

ë) mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës;

f) përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së.

8. Raportimi, sipas parashikimeve të këtij neni do të bëhet në përputhje me udhëzimet e APP-së.

Neni 108

Raportimi në rastet e mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale

1. Mospërbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike, sipas përcaktimeve të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 78, të LPP-së.

Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundimi i afatit të zbatimit të saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë.

2. Paraqitja e kërkesës në APP, jashtë afatit të përcaktuar në këtë pikë, ngarkon me përgjegjësi autoritetin/entin kontraktor. Në çdo rast, APP-ja nuk pengohet në veprimet e mëtejshme për shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin e operatorit ekonomik.

KREU XIV

HETIMI ADMINISTRATIV NGA AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Neni 109

Rastet për kryerjen e hetimit administrativ

1. Agjencia e Prokurimit Publik kryen hetim administrativ, në përputhje me parashikimet e nenit 129, të LPP-së, si më poshtë vijon:

a) për verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në kryerjen e procedurave të prokurimit publik, pasi ka përfunduar procedura me nënshkrimin e kontratës së prokurimit, por, në çdo rast, jo më vonë se 3 (tre) vjet nga nënshkrimi i saj;

b) për verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në kryerjen e procedurave të prokurimit edhe nëse këto procedura janë anuluar, por, në çdo rast, jo më vonë se 3 (tre) vjet nga anulimi i tyre;

c) për përjashtimin e një operatori ekonomik nga fitimi i kontratave publike, në çdo rast, jo më vonë se 3 (tre) vjet nga shkaktimi i situatës, për të cilën kërkohet përjashtimi;

ç) për monitorimin e zbatimit të kontratës së nënshkruar nga autoriteti/enti kontraktor, nga momenti i nënshkrimit të kontratës dhe jo më vonë se 3 (tre) vjet nga përfundimi i zbatimit ose ndërprerja e saj.

Neni 110

Procedura hetimore në procesin e përjashtimit të operatorëve ekonomikë

1. APP-ja përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike, për një periudhë nga 3 (tre) muaj deri në 3 (tre) vjet, në rastet e përcaktuara në nenin 78, të LPP-së.

2. Procedimi administrativ ndaj një operatori ekonomik mund të iniciohet në bazë të kërkesave nga të tretët, të argumentuara dhe mbështetura në prova dokumentare ose gjatë verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë së procedurave apo monitorimit të kontratave, nga vetë APP-ja.

3. Çdo kërkesë e paraqitur në APP nga të tretët duhet të shoqërohet me dokumentacionin provues.

Kur dokumentacioni i paraqitur sipas kësaj pike nuk është i plotë, APP-ja e kthen për plotësim pranë kërkuarit që ka nisur kërkesën. Nëse kërkesa nuk plotësohet, ajo do të konsiderohet e paparaqitur.

APP-ja, pasi vlerëson kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues, kur është e nevojshme, i kërkon autoritetit/entit kontraktor përkatës të bëjë verifikimet pranë institucioneve kompetente dhe të dërgojë në APP informacion për rezultatet e këtyre verifikimeve.

4. APP-ja ka të drejtë të bëjë verifikim të informacionit apo dokumenteve të paraqitura pranë saj për këtë qëllim në çdo fazë të procesit.



5. Procedura e hetimit administrativ nga APP-ja kryhet në përputhje me përcaktimet e nenit 129, të LPP-së dhe kodit të procedurave administrative.

6. APP-ja merr vendim:

a) për përjashtimin e operatorit ekonomik, kur provohet se plotësohen kushtet e përcaktuara në LPP;

b) të mbyllë procedimin administrativ, duke mos përjashtuar operatorin ekonomik, kur nuk provohen kushtet e përcaktuara në LPP.

7. Kur përjashtimi i operatorit ekonomik vjen si pasojë e një vendimi të formës së prerë të komisionit të autoritetit të konkurrencës për marrëveshje në oferta, APP-ja procedon direkt me marrjen e një vendimi përjashtimi dhe njofton operatorin ekonomik.

8. Në dhënien e një vendimi, APP-ja duhet të mbajë në konsideratë të paktën elementet, si më poshtë vijon:

a) vlerën e përlogaritur të fondit limit/kontratës;

b) faktin nëse operatori ka fituar fonde publike;

c) rrethanat e kryerjes së shkeljes;

ç) pasojat e ardhura;

d) shpeshtësinë e kryerjes së shkeljes;

dh) elemente të tjera në varësi të rastit konkret.

Neni 111

Verifikimi i kryerjes së procedurave të prokurimit dhe monitorimi i zbatimit të kontratave

1. APP-ja kryen hetim administrativ për zbatimin e legjislacionit për prokurimin publik, lidhur me:

a) kryerjen e procedurave të prokurimit publik, pas nënshkrimit të kontratës ose kryerjen e procedurave pas anulimit të procedurës së prokurimit;

b) ecurinë e zbatimit të kontratave publike.

2. Hetimi administrativ kryhet në përputhje me nenin 129, të LPP-së, dhe Kodin e Procedurave Administrative.

Ky hetim mund të iniciohet kryesisht nga APP-ja ose në bazë të pretendimeve të argumentuara dhe dokumentuara nga të tretët.

3. Në përfundim të hetimit administrativ, kur vëren se janë shkelur dispozitat ligjore të prokurimit dhe rregullat e prokurimit publik, APP-ja mund të vendosë të dënojë me gjobë ose të

propozojë dhënien e masave disiplinore, sipas parashikimeve të nenit 132, të LPP-së.

4. Në çdo rast, për vendosjen e masës së gjobës apo propozimit të një prej masave disiplinore, kur vëren shkelje të dispozitave të LPP-së, APP-ja duhet t'u referohet të paktën elementeve të mëposhtme:

- rolit të zyrtarit të prokurimit dhe kompetencave në vendimmarrje;

- vlerës së përlogaritur të fondit limit/kontratës;

- parimeve të prokurimit që janë shkelur;

- natyrës së shkeljes;

- pasojave të ardhura;

- përsëritjes së shkeljeve në raste të tjera ose procedurave të tjera;

- elementeve të tjera objektive, që APP-ja i evidenton dhe argumenton në vendimmarrjen e saj.

5. Pasi merr një vendim në përputhje me LPP-në dhe këto rregulla, APP-ja duhet t'ia njoftojë vendimin autoritetit/entit kontraktor.

Autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin t'u njoftojë vendimin e dhënë nga Agjencia e Prokurimit Publik personave të përfshirë në hetimin administrativ dhe të dokumentojë këtë njoftim.

Autoriteti/enti kontraktor përkatës ka detyrimin të informojë APP-në për zbatimin e masave të vendosura sipas këtij neni, brenda afatit kohor të përcaktuar prej saj.

Neni 112

Komunikimi, publikimi dhe ankimi i vendimmarrjes së Agjencisë së Prokurimit Publik

1. APP-ja i njofton vendimin përfundimtar palëve brenda ditës pasardhëse të punës nga marrja e vendimit.

2. Një përmbledhje me të dhënat kryesore për vendimin përfundimtar publikohen në faqen zyrtare të APP-së për çdo të interesuar.

3. Vendimet e dhëna nga APP-ja janë përfundimtare administrativisht dhe personat e interesuar kanë të drejtën të ankohen në gjykatën përkatëse, që shqyrton mosmarrëveshjet administrative.



Neni 113

Refuzimi për bashkëpunim

Refuzimi i autoritetit/entit kontraktor për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik dhe/ose Agjencinë e Prokurimit Publik ngarkon me përgjegjësi titullarin e autoritetit/entit kontraktor dhe dënohet nga këto institucione me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

Neni 114

Përgjegjësia penale

Sanksionet administrative dhe masat disiplinore nuk përjashtojnë përgjegjësinë penale të personit që ka kryer shkeljet.

KREU XV

MANUALET DHE TRAJNIMI

Neni 115

Udhëzime dhe manualët shpjegues

APP-ja harton udhëzime dhe manuale shpjeguese për t'u ardhur në ndihmë të gjitha palëve gjatë kryerjes së veprimtarive të prokurimit.

Neni 116

Ngritja e kapaciteteve

1. APP-ja bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për ofrimin e trajnimeve për institucionet publike, me qëllim ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe profesionalizimin e sistemit të prokurimit publik në përgjithësi.

2. APP-ja bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për hartimin e një plani trajnimi në fushën e prokurimit publik, bazuar në kërkesat e nevojat për trajnim, si dhe në hartimin e kurrikulave përkatëse.

Neni 117

Dispozita tranzitore

1. Procedurat e prokurimit të nisura para hyrjes në fuqi të këtij vendimi vazhdojnë sipas rregullave të prokurimit publik, në bazë të të cilave ato janë shpallur.

2. Verifikimi i procedurave të prokurimit nga APP-ja bazohet në gjetjet e evidentuara sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurave dhe vendimmarrja për këto procedura do të bazohet në dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi në kohën e dhënies së vendimit.

VENDIM**Nr. 288, datë 19.5.2021**

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË TURQISË, PËR
TRAJNIMIN DHE BASHKËPUNIMIN
NË FUSHËN E SHËNDETËSISË
USHTARAKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, për trajnimin dhe bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë ushtarake, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Erion Braçe****PROTOKOLL**

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË,
PËR TRAJNIMIN DHE BASHKËPUNIMIN
NË FUSHËN E SHËNDETËSISË
USHTARAKE**

PREAMBULË

Qeveria e Republikës së Turqisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (më poshtë referuar individualisht si “Pala” dhe së bashku si “Palët”),



duke marrë në konsideratë dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Trajnimit Ushtarak ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (më poshtë e referuar si “Marrëveshja”), të datës 19 nëntor 1992;

me dëshirën për të vendosur bashkëpunim në fushën e shëndetësisë ushtarake,
kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni I Qëllimi

Qëllimi i këtij protokoll është vendosja e kushteve, sipas të cilave Palët detyrohen në fushat e specifikuar në nenin IV, brenda përgjegjësisë së autoriteteve kompetente dhe zhvillimi i bashkëpunimit.

Neni II Objekti

Ky protokoll mbulon shkëmbimin e personelit, materialeve, pajisjeve, informacionit dhe eksperiencës në fushat e specifikuar në nenin IV.

Neni III Përkufizimet

Termat e përdorur në këtë protokoll kanë kuptimet e mëposhtme:

1. **“Pala Dërguese”** është Pala që i dërgon personelin, materialet dhe pajisjet Palës Pritëse për qëllimet e këtij Protokoll.

2. **“Pala Pritëse”** është pala që pret personelin, materialet dhe pajisjet e Palës Dërguese në territorin e saj për zbatimin e këtij protokoll.

3. **“Personeli Mik”** janë anëtarët ushtarakë/civilë ose rezervë të forcave të armatosura që një prej Palëve dërgon në territorin e Palës tjetër, për qëllimet e këtij protokoll.

4. **“Studentët Mik”** janë studentët ushtarakë ose civilë të padiplomuar të forcave të armatosura, që një prej Palëve dërgon në territorin e Palës tjetër, për qëllimet e këtij protokoll.

5. **“Të afërm”** janë bashkëshortët/et dhe fëmijët e Personelit Mik për të cilët këta janë përgjegjës për t’u kujdesur sipas legjislacionit të tyre përkatës të brendshëm.

6. **“Pacientë”** janë persona ushtarakë/civilë dhe personat e varur të tyre, të cilëve Palët nuk mund t’u japin trajtim me kapacitetet e tyre dhe që kërkojnë një ekzaminim të përparuar dhe që u jepet mundësia për ekzaminim dhe trajtim në Palën tjetër nëpërmjet korrespondencës së ndërsjellë.

7. **“Institucionet trajnuese”** janë institucionet trajnuese mjekësore dhe spitalet në Republikën e Turqisë dhe institucionet trajnuese ushtarake mjekësore dhe spitalet në Republikën e Shqipërisë.

8. **“Degë trajnuese”** janë degët e ndryshme të mjekësisë, stomatologjisë, farmacisë, mjekësisë veterinarë dhe çdo lloj tjetër trajnimi në fushën e mjekësisë.

9. **“Trajnim në punë”** është trajnimi teorik dhe i aplikuar në pajtim me kurrikulën në institucionet trajnuese të Palës Pritëse.

Neni IV Fushat e bashkëpunimit

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve mbulon fushat e mëposhtme:

1. Arsimimin në fakultetin e mjekësisë;
2. Arsimimin në stomatologji;
3. Arsimimin në farmaci;
4. Arsimimin e lartë profesional mjekësor;
5. Arsimin e lartë të infermierisë;
6. Trajnimin para misionit, kurset e orientuara për misionet dhe trajnimin në punë në fushën e shëndetit;
7. Aktivitetet shkencore, si panelet, kongreset, seminarët, simpoziumet etj., në fushën e shëndetit;
8. Projektet e përbashkëta në fushën e shëndetit;
9. Arsimimin me diplomë profesionale, diplomë kolegji, diplomë pasuniversitare në fushën e shëndetit;
10. Shkëmbimin e instruktorëve, këshilltarëve, vëzhguesve, personelit ekspert, stafit akademik dhe studentët;
11. Trajtimin e pacientëve;
12. Bashkëpunimin në fushën e logistikës mjekësore;
13. Vizitat në njësitë, qendrat, spitalet dhe institucionet në fushën e shëndetit;
14. Organizimin e ushtrimeve të përbashkëta në fushën e shëndetit dhe dërgimin e vëzhguesve në këto ushtrime;
15. Shkëmbimi i ndërsjellë i informacionit dhe i asistencës në fushën e ngritjes së institucioneve të



shëndetit, operimin e tyre dhe dhënien e shërbimit shëndetësor.

Neni V

Parimet e zbatimit dhe bashkëpunimit

1. Aktivitetet trajnuese:

a) Personeli Mik dhe Studentët Mik, që dërgohen për qëllime trajnimi përzgjidhen nga Palët me marrëveshje dhe në pajtim me legjislacionin dhe mundësitë e Palës Pritëse;

b) Periudhat e trajnimit do të përcaktohen në pajtim me legjislacionin e Palës Pritëse;

c) Kuotat për sferat e trajnimit përcaktohen çdo vit nëpërmjet bashkërendimit ndërmjet institucioneve të trajnimit të të dyja vendeve;

d) Personeli Mik dhe Studentët Mik respektojnë parimet e arsimit, diagnostikimit dhe trajtimit, në pajtim me dispozitat e legjislacionit të brendshëm të Palës Pritëse;

e) Gjuha e mësimdhënies do të jetë turqisht/anglisht në Republikën e Turqisë dhe shqip/anglisht në Republikën e Shqipërisë. Trajnimi dhe arsimimi që zgjat më shumë se një vit jepet në turqisht në Republikën e Turqisë dhe në shqip në Republikën e Shqipërisë;

f) Personeli Mik dhe Studentët Mik do të kenë nivelin e përshtatshëm të njohurive të gjuhës së mësimdhënies së Palës Pritëse për të ndjekur mësimin me sukses;

g) Nëse kërkohet, Palët reciprokisht ofrojnë mundësi për mësimin e gjuhës;

h) Gjatë praktikave të diagnostikimit dhe trajnimit, Personelit Mik dhe Studentëve Miq u jepet mundësia me të njëjtat kushte, si dhe personeli homolog i Palës Pritëse në praktikën që ata marrin pjesë si një domosdoshmëri e programit trajnues gjatë periudhës së trajnimit. Personi Mik lidh një siguracion për përgjegjësinë profesionale, sipas legjislacionit të Palës Pritëse;

i) Personeli Mik dhe Studentët Mik duhet të jenë në gjendjen shëndetësore për të ndjekur me sukses trajnimin e parashikuar. Personeli Mik dhe Studentët Mik i nënshtrohen një trajnimi pas marrjes së një raporti mjekësor në gjuhën turke ose angleze dhe pasi të kenë bërë të gjitha vaksinat e duhura. Në rast se raporti mjekësor dhe/ose raportet e vaksinave nuk sillen ose në raste të jashtëzakonshme, Pala Pritëse i ofron Personelit Mik dhe Studentëve Miq ekzaminimet mjekësore

dhe vaksinat e duhura, sipas dispozitave të nenit 7, “Shërbimet shëndetësore”;

j) Situata e Personelit Mik dhe Studentëve Miq, për të cilët vazhdimi i trajnimit konsiderohet të mos jetë i përshtatshëm për arsye të mospërparimit, mungesës së disiplinës ose shëndetit të dobët trajtohet në kuadrin e legjislacionit të Palës Pritëse. Situata e këtij personeli i njoftohet autoritetit kompetent të Palës Dërguese nga autoriteti kompetent i Palës Pritëse. Në këtë rast, Pala Dërguese tërheq Personelin Mik dhe Studentët Mik pa rimbursuar shpenzimet e bëra për ta;

k) Pala Dërguese mund të tërheqë Personelin Mik dhe Studentët Mik, për të cilët vazhdon trajnimi, pa dhënë asnjë arsye (shpenzimet e bëra për personelin e tërhequr nuk rimbursohen).

1. Pala Pritëse lëshon një certifikatë të përshtatshme për Personelin Mik dhe Studentët Mik, të cilët marrin pjesë në trajnime/kurse dhe i përfundojnë ato me sukses.

2. Shërbimet e trajtimit:

a) Pala Pritëse mund të japë çdo vit shërbim trajtimi falas për 100 pacientë të Palës Dërguese brenda objektit të legjislacionit shëndetësor dhe financiar të Palës Pritëse. Pacientët shqiptarë që përfitojnë nga trajtimi falas në institucionet mjekësore në Turqi janë të renditur më poshtë:

1) anëtarë aktivë në detyrë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (oficerë, kapterë dhe ushtarë të specializuar) dhe të afërmit e tyre (bashkëshortë/e, fëmijë, prindër);

2) personeli rezervë dhe në pension i Forcave të Armatosura Shqiptare;

3) personeli civil që punon në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë;

b) Pala Dërguese mbulon shpenzimet e udhëtimit vajtje-ardhje për pacientët të cilëve u jepet shërbim trajtimi falas. Nëse ka avionë korrierë të planifikuar ndërmjet të dy vendeve, pacientët dhe dy persona shoqërues për secilin mund të përfitojnë nga ky avion korrier falas sipas disponibilitetit. Megjithatë, çdo dëm pasuror dhe jopasuror, paaftësi dhe vdekje që mund të shkaktohet si pasojë e faktit që pacientët dhe shoqëruesit e tyre përdorin avionin korrier, nuk i nënshtrohet kompensimit.

c) Shpenzimet e shërbimit të ekzaminimit dhe trajtimit për pacientët me dhe pa pagesë



përcaktohen sipas legjislacionit të brendshëm të Palës Pritëse;

d) Autoriteti kompetent i Palës Dërguese bën përzgjedhjen e pacientëve që do të marrin shërbim trajtimi falas dhe autoriteti kompetent i Palës Pritëse i aprovon këta pacientë;

e) Personeli Mik dhe të afërmit e tyre, të Palës Dërguese mund të aplikojnë individualisht tek institucionet mjekësore të Palës Pritëse me shpenzimet e tyre brenda objektit të këtij Protokollit;

f) Pacienti dhe shoqëruesit e tij/saj mund të përfitojnë nga klubet e oficerëve, hotelet ushtarake, marketet ushtarake dhe mensat, sipas tarifës së çmimeve që do të përcaktohet nga Pala Pritëse;

g) Pala Dërguese njofton paraprakisht Palën Pritëse për pacientët pa pagesë që kërkojnë transferim nëpërmjet ambulancës, për shkak të domosdoshmërisë së gjendjes mjekësore. Pala Pritëse i transporton pacientët falas nga aeroporti për në spital me ambulancë në pajtim me legjislacionin e kujdesit shëndetësor dhe financiar të Palës Pritëse;

h) Pacientët që kërkojnë transplant indesh ose organesh marrin trajtim me kusht që ata të shoqërohen nga dhuruesi i tyre. Nga kuota e trajtimit falas prej 100 pacientësh, 3 pacientëve në total mund t'u bëhet transplant mëlçie, veshke ose palce. Numri i dhuruesve zbritet nga kuota e 100 pacientëve që i nënshtrohet trajtimit falas çdo vit;

i) Nga kuota e trajtimit falas prej 100 pacientësh, 2 pacientëve mund t'u bëhet vendosje proteze;

j) Pala Dërguese përmbush nevojat për një përkthyes për pacientët.

Neni VI

Autoritetet kompetente dhe plani i zbatimit

1. Autoritetet kompetente për zbatimin e këtij protokollit, janë:

a) në emër të Qeverisë së Republikës së Turqisë: Shtabi i Përgjithshëm i FA-së së Republikës së Turqisë;

b) në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë: Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë.

2. Autoritetet kompetente të Palëve përgatisin Planin Vjetor të Zbatimit, në lidhje me aktivitetet e përbashkëta për zbatimin e këtij protokollit. Planin e Zbatimit, në lidhje me aktivitetet e përbashkëta

mbulon emrin dhe objektin e aktiviteteve që do të zhvillohen, tipin e tyre, kohën dhe vendin, institucionet zbatuese, çështjet financiare dhe hollësi të tjera.

3. Bashkëpunimi bëhet në bazë të reciprocitetit duke pasur parasysh interesat dhe nevojat e ndërsjella të Palëve.

4. Materialet, informacioni teknik dhe dokumentet që Palët i japin njëra-tjetrës ose prodhojnë së bashku, për shkak të këtij protokollit nuk i transferohen një vendi të tretë pa pëlqimin paraprak të Palëve.

5. Bashkëpunimi ndërmjet Palëve forcohet nëpërmjet kërtimeve shkencore të përbashkëta, pjesëmarrjen në ekspozita dhe simpoziume në fushat e mjekësisë dhe teknologjisë mjekësore, si dhe vizitave të ndërsjella në të gjitha nivelet.

Neni VII

Shërbimet mjekësore

1. Personeli Mik dhe Studentët Mik duhet të jenë në gjendje të mirë shëndetësore për të kryer çdo aktivitet sipas këtij protokollit. Pala Pritëse mund të kërkojë një raport mjekësor që certifikon që ata janë në gjendje të mirë nga pikëpamja shëndetësore.

2. Shpenzimet e shërbimeve të ekzaminimit dhe trajtimit të Studentëve Miq mbulohen sipas legjislacionit të Palës Pritëse. Pala Pritëse mbulon shumat e sigurimeve shëndetësore ose shpenzimet shëndetësore të Studentëve Miq.

3. Pala Pritëse ofron falas shërbimet mjekësore të emergjencës dhe shërbimet emergjente të kujdesit dentar për Personelin Mik dhe të afërmit e tyre. Shpenzimet e ekzaminimit dhe të trajtimit mjekësor, përveç shërbimeve mjekësore të emergjencës dhe kujdesit dentar emergjent të Personelit Mik dhe të të afërmit të tyre mbulohen nga një siguracion shëndetësor që blihet në pajtim me legjislacionin e brendshëm të Palës Pritëse.

4. Pala Pritëse mund të ofrojë falas ose përkundrejt pagesës shumat e sigurimeve ose të gjitha shpenzimet e shërbimeve të trajtimit të Personelit Mik dhe të afërmit të tyre. Nëse Pala Pritëse vendos t'i ofrojë ato përkundrejt pagesës, shumat e sigurimeve ose të gjitha shpenzimet e shërbimit të trajtimit të Personelit Mik ose personave të varur të tyre mbulohen nga Pala Dërguese ose Personeli Mik.



Neni VIII Çështjet financiare

Të drejtat financiare dhe të punonjësve të Personelit Mik dhe Studentëve Miq që jepen për të zhvilluar aktivitetet e bashkëpunimit brenda objektit të këtij protokoll jepen nga Palët, si më poshtë:

1. Pala Pritëse vendos nëse aktivitetet zhvillohen përkundrejt pagesës, falas ose sipas tarifave faktike/të reduktuara.

2. Pala Dërguese mbulon të gjitha shpenzimet e transportit për në dhe nga Pala Pritëse për Personelin e Mik dhe të afërmit e tyre, si dhe Studentët Mik.

3. Sipas rastit, Personeli Mik dhe të afërmit e tyre, si dhe Studentët Mik të Shtetit Dërgues mund të përdorin mjetet ushtarake ajrore/tokësore të transportit falas, me kusht që të merret leja nga autoritetet kompetente të Palëve. Procedurat në lidhje me përdorimin e këtyre mjeteve të transportit vendosen në pajtim me rregulloret përkatëse të Palëve.

4. Në rast se Pala Pritëse vendos që aktivitetet do të zhvillohen falas, Pala Pritëse përmbush nevojat e mëposhtme për Personelin Mik dhe Studentët Mik, në pajtim me kushtet dhe procedurat e saj. Pala Dërguese mbulon zërat që nuk janë përmendur më poshtë.

a) Për Personelin Mik:

1) pagën mujore;

2) shpenzimet e trajnimit-arsimimit;

3) pagë shtesë për mjekët që marrin trajnim të specializuar (të gjithë Personelit Mik, i cili ka marrë trajnim të specializuar dhe ka qenë në detyrë qysh nga 2 janari 2014, sipas legjislacionit të brendshëm të Palës Pritëse, por që nuk ka marrë pagë shtesë, i paguhet kjo pagë, edhe nëse arsimimi i tyre ka përfunduar);

4) uniformën.

b) Për Studentët Mik:

1) akomodimin dhe qëndrimin gjatë periudhës së trajnimit;

2) dietën ditore;

3) pagat e paguara për studentët e vitit të 6 të Fakultetit të Mjekësisë gjatë trajnimit në stazh;

4) shpenzimet e trajnimit-arsimimit;

5) uniformën.

5. Në rast se Pala Pritëse vendos që aktivitetet do të zhvillohen përkundrejt pagesës, Pala Pritëse

bën të ditura shpenzimet e trajnimit dhe arsimimit. Pala Dërguese paguan në dollarë amerikanë në llogarinë përkatëse bankare të Palës Pritëse, brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo periudhe arsimimi.

6. Pala Pritëse përmbush kërkesat e mëposhtme pavarësisht nëse trajnimi është me pagesë apo falas:

a) materialet për eksperimentet, laboratorin dhe kurset, mjetet teknike ose materiale të tjera dhe veglat e nevojshme për trajnimin;

b) aksesin te bibliotekat, gjimnazet ose vendet e tjera të nevojshme për trajnim;

c) udhëtimet e brendshme për qëllimet e trajnimit dhe të aktivitetit shkencor të aprovuara nga institucioni i trajnimit, në pajtim me legjislacionin e brendshëm të Palës Pritëse dhe shpenzimet e këtyre udhëtimeve.

Neni IX Çështjet administrative

1. Personeli Mik dhe personat e varur të tyre, si dhe studentët e ardhur, nuk kanë asnjë privilegj dhe imunitet diplomatik.

2. Përveç kur bihet dakord ndryshe nga Palët, Pala Pritëse nuk i cakton Personelit Mik dhe Studentëve Miq detyra të ndryshme nga ato të specifikuar në këtë protokoll ose marrëveshjet dhe ujdite pasuese.

3. Personeli Mik dhe Studentët Mik u nënshtrohen masave administrative të zbatuara për personelin homolog të Palës Pritëse.

4. Personeli Mik dhe Studentët Mik kanë të drejtën të veshin uniformat e tyre kombëtare, përveç kur është rënë dakord ndryshe në memorandumet mirëkuptimi, protokolle dhe masa teknike, që duhet të nënshkruhen në kuadrin e këtij protokoll. Pala Pritëse ofron pajisjet e nevojshme për përmbushjen e çdo aktiviteti gjatë misionit.

5. I gjithë Personeli Mik dhe të afërmit e tyre përfitojnë nga klubet e oficerëve dhe mensat ushtarake brenda kuadrit të legjislacionit të Palës Pritëse.

6. Në rastin e vdekjes së një anëtarit të Personelit Mik, të afërmi të tyre, Studenti Mik dhe pacienti, Pala Pritëse njofton Palën Dërguese, në lidhje me situatën dhe ofron të gjitha llojet e ndihmës për të transportuar të vdekurin në aeroportin më të afërt ndërkombëtar në vendin e tij dhe merr përsipër të paguajë shpenzimet përkatëse. Pas këtij momenti,



transporti i të vdekurit është përgjegjësi e Palës Dërguese. Pala Pritëse merr të gjitha masat e nevojshme, duke përfshirë mbrojtjen sanitare deri në transportimin e të vdekurit.

7. Personeli Mik dhe Studentët Mik do të shmangin aktivitetet që mund të dëmtojnë mjedisin; ata i kushtojnë vëmendje të posaçme parandalimit të ndotjes së mjedisit dhe respektojnë marrëveshjet përkatëse të Palës Pritëse.

Neni X Çështjet e tjera

Për çështjet që nuk janë specifikuar në këtë protokoll zbatohen dispozitat e Marrëveshjes. Në rast se dispozitat e specifikuara në këtë protokoll bien në kundërshtim me dispozitat e Marrëveshjes, zbatohen dispozitat e protokollit.

Neni XI Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje që lind nga zbatimi ose interpretimi i këtij protokollit zgjidhet nëpërmjet bisedimeve dhe konsultimeve ndërmjet Palëve.

2. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, çështja trajtohet nga Palët dhe fillojnë bisedimet brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Nëse nuk përftohet asnjë rezultat brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, secila Palë mund ta prishë këtë Protokoll me një afat njoftimi paraprak me shkrim prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh.

Neni XII Amendimet

Secila Palë mund të propozojë, me njoftim me shkrim, amendime për këtë protokoll, nëse është e nevojshme. Bisedimet fillojnë 30 (tridhjetë) ditë pas njoftimit me shkrim. Nëse nuk përftohet asnjë rezultat brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pas njoftimit, secila Palë mund ta prishë këtë protokoll me një afat njoftimi paraprak me shkrim prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh. Ndryshimet e dakordësuara hyjnë në fuqi në pajtim me dispozitat e parashikuara në nenin 14.

Neni XIII

Kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Kohëzgjatja e këtij protokollit është 5 (pesë) vjet nga data e hyrjes së tij në fuqi, me kusht që “Marrëveshja” të jetë në fuqi. Në rast se “Marrëveshja” prishet, ky protokoll prishet automatikisht.

2. Përveç kur Palët kërkojnë me shkrim prishen e këtij protokollit 90 (nëntëdhjetë) ditë para përfundimit të tij, kohëzgjatja e këtij protokollit pranohet automatikisht të jetë zgjatur për një periudhë njëvjeçare çdo herë.

3. Nëse një Palë vjen në përfundimin që Pala tjetër nuk respekton ose nuk mund të respektojë dispozitat e këtij protokollit, ajo mund të propozojë, me njoftim me shkrim, zhvillimin e bisedimeve. Bisedimet fillojnë jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas njoftimit me shkrim. Nëse nuk arrihet asnjë rezultat brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve në vazhdim, secila Palë mund ta prishë këtë protokoll me një njoftim paraprak me shkrim prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh.

4. Prishja e këtij protokollit nuk cenon aktivitetet e trajnimit dhe shërbimet e trajtimit të papërfunduara.

Neni XIV

Ratifikimi, hyrja në fuqi dhe revokimi

1. Ky protokoll hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit nëpërmjet kanaleve diplomatike, nëpërmjet të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën për përmbushjen e të gjitha procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të këtij protokollit.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij protokollit, revokohen sa më poshtë:

a) “Protokollit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin në Trajnimin e Personelit Mjekësor të Forcave të Armatosura”, të datës 8 mars 1994;

b) “Protokollit shtesë i protokollit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin në Trajnimin në fushën e Personelit të Kujdesit Shëndetësor në Fushën Ushtarake, i datës 8 mars 1994”, i datës 19 qershor 2001; dhe



c) “Amendamenti nr. 3 i protokollit ndërmjet Shtabit të Përgjithshëm Turk të Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi Trajnimin dhe Bashkëpunimin e Korpusit Mjekësor”, i datës 30 maj 2008.

3. Revokimi i protokolleve të sipërpërmendura nuk cenon aktivitetet e trajnimit dhe trajtimet në vazhdim. Aktivitetet e trajnimit dhe trajtimet në vazhdim vijojnë sipas këtij protokoll.

Ky protokoll nënshkruhet në Tiranë, më 24.3.2021, në dy kopje origjinale në gjuhët turke, shqipe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rastin e mosmarrëveshjes në interpretim, mbizotëron teksti në anglisht.

Ky protokoll është nënshkruar në praninë e personave të poshtësuar, të cilët janë autorizuar për këtë nënshkrim nga qeveritë respektive.

NË EMËR TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

NË EMËR TË QEVERISË TË
REPUBLIKËS SË TURQISË

NËNSHKRIM

NËNSHKRIM

EMRI: Florian Kali
GRADA:
TITULLI: Drejtor i
Përgjithshëm i Politikave të
Mbrotjes

EMRI: Muhammet Kelami
Kabay
GRADA: Kolonel
TITULLI: Atashe Ushtarak i
Republikës së Turqisë në
Tiranë

VENDIM

Nr. 295, datë 19.5.2021

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I SPITALIT RAJONAL ‘MEMORIAL’ NË FIER”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i spitalit rajonal ‘Memorial’ në Fier”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “tokë arë” dhe “drufrutorë/kultura bujqësore”, me një vlerë të përgjithshme prej 20 892 266 (njëzet milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Masa e shpërblimit për pronarët që shpronësohen, prej 20 892 266 (njëzet milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

5. Vlera e shpenzimeve të procedurës, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të nisë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të shtetit.



11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësive në favor të shtetit për pasuritë e shpronësuara.

12. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia

Shtetërore për Shpronësimin, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA E SHPRONËSIMIT TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN
NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT
“NDËRTIMI I SPITALIT RAJONAL FIER”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m ²)	Shpronësim “tokë arë”			Drufrutorë/kultura bujqësore	VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME
								Sip. (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera lekë			
1	Myzafer	Qazim	Ferko	3980	15/5	arë	7700	5,189	269	1,395,841.00	0	1,395,841.00	KONFIRMUAR ASHK
2	Ramazan	Qazim	Ferko	3980	15/6	arë	6,343	4,151	269	1,116,619.00	482,010	1,598,629.00	KONFIRMUAR ASHK
3	Vjollca, Kujtim	Sotir, Sotir	Hodaj, Cuko	3980	15/13	arë	3,000	2,122	269	570,818.00	0	570,818.00	KONFIRMUAR ASHK
4	Nasi	Sotir	Cuko	3980	15/14	arë	4,519	3,215	269	864,835.00	69,800.00	934,635.00	KONFIRMUAR ASHK
5	Sadush, Vezire, Ilijaz, Adem, Engjellueshe, Rasim	Haxhi, Sadush, Sadush, Sadush, Sadush,	Ferko, Xhelaj, Ferko, Ferko, Ferko	3980	15/19	arë	5,400	3,808	269	1,024,352.00	2,216,480.00	3,240,832.00	KONFIRMUAR ASHK
6		Shtet		3980	15/20	arë	1,112	766	-	-	0	-	KONFIRMUAR ASHK
7	Nasi	Sotir	Cuko	3980	15/21	arë	3,201	2,219	269	596,911.00	0	596,911.00	KONFIRMUAR ASHK
8	Lulzim, Seada	Pelivan, Bajram	Troka, Troka	3980	15/23	arë	7,710	5,432	269	1,461,208.00	248,070.00	1,709,278.00	KONFIRMUAR ASHK
9	Trifon	Sotir	Cuko	3980	15/25	arë	7,720	5,374	269	1,445,606.00	242,580.00	1,688,186.00	KONFIRMUAR ASHK
10	Ilijaz	Sadush	Ferko	3980	15/26	arë	6,180	4,210	269	1,132,490.00	2,185,900.00	3,318,390.00	KONFIRMUAR ASHK
11	Fatmir	Sadush	Ferko	3980	15/30	arë	6,950	4,787	269	1,287,703.00	762,080.00	2,049,783.00	KONFIRMUAR ASHK
12	Nexhmije, Teuta, Amarildo, Paola	Liko, Piro, Piro, Piro	Çuko, Çuko, Çuko, Kaleci	3980	15/31	arë	6,847	4,675	269	1,257,575.00	182,640.00	1,440,215.00	KONFIRMUAR ASHK
13	Adem	Sadush	Ferko	3980	15/32	arë	6,000	4,052	269	1,089,988.00	1,258,760.00	2,348,748.00	KONFIRMUAR ASHK
VLERA TOTALE												20,892,266.00	

Shënime.

1. Vlerësimi për pasuritë e llojit “tokë arë” është bërë në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, ku për zonën kadastrale 3980, çmimi i tokës arë është 269 lekë/m².

2. Vlerësimi i kulturave bujqësore është bërë në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërbimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 1, datë 5.10.2000 “Për kriteret teknike të përllogaritjes së vlerës së bimëve drufrutore që shpronësohen për interes publik, në rastet kur mungojnë treguesit e deklaruar të shitblerjes”.

VENDIM

Nr. 296, datë 19.5.2021

PËR PËRCAKTIMIN E FLAMURIT, STEMËS, UNIFORMËS, SI DHE NGJYRËS E SHENJAVE NË MJETET E POLICISË SË BURGJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 27, të ligjit nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e flamurit dhe stemës së Policisë së Burgjeve, sipas aneksit nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e uniformës së Policisë së Burgjeve, sipas specifikimeve përkatëse në aneksin nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Llojet e uniformës së punonjësve të Policisë së Burgjeve janë:

- uniforma për punonjësit e rolit të mesëm e të lartë;
- uniforma për punonjësit e rolit bazë;
- uniforma për punonjësit e grupit të shoqërimit, forcave operationale dhe strukturës së posaçme.

4. Miratimin e ngjyrave dhe shenjave në mjetet e Policisë së Burgjeve, sipas aneksit nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Përdorimi i shenjave identifikuese, për Policinë e Burgjeve, dhe mjetet e tyre ka si qëllim:

a) identifikimin e punonjësit të Policisë së Burgjeve dhe mjeteve të tyre në nivel qendror, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe gjatë transferimeve e shoqërimeve të personave të burgosur;

b) krijimin e kushteve lehtësuese në kryerjen e detyrave në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe jashtë saj gjatë ushtrimit të veprimtarisë;

c) dallimin e punonjësve të Policisë së Burgjeve nga struktura të tjera me uniformë, në bazë të shenjave dalluese që mbahen në uniformë;

ç) rritjen e ndjenjës së përgjegjësisë morale dhe integritetit shoqëror të punonjësit të policisë, në ruajtjen e etikës, dinjitetit dhe figurës së tij;

d) përdorimin në mënyrë të njëjtë dhe të rregullt, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, brenda dhe jashtë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

6. Vendimi nr. 463, datë 6.5.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e ngjyrës, të uniformës dhe të shenjave në mjetet e Policisë së Burgjeve”, shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Aneks nr. 1

FLAMURI DHE STEMA E POLICISË SË BURGJEVE

1. Flamuri i Policisë së Burgjeve

Elementet përbërëse të flamurit të Policisë së Burgjeve janë:

a) pjesa valëvitëse e flamurit paraqet një fushë me ngjyrë blu, me shenjën e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve;

b) në pjesën anësore flamuri ka thekë në ngjyrë të artë;

c) pjesa jo valëvitëse paraqet një shtizë cilindrike, me majë në ngjyrë floriri;

ç) përmasat e flamurit përcaktohen në një drejtkëndësh në raportin 100 cm me 140 cm;

d) flamuri i Policisë së Burgjeve përdoret në ambiente të dukshme brenda strukturave të nivelit qendror.



Flamuri i Policisë së Burgjeve

2. Stema e Policisë së Burgjeve

Stema e Policisë së Burgjeve përbëhet nga stema zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, me ngjyrë të verdhë, e vendosur mbi një sfond me ngjyrë blu me mbishkrimin “Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve”. Kjo shenjë vendoset në krahun e djathtë dhe në krahun e majtë vendoset flamuri kombëtar.



Stema e Policisë së Burgjeve

Aneks nr. 2

UNIFORMA E POLICISË SË BURGJEVE

1. Llojet e uniformës së punonjësve të Policisë së Burgjeve janë:

a) uniforma për punonjësit e rolit të mesëm e të lartë;

b) uniforma për punonjësit e rolit bazë;



c) uniforma për punonjësit e grupit të shoqërimit, forcave operacionale dhe strukturës së posaçme.

2. Uniforma për punonjësit e rolit të mesëm e të lartë:

a) për stinën e verës, uniforma përbëhet nga këmisha me mëngë të shkurtra me spaleta dhe xhepa ngjyrë bojëqielli, pa kollare;

b) në krahun e majtë të këmishës vendoset stema e Republikës dhe në krahun e djathtë vendoset simboli i Policisë së Burgjeve. Në pjesën e gjoksit në krahun e djathtë vendoset shenja e emrit, ndërsa në krahun e majtë vendoset grada e vogël e Policisë së Burgjeve;

c) këmisha vishet me pantallona stofi të holla, ngjyrë blu e errët dhe funde për femrat;

ç) këpucët janë gjysma lëkure, të zeza dhe pa shkëlqim;

d) kapela është e rrumbullakët;

dh) për stinën e vjeshtës shtohet triko akrilik me jakë “V”, me mëngë të gjata, ngjyrë blu e errët me spaleta për grada. Në krahun e majtë të trikos vendoset stema e Republikës dhe në krahun e djathtë vendoset simboli i Policisë së Burgjeve. Në pjesën e gjoksit në krahun e djathtë vendoset shenja e emrit, ndërsa në krahun e majtë vendoset grada e vogël e Policisë së Burgjeve;

e) për stinën e dimrit uniforma përbëhet nga këmishë me mëngë të gjata me spaleta dhe xhepa ngjyrë bojëqielli, me kollare. Në krahun e majtë të këmishës vendoset stema e Republikës dhe në krahun e djathtë vendoset simboli i Policisë së Burgjeve. Në pjesën e gjoksit në krahun e djathtë vendoset shenja e emrit, ndërsa në krahun e majtë vendoset grada e vogël e Policisë së Burgjeve. Këmisha vishet me pantallona dimërore stofi dhe funde stofi për femrat, ngjyrë blu e errët. Kësaj uniforme i shtohet edhe kollare ngjyrë blu e errët;

ë) për stinën e dimrit vishet xhupi sintetik me veshje të ngrohtë brenda pa spaleta, ngjyrë blu e errët. Veshja e ngrohtë është me zinxhir dhe kopsa, e çmontueshme sipas stinës. Këpucët për këtë stinë janë me qafë lëkure pa shkëlqim. Në krahun e majtë të xhupit vendoset stema e Republikës dhe në krahun e djathtë vendoset simboli i Policisë së Burgjeve. Në pjesën e gjoksit në krahun e djathtë vendoset shenja e emrit, ndërsa në krahun e majtë vendoset grada e vogël e Policisë së Burgjeve;

f) këpucët për këtë stinë janë prej lëkure me qafë dhe pa shkëlqim;

g) për rastet ceremoniale uniforma përbëhet nga kostum me xhakëtë me xhepa pllakë, pantallona ngjyrë blu e errët. Xhaketa ka në të dy cepat e jakës shenjën e jakës së Policisë së Burgjeve, përkrenaren e Skënderbeut. Në krahun e majtë të xhakëtës vendoset stema e Republikës dhe në krahun e djathtë vendoset simboli i Policisë së Burgjeve. Në pjesën e gjoksit në krahun e djathtë vendoset shenja e emrit, ndërsa në krahun e majtë vendoset grada e vogël e Policisë së Burgjeve;

gj) kostumi në rastet ceremoniale vishet me këmishë me mëngë të gjata ngjyrë të bardhë. Këpucët janë gjysma lëkure, të zeza dhe pa shkëlqim. Kapela është e rrumbullakët. Kësaj uniforme i shtohet edhe kollare ngjyrë blu e errët;

h) punonjësit e rolit të mesëm e të lartë, sipas stinës, përfitojnë edhe pelerinë shiu, doreza lëkure, çorape, rrip mesi dhe rrip shumëfunksional.

3. Uniforma e rolit bazë në regjimin e jashtëm dhe të brendshëm:

a) për stinën e verës, uniforma përbëhet nga këmishë me mëngë të shkurtra me spaleta dhe xhepa ngjyrë bojëqielli, pa kollare;

b) në krahun e majtë të këmishës vendoset stema e Republikës dhe në krahun e djathtë vendoset simboli i Policisë së Burgjeve. Në pjesën e gjoksit në krahun e djathtë vendoset shenja e emrit, ndërsa në krahun e majtë vendoset grada e vogël e Policisë së Burgjeve;

c) këmishët vishen me pantallona stofi të holla, dhe funde stofi për femrat, ngjyrë blu e errët. Pantallonat dhe fundet e stofit janë cilësi e lartë;

ç) këpucët janë gjysma lëkure, të zeza dhe pa shkëlqim;

d) kapela është blu, sportive me strehë me emblemën e vogël të Policisë së Burgjeve;

dh) për stinën e vjeshtës shtohet triko akrilik me jakë “V”, me mëngë të gjata, ngjyrë blu e errët me spaleta për grada. Në krahun e majtë të trikos vendoset stema e Republikës dhe në krahun e djathtë vendoset simboli i Policisë së Burgjeve. Në pjesën e gjoksit në krahun e djathtë vendoset shenja e emrit, ndërsa në krahun e majtë vendoset grada e vogël e Policisë së Burgjeve;

e) për stinën e dimrit uniforma përbëhet nga këmishë me mëngë të gjata me spaleta dhe xhepa ngjyrë bojëqielli, me kollare. Në krahun e majtë të këmishës vendoset stema e Republikës dhe në krahun e djathtë vendoset simboli i Policisë së Burgjeve. Në pjesën e gjoksit në krahun e djathtë



vendoset shenja e emrit, ndërsa në krahun e majtë vendoset grada e vogël e Policisë së Burgjeve. Këmisha vishet me pantallona dimërore stofi dhe funde stofi për femrat, ngjyrë blu e errët;

ë) për stinën e dimrit vishet xhupi sintetik me veshje të ngrohtë brenda pa spaleta, ngjyrë blu e errët. Veshja e ngrohtë të jetë me zinxhir dhe kopsa, e çmontueshme sipas stinës. Këpucët për këtë stinë janë me qafë Në krahun e majtë të xhupit vendoset stema e Republikës dhe në krahun e djathtë vendoset simboli i Policisë së Burgjeve. Në pjesën e gjoksit në krahun e djathtë vendoset shenja e emrit, ndërsa në krahun e majtë vendoset grada e vogël e Policisë së Burgjeve;

f) kësaj uniforme i shtohet edhe kollare ngjyrë blu e errët;

g) këpucët për këtë stinë janë me qafë lëkure pa shkëlqim;

gj) për rastet ceremoniale uniforma përbëhet nga kostum me xhakët me xhepa pllakë, pantallona ngjyrë blu e errët. Xhaketa ka në të dy cepat e jakës shenjën e jakës së policisë së burgjeve, përkrenaren e Skënderbeut. Në krahun e majtë të xhakët vendoset stema e Republikës dhe në krahun e djathtë vendoset simboli i Policisë së Burgjeve. Në pjesën e gjoksit në krahun e djathtë vendoset shenja e emrit, ndërsa në krahun e majtë vendoset grada e vogël e Policisë së Burgjeve;

h) kostumi në rastet ceremoniale vishet me këmishë me mëngë të gjata ngjyrë blu. Këpucët janë gjysma lëkure, të zeza dhe pa shkëlqim;

i) kapela është e rrumbullakët. Kësaj uniforme i shtohet edhe kollare ngjyrë blu e errët;

j) punonjësit e rolit bazë në regjimin e jashtëm dhe të brendshëm, sipas stinës, përfitojnë edhe pelerinë shiu, doreza lëkure, çorape dhe rrip shumëfunksional.

4. Uniforma e rolit bazë në grupin e sigurisë, forcat operationale dhe strukturën e posaçme:

a) për stinën e verës, uniforma përbëhet nga bluzë me jakë me tri komça, me mëngë të shkurtra, ngjyrë blu e errët dhe bluzë me mëngë të shkurtra, jakë rrumbullakët;

b) në krahun e majtë të bluzës vendoset stema e Republikës dhe në krahun e djathtë vendoset simboli i Policisë së Burgjeve. Në pjesën e gjoksit në krahun e djathtë vendoset shenja e emrit, ndërsa në krahun e majtë vendoset grada e vogël e Policisë së Burgjeve;

c) bluzat vishen me pantallona doku për verë, me xhepa anësore, ngjyrë blu e errët. Pantallonat janë cilësi e lartë;

ç) këpucët janë me qafë (tip kambale), të zeza dhe pa shkëlqim;

d) kapela është sportive me strehë me emblemën e forcave operationale dhe të sigurisë;

dh) kësaj uniforme i shtohet edhe rripi shumëfunksional;

e) për stinën e vjeshtës shtohet një xhakavento sportive me përbërje dok terikoton ngjyrë blu. Në krahun e majtë të xhakaventos vendoset stema e Republikës dhe në krahun e djathtë vendoset simboli i Policisë së Burgjeve. Në pjesën e gjoksit në krahun e djathtë vendoset shenja e emrit, ndërsa në krahun e majtë vendoset grada e vogël e Policisë së Burgjeve;

ë) për stinën e dimrit uniforma përbëhet nga bluzë me jakë me tre komça, me mëngë të gjata, ngjyrë blu e errët dhe bluzë me mëngë të gjata, jakë e rrumbullakët. Në krahun e majtë të bluzës vendoset stema e Republikës dhe në krahun e djathtë vendoset simboli i Policisë së Burgjeve. Në pjesën e gjoksit në krahun e djathtë vendoset shenja e emrit, ndërsa në krahun e majtë vendoset grada e vogël e Policisë së Burgjeve. Bluzat vishen me pantallona dimërore dok të trashë, ngjyrë blu e errët. Këpucët janë me qafë (tip kambale), të zeza dhe pa shkëlqim;

f) për stinën e dimrit vishet xhupi sintetik me veshje të ngrohtë brenda pa spaleta, ngjyrë blu e errët. Veshja e ngrohtë të jetë me zinxhir dhe kopsa, e çmontueshme sipas stinës. Këpucët për këtë stinë janë me qafë lëkure pa shkëlqim. Në krahun e majtë të xhupit vendoset stema e Republikës dhe në krahun e djathtë vendoset simboli i Policisë së Burgjeve. Në pjesën e gjoksit në krahun e djathtë vendoset shenja e emrit, ndërsa në krahun e majtë vendoset grada e vogël e Policisë së Burgjeve;

g) kjo kategori punonjësish sipas stinës përfitojnë edhe pelerinë shiu, doreza lëkure, çorape dhe rrip shumëfunksional;

gj) në rastin e përgatitjes për stërvitje verore, uniforma përbëhet nga kostum sportiv verore. Ky kostum përbëhet nga pantallona të shkurtra, bluzë me krahë të shkurtra dhe atlete;

h) në rastin e përgatitjes për stërvitje dimërore, uniforma përbëhet nga kostum sportiv dimëror. Ky



kostum përbëhet nga pantallona të gjata, bluzë me krahë të gjata dhe atlete;

i) për rastet ceremoniale do të përdoret uniforma e verës ose e dimrit.

Aneks nr. 3

NGJYRAT DHE SHENJAT NË MJETET E POLICISË SË BURGJEVE

1. Mjetet e Policisë së Burgjeve kanë këto shenja dalluese:

- a) ngjyrë blu dhe të bardhë;
- b) targën e tyre në përputhje me kërkesat e Kodit Rrugor të Republikës;
- c) logon me mbishkrimin “Policia e Burgjeve” me ngjyrë të bardhë fosforeshente;
- ç) mjetet e policisë së burgjeve që kryejnë detyrimin e eskortimit, janë të pajisura me sistemin e paralajmërimit zanor dhe atë me drita vezulluese.

2. Ngjyra, targa dhe logoja në mjetet e policisë së burgjeve janë unike.

VENDIM

Nr. 297, datë 19.5.2021

PËR MIRATIMIN E DËMSPËRBLIMIT FINANCIAR PËR ISH-TË DËNUARIT POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10, të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë të dënuar me burgim, izolim në hetuesi, izolim në institucion mjekësor apo mjekësor psikiatrik, sipas listës së përcaktuar në aneksin A, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë të dënuar me dënim kapital ose të ekzekutuar pa gjyq, sipas listës së përcaktuar në aneksin B, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Shpërndarja e masës së dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë kryhet me këste, sipas kriterëve dhe kufijve të përcaktuar në nenin 12, të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar.

4. Shuma e llogaritur transferohet në një llogari të posaçme në Bankën e Shqipërisë. Pagesa e dëmshpërblimit për secilin përfitues bëhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në llogaritë personale të tyre, të hapura në bankat e nivelit të dytë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2017, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar.

5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe



Aneks A

Nr. rendor	Nr. i dosjes	Data e dosjes individuale	Emër	Mbiemër	Atësi	Amësi	Datëlindja	Vendlindja	Gjinia	Periudha e plotë e vuajtjes së dënimit	Shuma e dëmshtëpërlimit në lekë	Përfitimet nga ligje të mëparshme Ministria e Financave dhe Ekonomisë		Enti Kombëtar i Banesave	ASHK	Dëmshtëpërlimi përfundimtar
												Lekë	Letra me Vlerë			
1	689	12.2.2008	Hasan	Bracaj	Sylo	Aleme	25.7.1922	Mes, Shkodër	M	7 muaj e 5 ditë	444,000	0	0	0	0	444,000
2	980	15.2.2008	Shahin	Hoxhaj	Nuredin	Hajshe	11.1.1912	Vlorë	M	5 vjet	3,650,000	0	0	0	0	3,650,000
3	1188	19.2.2008	Andon	Bashuri	Tun	Marie	9.9.1941	Kavajë	M	10 vjet, 11 muaj e 24 ditë	8,032,000	0	1,197,600	0	0	6,834,400
4	1292	19.2.2008	Jorgji	Andrea	Jani	Urani	28.6.1938	Nartë, Vlorë	M	4 vjet e 2 ditë	2,924,000	100,000	380,000	0	0	2,444,000
5	1402	21.2.2008	Halit	Igrishti	Ajet	Fazile	3.1.1908	Peje	M	2 vjet, 4 muaj e 10 ditë	1,728,000	0	283,726	0	0	1,444,274
6	2303	3.3.2008	Hajdar	Hysa	Xhemal	Fatime	15.4.1909	Gramsh	M	3 vjet e 19 ditë	2,228,000	0	0	0	0	2,228,000
7	2445	4.3.2008	Hamdi	Hyra	Osmën	Lutlie	27.1.1938	Lushnjë	M	4 vjet, 3 muaj e 4 ditë	3,114,000	100,000	390,849	0	0	2,623,151
8	2530	4.3.2008	Isuf	Greca	Ali	Selime	13.2.1903	Gjuzej	M	9 vjet, 10 muaj e 29 ditë	7,248,000	100,000	1,100,080	0	0	6,047,920
9	2603	4.3.2008	Kosta	Nikolla	Mitro	Vasillo	7.4.1918	Dhivër, Sarandë	M	4 vjet, 10 muaj e 5 ditë	3,550,000	100,000	481,589	0	0	2,968,411
10	2886	6.3.2008	Kristo	Kenuti	Stavro	Katero	9.1.1903	Dhivër, Sarandë	M	2 vjet, 3 muaj e 20 ditë	1,686,000	0	276,164	0	0	1,409,836
11	3107	10.3.2008	Imer	Biba	Mahmut	Nure	4.2.1942	Kollovoz, Kukës	M	11 vjet, 4 muaj e 21 ditë	8,318,000	168,000	1,180,000	0	0	6,970,000
12	3495	12.3.2008	Sheme	Kaftirani	Yzeir	Mbylle	7.8.1922	Pogradec	M	4 vjet, 8 muaj e 28 ditë	3,472,000	120,000	600,000	0	0	2,752,000
13	3655	13.3.2008	Niko	Ligu	Kiço	Theno	6.3.1936	Gjirokastrë	M	15 vjet, 7 muaj e 18 ditë	9,284,000	200,000	2,000,000	0	0	7,084,000
14	3676	13.3.2008	Zenel	Braçi	Banush	Shefiko	4.2.1923	Novaj, Patos	M	2 vjet, 11 muaj e 6 ditë	2,154,000	100,000	350,000	0	0	1,704,000
15	4090	18.3.2008	Gjysho	Meto (Meta)	Dalip	Avushe	10.11.1920	Ferras, Fier	M	1 vit, 3 muaj e 4 ditë	924,000	150,000	627,562	0	0	146,438
16	4218	19.3.2008	Nazmi	Dramolli (Dramalliu)	Seit	Fatime	18.10.1910	Zemblak, Korçë	M	7 vjet e 1 ditë	5,112,000	100,000	740,816	0	0	4,271,184
17	4823	27.3.2008	Qamile	Lalica	Adem	Hava	18.9.1918	Kosovë	F	1 vit, 6 muaj e 16 ditë	1,134,000	200,000	718,560	0	0	215,440
18	4961	1.4.2008	Eduard (Eduart)	Vata (Marashi)	Llesh	Roza	18.2.1934	Kolonjë	M	D1 11 vjet, 8 muaj e 25 ditë D2 8 vjet, 10 muaj e 26 ditë	15,088,000	200,000	200,000	0	0	14,688,000
19	5228	2.4.2008	Mehmet (Met e)	Kapllani	Riza	Nazike	18.7.1903	Vërzehzhë, Skrapar	M	6 vjet, 11 muaj e 16 ditë	5,094,000	0	0	0	0	5,094,000
20	5389	3.4.2008	Dilaver	Agolli	Demir	Dudi	14.2.1895	Bulgarec, Korçë	M	7 vjet, 9 muaj e 7 ditë	5,682,000	100,000	117,268	0	0	5,464,732
21	6995	8.4.2008	Mark	Tufa	Gjergj	Leze	25.11.1928	Durrës	M	1 vit, 5 muaj e 7 ditë	1,054,000	100,000	120,000	0	0	834,000
22	7191	10.4.2008	Abdyl (Avdyli)	Allciu (Alku)	Halil	Mude	13.4.1917	Klobçisht, Dibër	M	1 vit, e 25 ditë	780,000	0	0	0	0	780,000
23	7293	11.4.2008	Frook	Beci	Dod	Prendë	27.1.1878	Zajz, Mirditë	M	2 vjet, 4 muaj e 13 ditë	1,734,000	70,000	280,767	0	0	1,383,233
24	7491	15.4.2008	Xhevat	Gjyrezi	Brahim	Emine	20.5.1929	Titograd	M	11 vjet e 11 muaj	8,712,000	200,000	1,200,000	0	0	7,312,000
25	7519	15.4.2008	Nasho	Dule	Kristo	Agathi	16.4.1905	Gorani, Gjirokastrë	M	6 vjet e 19 ditë	4,418,000	0	726,000	0	0	3,692,000
26	7522	15.4.2008	Mihal	Mari	Thanas	Marije	7.1.1883	Gjirokastrë	M	6 muaj e 8 ditë	388,000	100,000	36,000	0	0	252,000
27	7566	15.4.2008	Riza	Sallaj	Sello	Refije	15.2.1908	Fier	M	8 muaj	496,000	100,000	0	0	0	396,000
28	7831	17.4.2008	Flip	Sulla	Foto	Dhespo	15.10.1905	Karalibej, Sarandë	M	6 vjet e 27 ditë	4,434,000	90,000	0	0	0	4,344,000
29	7943	18.4.2008	Vangjel	Golgota	Spiro	Katerina	9.3.1890	Durrës	M	3 vjet, 6 muaj e 8 ditë	2,578,000	0	0	0	0	2,578,000
30	8638	30.4.2008	Nikolla	Gabeshi	Kristo	Froso	2.9.1910	Glinë, Gjirokastrë	M	5 vjet, 10 muaj e 11 ditë	4,292,000	0	0	0	0	4,292,000



31	9393	13.5.2008	Ukë	Idrizi	Shaqir	Dinore	6.3.1937	Petkaj, Kukës	M	D1 14 vjet, 9 muaj e 21 ditë D2 3 vjet, 4 muaj e 15 ditë	13,288,000	100,000	1,500,000	0	0	11,688,000
32	9575	14.5.2008	Llazar	Sako	Taqi(Taqo)	Kate	15.6.1941	Divjakë, Lushnjë	M	6 vjet, 2 muaj e 24 ditë	3,496,380	0	12,258	0	0	3,484,122
33	9786	19.5.2008	Nebi	Grëmi	Gani	Tabene	3.7.1922	Belin, Fier	M	1 vit, 9 muaj e 13 ditë	876,000	0	200,000	0	0	676,000
34	10022	22.5.2008	Panajot	Pano	Zoto	Harikla	19.2.1907	Dhivër, Sarandë	M	D1 7 vite, 9 muaj e 13 ditë D2 3 vite e 22 ditë	7,928,000	200,000	2,047,781	0	0	5,680,219
35	10324	28.5.2008	Gjok	Nikolli	Frok	Mrikë	18.10.1925	Rraja Zezë, Mirditë	M	2 vite, 4 muaj, 6 ditë	1,720,000	100,000	360,000	0	0	1,260,000
36	12084	8.7.2008	Sali	Gjoka	Birbil	Keke	10.1.1924	Zhulat, Gjirokastrë	M	5 vite e 7 ditë	1,628,000	0	120,000	0	0	1,508,000
37	12104	8.7.2008	Shpëtim	Laknori	Ali	Myhyrije	26.4.1949	Durrës	M	5 vite, 7 muaj e 23 ditë	4,130,000	0	500,000	0	0	3,630,000
38	12347	16.7.2008	Luto	Grabovaj	Mustafa	Shefikat	17.5.1920	Sevaster, Vlorë	M	2 vite, 7 muaj e 17 ditë	1,928,000	0	2,329,315	0	0	0
39	12981	7.8.2008	Sello	Hoxha	Ahmet	Bajaze	10.4.1925	Markat, Sarandë	M	5 vjet e 15 ditë	2,628,000	100,000	0	0	0	2,528,000
40	13161	18.8.2008	Sitki	Havalje	Fejzulla	Mude	10.10.1929	Tiranë	M	6 vjet e 10 muaj	5,000,000	200,000	740,658	0	0	4,059,342
41	13391	22.8.2008	Abas	Hysa	Xhemal	Fatime	11.5.1895	Shinëpremtë, Gramsh	M	9 muaj e 5 ditë	568,000	150,000	0	0	0	418,000
42	13487	2.9.2008	Lorenc	Lorja	Kolë	Luçe	22.8.1936	Shkodër	M	3 vjet, 8 muaj e 11 ditë	2,114,000	100,000	344,000	0	0	1,670,000
43	13766	15.9.2008	Hasan	Hoxha	Islam	Gjyslyme	2.5.1900	Ndroq, Tiranë	M	3 vjet e 13 ditë	2,216,000	0	364,274	0	0	1,851,726
44	13837	16.9.2008	Maksud	Koni	Bajram	Sheje	7.8.1911	Likesh, Durrës	M	1 vit, 3 muaj e 14 ditë	944,000	100,000	90,000	0	0	754,000
45	14340	7.10.2008	Isuf	Kovaçi	Hysen	Zahide	18.5.1930	Peshkopi	M	16 vjet, 9 muaj e 24 ditë	12,286,000	200,000	1,818,959	0	0	10,267,041
46	14811	27.10.2008	Razip	Gjonaj	Musli	Taibe	3.4.1925	Fterrë, Sarandë	M	7 vjet, 4 muaj e 13 ditë	5,384,000	0	0	0	0	5,384,000
47	15521	19.11.2008	Katrin	Kokaj	Lulash	Drande	6.8.1911	Hot, Shkodër	F	8 muaj e 27 ditë	550,000	200,000	718,560	0	0	0
48	15644	26.11.2008	Dilfiruze	Sturçe	Banush	Nurije	1.9.1907	Përmet	F	4 vjet, 11 muaj e 25 ditë	3,652,000	0	540,493	0	0	3,111,507
49	15655	26.11.2008	Kol	Marku	Pjeter	Barbull	14.5.1920	Milot, Krujë	M	1 vit, 5 muaj e 15 ditë	1,070,000	100,000	77,708	500000	0	392,292
50	15663	26.11.2008	Sokol	Byberi	Halil	Mire	15.1.1918	Shoshan, Tropojë	M	9 muaj e 29 ditë	616,000	90,000	682,520	0	0	0
51	15667	26.11.2008	Odhise	Kalaja	Mihal	Athina	29.6.1911	Hoshtev, Gjirokastrë	M	D1 6 vjet, 1 muaj e 20 ditë D2 16 vjet, 10 muaj e 28 ditë	12,720,000	250,000	4,400,000	1,787,736	0	6,282,264
52	15677	26.11.2008	Llesh	Bardhi	Dod	Dave	1.3.1959	Laç	M	1 vit, 1 muaj e 17 ditë	826,000	0	100,000	0	0	726,000
53	16284	11.12.2008	Jani	Gjika	Mitri	Dafinë	15.1.1949	Kozare, Berat	M	4 vjet, 9 muaj e 8 ditë	3,494,000	0	572,712	0	0	2,921,288
54	16370	12.12.2008	Musli	Haziraj	Ram	Fatime	15.5.1929	Gegaj, Tropojë	M	12 vjet, 4 muaj e 29 ditë	9,066,000	0	460,000	0	0	8,606,000
55	16959	26.12.2008	Riza	Cenolli	Suleman	Xheko	5.7.1909	Vashtmi, Korçë	M	6 vjet, 3 muaj e 20 ditë	4,606,000	100,000	900,000	0	0	3,606,000
56	17401	29.12.2008	Ndoc	Misloza	Gjok	Pavlina	31.8.1900	Tivar, Ish Jugosllavi	M	4 vjet, 11 muaj e 11 ditë	3,020,000	0	300,000	0	0	2,720,000
57	17737	8.5.2009	Novrus	Lara (Aliaj)	Abas	Merzo	12.3.1922	Mazhanj, Përmet	M	4 vjet, 7 muaj e 21 ditë	3,396,000	0	556,474	0	0	2,839,526
58	17847	8.5.2009	Demir	Nërpjetri	Adem	Emine	1.4.1903	Gjyral, Elbasan	M	2 vjet, 3 muaj e 16 ditë	1,678,000	190,000	0	0	0	1,488,000
59	18089	8.5.2009	Preng	Dedgjonaj (Laska)	Nikoll	Prene	13.1.1890	Fregen, Lezhë	M	2 vjet, 3 muaj e 2 ditë	1,650,000	50,000	269,918	0	0	1,330,082
60	18517	8.5.2009	Gjok	Vukaj	Tome	Noke	28.10.1962	Dedaj, Shkodër	M	7 vjet, 4 muaj e 3 ditë	5,364,000	0	880,318	0	0	4,483,682
61	19153	8.5.2009	Liman	Kuçi	Imer	Sullitane	25.8.1920	Reç, Dibër	M	2 vjet	1,460,000	0	309,407	0	0	1,150,593
62	19400	8.5.2009	Pashko	Çulaj	Marash	Drande	19.1.1931	Ivanaj, Shkodër	M	10 vjet, 3 muaj e 5 ditë	3,946,000	0	0	0	0	3,946,000
63	19725	27.5.2009	Caush (Çaush)	Sharka	Isuf	Ike	14.11.1914	Ballagat, Lushnjë	M	1 vit, 7 muaj e 23 ditë	1,210,000	0	197,918	0	0	1,012,082



64	20051	10.6.2009	Filip	Tushi	Gaqo	Meropi	28.10.1935	Korçë	M	8 muaj e 3 ditë	502,000	81,534	0	0	0	420,466
65	20257	19.6.2009	Kujtim	Pelaj	Refat	Hateme	4.1.1924	Himarë, Vlorë	M	D1 1 vit, 3 muaj e 12 ditë D2 4 vjet, 11 muaj e 29 ditë D3 15 vjet, 8 muaj e 18 ditë D4 9 vjet, e 3 muaj	22,838,000	250,000	250,000	0	0	22,338,000
66	20875	30.6.2009	Shaqo	Xhelili	Hariz	Hateme	3.5.1888	Kopaçez, Sarandë	M	1 vit, 3 muaj e 9 ditë	934,000	0	50,301	0	0	883,699
67	20942	30.6.2009	Gjon	Ljarja	Ejell	Nine	18.8.1929	Shkodër	M	3 vjet	2,190,000	0	0	0	0	2,190,000
68	21648	19.1.2011	Haki	Shtubina	Rasim	Gjylje	6.3.1956	Golem, Shkodër	M	11 vjet, 10 muaj e 19 ditë	4,136,000	0	1,200,000	0	0	2,936,000
69	21676	29.8.2009	Pandeli	Xhani	Jorgji	Dhimitrulla	17.7.1958	Nartë, Vlorë	M	1 vit, 6 muaj e 24 ditë	1,150,000	0	0	0	0	1,150,000
70	21660	12.10.2016	Ilia	Fani	Janaq	Fotini	12.2.1957	Finisq Sarandë	M	5 vjet, 6 muaj e 4 ditë	4,030,000	0	0	0	0	4,030,000
71	21678	15.11.2010	Fatos	Rrapaj	Mero	Leli	1.3.1928	Gumenicë, Vlorë	M	5 vjet, 2 muaj e 23 ditë	3,820,000	100,000	0	0	0	3,720,000
72	21696	6.10.2009	Skënder	Beriat	Bajram	Nekije	23.3.1953	Korçë	M	8 muaj e 1 ditë	498,000	200,000	720,000	0	0	0
73	21672	23.12.2011	Reshat	Ismailaj(Ismaili)	Izet	Haire	9.6.1943	Kallarat, Vlorë	M	2 vjet, 9 muaj e 25 ditë	2,068,000	0	337,973	0	0	1,730,027
74	21688	11.6.2011	Vasil (Fadil)	Duka	Dalan	Sadihan	7.10.1941	Mazhar, Vlorë	M	8 vjet, 6 muaj e 2 ditë	6,216,000	0	1,100,000	0	0	5,116,000
75	21668	28.8.2013	Harbert (Habert)	Çuka	Sokrat	Marjanthi	6.2.1956	Tiranë	M	7 vjet, 9 muaj e 13 ditë	1,897,999	0	0	0	0	1,897,999
76	21681	14.1.2011	Myfid (Myfit)	Ymeri	Qamil	Aishe	3.10.1954	Shkodër	M	4 vjet, 5 muaj e 2 ditë	3,234,000	0	500,000	0	0	2,734,000
77	21700	14.9.2009	Selami	Meka	Qamil	Zembako	15.8.1921	Bilisht, Devoll	M	D1 7 vjet, 11 muaj e 17 ditë D2 8 vjet, 8 muaj e 8 ditë	12,178,000	200,000	1,799,890	0	0	10,178,110
78	21701	16.5.2011	Kastriot	Ballaj	Muço	Tarihe	27.6.1959	Elbasan	M	2 vjet, 9 muaj e 29 ditë	2,076,000	0	440,000	0	0	1,636,000
79	21709	13.4.2011	Muhamet	Veizi	Hajdin	Hanife	4.6.1938	Pogradec	M	10 vjet, 4 muaj e 8 ditë	7,564,000	100,000	1143726	0	0	6,320,274
80	21712	9.5.2014	Mirbi	Ismaili	Ramazan	Nexhibe	26.2.1966	Kukës	M	9 muaj e 1 ditë	560,000	0	90,740	0	0	469,260
81	21734	20.4.2010	Nazmi	Peka	Asllan	Shkurte	28.9.1971	Krumë, Kukës	M	2 muaj e 29 ditë	182,000	0	0	0	0	182,000
82	21747	22.10.2014	Roland	Bollano	Thodhori	Fotina	17.3.1965	Vlorë	M	1 muaj e 7 ditë	76,000	0	419,836	0	0	0
83	21776	12.7.2016	Gazmend	Haxhiu	Gani	Bajramie	16.3.1964	Gjegjan, Kukës	M	1 vit e 15 ditë	760,000	124,300	124,300	0	0	511,400
84	21784	22.3.2011	Sotiraq	Stavri	Jorgji	Zoica	25.7.1950	Patos, Fier	M	5 vjet, 7 muaj e 15 ditë	2,742,000	0	675,616	0	0	2,066,384
85	21790	30.12.2014	Ferdinand	Papajani	Hetem	Suzana	26.6.1950	Shkodër	M	2 muaj e 26 ditë	176,000	0	0	0	0	176,000
86	21791	6.4.2015	Ramadan	Ramohitoj	Mezin	Zonjë	13.1.1944	Tragjas, Vlorë	M	D1 6 muaj D2 1 vit, 11 muaj e 13 ditë	1,810,000	0	0	0	0	1,810,000
87	21806	25.5.2010	Ali	Isufi	Hasan	Aishe	27.4.1933	Ulqin, Mali i Zi	M	7 vjet e 1 ditë	5,112,000	100,000	1,200,000	1328141	0	2,483,859

278,800,263



Aneks B

Nr.	Nr. i dosjes	Data e dosjes individuale	Emër	Mbiemër	Atësi	Amësi	Datëlindja	Vendlindja	Gjinia	Viti i vdekjes	Shuma e dëmshpërblimit në lekë	Përfitimet nga ligje të mëparshme				Dëmshpërblimi përfundimtar
												Ministria e Financave dhe Ekonomisë		Enti Kombëtar i Banesave	ASHK	
												Lekë	Letra me Vlerë			
1	586	12.2.2008	Neshat	Muja	Shero	Shane	1920	Korçë	M	31.12.1944	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
2	1024	18.2.2008	Idriz	Selimi	Nexhip	Cibe	3.3.1915	Karbunarë	M	12.1944	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
3	1360	20.2.2008	Mark	Kola	Preng	Marë	27.2.1897	Breg, Pukë	M	12.05.1951	5,840,000	200,000	720,000	0	2,000	4,918,000
4	1604	22.2.2008	Fahri	Dabulla	Avni	Fatime	21.9.1908	Prizren	M	30.11.1944	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
5	1937	28.2.2008	Njazi	Hasko	Myho	Hasie	1910	Tatrat, Sarandë	M	12.1944	5,840,000	0	0	0	0	5,840,000
6	1944	28.2.2008	Bako	Halili	Lilo	Begzade	7.9.1918	Selenicë, Përmet	M	28.5.1953	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
7	2948	7.3.2008	Zef	Ndoj	Shyt	Marë	19.6.1910	Gjegjan, Pukë	M	28.12.1949	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
8	3294	11.3.2008	Beqir	Kasa	Tafil	Behije	10.8.1917	Lojme, Kukës	M	23.10.1946	5,840,000	300,000	720,000	0	0	4,820,000
9	4059	18.3.2008	Ali	Sefaj(Sefa)	Halit	Zelihe	2.3.1918	Arren, Kukës	M	17.1.1949	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
10	4372	21.3.2008	Sali	Doda	Baftjar	Sulltane	30.5.1889	Reç, Dibër	M	10.12.1946	5,840,000	200,000	720,000	0	70,000	4,850,000
11	5203	2.4.2008	Xhemal	Zhaçi	Ali	Hatixhe	3.3.1912	Zhaçi, Fier	M	30.11.1946	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
12	7223	10.4.2008	Refat	Aliaj	Xhezo	Gjyle	1912	Fier	M	31.12.1944	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
13	9057	7.5.2008	Abdulla	Bajrami	Riza	Ismete	8.5.1928	Danillograd	M	31.9.1954	6,566,000	200,000	720,000	0	0	5,646,000
14	10047	22.5.2008	Frook	Jaku	Gjekë	Prena	31.7.1920	Ungrej, Lezhë	M	28.2.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
15	10304	28.5.2008	Zef	Pjetri	Gjok	Mare	1.1.1880	Skuraj, Krujë	M	14.8.1948	5,840,000	0	0	0	0	5,840,000
16	11333	17.6.2008	Durim	Kaba	Shelfet	Hane	13.4.1965	Lushnjë	M	31.12.1988	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
17	12294	15.7.2008	Besim	Kaja	Ymer	Zyme	15.2.1911	Kavajë	M	31.10.1946	5,840,000	200,000	1,000,000	0	0	4,640,000
18	16322	11.12.2008	Mark	Bajraktari	Ndue	Dilë	18.6.1918	Kuzhnen, Mirditë	M	10.5.1948	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
19	16329	11.12.2008	Losh	Bracaj	Fran	Pashkë	27.1.1900	Vukël	M	15.2.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	200,000	4,720,000
20	18397	8.5.2009	Liman	Kuqo	Abaz	Tule	7.6.1929	Remenj	M	3.5.1952	5,840,000	200,000	720,000	0	2,000,000	2,920,000
21	18589/A	8.5.2009	Aleksandra	Zahari	Nikolla	Mato	5.10.1883	Pepel	F	27.4.1947	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
22	18734	8.5.2009	Pashuk	Hila	Hil	Dilë	15.8.1925	Koman	M	2.2.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
23	19578	20.5.2009	Shagur	Prenci	Rexhep	Hane	30.10.1914	Droj, Reç	M	29.2.1947	5,840,000	0	0	0	0	5,840,000
24	19614	21.5.2009	Mark	Dodani	Gjon	Dilë	28.7.1927	Naraç	M	18.11.1947	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
25	19688	26.5.2009	Shahin	Skopeci	Beqir	Behare	8.7.1926	Librazhd	M	13.7.1945	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
26	19711	27.5.2009	Han	Kotarja	Sali	Hane	25.8.1896	Kukës	M	3.4.1952	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
27	19879	3.6.2009	Abas (Abaz)	Toluli	Murat	Fatime	31.12.1924	Droj, Reç-Dibër	M	31.12.1946	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
28	19883	3.6.2009	Ramadan	Toluli	Murat	Fatime	31.12.1922	Droj, Reç-Dibër	M	31.12.1946	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
29	20470	24.6.2009	Hajdar	Ymeraj (Imeraj)	Adem	Hate	3.2.1896	Shkodër	M	24.2.1953	5,840,000	400,000	800,000	0	0	4,640,000
30	20568	25.6.2009	Laze	Gjini	Ndoni	Jane (Janë)	3.4.1871	Gorica, Lushnjë	M	2.7.1951	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
31	20957	30.6.2009	Gjon	Marku	Ndue	Gjelë	20.10.1910	Shkolpë, Mnelë	M	5.9.1946	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
32	21426	8.4.2011	Ramadan	Doda	Selman	Hane (Have)	25.11.1914	Reç, Dibër	M	20.12.1944	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
157,994,000																

**VENDIM****Nr. 298, datë 19.5.2021**

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PILOT
“PËR MASAT PËR NXITJEN E TË
NXËNIT, TË VIJUESHMËRISË DHE
PËRPARIMIT TË NXËNËSVE TË
SHKOLLËS 9-VJEÇARE ‘NAIM
FRASHËRI’ KORÇË, PËR VITIN
SHKOLLOR 2021–2022”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e 243 (dyqind e dyzet e tre) bursave/kuotave ushqimore për nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri” Korçë, për vitin shkollor 2021–2022.

2. Vlera e bursës/kuotës ushqimore ditore është 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) lekë në ditë për nxënë, për mbulimin e kostos ushqimore. Vlera e bursës/kuotës ushqimore, që do t’u ofrohet nxënësve në mjediset e shkollës, në formën e shërbimit ushqimor ditor, të paketuar për çdo nxënë, për 170 (njëqind e shtatëdhjetë) ditë mësimore, jepet sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Korçë–Pustec, në fillim të vitit shkollor, të dërgojë në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Korçë, listën emërore të nxënësve që ndjekin mësimin në këtë institucion arsimor parauniversitar, përfitues të bursës/kuotës ushqimore. Lista emërore detajohet

sipas klasave, nga klasa e parë deri në klasën e nëntë. Një kopje e kësaj liste dërgohet në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë.

4. Fondet publike për mbulimin e shpenzimeve për bursat/kuotat ushqimore, me qëllim zbatimin e këtij vendimi, rialokohen nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për Bashkinë Korçë dhe administrohen nga kjo bashki.

5. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Korçë–Pustec dhe drejtoria e shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri” Korçë organizojnë aktivitete ekstrakurrikulare, me qëllim nxitjen e të nxënit, të vijueshmërisë dhe përparimit të nxënësve të kësaj shkolle. Këto aktivitete organizohen në përputhje me udhëzimin nr. 30, datë 12.9.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, të ndryshuar.

6. Efektet financiare mbulohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në programin buxhetor të arsimit bazë.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Korçë, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Korçë–Pustec dhe shkolla 9-vjeçare “Naim Frashëri” Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**



Aneks nr. 1

**KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E NXËNËSVE
(VITI SHKOLLOR 2021–2022)**

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar/njësi	Vlera ditore/në lekë
1	Bukë	gram	120	341.95	100	12.0
2	Makarona	gram	10.5	37.45	120	1.3
3	Oriz	gram	10.5	38.15	150	1.6
4	Sheqer	gram	14	54.95	100	1.4
5	Fasule	gram	10.5	32.55	150	1.6
6	Perime	gram	45.5	9.45	100	4.6
7	Fruta	gram	35	14.7	100	3.5
8	Vaj	gram	10.5	94.5	180	1.9
9	Gjalpë	gram	7	53.2	531	3.7
10	Mish	gram	31.5	45.5	750	23.6
11	Djathë	gram	8.75	14	400	3.5
12	Reçel	gram	7	32.55	250	1.8
13	Vezë	kokërr	0.35	14.7	12	4.2
14	Qumësht	gram	70	34.3	80	5.6
15	Patate	gram	70	59.5	40	2.8
16	Nënprodukte pule dhe mishi	gram	10.5	35	400	3.2
	Kuota ditore			912.45		76

Shënim. Është e domosdoshme që nxënësi të marrë kuotën ditore në lekë dhe në kalori, ndërsa gramaturat dhe lloji i ushqimit mund të ndryshojnë sipas menyve të ndryshme dhe çmimeve që ofrohen nga konkurrenca e prokurimeve dhe ndikimit të faktorëve të tjerë (gramaturat e normës ditore në pasqyrë janë përdorur për efekt planifikimi).

VENDIM**Nr. 301, datë 19.5.2021**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
TURIZMIT DHE MJEDISIT, TË
PRONËS SË PALUAJTSHME, ME
SIPËRFAQE PREJ 10 000 m², E LLOJIT
TRUALL, NDODHUR NË ZONËN
KADASTRALE 8561, ME NUMËR
PASURIE 1/911, NË PRONËSI TË
BASHKISË KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 12, 13, 14 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të pikës 3, të nenit 34, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të pronës së paluajtshme, me sipërfaqe prej 10 000 (dhjetë

mijë) m², e llojit truall, ndodhur në zonën kadastrale 8561, me numër pasurie 1/911, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim përdorimin e saj për zhvillimin e projekteve të investimit në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

2. Sipërfaqja prej 10 000 (dhjetë mijë) m², e llojit truall, ndodhur në zonën kadastrale 8561, me numër pasurie 1/911, e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme në pronësi të Bashkisë Korçë.

3. Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës të paluajtshme, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkia Korçë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

DREJTORIA VENDORE E ASHK
KORÇË

DREJTOR

Nada BANDILI

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZIKADASTRALE 2561 NR PASURIE 1134 Vot 55 Paq

INDEXI HARTES KQ-7-3 SHALLA 1-560

ADRESA E PASURISE: Rrëshi KORÇË QF KORÇË

Rr/L _____ PYG _____ Sh _____ K _____ Ap _____

B. KUFIZIMET

V. 1/9/12

L. 1/9/12 : K

J. 1/9/12

P. 1/9/12


D.Data: 12/15/2014

C. PRONARËT

BASHKIA KORÇË

Baj

Orn _____





UDHËZIM
Nr. 10, datë 17.5.2021

**PËR REGJISTRIMIN DHE
MBËSHTETJEN NË INSTITUCIONET
ARSIMORE PARAUNIVERSITARE
PUBLIKE TË FËMIJËVE TË
PERSONAVE NË SITUATË
MIGRIMI/AZILI, REFUGJATË, TË
FËMIJËVE TË HUAJ TË
PASHOQËRUAR, TË FËMIJËVE QË
KTHEHEN NGA EMIGRACIONI, NGA
ZONAT E KONFLIKTIT APO FËMIJË,
VIKTIMA TË TRAFIKIMIT, NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 5 dhe të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
ARSIMIMI I FËMIJËVE TË PERSONAVE
NË SITUATË MIGRIMI/AZILI,
REFUGJATË APO TË FËMIJËVE TË HUAJ
TË PASHOQËRUAR

1. Fëmijët e personave, të cilët janë në situatë migrimi/azili, refugjatë apo fëmijëve të huaj të pashoqëruar në Republikën e Shqipërisë, ndjekin arsimin parauniversitar me të njëjtat kushte, si edhe fëmijët me shtetësi shqiptare. Zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) përcaktojnë institucionet arsimore parauniversitare publike ku do të regjistrohen këta fëmijë.

2. Fëmijët e moshës 3–5 vjeç që nuk zotërojnë certifikatë lindjeje apo fëmijëve të huaj të pashoqëruar, të regjistrohen në arsimin parashkollor, sipas deklaramit të prindërve/kujdestarit ligjor dhe dokumentacionit që fëmija zotëron nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

3. Nxënësit e moshës 6–21 vjeç, në situatë migrimi/azili, refugjatë, apo pa shtetësi, për të vazhduar mësimin në arsimin bazë ose arsimin e mesëm të lartë, paraqesin në ZVAP dëftesën/dëftesat origjinale të përkthyer dhe të noterizuara.

ZVAP-ja bën ekuivalentimin e notave, siglon dëftesën e nxënësit dhe cakton institucionin arsimor parauniversitar publik ku do të vazhdojë mësimin nxënësi, sipas vendbanimit ku ai është vendosur:

a) në klasën pasardhëse, kur vjen në fillim të vitit shkollor;

b) në klasën përkatëse, kur vjen gjatë vitit shkollor.

4. Nxënësit që nuk provojnë me dokument zyrtar të shtetit nga vijnë, përfundimin apo vazhdimin e një klase, vlerësohen me testim, për shkallën e njohurive nga një komision ndërlëndor, i përbërë nga mësues dhe nga punonjësi i shërbimit psikosocial, që ngrihet në institucionin arsimor parauniversitar publik. Komisioni në bazë të vlerësimit cakton klasën ku nxënësit i përket të regjistrohet.

5. Institucioni arsimor parauniversitar publik trajton me plan individual për mësimin e gjuhës shqipe nxënësit e personave në situatë migrimi/azili, refugjatë apo fëmijëve të huaj të pashoqëruar.

6. Institucioni arsimor parauniversitar publik siguron tekstet shkollore për fëmijët e personave në situatë emigrimi/azili, refugjatë apo fëmijëve të huaj të pashoqëruar.

KREU II
ARSIMIMI I FËMIJËVE TË KTHYER NGA
EMIGRACIONI

1. Pranimi dhe administrimi i kërkesave të prindërve dhe/ose i kujdestarëve ligjorë të fëmijëve të kthyer nga emigracioni dhe të dokumentacionit shkollor që ata disponojnë për regjistrimin e tyre në institucionet arsimore publike të sistemit parauniversitar bëhet nga ZVAP-ja.

2. Kërkesa për regjistrim shoqërohet, me:

a) certifikatën e lindjes së nxënësit;

b) dokumentet e shkollimit;

c) fotokopje e dokumentit, që pasqyron datën e rikthimit në Shqipëri të nxënësit.

3. Institucioni arsimor parauniversitar publik, i përcaktuar nga ZVAP-ja, ngre një komision ndërlëndor për fëmijët që kthehen nga emigracioni. Komisioni, mbështetur në vetëdeklarimin e prindërve/kujdestarëve ligjorë dhe në dokumentacionin e pikës 2, vlerëson me testim dhe cakton klasën ku nxënësit i përket të regjistrohet.



4. Punonjësi i shërbimit psikosocial në institucionin arsimor parauniversitar harton një plan të posaçëm pune për ofrimin e shërbimeve, që ndihmojnë në zhvillimin social dhe individual të nxënësve që kthehen nga emigracioni.

5. Institucioni arsimor parauniversitar publik ku regjistrohen nxënësit e kthyer nga emigracioni:

a) ofron kurse të gjuhës shqipe për nxënësit, pasi ata vlerësohen për njohuritë e tyre në këtë lëndë;

b) trajton me plane individuale mësimore, nxënësit e regjistruar, me qëllim që të plotësohen detyrimet e programeve lëndore për periudhën kohore të munguar prej tyre;

c) mundëson pajisjen e nxënësve të kthyer nga emigracioni me tekste shkollore.

KREU III

ARSIMIMI DHE RIINTEGRIMI I FËMIJËVE TË KTHYER NGA ZONAT E KONFLIKTIT

1. Pranimi dhe administrimi i kërkesave të prindërve dhe/ose i kujdestarëve ligjorë të fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit për regjistrimin e tyre në institucionet arsimore publike të sistemit parauniversitar bëhet nga ZVAP-ja.

2. ZVAP-ja njofton institucionin arsimor parauniversitar publik për regjistrimin dhe riintegrimin e fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit.

3. Institucioni arsimor parauniversitar publik, i përcaktuar nga ZVAP-ja, ngre një komision ndërlëndor të përbërë nga mësues dhe nga punonjës të shërbimit psikosocial për fëmijët e kthyer nga zonat e konfliktit, me qëllim:

a) vlerësimin e nevojave arsimore dhe të atyre psikosociale të këtyre fëmijëve;

b) përcaktimin e klasës ku fëmija do të regjistrohet. Në varësi të specifikave, fëmija regjistrohet në klasën me grup-moshë të njëjtë me moshën e tij ose një vit më pak se kjo grup-moshë.

4. Institucioni arsimor parauniversitar publik:

a) harton planin individual mësimor për fëmijët e kthyer nga zonat e konfliktit, duke u bazuar te raporti i vlerësimit të komisionit ndërlëndor;

b) ngre grupin e punës, i cili harton planin individual për riintegrimin e fëmijëve. Në këtë grup bën pjesë drejtori i shkollës, mësuesi kujdestar, psikologu i shkollës/punonjësi social, oficeri i sigurisë dhe dy mësues lëndorë. Ky grup harton

raporte 1-mujore mbi ecurinë e rastit dhe i përcjell ato në ZVAP-në përkatës;

c) siguron tekstet shkollore për fëmijët që kthehen nga zonat e konfliktit.

5. Regjistrimi i fëmijëve që kthehen nga zonat e konfliktit edhe në rastet kur ka mungesë dokumentacioni do të bëhet në bashkëpunim me Njësine për Mbrojtjen e Fëmijëve.

KREU IV

ARSIMIMI I FËMIJËVE, VIKTIMA TË TRAFIKIMIT

1. Fëmijëve, viktimat të trafikimit në moshën e detyrimit shkolle (6–16 vjeç), u sigurohen kushtet për ndjekjen e arsimit parauniversitar. ZVAP-ja, në bashkëpunim me Njësine për Mbrojtjen e Fëmijëve, bazuar në dokumentacionin e disponueshëm, përcaktojnë institucionet arsimore parauniversitare publike ku ata do të regjistrohen.

2. Fëmijët, viktimat të trafikimit, që nuk provojnë me dokument zyrtar përfundimin apo vazhdimin e një klase, provohen për shkallën e njohurive me testim nga një komision ndërlëndor të përbërë nga mësues dhe nga punonjësi i shërbimit psikosocial, që ngrihet në institucionin arsimor parauniversitar, përcaktuar nga ZVAP-ja. Komisioni vlerëson dhe cakton klasën ku nxënësit i përket të regjistrohet.

3. Punonjësi i shërbimit psikosocial në institucionin arsimor parauniversitar publik harton një plan të veçantë pune për mbështetjen, trajtimin dhe integrimin në shkollë të fëmijëve viktimave të trafikimit.

4. Institucioni arsimor parauniversitar publik siguron tekstet shkollore për fëmijët viktimat të trafikimit që ndjekin arsimin parauniversitar.

KREU V

DISPOZITAT E FUNDIT

1. Udhëzimi nr. 32, datë 26.10.2009, i ministrit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, “Për regjistrimin dhe vlerësimin e nxënësve që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrtat vendore të arsimit



parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare publike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi

VENDIM
Nr. 20, datë 20.4.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare e Gjykatës Kushtetuese		
Elsa Toska	anëtare e	“	“
Marsida Xhaferllari	anëtare e	“	“
Altin Binaj	anëtar i	“	“
Përparim Kalo	anëtar i	“	“
Sonila Bejtja	anëtare e	“	“
Fiona Papajorgji	anëtare e	“	“

me sekretare Enina Kotoni, në datat 13.4.2021 dhe 20.4.2021 mori në shqyrtim në seancë plenare publike, çështjen nr. 13 (K) 2018 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, përfaqësuar nga drejtorja ekzekutive, Erida Skëndaj.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar me autorizim nga Mimoza Arbi, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar me autorizim nga përfaqësuesja e Avokaturës së Shtetit, Eva Dyrmishi, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga drejtuesi i saj, Arben Kraja.

OBJEKTI: Shfuqizimi i neneve 34, pika 2, shkronja “gj”, dhe 38, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i nenit 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e

Brendshme”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Paragrafi i 4-t i Preambulës, nenet 3, 4, 18, 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “a”, 134, pika 1, shkronja “h” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, pika 1 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, nenet 27, 28, 29, 30, 47, 49, 50, 51, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fiona Papajorgji, shqyrtoi pretendimet e kërkuarit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit (*KSHH*), i cili kërkoj pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (*Këshilli i Ministrave*), të cilat kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe parashtrimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*SPAK*), i cili paraqiti prapësime vetëm për ligjin nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” (*ligji nr. 95/2016*), duke kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I Rrethanat e çështjes

1. Kuvendi në datën 6.10.2016 ka miratuar ligjin nr. 95/2016, i cili ka hyrë në fuqi në datën 4.11.2016. Qëllimi i ligjit është garantimi i funksionimit të Prokurorisë së Posaçme (*SPAK*), si prokurori e specializuar, për të ushtruar kompetencat e parashikuara nga neni 148, pika 1, shkronja “dh”, i Kushtetutës, në mënyrë efektive dhe e pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm ose i jashtëm, dhe i Njësisë së Pavarur Hetimore për të hetuar veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe veprat e tjera penale të kryera nga subjektet e parashikuara



nga neni 135, pika 2, i Kushtetutës, e pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm ose i jashtëm.

2. Në nenin 34, pika 2, shkronja “gj”, të ligjit nr. 95/2016 është parashikuar se kandidati për drejtor i Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH) duhet të plotësojë disa kritere, midis të tjerash, të japë pëlqimin për t’iu nënshtruar testit të poligrafit. I njëjti parashikim gjendet edhe në nenin 38, pika 2, shkronja “e”, të po këtij ligji në rastin e kandidatit për hetues të BKH-së. Në të dyja nenet përcaktohet, gjithashtu, se informacioni në raportin e përgatitur nga specialisti i poligrafit mbahet në konsideratë gjatë procesit të përzgjedhjes së drejtorit dhe hetuesit të BKH-së.

3. Kuvendi në datën 5.3.2018 ka miratuar ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” (ligji nr. 12/2018), i cili ka hyrë në fuqi në datën 4.4.2018. Qëllimi i ligjit është vlerësimi kalimtar dhe periodik i punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve e Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme për të siguruar institucione të forta e të besueshme, me profesionistë me integritet.

4. Në nenin 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018 është parashikuar se punonjësi i nënshtrohet testit psikologjik të personalitetit, si dhe, me vendim të trupës së vlerësimit përkatëse dhe me pëlqimin e tij, testeve të tjera, edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së punonjësit dhe të deklarimeve personale. Refuzimi i kryerjes së testeve vlerësohet së bashku me rrethanat e tjera.

5. Kërkuesi, KSHH-ja, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) në datën 1.11.2018 duke kërkuar shfuqizimin e neneve 34, pika 2, shkronja “gj” dhe 38, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 95/2016, si dhe të nenit 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018.

6. Me plotësimin e kuorumit për funksionimin e kolegeve seleksionuese të Gjykatës dhe të Mbledhjes së Gjyqtarëve, Kolegji në datën 10.1.2020 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 9.2.2021 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuesi** në kërkesën e tij për shfuqizimin e dispozitave objekt shqyrtimi parashtron në mënyrë të përmbledhur si vijon:

7.1. Shoqata ka si qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe zbatimin e parimeve të shtetit ligjor, denoncimin e çdo shkeljeje që bie ndesh me legjislacionin shqiptar dhe normat e së drejtës ndërkombëtare, kundërshtimin e çdo forme të diskriminimit të personit për shkak të bindjeve politike, besimit fetar, përkatësisë etnike, racës, gjuhës, pozitës shoqërore dhe ekonomike. Kërkuesi e justifikon interesin në çështjen kushtetuese të ngritur dhe, për pasojë, legjitimohet në kërkimet e tij.

7.2. Është cenuar *dinjteti i njeriut*, i garantuar nga Preambula dhe nga neni 3 i Kushtetutës. Dinjteti i njeriut përfshihet jo vetëm në parimet themelore, por reflektohet edhe në disa të drejta të tjera, si e drejta për një proces të rregullt ligjor, e drejta e jetës private dhe e sigurisë juridike, e drejta për të zgjedhur vendin e punës dhe profesionin dhe barazia para ligjit në aspektin e parimit të mosdiskriminimit. Gjithashtu, edhe parashikimi i testit psikologjik, sipas nenit 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, cenon dinjtetin e njeriut.

7.3. Është cenuar *e drejta për jetë private dhe familjare*, pasi dinjteti shoqëron çdo qenie njerëzore në ushtrimin e së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare, e cila gëzon mbrojtje nga neni 8 i KEDNJ-së, si dhe neni 35 i Kushtetutës. Koncepti i jetës private është i gjerë, ndaj nuk i nënshtrohet përkufizimit shterues dhe mund të përmbledhë aspekte të shumëfishta të identitetit fizik e shoqëror të personit. Neni 8 i KEDNJ-së mbron edhe të drejtën për zhvillim personal dhe të drejtën për të krijuar e zhvilluar marrëdhënie me njerëz të tjerë dhe botën e jashtme. Gjithashtu, dinjteti ndikon edhe në ushtrimin e së drejtës për punë dhe profesion, e njohur nga neni 49 i Kushtetutës.

7.4. Nga formulimi i neneve 34, pika 2, shkronja “gj” dhe 38, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 95/2016 rezulton se shmangia ose refuzimi i kandidatit për t’iu nënshtruar testit të poligrafit i heq atij të drejtën e kandidimit edhe në rast se plotëson kriteret e tjera. Nënshtrimi i personit ndaj testit të poligrafit e trajton atë si një objekt dhe jo si



subjekt. Testi i poligrafit është kusht/kërkesë për emërimin si drejtues dhe hetues në BKH, por nuk mund të bëhet pa pëlqimin e personit. Në rast se subjekti pranon t'i nënshtrohet testit dhe rezultati i tij del “nuk e ka kaluar testin”, pavarësisht se ato vlerësohen në raport me tërësinë e vlerësimeve të tjera të kandidatit, ky i fundit mund të shihet si person jo i besueshëm dhe pa integritet, cilësi që lidhen me reputacionin dhe respektin për jetën private e profesionale, në kuptim të nenit 8 të KEDNJ-së. Edhe sipas ligjit nr. 12/2018 formulimi “testeve të tjera, edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme”, në nenin 38, pika 2, nënkupton zbatimin e testit të poligrafit, dhe një rezultat jo pozitiv i këtij testi, ndërhyrjen në të drejtën private.

7.5. Është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi dispozitat e ligjit nr. 95/2016 dhe të ligjit nr. 12/2018, objekt kundërshtimi, nuk janë të qarta dhe i lënë hapësirë zbatuesit për interpretime të ndryshme, gjë që nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin dhe besueshmërinë që synon vetë norma. Për më tepër, në ligjin nr. 12/2018 nuk jepet kuptimi i testit psikologjik, i testeve të tjera dhe i mjeteve teknologjike të posaçme, të cilave do t'u nënshtrohet punonjësi.

7.6. Është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi testi i poligrafit i parashikuar nga nenet 34, pika 2, shkronja “g” dhe 38, pika 2, shkronja “e” të ligjit nr. 95/2016 dhe testi psikologjik, i parashikuar në nenin 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018 jo vetëm që paraqiten si prova, por kanë edhe përparësi ndaj provave të tjera, ndërkohë që rezultatet e testit të poligrafit nuk përbëjnë provë sipas legjislacionit procedural shqiptar, përfshirë edhe të drejtën administrative, pasi të dhënat që mund të rezultojnë nga ky test janë të natyrës fiziologjike, nervo-psikike. Kandidati pa dhënë pëlqimin për përdorimin e testit, nuk mund të kandidojë dhe, nëse të dhënat e testit janë në disfavor të tij, prirja është që të mos caktohet në funksionin që kandidon. Ligji nr. 95/2016 dhe Rregullorja për Ekzaminimin e Poligrafit nuk parashikojnë garanci ligjore të nevojshme në kuadër të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si e drejta për t'u informuar, dëgjuar, mbrojtur, ankuar etj., për shtetasit që i nënshtrohen testit të poligrafit. Punonjësi që vlerësohet nuk ka të drejtë të kundërshtojë të dhënat e mjeteve teknologjike, informacionin ose

raportin e ekspertit apo të kundërshtojë edhe vetë ekspertin.

7.7. Është cenuar parimi i barazisë në ligj dhe i mosdiskriminimit, pasi edhe pse të dyja ligjet parashikojnë përdorimin e testeve dhe të pajisjeve teknike, mënyra e formulimit është e ndryshme. Konkretisht, sipas përmbajtjes së ligjit nr. 95/2016, nënshtrimi ndaj pajisjeve teknike për besueshmërinë e thënieve është kriter i detyrueshëm që kryhet me dhënien e pëlqimit të kandidatit, ndërsa sipas ligjit nr. 12/2018 nënshtrimi ndaj pajisjeve teknike kryhet vetëm pasi merret pëlqimi i punonjësit që i nënshtrohet. Për më tepër, në relacionin bashkëlidhur ligjit nr. 95/2016 nuk është sqaruar se përse verifikimi i figurës nëpërmjet testit të poligrafit është i domosdoshëm të përdoret vetëm për këtë kategori punonjësisht dhe jo edhe në procesin e vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të institucioneve të specializuara kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, i cili bazohet edhe në kontrollin e kriterit të integritetit. Gjithashtu, përdorimi i këtyre teknikave përbën diskriminim për punonjësit që i nënshtrohen.

7.8. Është cenuar parimi i hierarkisë së normave juridike, pasi përdorimi i testeve për të vlerësuar besueshmërinë e punonjësve nuk parashikohet në nenet 80 dhe 81 të Kodit të Procedurave Administrative (KPA), ku parashikohen mjetet e kërimit të provës. Ligji nr. 12/2018 është miratuar me shumicë të thjeshtë votash, prandaj dispozitat e KPA-së kanë përparësi.

8. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, ka paraqitur prapësimë, duke argumentuar:

8.1 Gjykata duhet të vendosë ndarjen e çështjeve, pasi kërkimet kanë karakter të veçantë dhe janë të ndryshme mes tyre. Ligjet objekt kundërshtimi, për shkak të rëndësisë që kanë, duhet të shqyrtohen më vete.

8.2 Kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae*, pasi nuk ka provuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin është krijuar ose veprimtarisë që kryen dhe pasojave që kanë sjellë mbi të dispozitat që kërkohen të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën.

8.3 Dispozitat e kundërshtuara nuk cenojnë dinjitetin e njeriut. Ligji e ka përcaktuar qartë realizimin e testit të poligrafit. Ai përdoret vetëm në procesin e emërimit të drejtorit dhe hetuesve të BKH-së. Kërkuesi nuk ka evidentuar cenimin e



dinjitetit dhe si shkelet ai. Kufizimi i vendosur nëpërmjet përdorimit të testit të poligrafit është për një interes publik dhe i sanksionuar në ligj, në përputhje me kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës.

8.4 Në rastin e parashikimit të poligrafit si kriter kualifikues, sipas parashikimeve të neneve 34 dhe 38 të ligjit nr. 95/2016, nuk jemi para zbatimit të legjislacionit procedural penal dhe ky lloj testi në asnjë mënyrë nuk mund të realizohet pa pëlqimin e vetë personit. Dispozitat nuk e përdorin asnjëherë termin “provë” dhe nuk e trajtojnë poligrafin si provë. Ai është një kriter punësimi që duhet të plotësojë kandidati, jo një provë në kuptimin e së drejtës procedurale penale.

8.5 Referimi në KPA nuk është i saktë, pasi ai nuk rregullon procedurat e rekrutimit/pranimi të funksionarëve publikë dhe nëpunësve shtetërorë. Si KPA-ja dhe ligji nr. 95/2016 janë miratuar me shumicë të cilësuar, pra kanë fuqi juridike të njëjtë. Gjithashtu, sipas parimit *lex specialis derogat generalis*, ligji nr. 95/2016, duke qenë ligj i posaçëm ka përparësi ndaj ligjit të përgjithshëm.

8.6 Pretendimi për *cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor* është i pabazuar, pasi kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankim, sepse nuk ka asnjë dispozitë që e ndalon kundërshtimin e rezultateve të testit, por edhe të së gjithë procedurës së vlerësimit në tërësi.

8.7 Kërkuesi nuk ka sqaruar se ku e mbështet pretendimin për *cenimin e parimit të barazisë dhe të mosdiskriminimit*. Pretendimi për t’iu nënshtruar edhe gjyqtarët, edhe prokurorët e strukturave të posaçme është i pabazuar, pasi ata kanë qenë në këto pozicione edhe më parë, si pjesë e sistemit të drejtësisë, ndërsa BKH-ja është një organ i krijuar për herë të parë. Testi përdoret vetëm për një kategori funksionarësh, si drejtuesi dhe hetuesit e BKH-së, për shkak të besueshmërisë dhe integritetit që duhet të tregojnë, të cilët janë në dijeni të parashikimit ligjor në momentin e aplikimit.

8.8 Pretendimet për ligjin nr. 12/2018 janë të pabazuara, pasi ai nuk cenon asnjë prej parimeve kushtetuese të pretenduara nga kërkuesi. Testi psikologjik i personalitetit parashikohet edhe në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe në ligjin nr. 70/2014, “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme”. Përdorimi i testit nuk përbën provë, nuk cenon dinjitetin e personit dhe kryhet në

respektim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi punonjësit që i nënshtrohen japin pëlqimin. Vlerësimi psikologjik bëhet nga një trupë e posaçme e ngritur me vendim të Urdhrit të Psikologëve, të cilët ia dërgojnë raportin trupës vlerësuese. Gjithashtu, formulimi, “*testeve të tjera, edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme,*”, në nenin 38, pika 2, të këtij ligji, nuk nënkupton në asnjë rast përdorimin e testit të poligrafit.

9. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, në parashtrimet e paraqitura ka argumentuar:

9.1 Gjykata duhet të shqyrtojë kushtetutshmërinë e ligjeve të kundërshtuara në mënyrë të veçuar, pasi dispozitat objekt kundërshtimi janë të ndryshme nga njëra - tjetra dhe palëve duhet t’u jepet mundësia për të dhënë shpjegimet e tyre në mënyrë shteruese për secilin ligj. Për këtë arsye Gjykata duhet të vendosë ndarjen e çështjes.

9.2 Kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae*, pasi nuk ka provuar interesin e tij, në çfarë cilësie vepron dhe në çfarë mënyrë mund të cenohet prej dispozitave të kundërshtuara, si dhe nuk ka provuar lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar mes situatës dhe normës. Gjithashtu, është krijuar edhe Sindikata e Policisë së Shtetit, e cila mund të mbrojë interesat e punonjësve të Policisë së Shtetit, si anëtarë të sindikatës dhe subjekte të ligjit nr. 12/2018.

9.3 Referencat në normat dhe vendimet gjyqësore për *cenimin e dinjitetit* nuk mund të merren parasysh, pasi janë të bazuara në legjislacionin penal, ku nënshtrimi ndaj testit bëhet pa pëlqimin e vetë personit. Ligji nr. 95/2016 nuk është legjislacion penal dhe personi jep pëlqimin e tij për t’iu nënshtruar testit të poligrafit. Kërkuesi nuk ka parashtruar se në cilën formë cenohet dinjiteti i personit dhe cilat janë pasojat konkrete. Rezultatet e testit nuk janë përfundimtare dhe përcaktuese, ato vlerësohen së bashku me kriteret e tjera.

9.4 Nuk cenohet e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi në ligj nuk ka asnjë normë që të ndalojë kundërshtimin e rezultateve të testit dhe të së gjithë procedurës së vlerësimit në tërësi. Zhvillimi i testit të poligrafit parashikohet në norma ligjore, për të cilat kandidati është në dijeni në momentin e zhvillimit të testit dhe në çdo rast kërkohet domosdoshmërisht pëlqimi i tij. Gjithashtu, nga viti 2015 e në vijim nuk është



ngritur asnjë padi lidhur me testin psikologjik, i cili vepron si kriter rekrutimi ose vlerësimi për punonjësit e policisë.

9.5 Procedura e zgjedhjes mes gjyqtarëve, prokurorëve dhe kandidatëve për BKH-në është tërësisht e ndryshme. Për pasojë, pretendimi *për cenimin e parimit të barazisë dhe të mosdiskriminimit* është i pabazuar.

9.6 Nga praktika e deritanishme asnjë subjekt i ligjit nr. 12/2018 nuk e ka refuzuar testin psikologjik dhe rezultatet e tij janë konsideruar si elemente ndihmuese dhe plotësuese gjatë procesit të vlerësimit. Dispozitat janë të qarta dhe janë proporcionale në funksion të qëllimit për të cilin janë krijuar. Gjithashtu, edhe refuzimi për të kryer testin do të vlerësohet së bashku me rrethanat e tjera. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit (KJV), deri më sot, për procesin e vlerësimit, nuk e ka parë të nevojshëm aplikimin e testeve të tjera edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme, por bazuar në nenin 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018 në *“testet e tjera me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme,”* përfshihen disa teste, si ai për alkoolin ose drogën.

10. **Subjekti i interesuar, SPAK-u,** ka paraqitur parashtrime vetëm në lidhje me shqyrtimin e pajtueshmërisë së neneve 34, pika 2, shkronja “gj” dhe 38, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 95/2016, duke argumentuar:

10.1 Gjatë procesit për përzgjedhjen e drejtorit të BKH-së janë zbatuar parashikimet ligjore të nenit 34 të ligjit nr. 95/2016, duke ndjekur në mënyrë kronologjike plotësimin/mosplotësimin e kriterëve nga kandidati. Duke pasur parasysh që shkronja “gj” e pikës 2 të këtij neni është e fundit, testi i poligrafit u konsiderua si faza finale e procesit të përzgjedhjes së drejtorit të BKH-së. Në funksion të mbarëvajtjes së procesit të poligrafit u nënshkrua edhe marrëveshja e bashkëpunimit me Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Në përfundim të testit të poligrafit, asnjë prej kandidatëve, si për drejtor dhe për hetues në BKH, nuk ka pasur pretendime ose ankesa në lidhje me procedurën e ndjekur për këtë test.

10.2 Rezultatet konkrete të testit të poligrafit vlerësohen nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës. Rezultatet e testit, të vetme, nuk kanë vlerë as të paracaktuar, as përcaktuese. Ato vlerësohen njëloj dhe në unitet

me të gjitha të dhënat e tjera të grumbulluara nga verifikimi. Edhe nga zbatimi në praktikë i testit të poligrafit, vetëm rezultatet e tij nuk kanë ndikuar në skualifikimin e kandidatit, nëse të gjitha kriteret e tjera ishin përmbushur.

10.3 Pretendimet *për cenimin e dinjitetit* nuk janë ngritur në nivel kushtetues. I gjithë procesi dhe në veçanti procedura e testit të poligrafit janë kryer në respektim të dinjitetit dhe personalitetit të secilit kandidat.

10.4 Nuk cenohet *parimi i sigurisë juridike*, pasi normat e kundërshtuara janë të qarta. SPAK-u, si institucioni përgjegjës në përzgjedhjen e drejtorit të BKH-së dhe në bashkëpunim me këtë të fundit edhe në rekrutimin e hetuesve të BKH-së, në zbatimin e dispozitave ligjore, objekt shqyrtimi, nuk ka pasur hapësirë për keqinterpretim ose keqzbatim të tyre.

10.5 Procedura e parashikuar nga ligji për përzgjedhjen e drejtorit dhe të hetuesve të BKH-së bazohet në një vlerësim objektiv të kushteve dhe kriterëve, si dhe transparencës dhe respektimit të standardeve për një proces të rregullt ligjor.

10.6 Testi i poligrafit nuk ka qëllim në vetvete të përdoret si provë, por të vlerësohet si e dhënë/verifikim shtesë, në unitet me të gjitha të dhënat e tjera. Referenca e kërkuesit në qëndrimet e gjykatave të tjera është e gabuar, pasi ato lidhen me procese penale dhe jo administrative për rekrutimin e punonjësve.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për shqyrtimin e përbashkët të kërtimeve të paraqitura në Gjykatën Kushtetuese

11. Kërkuesi kërkon shfuqizimin e neneve 34, pika 2, shkronja “gj” dhe 38, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 95/2016, si dhe të nenit 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, duke pretenduar cenimin e të njëjtave të drejta dhe parime kushtetuese nga secila dispozitë objekt kundërshtimi. Konkretisht, kërkuesi ka parashtruar se testi i poligrafit, testi psikologjik, si dhe testet e tjera të parashikuara në dispozitat e kundërshtuara cenojnë dinjitetin e njeriut, parimin e sigurisë juridike, të drejtën për një proces të rregullt ligjor, barazinë para ligjit dhe mosdiskriminimin, si dhe parimin e hierarkisë së normave juridike.



12. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, në prapësimet me shkrim kanë paraqitur kërkesë, të cilën e kanë përsëritur edhe gjatë seancës plenare publike, për shqyrtimin e kërtimeve të KSHH-së që lidhen me ligjin nr. 95/2016 veçantë nga ato që kanë të bëjnë me ligjin nr. 12/2018, pasi qëllimi i dispozitave ligjore të kundërshtuara është i ndryshëm, prandaj edhe trajtimi i tyre duhet të bëhet në mënyra të ndryshme. Subjekti i interesuar, SPAK-u, gjatë seancës u shpreh për pranimin e kërkesës së subjekteve të interesuara.

13. Për këtë kërkim, gjatë seancës plenare, kërkuesi prapësoi se dispozitat që parashikojnë kriteret për vlerësimin e ndershmërisë dhe të integritetit të kandidatëve për drejtues dhe hetues të BKH-së, si dhe të punonjësve të Policisë së Shtetit në kuadër të procesit të vlerësimit, cenojnë të njëjtat të drejta dhe parime kushtetuese, të cilat përbëjnë vlera të veçanta për mbrojtjen e dinjitetit njerëzor. Kërkesa për trajtimin njëkohësisht të të dyja ligjeve është bërë edhe në funksion të ekonomisë gjyqësore, eficiencës dhe efektivitetit të gjykimit.

14. Gjykata konstaton se çështja e paraqitur nga kërkuesi përmban dy kërtime: kërkitimi i parë lidhet me procedurat e emërimit të kandidatëve për drejtor dhe hetues të BKH-së, të parashikuara nga ligji nr. 95/2016, kurse kërkitimi i dytë me procesin e vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, të parashikuara nga ligji nr. 12/2018.

15. Gjykata vëren se neni 1, pika 2, i ligjit nr. 8577/2000 parashikon se për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj ose nga rregullorja e Gjykatës Kushtetuese, kjo e fundit merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedura të tjera duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes. Gjykata në këto rrethana i referohet nenit 23 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, në të cilin parashikohet: “Në një kërkesëpadi mund të parashtrihen disa kërtime, në rast se gjykata është kompetente për të gjitha kërkimet. Kur gjykata çmon se shqyrtimi i përbashkët i tyre shkakton vështirësi të dukshme në zhvillimin e gjykimin, vendos që ato të shqyrtohen veç e veç.”.

16. Për sa më lart, bazuar në përmbajtjen e dispozitave të kundërshtuara dhe në natyrën e argumenteve të parashtruara në kërkesë, që bazohen në cenimin e parimeve dhe të standardeve kushtetuese të njëjta, si dhe për ekonomi gjyqësore, Gjykata çmon se nuk është para rastit kur shqyrtimi i përbashkët i kërtimeve do të shkaktoje vështirësi në zhvillimin e gjykimin të çështjes. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkesa paraprake e subjekteve të interesuara është e pabazuar.

B. Për legjitimitimin e kërkuetit

17. Çështjen e legjitimitimit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur.

18. Kërkuesi parashtron se legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenin 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës dhe në jurisprudencën e Gjykatës. Kërkuesi parashtron se është një shoqatë që ka si qëllim, ndër të tjera, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe zbatimin e parimeve të shtetit ligjor, të cilat, sipas tij, në rastin konkret cenohen nga dispozitat e ligjeve nr. 95/2016 dhe nr. 12/2018, prandaj interesi për kundërshtimin e tyre është i justifikuar.

19. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, prapësuan se kërkuesi nuk legjitimohet në kërkimet e tij, pasi nuk arriti të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin është krijuar, veprimtarisë që kryen dhe pasojave që kanë sjellë për të dispozitat që kërkojnë të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën.

20. Gjithashtu, Këshilli i Ministrave, gjatë seancave gjyqësore parashtrori se kërkuesi nuk legjitimohet për pretendimet në lidhje me ligjin nr. 12/2018, pasi me vendimin nr. 3716, datë 17.5.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është krijuar Sindikata e Policisë së Shtetit, që ka si qëllim mbrojtjen e të drejtave të punës dhe atyre sociale të anëtarëve të saj, punonjës të Policisë së Shtetit, të cilët në këtë mënyrë mund të kërkojnë mbrojtjen e interesave e tyre nëpërmjet kësaj sindikate dhe jo nëpërmjet organizatave të tjera, siç është kërkuesi.



21. Për sa i përket legjitimitimit të shoqatave, si subjekte që vënë në lëvizje Gjykatën, sipas nenit 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, e cila ka pranuar legjitimitimin e këtyre subjekteve për çështje që lidhen me interesat e tyre. Ajo është shprehur se vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike për antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit. Vetëm fakti se dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë pasur një efekt çfarëdo për kërkuesen, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ajo legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që përfshihen në qëllimin e veprimtarisë së kërkueses, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimet nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 1, datë 16.1.2017; nr. 33, datë 8.6.2016; nr. 14, datë 21.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. KSHH-ja është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 17/1, datë 12.1.1991 të ministrit të Drejtësisë dhe më pas me vendimin nr. 2/1, datë 19.7.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas këtyre vendimeve dhe përmbajtjes së statutit është një organizatë jofitimprurëse që ka si mision mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ky funksion lidhet edhe me kujdesin për përsosjen e legjislacionit vendas, që garanton të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve.

23. Për rastin në shqyrtim, kërkuesi ka parashtruar para Gjykatës argumente në lidhje me cenimin që dispozitat e ligjeve objekt i këtij kontrolli kushtetues i bëjnë të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të cilat kjo organizatë ka për mision që t'i mbrojë. Prandaj, Gjykata, bazuar edhe në jurisprudencën e saj për legjitimitimin e KSHH-së (*shih vendimet nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 9, datë*

23.3.2010; nr. 20, datë 11.7.2006; nr. 16, datë 11.11.2004, të Gjykatës Kushtetuese), arrin në përfundimin se edhe në çështjen konkrete kërkuesi ka arritur të provojë interesin e tij për ta vënë në lëvizje Gjykatën, prandaj legjitimohet *ratione personae* për të iniciuar kontrollin kushtetues të ligjeve objekt shqyrtimi.

24. Gjithashtu, Gjykata e vlerëson të pabazuar pretendimin e ngritur në seancë nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, për mungesën e legjitimitimit të kërkuesit, për shkak se interesat e punonjësve të Policisë së Shtetit mund të mbrohen nga Sindikata e Policisë së Shtetit. Gjykata vëren se shoqatat janë persona juridikë që organizohen për mbrojtjen e një qëllimi të caktuar, i cili mund të jetë në të mirë dhe në interes të publikut ose të anëtarëve të saj. Në këtë kuptim krijimi i personave juridikë, me qëllim mbrojtjen e interesave të subjekteve të caktuara, nuk përjashton personat e tjerë juridike, si shoqata ose organizata të tjera, me objekt veprimtari të ngjashme, për të paraqitur kërkesë për pajtueshmërinë me Kushtetutën të ligjeve ose akteve normative që rregullojnë fusha të caktuara, kur ato justifikojnë interesin e tyre të drejtpërdrejtë.

25. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, sipas nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera me Kushtetutën duhet të paraqitet brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e aktit. Ligjet objekt shqyrtimi, konkretisht ligji nr. 95/2016, ka hyrë në fuqi në datën 4.11.2016, ndërsa ligji nr. 12/2018 në datën 4.4.2018. Gjykata konstaton se kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është paraqitur në datën 1.11.2018 nëpërmjet shërbimit postar, pra brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar nga ligji.

26. Për sa i përket legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruara nga kërkuesi për kontrollin e kushtetutshmërisë së dispozitave të ligjeve nr. 95/2016 dhe nr. 12/2018 lidhen me cenimin e parimeve dhe të drejtave kushtetuese, më konkretisht me dinjitetin e njeriut, parimin e sigurisë juridike, të drejtën për një proces të rregullt ligjor, parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, si dhe parimin e hierarkisë së normave juridike.

27. Për cenimin e parimit të hierarkisë së normave juridike, kërkuesi, në thelb, parashtron se ka përplasje mes ligjeve objekt shqyrtimi dhe KPA-së, pasi përdorimi i testeve për të vlerësuar



besueshmërinë e punonjësve nuk parashikohet në KPA, ku përcaktohen mjetet e kërimit të provës.

28. Gjykata thekson se, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “c”, të Kushtetutës, në juridiksionin e saj hyjnë pajtueshmëria e ligjeve dhe e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën. Gjykata ka evidentuar se nuk është detyrë e saj shqyrtimi i përplasjeve dhe papajtueshmërive mes dy ligjeve të ndryshme ose ligjeve dhe kodeve. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër, *lex superior derogat inferiori* (shih vendimet nr. 20, datë 4.4.2014; nr. 2, datë 3.2.2010, të Gjykatës Kushtetuese). Ndërsa në rastin e normave me të njëjtën fuqi juridike, Gjykata thekson se zbatohen parimet, sipas të cilave norma e posaçme ka epërsi ndaj normës së përgjithshme (*lex specialis derogat generali*) dhe se norma që ka hyrë në fuqi më vonë ka përparësi nga norma e mëparshme. Në këtë kuptim, mënyra e të kuptuarit, e të zbatuarit të ligjit dhe e harmonizimit ndërmjet dispozitave të tij me ligje të tjera nuk janë çështje që i përkasin kontrollit kushtetues dhe, për rrjedhojë, nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese (shih vendimet nr. 5, datë 5.2.2015; nr. 2, datë 3.2.2010; nr. 35, datë 10.10.2007; nr. 11, datë 27.5.2004, të Gjykatës Kushtetuese).

29. Për sa më lart, Gjykata, nisur edhe nga fakti se edhe vetë KPA-ja nuk përcakton në mënyrë shteruese të gjitha mjetet e provës, çmon se kërkuksi nuk legjitimohet *ratione materiae* për pretendimin e cenimit të hierarkisë së normave juridike. Pretendimet e tjera të tij për cenimin e dinjitetit të njeriut, të parimit të sigurisë juridike, të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe të parimit të barazisë para ligjit e të mosdiskriminimit hyjnë në juridiksionin dhe kompetencën e Gjykatës dhe do të shqyrtohen në vijim.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për cenimin e dinjitetit të njeriut

30. Kërkuksi ka pretenduar se nenet 34, pika 2, shkronja “gj” dhe 38, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 95/2016, si dhe neni 38, pika 2, i ligjit nr. 12/2018 bien në kundërshtim me Kushtetutën, pasi cenojnë dinjitetin e njeriut. Nënshtrimi i personit ndaj testit të poligrafit e trajton atë si një

objekt dhe jo si subjekt. Rezultatet e këtyre testeve përbëjnë provë të mirëfilltë dhe nëse ato tregojnë se “nuk e ka kaluar testin”, pavarësisht faktit që vlerësohen në raport dhe me tërësinë e vlerësimeve të tjera të kandidatit, ky i fundit mund të shihet si person jo i besueshëm dhe pa integritet, cilësi që lidhen me reputacionin dhe respektin për jetën private dhe profesionale, në kuptim të nenit 8 të KEDNJ-së.

31. Subjektet e interesuara, Kuvendi, Këshilli i Ministrave dhe SPAK-u, kanë parashtruar se pretendimi për cenimin e dinjitetit është i pabazuar. Ligji nr. 95/2016 e ka të përcaktuar qartë realizimin e testit të poligrafit, i cili përdoret vetëm në procesin e kandidimit për drejtor dhe hetues në BKH. Kërkuksi nuk ka evidentuar konkretisht cenimin e dinjitetit dhe mënyrën si është shkelur ai. Gjithashtu, edhe nënshtrimi ndaj testit psikologjik të personalitetit, sipas ligjit nr. 12/2018, është në respektim të dinjitetit të individëve, subjekte të ligjit.

32. Nisur nga natyra e pretendimit thelbësor të kërkuksit, ai i cenimit të dinjitetit të njeriut gjatë zhvillimit të procedurës për emërimin ose vlerësimin e punonjësve shtetërorë në institucione të posaçme, Gjykata vlerëson të ndalet fillimisht në trajtimin e nocionit kushtetues të dinjitetit të njeriut, duke u bazuar edhe në instrumentet ndërkombëtare të detyrueshme ose jo për rendin juridik.

C.1.1 Për dinjitetin e njeriut

33. Në Kushtetutë dinjiteti i njeriut sanksionohet shprehimisht që në Preambulën e saj ku lexohet: “Ne, populli i Shqipërisë, [...] me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor.”. Gjithashtu, ai deklarohet në nenin 3 të Kushtetutës, që gjendet në pjesën e parë të saj, atë të parimeve themelore, ku përcaktohen bazat që shteti, në përmbushje të detyrave të tij, duhet të mbrojë, pra vlerat themelore të shoqërisë demokratike. Sipas këtij neni: “Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë.”.



34. Gjatë diskutimeve për hartimin e Kushtetutës së vitit 1998 është rënë dakord që dinjiteti i njeriut të cilësohet si vlera njerëzore më e lartë, si dhe të vendoset përpara nocioneve të tjera që përbëjnë bazat e shtetit (*shih Debatit Kushtetues, vëllimi I, viti 2006, faqja 16*).

35. Nga sa më lart, edhe pse dinjiteti i njeriut nuk përkufizohet në mënyrë specifike në Kushtetutë, roli qendror i tij në rendin juridik sigurohet nga fakti që ai garantohet që në Preambulën e saj, e cila formulon qëllimet e kushtetutëbërësit dhe është shprehje e vullnetit të popullit. Për të njëjtin shkak, në përmbajtjen e nenit 3 të Kushtetutës, kushtetutëbërësi e ka renditur “dinjitetin” përpara “të drejtave dhe lirive”, për të theksuar dallimin dhe njëkohësisht lidhjen që ekziston ndërmjet tyre.

36. Gjykata në jurisprudencën e saj i është referuar dinjitetit të njeriut kur ka analizuar parimin e shtetit të së drejtës. Ajo ka theksuar se parimi i shtetit të së drejtës nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike (*shih vendimin nr. 16, datë 10.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, shteti duhet të marrë të gjitha masat për të mbrojtur dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, të ndëshkojë çdo përpjekje të paligjshme kundër tyre, si dhe të sigurojë që asnjë person të mos ndiqet dhe dënohet penalisht në mënyrë të padrejtë (*shih vendimin nr. 14, datë 21.7.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Në instrumentet ndërkombëtare nocioni i dinjitetit të njeriut parashikohet në Deklaratën Universale të OKB-së të vitit 1948, sipas së cilës: “Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta” (neni 1) në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të vitit 1976, që shprehen: “Të drejtat e njeriut burojnë nga dinjiteti i brendshëm i tij”. Gjithashtu, në deklaratën e Vjenës të mbajtur pas Konferencës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut të vitit 1993, përcaktohet, se: “të gjitha të drejtat e njeriut burojnë nga dinjiteti i njeriut”.

38. Dinjiteti i njeriut është trajtuar edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe ajo e gjykatave kushtetuese të vendeve të tjera si në gjykimin e çështjeve penale, ashtu edhe në fushën e mosmarrëveshjeve të

punës. Në këto raste ai është trajtuar ngushtësisht i lidhur me të drejtat që kanë të bëjnë me qenien njerëzore, si e drejta për jetën, trajtimi njerëzor dhe respektimi i jetës private.

39. GJEDNJ-ja për herë të parë dinjitetin njerëzor e ka trajtuar në çështjen *Tyrer kundër Mbretërisë së Bashkuar* në të cilën dënimi trupor, i dhënë si pjesë e një dënimi gjyqësor, u konsiderua në kundërshtim me nenin 3 (ndalimi i torturës) të KEDNJ-së, me arsyetimin se ishte një sulm “saktësisht mbi atë që është një nga qëllimet kryesore të nenit 3, përkatësisht mbrojtja e dinjitetit dhe integritetit fizik të një personi” (*shih Tyrer kundër Mbretërisë së Bashkuar, 25 prill 1978, § 33*). Që atëherë, dinjiteti është trajtuar në aspektin e së drejtës për një gjykim të drejtë (*shih Bock kundër Gjermanisë, 29 mars 1989, § 48*), së drejtës për të mos u ndëshkuar në mungesë të një ndalimi ligjor (*shih SW kundër Mbretërisë së Bashkuar, 22 nëntor 1995, § 44*), ndalimit të torturës (*shih Ribitsch kundër Austrisë, 4 dhjetor 1995, § 38*) dhe së drejtës për jetën private (*shih Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar, 11 korrik 2002, §§ 90 – 91*). GJEDNJ-ja e ka konsideruar dinjitetin njerëzor si bazën e të gjitha të drejtave të mbrojtura nga KEDNJ-ja, duke u shprehur, se: “thelbi i vërtetë i Konventës është respekti për dinjitetin njerëzor dhe lirinë e njeriut” (*shih Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar, 29 korrik 2002, § 65*).

40. Një trajtim i zgjeruar i dinjitetit të njeriut gjendet në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë, ku theksohet: “Në ushtrimin e pushtetit të tij ligjvënës duhet të mbajë parasysh, nga njëra anë, paprekshtueshmërinë e dinjitetit njerëzor, e cila është vlera më e lartë e rendit kushtetues dhe, nga ana tjetër, parimet kushtetuese, të tilla si parimi i barazisë, shteti i së drejtës dhe shteti social” (*shih çështjen e burgimit të përgjithshëm të vitit 1977*). Ndërsa, në një rast tjetër, Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë është shprehur: “...do të ishte në kundërshtim me dinjitetin njerëzor t'i kërkojë një personi të informonte dhe të regjistroheshin të gjitha aspektet e personalitetit të tij, madje edhe kur një gjë e tillë kryhet në mënyrë anonime në formën e një studimi statistikor. Shteti nuk mund ta trajtojë personin si një objekt që i nënshtrohet një inventari të çdo lloji. Ai nuk ka të drejtë të prekë sferën e privatësisë nëpërmjet një kontrolli në tërësi të çështjeve personale të qytetarëve të tij, por ai duhet ta lërë individin në një hapësirë private, me qëllim zhvillimin e lirë dhe të përgjegjshëm të personalitetit të tij. Brenda kësaj hapësire individi është zot i vetes së tij. [...] Megjithatë jo çdo vlerësim statistikor që kërkon zbulimin e të dhënave personale cenon



dinjitetin e individit ose shkel të drejtën e vetëvendosjes në fushat intime të jetës. Si anëtar i shoqërisë çdo person është i detyruar t'i përgjigjet një regjistrimi zyrtar të popullsisë dhe t'u japë përgjigje pyetjeve të caktuara për veten e tij, sepse një informacion i tillë është i domosdoshëm për planifikimin shtetëror” (shih çështjen Microcensus të vitit 1969).

41. Gjykata, nisur nga rasti në shqyrtim, vlerëson të evidentojë se si është trajtuar nocioni i dinjitetit të njeriut kryesisht në fushën e marrëdhënieve të punës, konkretisht në punësimin në institucione të posaçme, për të cilat mund të kërkohej edhe nënshtrimi ndaj testeve të veçanta, sikurse është edhe testi i poligrafit.

42. Gjykata Kushtetuese e Moldavisë, në një rast të ngjashëm, është shprehur se kur kandidatët për pozicionin e kryetarit ose zëvendëskryetarit të institucioneve të tilla, si Autoriteti Kombëtar i Integritetit, hyjnë në një konkurs, i cili kërkon kryerjen e testit të poligrafit, ata duhet të japin pëlqimin e tyre. Është e vërtetë se mund t'u bëhen pyetje për privatësinë e tyre, por në çdo rast ato nuk duhet të cenojnë nderin dhe dinjitetin (shih vendimin nr. 6 datë 10.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese të Moldavisë).

43. Gjithashtu, Gjykata vlerëson t'i referohet edhe çështjes *Oberg kundër qytetit Billings*, 22 dhjetor 1983, si vendim i cituar edhe nga palët në parashtrimet e tyre. Gjykata Supreme e Montanës për përdorimin e testit të poligrafit, i cili lejohej si përjashtim për agjencitë publike të zbatimit të ligjit, është shprehur: “*Neni II, Seksioni IV i Kushtetutës të shtetit të Montanës parashikon mbrojtjen e “dinjitetit individual” të çdo qytetari. Nuk mund të vibet në dyshim se nënshtrimi i një personi ndaj një testi për zbulimin e gënjeshtrës përbën cenimin e dinjitetit të tij dhe nëse nuk strukturohet në mënyrë rigorozë mund të përbëjë edhe një cenim të privatësisë”* (përkthim i Gjykatës Kushtetuese).

44. Nisur nga rëndësia që dinjiteti i njeriut ka në Kushtetutë, nga trajtimi i tij në aktet ndërkombëtare, si dhe në jurisprudencën kushtetuese, Gjykata vlerëson se dinjiteti i njeriut është vlera themelore nga e cila burojnë të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut. Në këtë kuptim dinjiteti përbën një vlerë unike, bazën e katalogut të të drejtave të njeriut. Dinjiteti ka përparësi absolute dhe qëndron në themel të tërësisë së vlerave të shprehura nga Kushtetuta. Ai përfaqëson një vlerë kushtetuese të veçantë që ka epërsi ndaj të tjerave, pasi në vetvete përshkon të drejtat e njeriut dhe luan një rol vendimtar në interpretimin e të gjitha

parimeve të sistemit juridik dhe rendit kushtetues.

45. Në vështrim të kësaj analize, Gjykata konstaton se dinjiteti i njeriut duhet trajtuar si vlerë e ndërlidhur me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Ai duhet të shihet si në aspektin objektiv, ashtu edhe në atë subjektiv. Objektiv, në kuptimin e përcaktimit të një detyrimi pozitiv për shtetin për të siguruar kushtet e nevojshme për respektimin e dinjitetit dhe subjektiv në kuptimin e ndalimit për të bërë ndërhyrje të drejtpërdrejta nga kushdo në liritë themelore të individëve. Në këtë kuptim, dinjiteti njerëzor luan një rol të rëndësishëm edhe në përcaktimin e hapësirave të kufizimit të një të drejte kushtetuese nga një akt i ligjvënës, duke shërbyer si gur themeli për interpretimin e të drejtave kushtetuese.

C.1.2 Për lidhjen mes dinjitetit dhe të drejtave të njeriut

46. Në rastin konkret kërkuesi pretendon se dinjiteti shoqëron çdo qenie njerëzore në ushtrimin e së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare, e cila gëzon mbrojtje nga neni 35 i Kushtetutës, si dhe nga neni 8 i KEDNJ-së. Gjithashtu, ai ndikon në ushtrimin e së drejtës për punë dhe profesion, të njohur nga neni 49 i Kushtetutës.

47. Gjykata vëren se edhe pse kërkuesi në parashtrimet në seancë plenare dhe në konkluzionet përfundimtare përmendi edhe cenimin e nenit 49 të Kushtetutës, në thelb, pretendimin e lidh me cenimin e së drejtës së jetës private. Prandaj, në vijim, Gjykata do të analizojë se sa nënshtrimi ndaj testit të poligrafit ose atij psikologjik të personalitetit, dhënia e pëlqimit për këto teste, si dhe struktura e lloji i pyetjeve që i drejtohen individit ndikojnë në dinjitetin e njeriut dhe në të drejtën e jetës së tij private.

48. Mbrojtja e jetës private dhe asaj familjare garantohen nga disa dispozita të Kushtetutës, veçanërisht nga neni 35 (*mbrojtja e të dhënave personale*), neni 36 (*liria dhe fshehtësia e korrespondencës*), neni 37 (*paprekshmëria e banesës*), neni 53 (*mbrojtja e martesës dhe familjes*). Për çështjen në gjykim, gjithsesi, Gjykata vlerëson se është e nevojshme të analizohet neni 35 i Kushtetutës, në të cilin deklarohet: “*Askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. Kushdo ka të drejtë të njohet me të dhënat e mbledhura rreth tij, me përjashtim të rasteve*



të parashikuara me ligj. Kushdo ka të drejtë të kërkojë ndreqjen ose fshejjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin.”.

49. E drejta e mbrojtjes së të dhënave personale, e sanksionuar në nenin 35 të Kushtetutës, si garanci kushtetuese, është konkretizuar më tej në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, i cili përshkohet nga fryma se përpunimi i ligjshëm i tyre bëhet duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e mbrojtjes së jetës private (*shih vendimin nr. 52, datë 1.12.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Padyshim që edhe në këtë rast, në parim, qëllimi i kushtetubërësit ka qenë pikërisht garantimi i asaj hapësire të nevojshme brenda së cilës individ do të mund të zhvillonte në mënyrë të pavarur personalitetin e tij. Në këtë kuadër, sigurisht që është e drejtë e individit të vendosë vetë për mënyrën dhe masën e paraqitjes së tij si person para të tjerëve dhe publikut në tërësi (*shih vendimin nr. 16, datë 11.11.2004, të Gjykatës Kushtetuese*).

50. Për sa i përket së drejtës së jetës private, Gjykata është shprehur se trajtimi i saj parashikon jo vetëm detyrimin negativ të autoriteteve publike për të mos ndërhyrë në jetën private dhe familjare, por edhe detyrimin pozitiv shtetëror për t’i mbrojtur këto të drejta sa më realisht, përmes organeve të të tria pushteteve ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore. Respektimi i jetës private kërkon, në parim, mosndërhyrjen në vendimet që merr vetë individ rreth mënyrës së jetesës, bërjes së jetës së tij. Në çdo rast, legjitimiteti ose jo i ndërhyrjes do të varej kryesisht nga intensiteti i saj, shkalla e cenimit të jetës private, domosdoshmëria e kësaj ndërhyrjeje në shoqërinë demokratike dhe në realitetin konkret që e ka diktuar atë, efektiviteti dhe proporcionaliteti në raportin e qëllimit që është synuar të arrihet dhe mjetet e përdorura për arritjen e tij. Mbi të gjitha, duhet pasur parasysh se sa më shumë të depërtohet në sferën e jetës intime ose sensitive, aq më shumë rritet edhe detyrimi i pushtetit publik për mbrojtjen e jetës private (*shih vendimet nr. 2, datë 18.1.2017; nr. 52, datë 1.12.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

51. Gjithashtu, Gjykata është shprehur se respektimi i së drejtës së jetës private në një shoqëri demokratike nuk do të thotë se nuk mund të ketë ndërhyrje në ushtrimin e kësaj të drejte kur kjo është e domosdoshme për sigurinë kombëtare, për

sigurinë publike, për mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit ose për parandalimin e veprave penale, si dhe për mbrojtjen e shëndetit, të moralit ose të të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Pra, siguria publike, parandalimi i veprave penale, si dhe mbrojtja e të drejtave të të tjerëve shërbejnë si premisa për të konsideruar, në përputhje me parimet kushtetuese, një ndërhyrje në të drejtën për jetë private (*shih vendimin nr. 4, datë 23.2.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

C.1.3 Për testin e poligrafit

52. Duke iu rikthyer pretendimit thelbësor të kërkesit, Gjykata vëren se ai ka të bëjë me rrethanën nëse nënshtrimi ndaj testit të poligrafit të kandidatëve për drejtor dhe për hetues të BKH-së, sipas parashikimeve të ligjit nr. 95/2016, si dhe nënshtrimi ndaj testit psikologjik të personalitetit të subjekteve të ligjit nr. 12/2018 cenojnë dinjitetin e njeriut duke e trajtuar atë si objekt dhe jo si subjekt.

53. Mbi këtë pretendim, subjektet e interesuara, Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se parashikimi i testit të poligrafit përbën një kriter punësimi që duhet të plotësojë kandidati, i cili ka shprehur interesin për t’u bërë pjesë e BKH-së, kjo për faktin se në përbërjen e këtij institucioni, që ka qëllim hetimin e veprave penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, duhet të punësohen njerëz me cilësi morale e aftësi të larta profesionale dhe se kufizimi i dinjitetit të njeriut është në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës.

54. Në këto kushte, Gjykata vlerëson të ndalet edhe në analizën e konceptit të testit të poligrafit të parashikuar për herë të parë në legjislacionin shqiptar nga ligji nr. 95/2016, i cili për këtë qëllim, sipas relacionit të tij, u mbështet në modelin e Byrosë Federale të Hetimit të SHBA-ve. Prandaj, në vijim, Gjykata do të vlerësojë mënyrën e funksionimit të testit të poligrafit në SHBA dhe përdorimin e tij vitet e fundit në Evropë në proceset e rekrutimit të punonjësve në institucione shtetërore të caktuara.

55. Në SHBA testi i poligrafit është një prej testeve që duhet t’i nënshtrimit individit që kërkon të punësohet në institucione të veçanta publike. Departamenti i Drejtësisë vazhdon të pajtohet me përfundimin e Komisionit për Operacionet Qeveritare të Dhomës së Përfaqësuesve, se: “*makina e poligrafit nuk është një “gjurmues i gënjeshtres”, as operatori që interpreton grafikët nuk zbulon*



“gënjeshtra.”. Mjeti regjistron përgjigjet fizike, të cilat lidhen ose jo me një reagim emocional dhe reagimi nuk lidhet domosdoshmërisht me fajin ose pafajësinë. Shumë faktorë fizikë dhe psikologjikë bëjnë të mundur që një individ të mposhtë poligrafin duke shmangur zbulimin e së vërtetës nga ana e aparaturës (*shih Employee Polygraph Protection Act of 1988, Pub. L. 100-347, Sec. 1, 29 U.S.C. §§ 2001 et seq. Section 2001(3), miratuar nga Kongresi Amerikan*).

56. Për sa i përket trajtimit të tij në jurisprudencë, Gjykata Supreme e Los Anxhelos shqyrtoi kërkesën e shoqatës së policëve të këtij qyteti, e cila pretendonte se procedurat për t’u ngritur në detyrë, për lëvizje paralele ose për t’u emëruar në pozicione pune për të cilat kërkohej nënshtrimi edhe në testin e poligrafit, ishte një parashikim jo i drejtë ligjor dhe duhej të anulohet. Gjykata në këtë rast u shpreh se personat që shprehin vullnetin për t’u emëruar në detyra të ndjeshme duhet t’i nënshtrohen testit të poligrafit, pasi punë të tilla kërkojnë “nivele të lartë të integritetit”. Detyra të tilla përfshinin punën në aktivitete antiterroriste, antinarkotike dhe ndaj krimit të organizuar (*shih çështjen Los Angeles Police Protective League kundër City of Los Angeles, vendim i vitit 1995*).

57. Edhe në çështjen *Oberg kundër qytetit Billings, 22 dhjetor 1983* të lartpërmendur (*shih paragrafin nr. 41 të këtij vendimi*), Gjykata Supreme e Montanës për testin e poligrafit është shprehur: “*Ligjvënësit ishin të shqetësuar për llojet e pyetjeve që mund të përdorreshin nga ekzaminuesit e poligrafit duke krijuar një model përgjigjeje dhe ky shqetësim u shpreh në seancat dëgjimore të komisioneve që paraprinë miratimin e këtij ligji. Ne nuk mund të supozojmë se gjatë administrimit të një testi poligraf, të gjitha pyetjet do të kufizohen në çështje të lidhura vetëm me punësimin. Duke supozuar për më tepër, se ligji u miratua në mënyrë specifike për të përjashtuar oficerët e policisë nga mbrojtja e përgjithshme ligjore që u është dhënë të gjithë punonjësve të tjerë në këtë shtet, dyshojmë se ky përjashtim i tillë do t’i “mbijetojë” një shqyrtimi të rreptë*” (përkthim i Gjykatës Kushtetuese).

58. Në Evropë testi i poligrafit parashikohet në disa vende. Në Lituanë, ligji “Për përdorimin e poligrafit”, datë 29 gusht 2000, përcakton, ndër të tjera, listën e institucioneve që mund të zbatojnë testin e poligrafit, përkatësisht: Departamenti i Policisë, Departamenti i Sigurimit të Shtetit, Shërbimi i Mbrojtjes së Kufirit, agjencitë e

Ministritë së Punëve të Brendshme, Departamenti i Shërbimeve Operacionale pranë Ministrisë së Mbrojtjes së Rajonit, Departamenti i Doganave i Ministrisë së Financave dhe Shërbimi Special i Hetimeve. Ligji ndalon përdorimin e poligrafit nga institucionet tjera, por mund ta kryejnë: 1) në rastet kur u lejohet akses në informacione që përbëjnë sekret shtetëror dhe në lidhje me personat për të cilët ekzistojnë dyshime se kanë dhënë informacion të rremë biografik; 2) për procesin e hetimit të veprave penale të kryera gjatë shërbimit në hetime të brendshme, si dhe në hetime speciale; 3) në rastet e kryerjes së krimeve dhe veprimeve të tjera të paligjshme, si dhe në rastet e shkeljes së regjimit të punës kur informacioni përbën sekret shtetëror; 4) në rastet e dyshimit për ushtrim presioni ndaj personit i cili ka akses në informacione që përbën sekret shtetëror; 5) në rastin kur personi i testuar me iniciativën e vet kërkon testimin e përsëritur. Sipas ligjit, poligrafi zbatohet për testimin e nëpunësve civilë, zyrtarëve, ushtarakëve të institucioneve të përmendura.

59. Në Poloni, testi i poligrafit përdoret për rekrutimin e personelit të institucioneve të zbatimit të ligjit (*Policia, Shërbimi Informativ Ushtarak, Shërbimi i Kundërzbulimit Ushtarak, Byroja Doganore, Agjencia e Sigurisë së Brendshme, Agjencia e Inteligjencës, Byroja Qendrore Antikorrupsion dhe Shërbimi i Rojës Kufitare*). Baza ligjore është rregullorja e brendshme e këtyre institucioneve. Testi nuk mund të përmbajë pyetje për bindjet e brendshme ose fetare. Nëse rezultatet e testit nuk janë përfundimtare, atëherë ato mund të përsëriten vetëm një herë, brenda 30 ditëve nga intervista e parë.

60. Lidhur me rëndësinë që duhet të ketë testi i poligrafit në rekrutimin e punonjësve, Gjykata Kushtetuese e Moldavisë në vendimin e lartpërmendur (*shih paragrafin nr. 42 të këtij vendimi*), ka theksuar, se: “*kushti për të kaluar testin e poligrafit duhet të jetë vetëm një çështje procedure dhe jo thelbësore*” (*shih vendimin nr. 6 datë 10.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese të Moldavisë*).

61. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se testi i poligrafit nënkupton një aparaturë që regjistron në mënyrë të vazhdueshme dhe njëkohësisht si të dhënat kardiovaskulare të frymëmarrjes ashtu edhe ato elektrodermale. Rezultatet e testit mund të shërbejnë si një prej të dhënave për të përcaktuar integritetin e personit, i cili i nënshtrohet procedurës, bazuar në vërtetësinë e përgjigjeve të



tij. Ai zbatohet në marrëdhëniet e punës vetëm për struktura të caktuara publike, që kërkojnë në radhët e tyre punonjës me integritet të lartë.

C.1.4 Për testin psikologjik të personalitetit

62. Për qëllim të së njëjtës analizë, Gjykata do të ndalet edhe në konceptin e testit psikologjik të personalitetit, të parashikuar nga ligji nr. 12/2018.

63. Gjykata vëren se sikurse u shprehën subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, testi psikologjik i personalitetit konsiston në vlerësimin e pesë dimensioneve të personalitetit si: dobësia emocionale, sjellja ndërpersonale, hapja ndaj përvojës, toleranca dhe ndërgjegjia e punonjësit. Pas përfundimit, psikologët hartojnë raportin, i cili i përcillet zyrtarisht KJV-së. Në konkluzionet e testit janë tri elemente që përshkruhen: 1- Subjekti nuk shfaq probleme të shëndetit mendor ose probleme të lehta emocionale, të cilat mund të ndikojnë dhe dëmtojnë funksionimin e përditshëm të tij. 2- Shfaq aftësi të mira në marrëdhënie personale dhe ndërpersonale, aftësi të mira resiliente dhe aftësi të mira për të menaxhuar emocionet, duke ruajtur vetëkontrollin. 3-Subjekti paraqet funksionim të mirë ditor dhe tipare të një personaliteti të qëndrueshëm, të cilat bëjnë të mundur aktualisht arritje të kënaqshme në të gjitha fushat e jetës.

64. Edhe në këtë rast, Gjykata vlerëson se rezultatet e testit psikologjik mund të shërbejnë si pjesë e të dhënave për përcaktimin e qëndrueshmërisë së personalitetit të punonjësit që i nënshtrohet dhe kanë si qëllim kontrollin e problemeve të shëndetit mendor të tij ose atyre emocionale. Ai zbatohet në marrëdhëniet e punës për atë kategori punonjësish publike, që duhet të ketë aftësi të mira në aspektin emocional, me qëllim garantimin e shërbimit sa më cilësor të sigurisë ndaj publikut.

C.1.5 Testi i poligrafit dhe ai psikologjik në dispozitat e kundërshtuara

65. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se testi i poligrafit, sipas ligjit nr. 95/2016, është parashikuar për kandidatët për drejtor dhe hetues të një strukture të veçantë, si BKH-ja, e cila është një organ kushtetues në varësi të Prokurorisë së Posaçme, me kompetencë hetimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Drejtori i BKH-së është përgjegjës për funksionimin e saj. Drejtori, zëvendësdrejtori, hetuesit e BKH-së dhe oficerët e shërbimeve të

Policisë Gjyqësore në ushtrimin e funksioneve të tyre drejtohen dhe kontrollohen nga prokurorët e posaçëm. Punonjësit e BKH-së ruajnë sekretin e hetimeve penale, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe legjislacionin në fuqi (*neni 40 i ligjit nr. 95/2016*). BKH-ja është institucioni që ekzekuton urdhrat për përgjim të kërkuara nga Prokuroria e Posaçme dhe të autorizuar nga gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

66. Gjithashtu, Gjykata konstaton se gjatë procesit të kandidimit për pozicione të tilla si drejtor dhe hetues të BKH-së, nënshtimi ndaj testit të poligrafit bëhet gjithmonë me dhënien e pëlqimit të kandidatit. Ky i fundit i nënshtrohet verifikimit të pasurisë dhe pastërtisë së figurës e së bashku me to edhe testit të poligrafit, pasi ka kaluar me sukses testet e tjera, si shqyrtimi i dokumenteve të aplikimit, arsyetimi logjik, testi i aftësisë fizike, shkrimi i esesë, intervista e strukturuar dhe vizita mjekësore.

67. Në procesin e vlerësimit kalimtar dhe periodik, sipas ligjit nr. 12/2018, testit psikologjik të personalitetit i nënshtrohen detyrimisht të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme. Këto subjekte, mes të tjerash, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit kanë detyrimin për të plotësuar deklaratën për kontrollin e figurës dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale (*neni 36 i ligjit nr. 12/2018*). Sipas parashikimit të nenit 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, punonjësit mund t'u nënshtrohen edhe testeve të tjera, duke përfshirë edhe ato që zhvillohen edhe me ndihmën e mjeteve të teknologjisë së posaçme, por në këtë rast vetëm pas vendimit të trupës së vlerësimit përkatëse dhe me pëlqimin e kandidatit. Sipas këtij parashikimi testet kanë si qëllim vlerësimin e besueshmërisë së punonjësit dhe të deklarimeve personale dhe refuzimi i kryerjes së testeve vlerësohet së bashku me rrethanat e tjera në tërësi dhe nuk përbën shkak më vete për përjashtim.

68. Bazuar në parashtrimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave, vlerësimi për testin psikologjik të personalitetit bëhet pa praninë e trupës vlerësuese të KJV-së, por



vetëm me praninë e psikologëve të licencuar nga Urdhri i Psikologëve. Subjekti njihet me konkluzionet e testit të psikologut, si pjesë e raportit paraprak të vlerësimit në momentin që trupa vlerësuese ka marrë vendim për mbylljen e hetimit administrativ dhe ka të drejtë, para se të dalë në seancë, të dërgojë prapësime/shpjegime për çdo përfundim të relacionit. Gjithashtu, konkluzionet e testit konsiderohen si elemente ndihmuese dhe plotësuese, por asnjëherë vendimtare për të ndikuar në gjykimin e trupës vlerësuese lidhur me komponentët e kontrollit të figurës së subjektit të vlerësimit. KJV-ja, në marrjen e vendimit për vlerësimin e punonjësit të policisë, bazuar në parimin e kontradiktoritetit, mbështetet edhe në shpjegimet që jep subjekti pas dërgimit të relacionit, si dhe ato në seancë dëgjimore.

69. Nga të dhënat e paraqitura nga KJV-ja, rezulton se të gjitha vendimet kanë përfshirë si pjesë të kontrollit të figurës edhe rezultatet e testit të psikologut dhe të gjitha subjektet që kanë dalë në seancë dëgjimore i janë nënshtruar këtij testi. Gjithashtu, nga praktika e ndjekur, rezultatet e testeve të kryera nga psikologët kanë qenë në favor të subjektit të vlerësimit dhe nuk ka qenë asnjëherë e nevojshme kryerja e testeve të tjera edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme.

70. Nisur nga sa më lart, Gjykata vlerëson se nënshtrimi ndaj testit të poligrafit, në procesin e emërimit të drejtorit dhe të hetuesve të BKH-së, sipas ligjit nr. 95/2016, si dhe nënshtrimi ndaj testit psikologjik të personalitetit në procesin e vlerësimit të subjekteve të ligjit nr. 12/2018, për shkak të metodës së strukturimit dhe llojit të pyetjeve që i drejtohen individit, vendosin kufizim të së drejtës së jetës private të kandidatit për këto pozicione, i cili pashmangshmërisht cenon edhe dinjitetin e tij.

C.1.6 Për respektimin e kritereve të vendosura nga neni 17 i Kushtetutës

71. Gjykata kufizimin e lartpërmendur do ta vlerësojë në aspektin e respektimit të kritereve të vendosura nga neni 17 i Kushtetutës, i cili është edhe testi që duhet të gjejë zbatim për çdo ndërhyrje në të drejtat dhe liritë themelore të individit, bazuar edhe në praktikën e konsoliduar të Gjykatës. Pra, Gjykata do të ndalet në analizën nëse ndërhyrja e ligjvënësit, nëpërmjet parashikimit të testit të poligrafit, si një ndër kriteret që duhet të plotësohet për t'u punësuar në pozicionin drejtor dhe hetues në BKH dhe testit psikologjik të

personalitetit gjatë procesit të vlerësimit të subjekteve të ligjit nr. 12/2018, ka respektuar ose jo të drejtën e jetës private, dhe së bashku me të edhe dinjitetin e njeriut.

C.1.6.1 Për kriterin e kufizimit me ligj

72. Kriteri i parë për t'u analizuar është kufizimi vetëm me ligj i të drejtave dhe lirive të individit. Referuar nenit 17 të Kushtetutës dhe praktikës së Gjykatës, ky kriter, pra detyrimi për parashikimin e ndërhyrjeve me ligj në kuptimin formal, rezulton të jetë respektuar, pasi ndërhyrja, në secilin rast, është bërë nëpërmjet një ligji të miratuar nga Kuvendi, konkretisht me ligjin nr. 95/2016 dhe ligjin nr. 12/2018, sipas procedurave të parashikuara për këtë qëllim.

C.1.6.2 Për kriterin e ekzistencës së interesit publik

73. Kriteri i dytë për t'u vlerësuar nga Gjykata është ekzistenca e interesit publik në ndërhyrjen e ligjvënësit për vendosjen e kufizimit.

74. Koncepti kushtetues i interesit publik, ashtu siç është trajtuar në praktikë të vazhdueshme nga Gjykata, është mjaft i gjerë dhe duhet parë në këndvështrimin e aktit konkret që paraqitet për kontroll para saj. Është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese çështjet që përbëjnë interes publik ose të arsyes publike që të çojnë në kufizimin e një të drejte themelore, pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në varësi të situatave të ndryshme që krijohen. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit të çdo rasti konkret. Në praktikën kushtetuese është pranuar tashmë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë (*shih vendimet nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 1, datë 16.1.2017; nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 10, datë 19.3.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

75. Në çështjen konkrete shqyrtimi i ligjit nr. 95/2016 lidhet me vlerësimin e një prej kritereve që duhet të plotësojnë kandidatët për drejtor dhe hetues të BKH-së, konkretisht nënshtrimi ndaj testit të poligrafit. Sipas parashikimit ligjor, informacioni në raportin e përgatitur nga specialisti i poligrafit merret në konsideratë gjatë procesit të përzgjedhjes së drejtorit (*neni 34, pika 2, shërkronja "gj", i ligjit nr. 95/2016*), si dhe gjatë procesit të emërimit dhe atij të riemërimit për hetuesin e BKH-së (*neni 38, pika 2, shërkronja "e" dhe pika 6, i ligjit nr. 95/2016*).



76. Gjykata vëren se referuar *ratio legis*, ligjvënësi në ligjin nr. 95/2016, mes të tjerash, ka pasur si qëllim garantimin e funksionimit të BKH-së për të hetuar veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe veprat e tjera penale të kryera nga subjektet e parashikuara në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, e pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm ose i jashtëm. Kjo nevojë është diktuar për shkak të përmasave dhe nivelit të përhapjes së fenomenit të korrupsionit në Shqipëri, i cili ka ndikuar edhe në funksionimin efektiv të shtetit të së drejtës.

77. Në këtë drejtim, Komisioni Evropian në Progresraportin e tij ka theksuar: *“Vendi ka arritur nivel në përgatitjen e luftës kundër korrupsionit. Sidoqoftë, korrupsioni është i përhapur dhe nevojiten më shumë përpjekje për të krijuar qëndrueshmëri të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në të gjitha nivelet, veçanërisht për rastet ku përfshihen zyrtarë të nivelit të lartë shtetëror”* (shih Progresraportin e Komisionit Evropian, viti 2015, faqja 15). Edhe Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) në raportin e vlerësimit për Shqipërinë shprehet: *“një nga përparësitë kryesore të strategjisë është lufta ndaj korrupsionit brenda gjyqësorit dhe midis zyrtarëve të nivelit të lartë”* (shih Raportin e Vlerësimit për Shqipërinë GRECO mars 2014, § 16). Kjo problematikë vazhdon të monitorohet nga organizmat ndërkombëtarë, edhe me zbatimin e ligjit nr. 95/2016, duke u rekomanduar që *“... të harmonizohet dhe të rritet koherenca e brendshme e kuadrit ligjor dhe institucional për luftën kundër korrupsionit dhe integritetin e nëpunësve publikë, veçanërisht në lidhje me personat të cilëve u janë besuar funksione të larta ekzekutive dhe Policisë së Shtetit”* (shih Raportin e Vlerësimit për Shqipërinë GRECO tetor 2020, § 60, faqja 16).

78. Gjithashtu, Gjykata vëren se përhapja e korrupsionit sjell nevojën për ngritjen e organeve të posaçme për ta luftuar atë dhe njëkohësisht, për të forcuar integritetin dhe besimin e publikut për funksionimin e tyre, ndikon në marrjen e masave të duhura që në këto institucione të punësohen persona me vlera të larta morale. Këto masa domosdoshmërisht kanë përfshirë edhe BKH-në, si një njësi që ka si funksion hetimin e veprave penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

79. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se ligjvënësi nëpërmjet nënshtrimit të kandidatit ndaj testit të poligrafit, gjatë procedurave të punësimit në institucionin e BKH-së, sipas ligjit nr. 95/2016, ka

një interes publik, i cili e justifikon ndërhyrjen. Interesi publik në këtë rast lidhet me luftën ndaj korrupsionit, si dhe me marrjen e masave, duke krijuar institucione të posaçme në përbërjen e të cilave duhet të punësohen njerëz me cilësi morale dhe aftësi të larta profesionale.

80. Edhe për sa i përket ligjit nr. 12/2018, qëllimi i ligjvënësimit është vlerësimi i punonjësve të institucioneve të caktuara, të cilat duhet të kenë në përbërje të tyre funksionarë me integritet të lartë, me qëllim rritjen e cilësisë e të efikasitetit në hetime, si dhe garantimin e shërbimit sa më cilësor të sigurisë ndaj publikut. Për rrjedhojë, edhe në këtë rast kufizimi bazohet te interesi publik, i cili justifikon ndërhyrjen në të drejtën e jetës private dhe dinjitetin e punonjësit, që i nënshtrohet procesit të vlerësimit sipas këtij ligji.

C.1.6.3 Për kriterin e proporcionalitetit

81. Bazuar në nenin 17 të Kushtetutës, kriteri tjetër për kufizimin e të drejtave themelore është përpjesëtimi i drejtë midis ndërhyrjes dhe gjendjes që e dikton atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave, e në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

82. Gjykata në mënyrë të vazhdueshme ka mbajtur qëndrimin se parimi i proporcionalitetit nënkupton që ndërhyrja e ligjvënësimit për kufizimin e një të drejte ose lirie të caktuar të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet. Përveç kësaj, përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, çka do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria lidhet edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Kushti i përpjesëtimt të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar, konkretizohet në kërkesën e domosdoshmërisë, të dobishmërisë dhe të proporcionalitetit. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se respektimi i përmbushjes së kushteve të mësipërme të kufizimit kërkon një trajtim të diferencuar, në varësi të të drejtave dhe lirive individuale që i nënshtrohen kufizimit (shih vendimet nr. 1, datë 16.1.2017; nr. 2, datë 18.2.2013, të Gjykatës Kushtetuese).

83. Në jurisprudencën e saj, Gjykata kur ka çmuar ndërhyrjen në të drejtat themelore, ka marrë parasysh kriteret në vijim: i. nëse objektivi i ligjvënësimit është mjaftueshmërisht i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; ii. nëse masat e marra janë të lidhura



në mënyrë të arsyeshme me objektivin, ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; iii. nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpër se sa duhen për të arritur objektivin e kërkuar, sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t'u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme. Gjykata ka theksuar se proporcionaliteti i një kufizimi vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh që aspektet e mësipërme të mos analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra-tjetrën (shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese). Pra, në thelb të parimit të proporcionalitetit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre (shih vendimet nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 1 datë 6.2.2013; nr. 52, datë 5.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese).

84. Edhe GJEDNJ-ja në lidhje me të drejtën për jetë private duke theksuar se shtetet kanë një detyrim pozitiv për të siguruar respektimin e dinjitetit njerëzor dhe cilësinë e jetës në disa aspekte (shih L. kundër Lituanisë, 11 shtator 2007, § 56), është shprehur se parimi i proporcionalitetit në kufizimin e dinjitetit dhe të të drejtave e lirive themelore kërkon një balancë, e cila ka qëllim ose synim të ligjshëm dhe është “e nevojshme në shoqëri demokratike” (shih Glass kundër Britanisë së Madhe, 9 mars 2004, § 73; Pretty kundër Britanisë së Madhe, 29 korrik 2002, § 68 dhe 78).

85. GJEDNJ-ja është shprehur gjithashtu se ndonëse institucionet publike kanë një hapësirë të gjerë vlerësimi për të caktuar kufizime të të drejtave themelore, ato i nënshtrohen shqyrtimit të saj, si dhe vlerësimit të përputhshmërisë së tyre me Konventën, duke vlerësuar rrethanat konkrete të rastit, duke shqyrtuar “ndërhyrjen” nën dritën e çështjes në tërësi dhe duke përcaktuar që ajo ka ndjekur një “qëllim legjitim”, që i është përgjigjur “nevojës reale të ndërhyrjes” dhe, në veçanti, nëse ka qenë proporcionale me qëllimin, si dhe nëse arsyet e përdorura nga institucionet publike për ta justifikuar atë kanë qenë “të rëndësishme dhe të mjaftueshme” (shih Pretty kundër Britanisë së Madhe, 29 korrik 2002, § 70).

86. Nga përmbajtja e neneve 34, pika 2, shkronja “gj” dhe 38, pika 2, shkronja “e” të ligjit nr. 95/2016 për procesin e emërimit të drejtorit dhe të hetuesve të BKH-së, por edhe të nenit 38, pika 6, për procesin e riemërimit të hetuesve të

BKH-së, Gjykata konstaton se duke qenë se rezultati i testit të poligrafit “mbahet në konsideratë” gjatë procesit të emërimit të kandidatëve, ai shërben për marrjen e një informacioni plotësues për kandidatët. Rezultati i testit vlerësohet së bashku me tërësinë e të dhënave të marra nga kontrolli i pasurisë dhe pastërtisë së figurës së kandidatëve për drejtor dhe hetues të BKH-së, të cilët duhet të gëzojnë cilësi të larta profesionale dhe morale.

87. Gjithashtu, si nga faqja zyrtare e BKH-së, ashtu edhe nga shpjegimet në seancë plenare të subjektit të interesuar, SPAK-ut, rezulton se nëse testet e tjera, të cilave u janë nënshtruar kandidatët për hetues të BKH-së (testi i aftësive fizike, testi i arsyetimit logjik, testi për shkrimin e esesë dhe intervista e strukturuar), janë kryer në mënyrë të tillë që moskalimi i njërit prej tyre sjell skualifikim për vazhdimin e fazës së mëtejshme, testi i poligrafit është pjesë përbërëse e procesit të vlerësimit të pasurisë dhe kontrollit të pastërtisë së figurës së kandidatit dhe kryhet së bashku me to.

88. Gjykata, në vijim të sa më lart, vlerëson se sa më i ndjeshëm të jetë kufizimi i të drejtave, për më tepër kur ato lidhen me dinjitetin e njeriut, bazuar në parimin e proporcionalitetit, aq më bindës duhet të jetë justifikimi i tij. Në rastin në shqyrtim, nga njëra anë, kandidatët për drejtor dhe hetues të BKH-së në momentin e shprehjes së vullnetit për të kandiduar janë në dijeni të kriterëve dhe testeve që duhet të plotësojnë për t'u emëruar në detyrat përkatëse sipas parashikimeve ligjore duke “pranuar” edhe kufizimin e të drejtave dhe lirive. Por, nga ana tjetër, Gjykata vlerëson se meqenëse nënshtrimi ndaj testit të poligrafit ka qëllim marrjen e sa më shumë të dhënave për integritetin, moralin dhe aftësitë nervo-psikike, testi duhet të justifikojë qëllimin e tij.

89. Po në këtë drejtim, nga mënyra si ligjvënësi ka formuluar nenet 34, pika 2, shkronja “gj” dhe 38, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 95/2016, duke përcaktuar kriteret që kandidatët duhet të plotësojnë për drejtor dhe hetues të BKH-së, Gjykata vlerëson se dhënia e pëlqimit për t'u nënshtruar testit të poligrafit është një ndër kriteret e punësimit për emërimin në pozicionin e drejtorit ose hetuesit të BKH-së dhe, si i tillë, refuzimi për t'u nënshtruar këtij testi sjell skualifikim nga kandidimi.



90. Në lidhje me rezultatet e testit të poligrafit, Gjykata çmon se ato nuk përbëjnë *per se* kriter skualifikues në procedurën e emërimit të kandidatëve për drejtor dhe hetues të BKH-së, por duhet të vlerësohen nga Komisioni i Posaçëm së bashku me verifikimet për kontrollin e pasurisë dhe pastërtisë së figurës së kandidatit, sikurse rezultoi edhe nga shpjegimet e subjektit të interesuar, SPAK-ut, për praktikën e deritanishme të zbatimit të ligjit në fjalë, sipas të cilit vetëm rezultatet e testit të poligrafit nuk janë përdorur si kriter skualifikues gjatë procedurës së emërimit të drejtorit dhe hetuesve të BKH-së. Për rrjedhojë, në vlerësimin e Gjykatës vetëm moskalimi me sukses i testit të poligrafit, në rastet kur kriteret e vlerësimit të pasurisë dhe kontrollit të figurës janë përmbushur nga kandidatët, nuk mund të përbëjë kriter skualifikimi në procesin e emërimit për drejtor dhe hetues të BKH-së.

91. Gjithashtu, Gjykata vëren se informacioni i nxjerrë prej rezultateve të testit të poligrafit përfshihet në konceptin e *“të dhënave që mbledhen rreth individit”* dhe për rrjedhojë, në këtë rast zbatohen të gjitha garancitë kushtetuese për të dhënat personale të parashikuara nga neni 35 i Kushtetutës, duke përfshirë ndalimin pa pëlqim të publikimit të tyre dhe të drejtën e njohjes së kandidatit me to. Rastet përjashtimore nga garancitë kushtetuese të nenit 35 të Kushtetutës përfshijnë vetëm situatat specifike dhe sipas procedurave rigoroze, të parashikuara në mënyrë të shprehur nga ligji, siç mund të jenë ato që bëjnë të zbatueshëm ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, *“Për informacionin e klasifikuar ‘sekret shtetëror’”*, të ndryshuar (*ligji nr. 8457/1999*).

92. Në vijim të kësaj analize, Gjykata konstaton se në Rregulloren për ekzaminimet e poligrafit, të depozituar nga SPAK-u, përcaktohet se informacioni i marrë gjatë kryerjes së ekzaminimit poligrafik trajtohet si *“tepër sekret”* dhe i vihet në dispozicion vetëm personelit të autorizuar (*KLP-së, drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe drejtorit të BKH-së*). Në asnjë lloj situatë raporti nuk iu jepet personave të tjerë dhe pasi lexohet e rishikohet nga personeli i autorizuar, të gjitha regjistrimet elektronike duhet të fshihen plotësisht, përveç rasteve kur udhëzohet ndryshe nga drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

93. Gjykata vlerëson se përderisa procedurat për klasifikimin e një informacioni janë të parashikuara nga ligji nr. 8457/1999, asnjë akt nënligjor,

përfshirë edhe rregulloret e brendshme, nuk mund të përcaktojnë statusin *“sekret shtetëror”* të dokumenteve. Subjekti i interesuar, SPAK-u, gjatë seancës plenare sqaroi se informacioni i marrë nga rezultati i testit të poligrafit është klasifikuar *“tepër sekret”*, pasi është vlerësuar se ky lloj testi është parashikuar vetëm për këtë ligj dhe për një qëllim të caktuar, pra vetëm në funksion të procesit të kandidimit për drejtor dhe hetues në BKH, por pranoi, se: *“duke qenë se kemi të bëjmë me një proces të ri, gjithmonë ka diçka për të rregulluar”*. Gjykata thekson se edhe pse objekt i gjykimit kushtetues nuk mund të jenë rregulloret, për efekt të qartësisë dhe mënyrës së zbatimit të dispozitave ligjore, rregullimet e tyre nuk mund të tejkalojnë parashikimet ligjore.

94. Nga sa më lart, nisur nga parashikimi i nenit 35, pika 3, të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se kandidati që i nënshtrohet testit të poligrafit, pas kërkesës së tij, duhet të ketë të drejtën të njihet me rezultatet e marra në përfundim të testit të poligrafit. Kandidatët për drejtor dhe hetues në BKH duhet të kenë akses në materialet e dosjes së tyre, pasi vetë ata kanë dhënë pëlqimin për t’iu nënshtruar pyetjeve dhe kanë lejuar marrjen e të gjitha të dhënave në lidhje me personin e tyre.

95. Në analizë të fundit, Gjykata, nisur nga fakti se parashikimet ligjore të neneve 34, pika 2, shkronja “gj” dhe 38, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 95/2016 kanë për qëllim punësimin e njerëzve me cilësi morale dhe aftësi profesionale të larta në strukturat që kanë për mision luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, vlerëson se testi i poligrafit në mënyrë që të justifikojë qëllimin e tij, duhet zbatuar në mënyrë të mirëpërcaktuar. Konkretisht, mosdhënia e pëlqimit për t’iu nënshtruar testit të poligrafit sjell skualifikimin e kandidatit, pyetjet që i drejtohen këtij të fundit duhet të jenë të strukturuar në mënyrë që të mbeten brenda qëllimit të ligjit, ndërsa rezultatet e testit, në vetvete, nuk kanë vlerë përcaktuese në procesin e emërimit të drejtorit ose hetuesve të BKH-së, në rastin e përmbushjes nga ana e kandidatëve të kriterëve të tjera të kontrollit të pasurisë dhe të pastërtisë së figurës. Gjithashtu, në vlerësimin e Gjykatës, kandidati, në përfundim të procesit, me kërkesë të tij, ka të drejtë të njihet me rezultatet e testit të poligrafit.

96. Gjykata vlerëson se në interpretimin e testit të poligrafit, si më lart, në balancën midis kufizimit



të të drejtave dhe kontributit që sjell krijimi i një institucioni si BKH-ja, kufizimi i vendosur prej dispozitave në fjalë nuk cenon kriterin e proporcionalitetit.

97. Për sa i përket ligjit tjetër objekt shqyrtimi, nr. 12/2018, Gjykata vlerëson se *ratio legis* për nënshtimin ndaj testeve psikologjike të subjekteve të këtij ligji është i parashikuar në funksion të objektivit që ligjvënësi kërkon të arrijë, sikurse është edhe krijimi i institucioneve me punonjës që karakterizohen nga integriteti i lartë moral dhe profesional.

98. Nga përmbajtja e nenit 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018 del qartë se punonjësi i nënshtrohet detyrimit të testit psikologjik të personalitetit. Po në këtë drejtim, konstatohet se ky test parashikohet edhe në nenin 135, pika 1, shkronja “ç”, të rregullores së Policisë së Shtetit (*në lidhje me procedurat për pranimin në Akademinë e Policisë*) dhe në nenin 67, shkronja “ç”, të rregullores së Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme (*në lidhje me procedurat e aplikimit, konkurimit dhe pranimit në shërbim*). Gjithashtu, neni 38, pika 2, i ligjit nr. 12/2018 parashikon se pas vendimit të trupës së vlerësimit dhe pas pëlqimit të punonjësit, ai i nënshtrohet edhe testeve të tjera, edhe me ndihmën e mjeteve të teknologjisë së posaçme, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së punonjësit dhe të deklarimeve personale.

99. Gjykata konstaton se subjektet e ligjit nr. 12/2018, bazuar në nenin 36 të po këtij ligji, plotësojnë deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës nr. 2 bashkëlidhur ligjit, duke dhënë pëlqimin për mbledhjen e të dhënave dhe kryerjen e kontrollit të figurës, sipas parashikimeve ligjore. Duke qenë se sipas nenit 38 të ligjit në fjalë, procesi i kontrollit të figurës së punonjësit bazohet edhe në të dhënat që dalin nga testi psikologjik i personalitetit (*pika 2*), dhënia e pëlqimit për kontrollin e figurës, në vlerësimin e Gjykatës, përfshin edhe dhënien e pëlqimit për kryerjen e këtij testi. Në të njëjtën mënyrë, sikurse edhe në rastin e testit të poligrafit, kryerja e tij është kriter i detyrueshëm në procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësit.

100. Nga ky arsyetim, Gjykata, nisur edhe nga fakti se qëllimi i këtij testi konsiston kryesisht në kontrollin e problemeve të shëndetit mendor ose të problemeve emocionale të punonjësit, subjekt i

ligjit nr. 12/2018, apo të aftësive të tij për të menaxhuar emocionet, duke ruajtur vetëkontrollin, si dhe të tipareve të një personaliteti të qëndrueshëm (*shih paragrafin nr. 63 të këtij vendimi*), vlerëson se parashikimi i testit psikologjik të personalitetit, të cilit duhet t'i nënshtrohet punonjësi, sipas nenit 38, pika 2 të ligjit nr. 12/2018, dhe kufizimi i jetës private në këtë drejtim, përmbush kriterin e proporcionalitetit.

101. Me të njëjtin arsyetim edhe shprehja “*testeve të tjera, edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme*,” e parashikuar në nenin 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018 është në përputhje me testin e proporcionalitetit për të dhënat e mbledhura. Ndërkohë kjo shprehje do të kontrollohet nga Gjykata edhe nën dritën e parimit të sigurisë juridike, për shkak të pretendimit të veçantë të kërkuarit për këtë çështje.

C.2. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike

102. Kërkuari pretendon se dispozitat e ligjit nr. 95/2016 cenojnë parimin e sigurisë juridike, pasi përmbajtja e tyre është e paqartë, duke i lënë hapësirë zbatuesit për interpretime të ndryshme, gjë që nuk përputhet me qëllimin, qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë që synon vetë norma. Nga formulimi i neneve 34, pika 2, shkronja “gj” dhe 38, pika 2, shkronja “e”, të po këtij ligji rezulton se shmangia ose refuzimi i kandidatit për t'iu nënshtrohet testit të poligrafit i heq atij të drejtën e kandidimit edhe sikur të plotësojë kriteret e tjera. Testi i poligrafit është kusht/kërkesë për emërimin si drejtues ose hetues në BKH, por nuk mund të bëhet pa pëlqimin e personit. Në rast se subjekti pranon t'i nënshtrohet, por rezultati del “*nuk e ka kaluar testin*”, pavarësisht se ky rezultat vlerësohet në raport me tërësinë e vlerësimeve të tjera të kandidatit, ky i fundit mund të shihet si person jo i besueshëm dhe pa integritet. Ndërsa, në ligjin nr. 12/2018 nuk jepet kuptimi i testit psikologjik, i testeve të tjera dhe i mjeteve teknologjike të posaçme, të cilave do t'u nënshtrohet punonjësi. Formulimi “*testeve të tjera*” nënkupton zbatimin e testit të poligrafit dhe në rast se rezultati del jo pozitiv, kjo sjell ndërhyrje në të drejtën e jetës private.

103. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar, pasi ligjet janë të qarta për zbatim. Vlerësimi psikologjik, i parashikuar nga ligji nr.



12/2018, bëhet nga një trupë e posaçme e ngritur me vendim të Urdhrit të Psikologëve, e cila pas kryerjes së testimit, i dërgon komisionit të vlerësimit një raport për rezultatet e këtij testimi. Gjithashtu, subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi, gjatë seancës plenare dhe në pretendimet përfundimtare theksuan disa herë se fraza “*testeve të tjera, edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme,*” në asnjë rast nuk nënkupton zhvillimin e testit të poligrafit, por ka të bëjë me kryerjen e testeve të tjera që mund të rekomandohen nga trupa e posaçme. Sipas Këshillit të Ministrave, deri më sot, për procesin e vlerësimit sipas ligjit nr. 12/2018, KJV-ja nuk e ka parë të nevojshme aplikimin e testeve të tjera edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme, por, bazuar në nenin 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018 me “*testeve të tjera, edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme,*” është fjala për teste si ai për alkoolin ose drogën.

104. Subjekti i interesuar, SPAK-u, ka parashtruar se pretendimi për *cenimin e parimit të sigurisë juridike*, në lidhje me normat e ligjit nr. 95/2016, nuk është i bazuar. SPAK-u, si institucioni përgjegjës në përzgjedhjen e drejtorit të BKH-së dhe në bashkëpunim me këtë të fundit edhe për rekrutimin e hetuesve për BKH-në, nuk ka konstatuar hapësirë për keqinterpretim ose keqzbatim të dispozitave ligjore objekt shqyrtimi.

105. Gjykata rithekson se parimi i sigurisë juridike garanton parashikueshmërinë e sistemit normativ. Nxjerrja e normave juridike nuk i shërben vetëm zgjidhjes së një konflikti të mundshëm ose rregullimit të një situatë të parregulluar më parë. Ky proces duhet të krijojë përshtypjen se subjektet e së drejtës së përmbajtja e normave juridike garanton siguri dhe qëndrueshmëri për të ardhmen. Siguria juridike trajtohet edhe si kusht për vlefshmërinë materiale të një akti, duke garantuar pandryshueshmërinë në parim të akteve normative, ku i kushtohet vëmendje rregullimit të situatave pa ndryshime substanciale në vazhdimësi, pasi në të kundërt do t'i vendosnim subjektet e së drejtës në pozicione të papëlqyeshme dhe të pafavorshme për ta (*shih vendimet nr. 2, datë 18.2.2013; nr. 33, datë 24.6.2010; nr. 10, datë 19.3.2008; nr. 26, datë 2.11.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

106. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se vetë siguria juridike, si element i shtetit

të së drejtës, ka si kërkesë të domosdoshme që ligji në tërësi ose dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme (*shih vendimin nr. 9, datë 26.2.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Për të kuptuar dhe zbatuar drejt parimin e sigurisë juridike, kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t'i japë formë një koncepti. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t'i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (*shih vendimet nr. 10, datë 26.2.2015; nr. 36, datë 15.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

107. Gjykata vëren se ligji nr. 95/2016, sikurse u theksua më lart, ka si objekt përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e SPAK-ut dhe të BKH-së, përcaktimin e kushteve dhe të procedurave për emërimin e drejtuesit dhe prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme, si dhe të kriterëve për t'u punësuar në BKH. Ndër të tjera, qëllim i ligjit është edhe garantimi i funksionimit të strukturës së BKH-së për të hetuar veprat penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, e pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm ose i jashtëm.

108. Gjykata vlerëson se dispozitat e kundërshtuara të ligjit nr. 95/2016 kanë përcaktuar fushën e zbatimit, si dhe personat që i nënshtrohen. Konkretisht, ky ligj zbatohet vetëm për personat të cilët shprehin vullnetin për të kandiduar për drejtor ose hetues në BKH. Po në këtë kuptim, testi i poligrafit, duke qenë një kriter punësimi, në mënyrën e interpretuar nga kjo Gjykatë (*shih paragrafët 89-90 dhe 94-95 të këtij vendimi*) nuk lë vend për arbitraritet në zbatimin e dispozitave të ligjit. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se nenet 34, pika 2, shkronja “g” dhe 38, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 95/2016 nuk cenojnë parimin e sigurisë juridike.

109. Gjithsesi, nisur edhe nga sa u arsyetua më sipër lidhur me mospërputhjen e dispozitave ligjore, me mënyrën si ato kanë gjetur pasqyrim në rregulloren për ekzaminimin e poligrafit (*shih paragrafin 93 të këtij vendimi*), Gjykata rithekson qëndrimin e mbajtur se, në kuptim të dispozitave të



kundërshtuara të ligjit nr. 95/2016, testi i poligrafit kryhet vetëm me pëlqimin e kandidatit dhe se refuzimi i tij për të kryer këtë test përbën kriter për skualifikimin nga kandidimi. Testi i poligrafit nuk mund të ketë vlerë përcaktuese për rezultatet e procesit të emërimit të drejtorit dhe hetuesit të BKH-së. Qëllimi i tij mund të justifikohet vetëm nëse procesi i kontrollit të figurës dhe verifikimit të pasurisë së kandidatit nuk janë të mjaftueshme për të plotësuar kontrollin e plotë të personit të tij. Në çdo rast, kandidati, në përfundim të procesit, me kërkesë të tij, ka të drejtë të njihet me rezultatet e testit të poligrafit.

110. Për sa u përket dispozitave të kundërshtuara të ligjit nr. 12/2018, Gjykata vlerëson se kryerja e testit psikologjik të personalitetit nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, të cilët i nënshtrohen procesit të vlerësimit, në funksion të kontrollit të figurës, sikurse u theksua më lart (*shih paragrafin nr. 63 të këtij vendimi*), konsiston në vlerësimin e pesë dimensioneve të personalitetit dhe ka si qëllim kryesisht kontrollin e problemeve të shëndetit mendor ose të problemeve të lehta emocionale të punonjësit apo të aftësive të tij për të menaxhuar emocionet, duke ruajtur vetëkontrollin, si dhe të tipareve të një personaliteti të qëndrueshëm të tij. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se neni 38, pika 2, i ligjit nr. 12/2018 në lidhje me testin psikologjik nuk paraqet paqartësi si në mënyrën e formulimit, ashtu edhe të zbatimit të tij.

111. Gjykata gjithashtu vëren se sipas parashikimit të nenit 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, subjektet e vlerësimit mund t'i nënshtrohen edhe "*testeve të tjera, edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme*," me vendim të trupës së vlerësimit përkatëse dhe me pëlqimin e tij, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së punonjësit dhe të deklarimeve personale. Gjykata vlerëson se shprehja "*testeve të tjera*" lidhet me ato teste që trupa e posaçme që kryen testin psikologjik mund të çmojë se janë të nevojshme të kryhen për subjektet e ligjit nr. 12/2018. Pra, testet e tjera kryen vetëm kur trupa vlerësuese pas marrjes së raportit të grupit të psikologëve vlerëson se përtej rezultateve të testit psikologjik të personalitetit duhet të kryhen edhe disa teste të tjera. Për këtë arsye pretendimi i kërkuar se ato nënkuptojnë nënshttrimin e

punonjësit ndaj testit të poligrafit, përderisa ai nuk është parashikuar shprehimisht në ligj, është i pabazuar. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se shprehja "*testeve të tjera*" nuk paraqet paqartësi në kuptimin e saj.

112. Gjithashtu, Gjykata konstaton se pretendimi i subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, se në shprehjen "*testeve të tjera*" mund përfshihen disa teste, si ai për alkoolin ose drogën, është i pabazuar, pasi këto teste janë shprehimisht të përcaktuara në nenin 38, pika 1, shkronjat "ë" dhe "p", të ligjit nr. 12/2018 dhe, si të tilla, nuk mund të përfshihen në shprehjen "*testeve të tjera*", të parashikuara në nenin 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018.

113. Për sa më lart, Gjykata thekson se fakti që një dispozitë ligjore mund të ketë më shumë se sa një mënyrë interpretimi, nuk e bën atë të paqartë. Përkundrazi, ligji nuk duhet të jetë shterues dhe i ngurtë, por duhet t'u lërë hapësirë interpretimi organeve administrative dhe gjyqësore, në varësi të rrethanave konkrete dhe zhvillimit të normave në kontekst të praktikës. Megjithatë, që vetë ligjvënësi të mos jetë në gjendje të japë, si gjatë parashtrimeve me shkrim, seancave plenare apo relacionit shpjegues të projektligjit, disa lloj interpretimesh potenciale, joshteruese, se cilat mund të jenë testet e tjera "*edhe me ndihmën e mjeteve të tjera teknologjike*," nuk mund të justifikohet. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se arbitrariteti nuk qëndron në faktin e mosparashikimit konkretisht në ligj se cilat janë testet e tjera, ose pse janë parashikuar teste të tjera, por lidhet me teknikën legislative të përdorur që çon në paparashikueshmëri dhe paqartësi lidhur me shprehjen "*edhe me ndihmën e mjeteve të tjera teknologjike*," pasi nuk arrin të shpjegojë testet e tjera që mund të realizoheshin me mjete teknologjike dhe se cilat mund të ishin potencialisht ato.

114. Për pasojë, në vlerësimin e Gjykatës formulimi i shprehjes "*edhe me ndihmën e mjeteve të tjera teknologjike*," në përmbajtjen e këtij neni, mund të sjellë edhe arbitraritet në mënyrën e zbatimit të saj dhe, si e tillë, cenon parimin e sigurisë juridike. Gjithashtu, Gjykata, me qëllim që t'i japë ligjvënësit kohën e mjaftueshme për të miratuar rregullat e reja ligjore në përputhje me vendimin e saj, vlerëson se Kuvendi duhet të plotësojë ligjin nr. 12/2018 brenda afatit 6-mujor, që fillon nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.



C.3. Për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor

115. Kërkuesi ka pretenduar se normat cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pasi nuk parashikohet e drejta për të ankimuar rezultatet e testit të poligrafit sipas ligjit nr. 95/2016 dhe testit psikologjik të personalitetit sipas ligjit nr. 12/2018. Sipas tij nuk parashikohen garanci ligjore të nevojshme në kuadër të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shtetasit që i nënshtrohen testit të poligrafit, si e drejta për t'u informuar, dëgjuar, mbrojtur, ankuar etj. Punonjësi që vlerësohet nuk ka të drejtë të kundërshtojë të dhënat e mjeteve teknologjike, informacionin ose raportin e ekspertit, apo të kundërshtojë edhe vetë ekspertin. Gjithashtu, testi i poligrafit jo vetëm që paraqitet si provë, por ka edhe përparësi ndaj provave të tjera, ndërkohë që rezultatet e tij nuk përbëjnë provë sipas legjislacionit procedural shqiptar, përfshirë edhe të drejtën administrative, pasi të dhënat që mund të rezultojnë janë të natyrës fiziologjike, nervo-psikike.

116. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se ligjet objekt kontrolli kushtetues nuk kanë asnjë normë që të ndalojë kundërshtimin e rezultateve të testit dhe të të gjithë procedurës së vlerësimit në tërësi. Zhvillimi i testit të poligrafit parashikohet në norma ligjore, për të cilat kandidati është në dijeni në momentin e zhvillimit të testit dhe në çdo rast kërkohet domosdoshmërisht pëlqimi i tij. Po ashtu, edhe subjektet e ligjit nr. 12/2018 kanë të drejtë të njihen me të gjitha rezultatet e procesit të vlerësimit. Në rastin e marrjes së një vendimi negativ të trupës së vlerësimit (*përgjykim ose largim nga detyra*), subjekti ka të drejtën e tij kushtetuese të ankohet pranë organeve gjyqësore kundër këtij vendimi.

117. Subjekti i interesuar, SPAK-u, ka prapësuar se procedura e parashikuar nga ligji në përzgjedhjen e drejtorit dhe të hetuesve të BKH-së bazohet në një vlerësim objektiv të kushteve dhe kriterëve, si dhe transparencës e respektimit të standardeve për një proces të rregullt ligjor. Kandidati ka të drejtë të kundërshtojë të gjithë procesin për vlerësimin e pasurisë dhe të figurës, njësoj si dhe fazat e tjera të mëparshme të konkurrimit. Edhe në praktikë ka pasur raste të ankimit në gjykatën administrative, sidomos për testin fizik, nga kandidatët për këto pozicione.

118. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter disiplinor administrativ. Në këtë kuptim, ajo ka theksuar se çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor, është i detyruar të respektojë standardet demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë (*shih vendimet nr. 34, datë 10.4.2017; nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata është shprehur se njohja paraprake e personit me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, nëpërmjet dhënies së sqarimeve paraprake ashtu edhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt si një e drejtë themelore (*shih vendimet nr. 34, datë 10.4.2017; nr. 2, datë 18.1.2017; nr. 67, datë 11.11.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

119. Gjykata vëren se dispozitat objekt kundërshtimi, në thelb, lidhen me dy procese administrative, në njërën anë kandidimi për drejtor dhe hetues në BKH dhe, në anën tjetër, vlerësimi kalimtar dhe periodik i punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme.

120. Lidhur me procedurat e kandidimit për drejtor dhe hetues të BKH-së në ligjin nr. 95/2016 nuk është e parashikuar shprehimisht e drejta për të kundërshtuar procesin e përzgjedhjes si në tërësi ashtu edhe në veçanti për secilën nga fazat e përzgjedhjes. Gjithsesi, sipas kuptimit dhe rolit që duhet të ketë testi i poligrafit në procesin e kandidimit për drejtor dhe hetues të BKH-së, vetë kandidati, pas përfundimit të procesit, ka të drejtë të njihet me rezultatet e tij (*shih paragrafët 95 dhe 109 të këtij vendimi*). Përveç sa më sipër, në kontekstin e garancive që përcakton neni 23 i Kushtetutës për të drejtën e informimit dhe veçanërisht me kuptimin që merr kjo e drejtë në procedurat administrative, sipas KPA-së, Gjykata vëren se të gjitha palët në një procedurë administrative kanë të drejtë të njihen me dokumentet e dosjes së kësaj procedure, si dhe të marrin kopje të tyre.

121. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se kandidatëve për drejtor ose hetues të BKH-së, u



garantohen elementet bazë që përbëjnë të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Kandidati ka të drejtë të njihet me rezultatet e procesit administrativ të kryer ndaj tij, përfshirë ato testit të poligrafit dhe më pas mund t'u drejtohet gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për të kundërshtuar rezultatet e fazës së vlerësimit të pasurisë dhe të pastërtisë së figurës së tij, njësoj si për të gjitha fazat e tjera të kandidimit.

122. Po në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se rezultatet e testit të poligrafit, në asnjë rast, nuk kanë vlerën e provës në procesin e emërimit të drejtorit dhe hetuesve të BKH-së. Testi i poligrafit është kriter punësimi që duhet të përmbushet nga kandidati dhe rezultatet e tij janë në funksion të vlerësimit të besueshmërisë së figurës së tij.

123. Ndërsa lidhur me procedurat e vlerësimit kalimtar, Gjykata vëren se në nenin 50 të ligjit nr. 12/2018 parashikohet e drejta e punonjësit që të informohet për raportet e vlerësimit dhe në nenin 63 të po këtij ligji përcaktohet se kundër vendimeve të organeve të vlerësimit mund të ushtrohet ankim i drejtpërdrejtë në gjykatën administrative kompetente.

124. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuar për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor është i pabazuar.

C.4. Për cenimin e parimit të barazisë para ligjit dhe të mosdiskriminimit

125. Kërkuar pretendon se është cenuar parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sepse ndërkohe që të dyja ligjet parashikojnë përdorimin e testeve dhe të pajisjeve teknike, mënyra e formulimit të dispozitave përkatëse është e ndryshme. Konkretisht, sipas përmbajtjes së ligjit nr. 95/2016, nënshtrimi ndaj pajisjeve teknike për besueshmërinë e thënies është kriter i detyrueshëm që kryhet me dhënien e pëlqimit të kandidatit, ndërsa sipas ligjit nr. 12/2018 nënshtrimi ndaj pajisjeve teknike kryhet vetëm me pëlqimin e punonjësit që i nënshtrohet testit. Për më tepër, në relacionin bashkëlidhur ligjit nr. 95/2016 nuk është sqaruar se përse verifikimi i figurës nëpërmjet poligrafit është i domosdoshëm vetëm për këtë kategori punonjësish dhe jo edhe në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, që do të zgjidhen në institucionet e specializuara kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, për sa i përket verifikimit të figurës. Gjithashtu, përdorimi i këtyre teknikave përbën

diskriminim për punonjësit që i nënshtrohen testit.

126. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, parashtruan se pretendimi për përdorimin e testit të poligrafit edhe në mënyrën e përzgjedhjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk qëndron, përderisa procedura e zgjedhjes midis gjyqtarëve, prokurorëve dhe kandidatëve për BKH-në është tërësisht e ndryshme.

127. Në nenin 18 të Kushtetutës garantohet shprehimisht barazia e shtetasve para ligjit. Gjithashtu, në paragrafët 2 dhe 3 të tij ligjvënësi ka garantuar se askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla, si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Krahës kësaj dispozite kushtetuese qëndron edhe neni 14 i KEDNJ-së, i cili u ndalon shprehimisht shteteve anëtare që të drejtat dhe liritë e garantuara nga kjo konventë t'ua nënshtrojnë kriterëve të tilla, si gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, gjuha, besimi ose pikëpamjet politike, si dhe prejardhjes sociale dhe nacionale.

128. Sipas jurisprudencës kushtetuese parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Megjithatë, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, por trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë mund të përliqet vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive (*shih vendimet nr. 34, datë 10.4.2017, nr. 10, datë 29.2.2016; nr. 71, datë 27.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

129. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se përkufizimi i një rregullimi juridik nëse është ose jo *objektivisht* i arsyetuar, nuk është vetëm një çështje e thjeshtë juridike, por kërkon edhe një vlerësim real. Diferencimet, si dhe arsyet që çojnë tek to ose kundër tyre duhen ballafaquar për t'ia lënë në dorë përfundimisht vendimin organit kompetent sipas kriterëve të tij. Mënyra e zgjidhjes është një e drejtë e organit përkatës, sepse çdo çështje ka specifikat e saj. Sipas praktikës së Gjykatës, ndodhemi para diskriminimit, kur



subjekte juridike që ndodhen në të njëjtën gjendje trajtohen në mënyra të ndryshme pa justifikim ligjor të arsyeshëm dhe objektiv. Natyrisht që përkufizimi i çdo kriteri për ta cilësuar arsyetimin *objektiv* varet në një masë të madhe nga çmuarja e vlerave dhe nuk mund të jetë i përcaktuar në mënyrë precize (*shih vendimet nr. 48, datë 15.11.2013; nr. 4, datë 12.2.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

130. Bazuar në sa më lart, Gjykata vlerëson se në rastin në shqyrtim argumentet e kërkuarit kanë të bëjnë me mënyrën se si ligje të ndryshme kanë parashikuar testet që duhet t'u nënshtrohen subjekte të ndryshme. Konkretisht, lidhur me pretendimin se në rastin e nënshtimit të testit të poligrafit kërkohej pëlqimi i kandidatit, ndërsa në rastin e punonjësit që i nënshtrohet vlerësimit kalimtar, sipas ligjit nr. 12/2018, ai i nënshtrohet automatikisht testit psikologjik të personalitetit, pa dhënë pëlqimin e tij, Gjykata vlerëson se parashikimi në ligje të ndryshme i formave të ndryshme të testeve nuk përbën cenim të parimit të barazisë përpara ligjit ose të parimit të mosdiskriminimit.

131. Gjithashtu, kërkuari pretendon se cenohen neni 18 i Kushtetutës dhe neni 14 i KEDNJ-së, pasi testit të poligrafit nuk i nënshtrohen edhe prokurorët edhe gjyqtarët, që kalojnë procesin e rivlerësimit, për t'u emëruar në Prokurorinë e Posaçme dhe Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Gjykata vëren se drejtori dhe hetuesi i BKH-së, nga njëra anë, dhe gjyqtarët dhe prokurorët, nga ana tjetër, përbëjnë dy kategori funksionarësh publikë, që pavarësisht se i shërbejnë të njëjtit qëllim, kryejnë detyra të ndryshme, prandaj edhe trajtimi i tyre i diferencuar është i përligjur. Pikërisht për këtë arsye rivlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve i nënshtrohet zbatimit të dispozitave ligjore të ndryshme nga ato në shqyrtim, konkretisht ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Për rrjedhojë, Gjykata çmon se edhe ky pretendim i kërkuarit nuk është i bazuar.

132. Në përfundim, Gjykata, bazuar në analizën e pretendimeve të kërkuarit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, vlerëson se kërkesa është pjesërisht e bazuar sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "a" dhe 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës, si dhe neneve 49, pika 3, shkronja "d", 51/a, pika 1, shkronja "b" dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e togefjalëshit "edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme", të parashikuar në nenin 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme", si të papajtueshëm me Kushtetutën.

3. Rrëzimin e kërkesës për kërkimet e tjera.

4. Detyrimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të plotësojë nenin 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, të lartpërmendur, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 20.4.2021.

Shpallur më 19.5.2021.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Elsa Toska, Altin Binaj, Përparim Kalo, Sonila Bejtja

Anëtare pjesërisht kundër: Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të kërkesës së paraqitur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, me objekt: "*Shfuqizimin e neneve 34, pika 2, shkronja "gj" dhe 38, pika 2, shkronja "e", të ligjit nr. 95/2016 dhe të nenit 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, si të papajtueshme me Kushtetutën*", jemi pjesërisht kundër qëndrimit të shumicës lidhur me pretendimin e kërkuarit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, pasi vlerësojmë se shprehja "*testeve të tjera, edhe me ndihmën*"



e mjeteve teknologjike të posaçme,” e parashikuar në nenin 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018 duhej shfuqizuar tërësisht.

2. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8 të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, parashatrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tonë pjesërisht kundër.

3. Kërkuesi ka pretenduar se në nenin 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018 nuk jepet kuptimi i testeve të tjera dhe i mjeteve teknologjike të posaçme, të cilave do t’u nënshtrohet punonjësi. Ndërsa formulimi “*testeve të tjera*” nënkupton zbatimin e testit të poligrafit dhe në rast se rezultati i tij del jo pozitiv, kjo sjell ndërhyrje në të drejtën e jetës private. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se fraza “*testeve të tjera, edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme,*” në asnjë rast nuk nënkupton zhvillimin e testit të poligrafit, por ka të bëjë me kryerjen e testeve të tjera që mund të rekomandohen nga trupa e posaçme, të tilla, si testi për alkoolin ose drogën. Deri më sot, për procesin e vlerësimit sipas ligjit nr. 12/2018, KJV-ja nuk e ka parë të nevojshëm aplikimin e testeve të tjera edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme (*shih paragrafin nr. 103 të vendimit*).

4. Shumica, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimin e kërkuesit dhe prapësimet e subjekteve të interesuara, ka vendosur shfuqizimin e togfjalëshit “*, edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme,*” me arsyetimin e përmbledhur se shprehja “*testeve të tjera*” nuk ka kuptim të paqartë, pavarësisht se ajo mund të interpretohet në më shumë se një mënyrë, ndërsa formulimi i shprehjes “*, edhe me ndihmën e mjeteve të tjera teknologjike,*” sjell arbitraritet në mënyrën e zbatimit të nenit 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018 dhe, si e tillë, cenon parimin e sigurisë juridike. Sipas shumicës, arbitrariteti nuk qëndron në faktin pse nuk është parashikuar konkretisht në ligj, cilat janë testet e tjera ose pse janë parashikuar teste të tjera, por se teknika legjislative e përdorur të çon në paqartësi lidhur me shprehjen “*, edhe me ndihmën e mjeteve të tjera teknologjike,*”, pasi nuk arrin t’i shpjegojë testet e tjera që mund të realizoheshin me mjete teknologjike dhe se cilat mund të ishin potencialisht ato (*shih paragrafët 111 dhe 113 të vendimit*).

5. Në vlerësimin tonë kushtetues të çështjes, çmujmë se shprehja “*testeve të tjera, edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme*” në tekstin e nenit 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018 duhej shfuqizuar në tërësi, pasi kjo shprehje i jep dispozitës së kundërshtuar një kuptim të paqartë dhe arbitrar, që rrezikon të cenojë të drejtën individuale të jetës private të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme që i nënshtrohen procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik, të lidhur edhe me dinjitetin e tyre.

6. Ne biem dakord me shumicën në nivel parimor, teksa shprehet për përmbajtjen e parimit të sigurisë juridike, si element i shtetit të së drejtës dhe ndikimin që ai ka në procesin e hartimit dhe miratimit të normave ligjore, me qëllim që ato të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme. Ashtu siç shprehet shumica, një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t’i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (*shih paragrafët 105-106 të vendimit*).

7. Gjithsesi, ne gjyqtaret në pakicë duam të theksojmë se, përveç sa është shprehur shumica, në jurisprudencën e saj Gjykata në lidhje me parimin e sigurisë juridike ka vlerësuar se para së gjithash ligji duhet kuptuar saktë dhe drejt. Prandaj duhet të dalë i qartë qëllimi i hartimit të tij. Ai duhet të përcaktojë mjetet e ndërhyrjes, subjektet të cilave u drejtohet, raportet e caktuara të sjelljes dhe mënyrën e zbatimit të tij. Rezultati që synohet duhet të jetë i pritshëm dhe pasojat të parashikueshme për subjektet të cilave u drejtohet ligji në tërësi ose dispozita të veçanta të tij (*shih vendimin nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Për këtë arsye siguria juridike, në jurisprudencën kushtetuese, si element thelbësor i shtetit të së drejtës, është e lidhur edhe me respektimin dhe garantimin e dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike, sikurse është trajtuar edhe në vendim për dinjitetin e njeriut.

8. Gjithashtu, jemi të një mendimi me shumicën se shprehja “*testeve të tjera*” nuk nënkupton nënshttrimin e punonjësit subjekt të ligjit nr. 12/2018 ndaj testit të poligrafit, përderisa ky i fundit nuk është parashikuar shprehimisht në ligj (*shih paragrafin 111 të vendimit*) dhe se në këtë



shprehje nuk mund të përfshihen teste, si ai për alkoolin ose drogën, pasi ato janë shprehimisht të përcaktuara në nenin 38, pika 1, shkronjat “ë” dhe “P”, të ligjit nr. 12/2018 *(shih paragrafin 112 të vendimit)*.

9. Ajo që na ndan me shumicën lidhet nga njëra anë me nivelin e standardit të qartësisë që duhet të ketë ligji në tërësi ose dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre dhe, nga ana tjetër, me zbatimin e tij në rastin konkret. Shumica pranon se standardi i qartësisë nuk cenohet nëse një normë lejon më shumë se një mënyrë interpretimi dhe se në rastin në shqyrtim ky standard cenohet vetëm nga shprehja “, edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme,” *(shih paragrafët 113-114 të vendimit)*.

10. Në vlerësimin tonë, në shtetin e së drejtës, standardi i qartësisë së ligjeve, si kërkesë që buron nga parimi i sigurisë juridike, duhet të jetë i nivelit të lartë. “I qartë” do të thotë të jetë i lehtë për t’u kuptuar në masën që të mos shkaktojë konfuzion apo pasiguri në zbatim. Do të thotë gjithashtu, jo i errët dhe i njëkuptimtë. Që një normë ligjore të përcaktohet “e qartë”, ajo duhet jo vetëm të jetë e kuptueshme, por po ashtu të jetë e aftë të përcjellë të njëjtin mesazh të çdokush, pasi në këtë mënyrë sigurohet edhe kontrolli i dobishmërisë dhe i arsyeshmërisë, si dhe uniformiteti në zbatimin e saj. Është e vërtetë që në parim normat ligjore kanë natyrë abstrakte, pasi duhet të zbatohen në një numër të pakufizuar rastesh të ngjashme dhe iu drejtohen një numri të pakufizuar individësh. Megjithatë, formulimet abstrakte nuk mund të shkojnë deri aty sa të bëjnë të pamundur përcaktimin e kuptimit të normës ligjore ose t’i japin asaj një kuptim të paqartë. Thënë ndryshe, është e nevojshme gjetja e ekuilibrit të duhur, si rrjedhojë e të cilit grupi i individëve i synuar nga norma ligjore të mos përfshihet në gjendje pasigurie, ndërsa zbatuesit e normës ligjore të ndjekin praktika uniforme në raste të ngjashme.

11. Në rastin konkret, shprehja “testeve të tjera, edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme,” nuk përmbush standardin e qartësisë pasi formulimi i saj është aq abstrakt sa që krijon konfuzion të përgjithshëm. Kështu, në radhë të parë, përfaqësuesit e Këshillit të Ministrave dhe të Kuvendit, në cilësinë e hartuesve të ligjit, nuk arritën dot të shpjegojnë kuptimin e saj. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në pozicionin e monitoruesit të të drejtave të njeriut, si pjesë e shoqërisë civile,

parashtron se norma juridike është e paqartë dhe cenon të drejtat e njeriut. KVJ-ja, në cilësinë e zbatuesit të saj, pohon se nuk e kanë zbatuar asnjëherë atë, megjithëse ligji është në fuqi prej më shumë se 3 vjetësh. Paqartësia në zbatim bëhet edhe më e ndjeshme, në kushtet kur anëtarët e KVJ-së, sipas parashikimeve të ligjit nr. 12/2018, nuk vijnë nga radhët e specialistëve të ligjit dhe mund të kenë vështirësi në identifikimin dhe zbatimin e parimeve ligjore që ndërveprojnë kur norma ligjore ka paqartësi. Së fundmi, edhe Gjykata Kushtetuese, në cilësinë e kontrolluesit të normës ligjore, krijon bindjen se asaj mund t’i jepen më shumë se një kuptim. Bazuar në këtë analizë, ne çmojmë se neni 38, pika 2, i ligjit nr. 12/2018, në pjesën e shprehjes së kundërshtuar, nuk respekton në nivelin e duhur standardin e qartësisë.

12. Në ndryshim nga shumica, ne vlerësojmë se shfuqizimi duhet të shtrihej tek e gjithë shprehja e kundërshtuar “testeve të tjera, edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme,” pasi zbatimi i saj vetëm për mjetet teknologjike nuk e riparoi kuptimin e normës në drejtim të qartësisë. Në parantezë, duhet theksuar se ndalimi i përdorimit të mjeteve teknologjike në përgjithësi dhe për zhvillimin e testeve në veçanti, nuk i përgjigjet situatës aktuale shoqërore, që karakterizohet me zhvillime të vrullshme të teknologjisë dhe përdorimit gjithmonë e më shumë të tyre. Në mendimin tonë, gjithsesi, mjetet teknologjike vetëm kur përdoren në mënyrën e duhur, kanë efekte pozitive. Në këtë këndvështrim, detyra e sistemit juridik është krijimi i rregullave ligjore dhe përcaktimi i standardeve për mënyrën se si duhen përdorur mjetet teknologjike dhe jo ndalimi ose pengimi i tyre.

13. Në vijim të analizës, ne vlerësojmë se problemi kushtetues i normës nuk lidhet në vetvete me përdorimin e mjeteve teknologjike, por me paqartësinë e llojeve të testeve që norma ligjore lejon të zhvillohen ndaj individit. Ashtu siç është arsyetuar gjerësisht, në vendim për këtë çështje, zhvillimi i këtyre testeve është një mjet për mbledhjen e të dhënave individuale të punonjësit të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme që i nënshtrohet procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë dhe të deklarimeve të tij. Për këtë shkak dhe në zbatim të nenit 35, pika 2, të Kushtetutës, i cili parashikon se



mbledhja e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, është e rëndësishme që zhvillimi i këtyre testeve të bëhet me pëlqimin e individit, kusht i cili, në fakt, përcaktohet shprehimisht në përmbajtjen e nenit 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018 dhe duket sikur plotësohet.

14. Në situatën kur kuptimi i normës që parashikon këto teste është i paqartë për llojin e tyre, atëherë ekziston një hapësirë ligjore që krijon mundësi reale që ndaj individit të zhvillohen edhe teste, me metoda dhe teknika, me ose pa mjete teknologjike, të cilat cenojnë lirinë e vullnetit të individit. Zhvillimi i testeve që lejojnë cenimin e vullnetit të individit zhvleftëson pëlqimin paraprak të dhënë prej tij dhe, për pasojë, cenon garancitë kushtetuese të nenit 35 të Kushtetutës dhe gjithashtu, e shndërron individin në objekt, duke cenuar edhe dinjitetin e tij.

15. Për sa më lart, arsyetimin e shumicës për shfuqizimin vetëm të shprehjes “, *edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme,*” e konsiderojmë të sforcuar dhe kontradiktor, pasi në mendimin tonë në shprehjen “*testeve të tjera, edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme,*” theksin kryesor nuk e merr shprehja “, *edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme,*” por fjalët “*testeve të tjera*”, çka nënkupton se shprehja “*edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme,*” është në funksion të “*testeve të tjera*” që mund të kryhen. Sikurse u theksua më lart, shfuqizimi vetëm i përdorimit të mjeteve teknologjike nuk e zgjidh problemin e paqartësisë dhe të arbitraritetit të nenit 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, pasi lejimi i testeve të tjera, përveç testit psikologjik, pavarësisht përdorimit ose jo të mjeteve teknologjike, mbart në vetvete të njëjtën problematikë në drejtim të pasigurisë se cilave teste duhet t’iu nënshtrohen subjektet e ligjit nr. 12/2018. Edhe pyetjet, të cilat iu drejtuan subjekteve të interesuara gjatë seancës plenare dhe për të cilat nuk u arrit të merrej përgjigje prej tyre, ishin pikërisht në drejtim të përcaktimit të “*testeve të tjera*” nëpërmjet mjeteve teknologjike dhe jo në drejtim të individualizimit të mjeteve teknologjike që mund të përdoren.

16. Mbi bazën e këtij arsyetimi, ne, gjyqtaret në pakicë, çmojmë se punonjësit e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme përveç testeve të mirëpërcaktuara nga neni 38 i ligjit nr. 12/2018 (testimi për përdorim

lëndësh narkotike, për varësinë nga alkooli ose nga lojërat e fatit; testi psikologjik i personalitetit), nuk mund t’u nënshtrohen testeve të tjera të painedividualizuara, qoftë edhe me pëlqimin e tyre, për sa kohë ligji, që lejon zhvillimin e këtyre testeve, nuk përmban asnjë klauzolë garancie për ndalimin e cenimit të vullnetit të punonjësit që u nënshtrohet atyre.

17. Si përfundim, vlerësojmë se Gjykata duhet të kishte vendosur shfuqizimin tërësor të shprehjes “*testeve të tjera, edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme,*”, pasi ajo cenon parimin e sigurisë juridike për shkak të paqartësisë së formulimit të saj.

Anëtare: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari

VENDIM

Nr. 104, datë 22.4.2021

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 27, DATË 29.1.2021, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘AGETA’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HEC ‘BORIE – LURË 1’ ME KAPACITET TË INSTALUAR 1800 kw”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 56/1 prot., datë 15.4.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 27, datë 29.1.2021, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Ageta’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Borie – Lurë 1’, me kapacitet të instaluar 1800 kw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 27, datë 29.1.2021, ndër të tjera, ka vendosur:

“1. Të licencojë shoqërinë ‘Ageta’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga



HEC 'Borie – Lurë 1', me kapacitet të instaluar 1800 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria të dokumentojë në ERE, brenda 3-muajve, miratimin/njoftimin nga MIE të shoqërisë 'Ageta' sh.p.k., si përfaqësuese dhe zbatuese në vijim të kontratës nr. 65 rep., nr. 38/1 kol., datë 16.1.2018, 'Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit 'Borie – Lurë 1', me kapacitet prodhues 1800 kw, në rrjedhën e përrenjve të kurores së Lurës, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër, qarku Dibër, pas tërheqjes/largimit të shoqërisë 'Bajrami N.'."

- Në plotësim të kushtit të sipërcituar, shoqëria "Ageta" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 32/5 prot., datë 13.4.2021, ka përcjellë një komunikim të MIE-s (*e-mail* datë 18.11.2020), nga i cili rezulton se kjo e fundit ka njohur shoqërinë "Ageta" sh.p.k. si zbatuese të kontratës nr. 65 rep., nr. 38/1 kol., datë 16.1.2018, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e HEC 'Borie – Lurë 1' me kapacitet prodhues 1.8 mw, në rrjedhën e përrenjve të Kurores së Lurës, degë e Lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër, qarku Dibër".

- Sa më sipër, shoqëria "Ageta" sh.p.k. ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27, datë 29.1.2021 "Mbi licencimin e shoqërisë 'Ageta' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Borie – Lurë 1', me kapacitet të instaluar 1800 kw".

- Me plotësimin e kushtit nga ana e shoqërisë, nuk ka më asnjë dokument i cili duhet t'i nënshtrohet procedurës së rinovimit, si referuar në konstatimet e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 27/2021, për licencimin e shoqërisë "Ageta" sh.p.k. Aktualisht shoqëria rezulton me një dokumentacion të plotësuar tërësisht.

- Neni 113, i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë parashikon mundësinë e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 2 dhe 5, të vendimit nr. 27, datë 29.1.2021, shfuqizohen.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë subjektin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 105, datë 22.4.2021

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "DEVOLL HYDROPOWER" SHA, PËR RINOVIMIN E LICENCËS NR. 343, SERIA F16, PËR FURNIZIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa "ç" dhe nenit 110, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "P"; të nenit 5, pika 1, germa "P"; të nenit 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dhe të nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 47/7, datë 14.4.2021, mbi kërkesën e shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 540 prot., 9.4.2021, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.



- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, për rinovimin e licencës, sipas aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”. Po ashtu ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., në fazën e fillimit të procedurës, në bazë të nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton kryesisht i plotësuar, si më poshtë:

- Delegimi i të drejtave të aplikuesit (neni 7, pika 2, germa “a”). Plotësuar;

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”). Plotësuar;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, “a”, “b”, “c”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte. Plotësuar;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, “a”, “b”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte. Plotësuar;

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike (neni 4.7, germat: “a”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”). Plotësuar.

- Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Neni 7, “Delegimi i të drejtave të aplikuesit”, pika 2:

- germa “b”, vërtetim që përfaqësuesi dhe i përfaqësuar nuk janë të përfshirë në një proces të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata).

Dokumentet juridike, administrative dhe pronësore:

Neni 9, pika 2:

- germa “d” (vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata).

Neni 16, pika 1, germa “c”:

Dokumentet financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3:

- germa “c” (Dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe

struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.).

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike

Neni 9, pika 4.7:

- germa “b” (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj). Duke qenë se sa thënë nga shoqëria, mbetet në kuadrin e deklaratës, në vijim do t’i kërkohej të paraqesë në ERE vërtetim për gjendjen e llogarisë nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj, si dhe kapitalin financiar të shprehur në vlera monetare që do të verë në dispozicion të kësaj veprimtarie.

Shoqëria do të njoftohet, që në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 343, seria F16, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 106, datë 22.4.2021**

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 241, DATË
21.12.2020, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘HEC ZALL XHUXHË’
SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC ‘XHUXHË 1’, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 3487 kw,
DHE HEC ‘XHUXHË 2’, ME KAPACITET
TË INSTALUAR 1254 kw, DHE ME
KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR
4741 kw”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 56/2 prot., datë 19.4.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 241, datë 21.12.2020,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 241, datë 21.12.2020, ka vendosur të licencojë shoqërinë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Zall Xhuxhë 1”, me kapacitet të instaluar 3487 kw, dhe HEC “Zall Xhuxhë 2”, me kapacitet të instaluar 1254 kw, dhe kapacitet total të instaluar 4741 kw, për një afat 27 vjet e 9 muaj, me kushtin që brenda 3 muajve nga marrja e këtij vendimi, shoqëria të depozitojë në ERE:

- i. licencën për drejtuesin teknik e elektrik;
- ii. vërtetimin për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore;

iii. studimin e fizibilitetit.

- ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 451 prot., datë 16.3.2021, duke i rikujtuar detyrimin për plotësimin e kushteve të mësipërme.

- Në përgjigje me shkresën nr. 7 prot., datë 12.4.2021, protokolluar në ERE me nr. 451/1

prot., datë 12.4.2021, shoqëria ka depozituar në ERE licencën e drejtuesit teknik, vërtetimin për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore, si dhe studimin e fizibilitetit.

- Me depozitimin e dokumentacionit të sipërcituar, shoqëria ka plotësuar kushtet e vendosura në pikën 1, gerrat “i”, “ii” dhe “iii”, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241/2020, ndaj këto kushte shfuqizohen, bazuar në përcaktimet e nenit 113, të KPA-së.

- Po ashtu, shoqëria ka depozituar shkresën e protokolluar në ERE me nr. 451/2 prot., me anë të së cilës ka deklaruar se dokumentacioni është dërguar me vonesë nga ana e saj, për shkak të infektimit të stafit administrativ të shoqërisë me *COVID-19*, çka ka sjellë pamundësinë e shoqërisë për të plotësuar dokumentacionin e kërkuar brenda afatit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 241, datë 21.12.2020, pika 1 ishte:

“1. Të licencojë shoqërinë “HEC ZALL XHUXHË” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Zall Xhuxhë 1”, me kapacitet të instaluar 3487 kw, dhe HEC “Zall Xhuxhë 2”, me kapacitet të instaluar 1254 kw, dhe kapacitet total të instaluar 4741 kw, për një afat 27 vjet e 9 muaj, me kushtin që brenda 3 muajve nga marrja e këtij vendimi të depozitojë në ERE:

- i. licencën për drejtuesin teknik e elektrik;
- ii. vërtetimin për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore;
- iii. studimin e fizibilitetit.”.

Bëhet:

“1. Të licencojë shoqërinë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Zall Xhuxhë 1”, me kapacitet të instaluar 3487 kw, dhe HEC “Zall Xhuxhë 2”, me kapacitet të instaluar 1254 kw, dhe kapacitet total të instaluar 4741 kw, për një afat 27 vjet e 9 muaj.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkolet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 107, datë 22.4.2021

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 242, DATË
21.12.2020, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘HEC ZALL XHUXHË’
SHPK NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 92, pikat 1 dhe 2, si dhe të nenit 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 22.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 56/2 prot., datë 19.4.2021, të për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 21.12.2020,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 242, datë 21.12.2020, ka vendosur të licencojë shoqërinë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, me kushtin që shoqëria të depozitojë, brenda 3 muajve nga marrja e këtij vendimi:

i. vërtetimin për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore;

ii. dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura

e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, etj.);

iii. sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për t’u tregtuar në gWh, për pesë vitet e licencës së tregtimit të energjisë elektrike;

iv. kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

- Ky vendim i është njoftuar shoqërisë me shkresën e ERE-s nr. 1165/3 prot., datë 24.12.2020, tërhequr dorazi nga përfaqësuesi i shoqërisë në datën 27.12.2020.

- Duke qenë se në përmbushje të afatit të përcaktuar në vendimin nr. 242/2020, shoqëria nuk kishte depozituar në ERE dokumentacionin përkatës, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 451 prot., datë 16.3.2021, duke i rikujtuar detyrimin për plotësimin e kushteve të mësipërme.

- Në përgjigje, me shkresën nr. 7 prot., datë 12.4.2021, protokolluar në ERE me nr. 451/1 prot., datë 12.4.2021, shoqëria ka depozituar në ERE vërtetimin për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore. Me depozitimin e këtij dokumenti, shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 1, germa “i”, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 242/2020, ndaj ky kusht shfuqizohet, bazuar në përcaktimet e nenit 113, të KPA-së.

- Po ashtu, shoqëria ka depozituar shkresën e protokolluar në ERE me nr. 451/2 prot., me anë të së cilës ka deklaruar se dokumentacioni është dërguar me vonesë nga ana e saj, për shkak të infektimit të stafit administrativ të shoqërisë me COVID-19, çka ka sjellë pamundësinë e shoqërisë për të plotësuar dokumentacionin e kërkuar brenda afatit, si dhe ka kërkuar mirëkuptimin e ERE-s për të shtyrë me 30 ditë afatin e plotësimit të dokumentacionit të përcaktuar në kushtet e vendimit nr. 242/2020, që lidhen me veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Duke marrë në konsideratë vullnetin e shoqërisë, për të plotësuar një pjesë të dokumentacionit, për të përmbushur kushtet përkatëse të vendosura në vendimin e licencimit, vlerësohet se duhet marrë parasysh kërkesa e saj për të shtyrë afatin për plotësimin e kushteve të vendimit nr. 242/2020. Duke qenë se nga data 27.3.2021, si afati i fundit për të depozituar dokumentacionin përkatës nga shoqëria, ka kaluar pothuajse një muaj, vlerësohet që afati për



plotësimin e kushteve të vendimit nr. 242/2020, të zgjatet me 60 ditë, duke filluar ky afat nga data 28.3.2021, duke përfshirë në këtë mënyrë dhe afatin e kaluar tashmë dhe për t'i dhënë mundësinë shoqërisë që të plotësojë kushtet e vendimit 242/2020.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 242, datë 21.12.2020, pika 1: Ishte:

“1. Të licencojë shoqërinë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, me kushtin që shoqëria të depozitojë brenda 3 muajve nga marrja e këtij vendimi:

i. vërtetimin për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore;

ii. dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.);

iii. sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për t'u tregtuar në gWh, për pesë vitet e licencës së tregtimit të energjisë elektrike;

iv. kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.”.

Bëhet:

“1. Të licencojë shoqërinë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, me kushtin që shoqëria të depozitojë brenda 60 ditëve, duke filluar ky afat nga data 28.3.2021:

i. dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.);

ii. sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për t'u tregtuar në gWh/për pesë vitet e licencës së tregtimit të energjisë elektrike;

iii. kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 108, datë 22.4.2021

MBI MIRATIMIN E “RREGULLAVE TË PËRBASHKËTA TË SHLYERJES PËR SHKËMBIMIN E ENERGJISË, NË PËRPTHJE ME NENET 50 (3) DHE 51 (1), TË KOMISIONIT RREGULLATOR TË BASHKIMIT EVROPIAN 2017/2195”

Në mbështetje të neneve 16, 20 dhe 55, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të neneve 15 e 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 56/5 prot., datë 20.4.2021 të Drejtorive Teknike, “Mbi miratimin e Rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë, në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 77, datë 19.3.2021, ka vendosur fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), për miratimin e “Rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë, në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me shkresën nr. 494 prot., datë 31.3.2021, të ERE-s, vendimi sipërcituar, i është përcjellë Ministrisë së



Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe shoqërisë OST sh.a.:

- Dokumentacioni shoqërues i “Rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë, në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”, është publikuar në faqen zyrtare të ERE (www.ere.gov.al), që nga data 1 mars 2021, në rubrikën “Konsultime”, me qëllim që çdo palë e interesuar të mund të konsultohet dhe të shprehë qëndrimin në ERE, në lidhje me përmbajtjen e këtij akti, brenda afateve të parashikuara në ligjin nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, në lidhje me sa propozuar nga OST sh.a.

- Lidhur me “Rregullat të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë, në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”, nuk janë paraqitur komente ose opinione.

- “Rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë, në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”, të datës 23 nëntor 2017, përbëhen nga:

I. Të gjitha propozimet e TSO-ve Kontinentale Evropiane, për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta për të gjitha shkëmbimet e energjisë të paqëllimshme, në përputhje me nenin 51 (1), të rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike.

Ky dokument është një propozim i përbashkët i zhvilluar nga të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmetimit në Zonën Sinkronike të Evropës Kontinentale, në lidhje me zhvillimin e rregullave të përbashkëta të shlyerjes për të gjitha shkëmbimet e energjisë të paqëllimshme, në përputhje me nenin 51 (1), të rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike.

II. Të gjitha propozimet e TSO-ve Kontinentale Evropiane, për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencave dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje), në përputhje me nenin 50 (3), të rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike.

Ky dokument gjithashtu është një propozim i përbashkët i zhvilluar nga të gjithë Operatorët e

Sistemit të Transmetimit në Zonën Sinkronike të Evropës Kontinentale, në lidhje me zhvillimin e rregullave të përbashkëta të shlyerjes, për të gjitha shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje), në përputhje me nenin 50 (3), të rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike. Ky mekanizëm do të përdoret si një mekanizëm i përbashkët i shlyerjes së devijimeve për Evropën Kontinentale, për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje).

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 55, pika 3, përcakton se: “Operatori i Sistemit të Transmetimit shkëmben ose ndan shërbimet e balancimit me operatorët e sistemit të transmetimit të shteteve fqinje, për rregullimin e frekuencës brenda rrjetit, në përputhje me marrëveshjet operationale ndërmjet operatorëve të sistemit të transmetimit të rajonit dhe parashikimeve të këtij ligji për promovimin e bashkëpunimit rajonal”.

- Duke marrë në konsideratë detyrimet që OST sh.a. ka si palë e ENTSO-E, si dhe faktin që ky mekanizëm i propozuar është një mekanizëm që është dakordësuar nga gjithë OST-të në Evropën Kontinentale, anëtarë të ENTSO-E, për rrjedhojë nuk mund të ndryshojë pasi është mekanizëm i përbashkët që afekton gjithë OST-të anëtare të ENTSO-E.

- Rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë, në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195, priten të aplikohen nga OST-të e Evropës Kontinentale, anëtare të ENTSO-E, që nga data 1 qershor 2021.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë, në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51

(1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195, të përbërë nga:

I. Të gjitha propozimet e TSO-ve Kontinentale Evropiane për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta,



për të gjitha shkëmbimet e energjisë të paqëllimshme, në përputhje me nenin 51 (1), të rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike (bashkëlidhur këtij vendimi).

II. Të gjitha propozimet e TSO-ve Kontinentale Evropiane për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta, për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencave dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje), në përputhje me nenin 50 (3), të rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike (bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Kostot e krijuara si rezultat i devijimeve nga vlerat nominale do t'i faturohen palëve përgjegjëse për balancimin, në përputhje me Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020.

3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë OST sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 109, datë 22.4.2021

MBI KËRKESËN E OSSH SHA, LIDHUR
ME VENDIMIN E ERE-s NR. 60,
DATË 25.2.2021

Në mbështetje të nenit 20, germa “ë”, nenit 81, pika 3, germa “ç”, nenit 94, pika 2, germa “b” dhe “ë”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 16, pika 16, nenit 20, nenit 17, pika 1, germa “ë”, nenit 96, pika 11, nenit 98, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të neneve

42, 54 dhe 55, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të neneve 15 dhe 26, të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”; “Rregulloren mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë”, miratuar me vendimin nr. 162, datë 20.10.2020, të Bordit të ERE-s; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 22.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 56/4 prot., datë 20.4.2021, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi kërkesën e OSSH sh.a., lidhur me vendimin e ERE-s nr. 60, datë 25.2.2021”,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 218, datë 15.12.2020, Bordi i ERE-s ka filluar procedurën për miratimin e “Standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror, nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit”.

- Përmes shkresës nr. 1315 prot., datë 30.12.2020, ERE ka kërkuar nga palët e interesit: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Furnizuesi i Shërbimit Universal, Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike, Autoriteti i Konkurrencës, Ministria e Mirëqenies Sociale, Ministria për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Avokati i Popullit, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë, Shoqata e Konsumatorit, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, të shprehin opinionet dhe komentet e tyre mbi draft-Rregulloren, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni.

- Rregullorja për të cilën Bordi i ERE-s ka filluar procedurën është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ERE-s: www.ere.gov.al, në zërin “Konsultime”, si dhe bërë me dije në regjistrin e vendimeve të ERE-s për vitin 2020, publikuar në zërin “Vendime”. Vendimi nr. 218/2020 është publikuar gjithashtu në Fletoren Zyrtare nr. 3, datë 8.1.2021.

- OSSH sh.a., me shkresën nr. 2617/1 prot., datë 23.3.2021, protokolluar në ERE me nr. 435/1, datë 23.3.2021, ka paraqitur kërkesën për ushtrimin e së drejtës për t'u shprehur në cilësinë e palës së interesuar, lidhur me këto standarde, si dhe rishikimin e tyre nëse do të rezultojë e nevojshme,



duke konstatuar gjithashtu se si afektohet nga ky akt rregullator.

- Neni 54, pika 1, e Kodit të Procedurave Administrative parashikon se: “...pala mund të kërkojë rivendosjen në afat, nëse është penguar për shkaqe të arsyeshme për respektimin e afatit procedural, me përjashtim të rasteve kur afatet kanë karakter prekluziv”, ndërkohë që neni 55, pika 2, parashikon se: “depozitimi i kërkesës shkakton pezullimin e të gjitha veprimeve procedurale të kryera si pasojë e humbjes së afatit”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës për rivendosjen në afat të shoqërisë OSSH sh.a., për përcjelljen e mendimeve apo objeksioneve në lidhje me “Rregulloren e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit”.

2. Pezullimin e zbatimit të afateve të parashikuara në vendimin e ERE-s nr. 60/2021, “Mbi miratimin e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit”, për shoqërinë OSSH sh.a., për një periudhë 45-ditore nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Shoqëria OSSH sh.a. të përcjellë në ERE qëndrimin apo propozimet e saj për ndryshime në “Rregulloren e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit”, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

4. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve të njoftojë shoqërinë OSSH sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

KËRKESË

Shtetasi David Horjeti, lindur dhe banues në Tiranë, dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkojnë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë shpalljen të zhdukur të shtetasit Mentor Horjeti, lindur më datë 13.12.1961 në Tiranë, si dhe caktimin si kujdestar të përhershëm të pasurisë së tij kërkuesin David Horjeti.

KËRKUES
David Horjeti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 512 lekë